

E

BIBLIOTEKA

SHTETIT

GJIROKASTER



Tregime
të zgjedhura

Koço
Kosta

1938
BIBLIO
MUSEUM

DJALOSHI QË DONTE KUAJT

I

1

Ajo ishte një shtëpi e madhe e vjetër. Ngrihej në anë të fshatit. Kopshtin nga e djathta e kishte të mbjellë me thekër. Thekra ishte ngritur e harlisur dhe kishte nisur të kthente krye. Në oborrin e shtëpisë, nën stivën e lartë të druve, gugiste një derrkuc në misurin e drunjtë. Disa pula cëmbonin derrkucin nëpër turinjtë e ngjyer në lëtyra. Ngjitur me shtëpinë, në një kasolle të ulët mbuluar me llamarinë, ngrihej tym.

Ai që doli papritur nga thekra, ndjeu erë buke të ngrohtë dhe ndali një çast. Pastaj ndjeu të troshitëshin enë kuzhine. Pas tij doli një tjetër. Ata dolën befas nga barku i gjelbër i arës me thekër dhe vërenin për-qark, sikur posa ishin zgjuar nga një gjumë somnambulik. Shikuan njëri-tjetrin në sy dhe u tërhoqën përsëri në arën me thekër. Pas një çasti në kasollen e ulët mbuluar me llamarinë ra një guriçkë. Edhe një guriçkë tjetër. Nga brenda thirri zë gruaje, po askush nuk

doli jashtë. Atëherë nga thekra rrahën përsëri gurë dhe pas ca, nga një copë deriçkë e vjetër dhe e nxirë, doli një grua. Ajo doli duke shikuar përçark, duke fshirë duart me përparësen e zezë.

Atë çast nga thekra u ngrit e doli njeriu i parë. Pas tij doli edhe tjetri. Njëri iu afrua nënës. Tjetri vërente përçark.

Ata hynë në kasollen me llamarinë. Nëna i njohu dhe ai trazim që iu ngre në fillim, nisi t'i shkrihej. Ajo u ngrit që t'u jepte të hanin, po ata ngulën këmbë të nxitonin. Njëri nga të ardhurit e ndjeu se nëna pshe-rëtiu thellë, ndaj iu qas, i vuri dorën në shpatullat e lodhura dhe i mori kryet në gjoks.

— Eh, moj nënë, — tha ai.

Ajo heshti një hop me kryet te gjoksi i tij, që vinte erë djersë.

— Lart është? — pyeti njëri.

— Po fle, — tha ajo, pa e shikuar atë në sy.

Ajo doli. Ata ndenjën atje. U shponte hundët buka e ngrohtë e porsadalë. Avulli i bukës i përkundi në mendime.

— Luftë! — tha njëri.

— Luftë! — tha edhe tjetri, pa e shikuar shokun në sy.

Nëna hyri në katua. Në katua kishte pak dritë. Ajo hynte nga një dritare e vogël atje në fund. Një copë herë u soll rrotull në katua. Mandej shkoi e ndenji një çast atje te këndi i errët. Binte erë bajgë e kakërdhi. Asaj iu drodh diçka përbrenda. Aty nëpër errësirë iu përhinë fytyrat e të dy djemve që kishte partizanë. Njëri ishte komandant batalioni diku larg. Pastaj iu përhi edhe fytyra e njomë e Bastriut. Ai ishte ende i vogël. Flinte tani atje lart në dhomë. Tërë natën ishte pa gjumë dhe ditën kishte mbledhur bar. Po lufta kërkonte edhe Bastriun. Ashtu kishte përcjellë të parin ajo nënë, ashtu kishte përcjellë të dytin, ashtu po përcillte edhe këtë Bastriun e vogël. A do të kthehej ai nesër?

Nënës i shkanë lot. Ajo e dinte se në kasollen me llamarinë prisnin dy partizanë, që i kishte marrë uria, që ecnin natë e ditë, që kishin lënë nënat e shtëpitë, që kishin dalë të luftonin. Në krye të herës edhe këtë nënë e kishte truar ajo ndjenja e ngushtë e amësisë për të bijtë, po pak nga pak ajo po mësohej me luftën dhe kishte filluar prej kohësh ta ndiente veten në anën e djemve. Ajo e dinte ç'do të thosh ta ndihmoje luftën. Me gjithçka, me gjithçka...

Fshiu lotët me cepin e shamisë dhe ngjiti shkallët. I biri ishte shtrirë pëmbys në anë të dhomës. Ishte shtrirë mbi një velenxë të kuqe të hapur dhe merrte frymë thellë. Ajo iu qas pranë dhe nisi t'i fshinte djersët. O, ç'pamje të paqme e të mjerë që kish djali i saj në ato çaste!

Ajo i ngriti fundrat e pantallonit dhe i fërkoi pulpët e mbushura e të bardha. Dora e reshkur e nënës i kaloi nëpër shpatullat ende të papjekura dhe i fërkoi qafën. Ajo e fërkoi një copë herë, pastaj e puthi. E puthi në qafë, në faqe, në pulpët. Puthte të birin. Në ato çaste te mishrat e djalit të vogël qaseshin ato dy fytyrat e djemve partizanë dhe ajo i puthte e i puthte edhe ata. Të tre.

Nëna u shkund nga tundimi dhe thirri:

— Bastri, ngrehu, ngrehu!

Djali u shtriq disa herë, pastaj u kthye nga nëna dhe, duke kulluar një buzëqeshje të ëmbël, e si të larë në agun e mëngjesit, i tha:

— Pse më zgjove?

— Boll fjete, fëmijë je? — ia priti ajo.

Me atë ndjenjë të pastër e të gëzuar, që i buronte natyrshëm, ai bellbëzoi:

— Pse, i madh jam?

Dhe qeshi.

Ajo i tha se kishin ardhur partizanë. Ata thoshnin se Bastriu duhej të udhëtonte për në mal. Nesër nga dreka të ishte atje.

Djalit iu rrit balli dhe ra në mendime.

— Po ku? — tha ai.

— Të thonë ata.

— Partizanë, the?

— E.

Ai u çua dhe u vesh. Poshtë në kasolle u takua me dy partizanët.

— Ulu aty, — i tha njëri.

Ai u ul dhe nuk dinte ku të shikonte, nuk dinte as ku t'i mbante duart.

— Nënë, na vërë një çikë bukë në trastë, — tha tjetri dhe hodhi në truall një trastë.

Ata iu afruan Bastriut.

— Sa vjeç je? — i tha njëri, ai që kishte flokët të kuq.

— Trembëdhjetë.

— Ne kujtuam se ishe dhjetë. Mirë. Dëgjo këtu! Do të ngarkojmë pelën. Do të ngarkojmë miell. Kështu do të thuash ti. «Miell». Do ta ngarkojmë mirë. Ti do ta nxjerrësh pelën nga fshati dhe do ta vësh në Udhën e Malit. Kupton? Ke qenë ndonjëherë në stanë, në Vukle? Një herë? I mban mend mirë? Ti do të nxjerrësh pelën tej fshatit, te shkalla dhe pastaj vure në udhë se e ndjek vetë rrugën pela. Kupton? Nuk ngatërrohet pela. Do të ecësh. Dhe në pelë ke «miell», ë? «Ku shkon?, do të thonë. «Në stan», mirë? Ja, kështu. Do ecësh. Kështu është puna. Duhet të mendosh si partizan. Po t'u prenë gjunjët e lodhesh, ndalu në ndonjë vend. Pelës do t'ia heqim zilen. Do të ndalesh, po nuk do ta shkarkosh. Mirë? Nuk do ta shkarkosh. Ti çlodhu, duke e mbajtur nga kapistra. Mirë? Pela juaj është e mirë, «është nishan», — tha Aliu, — Edhe po u ndale, nesër nga dreka arrin. Mirë? E bën? Si thua? Po, po, e bën ti. Duhet bërë. Ti je goxha djalë. Deri në të dalë të fshatit do të përcjellim ne. Po ne do të rrimë fshehur. Mirë? Ashtu de. Tani ha bukë. Miellin do t'ia sjellësh prapë nënës...

Ata të dy u ngritën. Nëna doli jashtë. Ata hynë në

thekër e diç sollën andej. Shkuan disa herë në thekër dhe disa herë diç sollën.

— Material lufte, — thanë ata. — Ti, nënë, na trego thasët me miell dhe sill pelën.

Ata mbushën njërin thes, pastaj mbushën thesin tjetër. Si kishin shtirë brenda materialin e luftës, hodhën miell dhe thasët u mbushën mirë. Po ata kërkuan thasë të tjerë dhe i bënë më dysh që të mos shqepeshin. Nëna i solli Bastriut edhe një gjilpërë e pe që ti kishte për rrugës. Pastaj ngarkuan pelën, i hoqën asaj zilen dhe morën trastën me bukë e humbën prapa kasolles, në thekrën e papjekur ende.

2

Pela ecte përpara dhe ai pas. Ngjitnin një të përpjetë kodre. Nën këmbët e tyre shkërmoqeshin gurët e udhës. Prapa kishin lënë lumin, atë zhaurimë të fshehur midis detit të errët të rrapeve dhe shelgjeve, që zgjateshin në të dy brigjet dhe kridheshin në shkru mbnin e zi. Kishte rënë drita e mugët e yjeve. Afshi i lumit ngjitte që poshtë erërat e gjetheve të shelgut dhe miellin e rrapeve. Heshtnin. Edhe pela, edhe djaloshi. Ai ndjeu klithmën e vajtueshme të bufit dhe iu kujtua rasa e zezë e priftit. Ai e kishte takuar priftin atë kohë që merrte kthesën te çezma. Prifti i ishte qasur, e kishte pyetur me zërin e unjët e të përvuajtur për barrën e pelës dhe lehtë-lehtë, si një hije e zezë, ishte larguar. Atij i bubulliti në vesh angullima e kaltër e kambanës së kishës, që ngrihej çdo mbrëmje si një pirg i dridhur dhe mendoi një çast se kur vallë kish rënë kambana sonte. Pastaj iu kujtua ajo ditë kur kishte vdekur hoxha. Në fshatin e tyre kishte pasur edhe hoxhë. Nuk i hieq nga sytë ajo siluetë e përkulur paksa përpara e priftit dhe ndjeu përbrenda një drithmë që e bëri t'i regëtinte gjoksi. Kjo endoqi nga pas dhe djaloshi iu qas më afër pelës, i foli ulët, shu-

më ulët dhe u kap pas bishtit të saj. Pela ecte gjithmonë me të njëjtin çap. Papritur Bastriut iu duk sikur dëgjoi rrahjen ritmike të ziles së pelës. Po rrahje ritmike të ziles së pelës nuk kishte, se ai ia kishte hequr zilen pelës. U mundua të largonte tërë këto dhe të mendonte vetëm për stanin. Aty afër rrëshqiti fëshfërima e lakuriqit të natës dhe Bastriu nuk e lëshoi bishtin e pelës. Ai shikoi qiellin. Dhe dalloi Yllin e Çobanit, që ishte ndezur e shpërndante butë-butë zjarrin e vet të gjelbër mbi pllajrat e mbi kodrat. Ai pa shumë yje, pa edhe hënën, që shtyhej nga duar të padukshme. Ajo e kishte kthyer kupën e saj dhe kishte derdhur mbi natën e kaltër tërë atë lyrë të bardhë.

Ai i foli përsëri pelës dhe ngau çapat. Pela ecte me këmbët e saj të gjata e të holla duke tundur kokën me krifën e zezë. Atij iu sollën përsëri në mend rrahjet ritmike të ziles së pelës në gjoksin e saj në këtë të përpjetë. Po ata bënë mirë që i thanë t'ia hiqte zilen, se Bastriu dhe pela po udhëtonin atë natë me një detyrë të vështirë. Atij iu kujtuan partizanët dhe nisi të numëronte sa veta kishin dalë partizanë nga fshati i tyre. Iu kujtua se njëri nga djemtë e fshatit ishte vrarë në luftë, dhe befas i shkrepri në mendje se edhe ai mund të dilte partizan. Ai nisi të mendonte për pushkët dhe për partizanët. Pastaj nisi të mendonte për gjermanët. Ata ishin të egër e të gjatë. Ai i kishte parë kur kishin kaluar njëherë në fshatin e tyre, atje tej oborrit, sipër atij muri që shihte nga larg, me helmë, me gjoksin e nxjerrë, me automatikun në qafë dhe me këmbë të gjata. Atë kohë një plakë nga fshati, kishte vënë kujën, po asnjë nga ata nuk e kishte kthyer kryet. Mandej djaloshi, me flokë ngjyrë thekre që i rrëzoheshin në ballin e përhedhur, mendoi për luftën. Iu duk sikur ai gjermani me helmëtë, me gjoksin para, me automatikun në qafë dhe me këmbët e gjata të hapura atje, përmbi murin që ndodhej kundruall shtëpisë, bëri një lëvizje energjike dhe me fytyrë të shëmtuar u kthye nga nëna e tij. Nëna po vinte rrotull në

oborr dhe atë kohë po mbushte misurin e derrit. Ai drejtoi automatikun dhe qëlloi nënën e tij.

Bastriut iu ngroh gjaku dhe ai mendoi se vetëm po të urreje, mund të luftoje. Ai urrente.

Ende nuk e kishin ngjitur atë të përpjetë. Pela kishte ndalur dhe merrte frymë duke shfryrë flegrat. Edhe ai ndaloi dhe nisi të merrte frymë me zor. Vinte erë e freskët. E shtynte nata.

Një çast, dhe ai i foli pelës. Ajo ktheu përgjysmë kryet nga Bastriu, e pa një kohë ashtu me ata sytë e saj prej kafshe nëpër dritën e yjeve dhe të hënës dhe nisi çapitjen. Ç'mendon pela tani, tha ai. A mendojnë kuajt?

Atij iu duk sikur pela e tij mendonte, sikur edhe ajo e dinte se ç'mbante mbi shpinë dhe e dinte pse do ta çonin atje. Bile edhe asaj i përhihej rrugës rase e priftit me shpinën paksa të përkulur para, që çapitej lehtë-lehtë nëpër rrugën e kishës.

Ai e donte shumë pelën e tij; i donte kuajt dhe kishte ndaj tyre një ndjenjë të mirë. Edhe pela e donte shumë atë. Ai dhe pela kuptoheshin shumë mirë. Kur ndodheshin sadopak larg, ata malloheshin shumë për njëri-tjetrin. Po të qëllonte një ditë që ai të mos ishte në shtëpi, pela hingëllinte dhe nëna e kuptonte pse hingëllinte ajo. Kishte vite që flinte natë e ditë me pelën. Shumë vite. Ledhave e livadheve, buzë ujërave e buzë kories, nëpër netët e ndezura e nëpër hije, mëngjeseve të lagura dhe erërave e borërave. Atij i gumëzhinte ai gjaku i tij i njomë, në të cilin ishin kredhur zëra dhe hingëllima, çuçurimat e shpezëve të pyllit dhe thirrje të kojrrillave, tërë harlisje dhe erërat e barërave. Shumë vite. Binte mbrëmja dhe ai hidhte velenxën e kuqe në samarin e pelës. Pastaj i hipte dhe dilte poshtë nga livadhet. Atij i kujtoheshin ato çaste, kur kulloste pelën gjer ndaj të gdhirë. Mandej e dremiste gjumi mu në mes të livadhit. Kur zgjohej në mëngjes, pela i rrinte atje pranë, duke turfulluar e duke tundur veshët.

Ai ishte mbledhur në velenxë dhe ngjante si një njo-llë e ndezur në livadh. Ai dëshirote një mëz nga pe-
la. Sivjet do ta ruante pelën që të bënte një mëz.
Ai i donte shumë kuajt.

Mendoj një copë rrugë për mëzin. Pastaj tha: Po,
unë do të shkoj partizan!

Këtë e tha pothuaj me zë të lartë. Ndoqi çapit-
jen dhe i foli vetes me zërin e heshtur: Unë do të dal
partizan!

Kishin kaluar edhe një pllajë dhe po ngjitnin një
kodër.

Pela ecte dhe hera-herës ndalonte. Turfullonte e
kthente kryet, duke shikuar heshturazi Bastriun. Ai
e kuptonte ç'kërkonte ajo. Edhe ai ishte lodhur. I
therrin këmbët, i dhembnin kyçet.

E arritën edhe kreun e asaj kodre. Përpara shtri-
hej një pllajë e gjerë. Atij i kujtohej përhumbar rru-
ga për në stan. Ai kishte kaluar dikur në atë rrugë,
po ishte tepër i vogël atëherë.

Atëherë s'mund të dilte as partizan. Se ishte i
vogël!

Po ai i besonte intuitës së pelës, kujtesës së asaj
kafshe të mirë.

Pela ndali përsëri. Dhe përsëri ktheu kryet e gja-
të të heshtur.

Kaloi shumë që s'ke ngrënë, mendoj ai. Tashti do
të ishte në livadhe.

I foli edhe një herë dhe mendoj që diku të ndalte.
E ndiente se edhe vetë s'mund të bënte më tej. Edhe
rrezikun duhej ta kishte kaluar dhe ndoshta s'mbe-
tej shumë rrugë për të bërë. Ai i shtiu pëllëmbën e
njomë tej vitheve nën samar dhe pëllëmba iu lag. I
erdhi ligisht për pelën. I sëmboi në zemër. Ajo që lo-
dhur dhe nga lodhja kishte djersitur.

Më tej gjeti një shesh të shtruar. Aty ndali pela.
Aty ndali dhe ai. Të dy ishin të lodhur e të drobitur.
Ai hoqi trastën. Brenda në futë nëna kishte mbësh-
tjellë bukë. Ai e hoqi bukën dhe e rrsi në trastë. Fu-

tën e mbështolli në pëllëmbë dhe me të filloi të fshinte djersët e pelës, që i kullonin nën samar. Ajo filloi t'i merrte erë djaloshit, sikur i merrte erë mëzit të vet. Pastaj nisi të hingëllinte me një hingëllimë të heshtur si të qe penguar nëpër rudina. Djaloshi e ndjeu se ajo gurgullonte kështu kënaqësinë dhe dashurinë e madhe.

I hoqi kapistrën dhe ia hodhi në samar. Ai duhej të mendonte si partizan, andaj do të vepronte ashtu.

Pllaja ishte e ngjeshur në bar të njomë. Bari ngrihej deri në gju. Ai nuk hëngri bukë. Pela nisi të rrëmbente bar. Ai u shtri poshtë barkut të pelës. Ishte i lodhur, po nuk e rrëmbeu gjumi menjëherë. Kur kolle, druhej mos shqetësonte errësirën e kaltër, lyer me ngjyrën e bardhë të hënës dhe shpuar nga rrëketë e kuqe që kullonin yjet. Përçark, aty-këtu, në pllajë dukeshin ishuj me gëmusha të errëta. Frynte erë. Erë mali përzier me kundërmime lulesh. Atë e goditnin shumë mendime në kokë. Ndërsa pela këpuste bar. Ajo qëmtonte barin përpara, majtas, djathtas, mandej nuk bënte asnjë çap. Nën të ishte djaloshi. Ai po shihte ëndrra me pushkë, me partizanë. Po shihte në ëndërr edhe atë priftin e zi.

Kur nuk arrinte më tej dhe s'kishte më ç'të qëmtonte, atëherë mushka ngrinte kryet dhe me njërën nga këmbët e para i binte lehtë djaloshit. Ai zgjohej dhe ngrihej e ikte më tej. Përsëri nën barkun e pelës. Ajo rrëmbente bar përçark, dhe ai mbyllte sytë e dremiste. Atje duhej të flinte ai, atje midis katër këmbëve të pelës. Që të ishte i sigurt, që të ishën pranë njëri-tjetrit, për çdo të mirë, për çdo të keqe.

Djaloshi flinte një gjumë të trazuar e të shqetësuar. Hera-herës ëndërronte duke pëshpëritur në gjumë. Edhe pela i rrëmbente e i përtypte ëndrrat e tij të njoma e të qashtra, me barin e njomë e tërë lëng e tërë erëra mali.

Çdo zhurmë e lehtë apo çdo klithmë që ndihej papritur përçark, e shqetësonte pelën, dhe ajo ngrinte

kryet, ngrinte veshët e një çast ndalte në përgjim. Pastaj niste përsëri kullotjen. Përsëri e çukiste djaloshin me këmbën e parë, të hollë. Dhe djaloshi ngrihej e shkonin më tej. Po në shtrorjen e njomë të barit, po nën barkun e pelës.

Hera-herës pela i afronte buzët e ngrohta, mandej mblaçitej, duke lëvizur nofullat nga një anë në tjetrën. Përtypte barin e lagur me vesë dhe thithte erërat e freskëta, duke fryrë flegrat e hundës.

Ende s'kishte kaltëruar agimi. Yjet po veniteshin dalëngadalë, po kridheshin nëpër qiellin që ngrihej dhe shkriheshin.

Pela u nginj, andaj kishte ngritur kryet dhe kundronte përreth, pastaj kishte nisur e përplaste këmbën nën kryet e djaloshit.

Ai po shifte në ëndërr priftin ato çaste. U zgjua dhe belbëzoi:

— Ritë, do nisemi? Mirë, mirë.

U ngrit nga gjumi në atë kohë madhore të heshtjes që ndodhet para agimit, por që pas pak gremiset papritur nën shqetësimin e parë që lëshojnë grumbujt e gëmushave.

Ai i hoqi kapistrën nga samari dhe Rita pështeti kryet e gjatë në supin e tij, që djaloshi t'i vinte kapistrën.

Pastaj u nisën. Atje i prisnin partizanët. Ajri rreth e qark ishte mbushur me vezullime lagështie.

Kishte nisur të pikonte vesa nga lulet e malit.

II

1

Ishte mëngjes i freskët si i larë nga ujëra burimesh. Ai zbriste tragës së malit dhe gjoksi i mbushej me erë çaji e erë kulumbrie. Pela i shkonte nga pas. Ai nuk i kishte hipur pelës, se ishte tatëpjetë. E rrihnin filladët e mëngjesit dhe atij i dukej vetja më i rritur e



më i arrirë. Prapa kishte lënë dy kasolle stani dhe ata katër partizanë.

Tre prej tyre i gjeti buzë rrugës së malit. Ata kishin dalë më parë atje dhe e prisnin. Kur Bastriu me pelën u ngjit pranë tyre, ata u ngritën dhe i thanë: «Vdekje fashizmit!». Djaloshit iu drodh diçka. Pëla ndaloi dhe ktheu kryet pas nga ai. Pastaj ata u çapitën dhe iu afruan edhe më. Atë kohë djaloshi thirri: «Liri popullit!». Po atij sikur iu drodh buza, sikur belbëzoi. Mëgjithatë ata tre partizanët nuk u tallën me të. Ata nderuan përsëri me grusht dhe u përçafuan me Bastriun, sikur u përçafuan me një shokun e tyre.

— U lodhe, — tha njëri prej tyre dhe i lëshoi pëllëmbën e hapur në shpatulla.

Bastriu nuk mbante mend në i foli gjë me gojë. Ai përsëri u hutua dhe bëri çudi se si ata u sollën me të si me një të rritur, si me shokun e tyre. Ata kishin pushkë dhe kapelë me yll të kuq. Njëri nuk kishte pushkë dhe kapelë. Ai kishte një xhakëtë ushtarake me shirit të kuq.

— Ecte pela? — pyeti ai që kishte xhakëtën ushtarake me shirit të kuq.

— Ecte, — tha Bastriu.

— Kafshë e mirë, — tha ai dhe i ra në vithe sikur e gëzoi.

Pastaj ata e pyetën për fshatin dhe për nënën. Ata i thanë se punët shkonin mirë dhe se ca shokë të tyre, një natë më parë, kishin çarmatosur një postë të armikut. Atje kishin kapur shumë pushkë dhe materiale të tjera lufte.

Bastriu i dëgjonte dhe heshte. Ai çuditej. Pastaj ata e pyetën se sa shtëpi kishte fshati i tij dhe se ku i bënë mbledhjet të rinjtë.

Kur arritën te sheshi para kasolles së stanit, pëla ndali dhe turfulloi. Nga kasollja doli një njeri. Edhe ai nderoi si shokët dhe e pyeti për nënën e tij dhe për Lëvizjen në fshat e në krahinë. Ata flisnin për këto gjëra duke shkarkuar thasët. Flisin thjesht, si për gjë-

rat që ndodhnin përçark, siç flisin me nënën atje në fshat. Ata shkarkuan fishekët e mitralozit dhe të automatikëve. I thanë pastaj se në fshat ai do të mbante lidhje me shokë të tyre. Ata i thanë se do t'i jepnin edhe një letër dhe këtë letër, që do ta fshihnin diku në samarin e pelës, do ta merrnin tek ai shokët.

Bastriut me flokët e shpupuritur iu drodhën qerpi-kët dhe papritur tha:

— Po unë dua të dal partizan! — Dhe i shikoi drejt në sy.

Njëri prej tyre, ai që kishte dalë prej kasolles, iu afrua i menduar, hodhi sytë diku tej, mandej shtriu krahun dhe, si i lëshoi pëllëmbën në sup, e shikoi drejt e i tha:

— Partizanët janë kudo, ata duhet të jenë kudo. Edhe në fshat si partizan do punosh... Kështu, shok, kështu. Ja që ti duhet të punosh në fshat.

Pra, ai ishte partizan. Po këtë duhej ta mbante shumë të fshehtë, sidomos tani.

Ai ecte dhe ndalte aty-këtu, që pela të rrëmbente diçka. Pastaj varej më tëposhtë barërave që kërleshen nëpër rrugë dhe mendonte. Iu kujtua nëna atje në fshat. Ndjeu hon përbrenda, kur kujtoi nënën. Ajo shpesh rrinte vetëm. Dy vëllezërit e rritur ishin larguar prej kohe, dhe ajo dridhej sa herë i binin kambanës. Atë e mori malli për nënën. U lektis. Ai dëshironte të binte në prehrin e nënës dhe ajo t'i shpupuriste flokët dhe t'i këndonte... Dhe ai të flinte vetëm një çast. Pastaj të zgjohej e t'i këndonte asaj një këngë partizane. Ta këndonte me zë të ulët. Nënën e mallëngjenin ato këngë; ajo i donte shumë partizanët.

Ai nisi të këndonte me mend këngën partizane. Befas pela u tremb dhe turfulloi. Përballë tij arritën tre vetë. Veshur me shajak të zi dhe me pushkë.

Ata i thanë:

— Pa eja këtej!

Djaloshi nuk lëvizi. Atij i gjëmonte në kokë jehona e këngës partizane. Pela hingëlliu përsëri. Atij i

kaluan përpara syve nëna, partizanët, vëllezërit dhe pela.

Dy prej tyre bënë nga e majta me pushkët të he-
dhura krahëve. Ndërsa njëri tha përsëri:

— Pa eja këtej!

Dhe nuk e ktheu kokën.

Tjetri, pesë hapa më tej, nuk lëvizte.

— Ç'keni, — tha djaloshi dhe i regëtinë e ju dro-
dhën lulet e malit që i kishin mbirë në sytë e kaltër.

— Pa qasu, pa qasu, bëj beli!

Ata dy burrat u ulën atje buzë një shpelle nja
tri-katër metra të lartë.

Të heshtur e të ftohtë. Nxorën pushkët dhe i vunë
përpara gjunjëve, nxorën kapelat dhe i lanë në një anë.

— Na kërreve këmbët, — tha njëri.

— E çë, çë! — pëshpëriti djaloshi dhe u zvarrit
pranë tyre. Çapitej heshturazi, ngadalë.

Ai që qëndroi më tej, zuri pelën dhe e hoqi për
kapistre. Pelës i ngeli koka nga djaloshi.

— Ku ishe?

E pyeste njëri me kokë të madhe, i gjatë e i tra-
shë, veshur i tëri në të leshta.

— Në mal, — tha djali.

— Ku?

— Në stan.

— Ku?

— Në stan, çë, çë?!

— Ku, qen?!

Ai që e pyeste, u ngrit dhe e qëlloi djaloshin fort
në fytyrë. Djaloshit iu shkund kryet dhe iu skuq fy-
tyra. Kaloi dorën në faqe dhe shikoi andej shtrem-
bër, me inat.

Ai që e goditi, u ul përsëri dhe, duke nxjerrë ku-
tinë e duhanit, i tha atij që ishte më këmbë:

— Kontrolllo për letër.

Pastaj iu kthye përsëri djaloshit.

— Ç'ke në pelë?

Djaloshi heshti i hakërryer.



— Ç'ke në pelë të them?!

— Pse më rreh?

Thirri fort djaloshi dhe e shikoi në sy tërë urrejtje.

— Hi-hi-hi, — ia bëri ai duke nxjerrë dhëmbët.

Edhe tjetri qeshi. Pastaj u vrenjt dhe bërtiti:

— Ç'ke në pelë?

— Miell, ç'të duhet ty?

— Nga e sjell?!

— Nga mali, nga stani.

— E gjeçë, — thirri ai që kontrollonte tek samari i pelës. Ai e lëshoi pelën dhe u afrua tek ata me një copë letër. Djali u drodh dhe ndjeu tronditje. Ai puliste sytë dhe shikonte te kofshët e tyre të bëshme, mbi të cilat kishin mbështetur bërrylat e lexonin atë copë letër që ishte fshehur poshtë kaptellit të samarit. Pelës i ra kapistalli. Ajo u avit pranë djaloshit dhe ngjante sikur shikonte atë me trishtim e çudi.

Ata e lexuan letrën dhe shikuan nga djaloshi.

— Mirë, — tha ai që jepte urdhra. — Byrazeri i këtij na vrau Rexhon! Mirë!

Dhe u ngritën.

— Hip këtu te guri, te shpella, — tha përsëri ai.

— Dhe ktheje fytyrën andej, — tha tjetri.

— Jo, — ia preu i pari, — me fytyrë këtej.

— Mirë.

Djaloshi nuk lëvizi. Ai i shikoi me inat, me një egërsi fëmijnore të patreguar. Pastaj tha:

— Pse?!

Njëri e kapi dhe e shtyu. Ai lëvizi supet e vogla dhe e shikoi atë me inat. Ai e shtyu përsëri. Djaloshi ndali një hop, e shikoi atë përtej supit që e shtyu, u mendua dhe shkoi e u ngjit në shpellë. Përballë ishin ata të tre. Pela lëvizi dhe bëri të afrohej, po njëri nga ata e trembi dhe nuk e la të qasej.

Në sytë e djaloshit u trondit gjelbërimi i malit, erërat e lara të mëngjesit dhe çuqurima e thëllëzave. Në mendtë e tij të njoma goditi kujtesa e nënës që e priste, e vëllezërve, e partizanëve. Ai pështyu dhe u

bë gati të kujtonte atë këngën partizane që do t'ia këndonte nënës në pëqi, kur ajo do t'i ngatërronte kaçurrelat, por befas iu shfaq rasa e priftit dhe shpina e tij paksa e përkulur përpara.

Atë kohë pushkët u ngritën dhe tre plumba e goditën njëherësh.

Trupi i njomë, lastar, u këput e u thërrmua në gungat e shpellës dhe ra në anën tjetër të saj. Në sytë e kaltër kishin ngrirë reflekset e pranverës së maleve (se ngjitet vonë pranvera në malet tona).

Kaçurrelat ngjyrë thekre ishin pleksur e ngatërruar në pellgun e gjakut. Në fytyrë e në mollëza i kishte ngrirë një buzëqeshje prej fëmije, e prerë në mes.

Kryet i kishte shkuar pak menjandë dhe të dyja doçkat e vogla i kishte shpurë nga e majta, atje ku kishin çelur vrima plumbat dhe tek gurgullonte ende gjak.

Pela vrapoi atje, vari kokën gjer përdhe, e ngrohu me avullin e vakët dhe nga syri iu rrokullis një pikë lot.

Rrahu lulet dhe barin e njomë me thundër, pastaj hingëlliu, hingëlliu si e tërbuar.

Dhe rrahu e rrahu tokën me potkua.

2

Na ishte njëherë një djalë, një djalë i vogël e i njomë. Kishte sy të kaltër e flokë të verdhë që i binin mbi ballë. Atë djalë e quanin Bastri. Kishte një nënë ai Bastriu dhe dy vëllezër më të rritur. Vëllezërit e Bastriut patën dalë partizanë që herët dhe nëna e Bastriut u bënte bukë e ndihte partizanët. Kishte edhe një pelë Bastriu, që e donte shumë. Pela ishte e madhe dhe Bastriu ishte i vogël. Po ata e donin shumë njëri-tjetrin. Dhe e kuptonin. Ai i thërriste Ritë pelës dhe ajo e ndiqte prapa. Ditët e Luftës e rritën më shpejt edhe këtë Bastriun. Dhe e thi-

rrën djaloshin e vogël, me sytë e kaltër dhe flokët e verdhë, që i binin mbi ballë, të çonte materiale lufte në mal. Dhe u nis Bastriu një natë me pelën e vet. Dhe eci e eci djaloshi. Dhe fjetei nën barkun e pelës, gjersa të nesërmen arriti në mal tek ata. Ata ishin partizanë, ishin partizanë me yj të kuq dhe me pushkë në krah. I thanë atij, Bastriut të njomë, se do të bënte punën e Partisë atje në fshat, se do të bënte punën e partizanëve. Kështu, ky Bastriu nisi të kthehej për në fshat me pelën e tij dhe me një copë letër, që do të vinin ta merrnin partizanë të tjerë.

Po rrugës kishin zënë pritë ca njerëz, ca njerëz të zyrtë e të egër. Këta njerëz ishin ballistë.

Dhe ballistët e vranë me plumba djaloshin me sytë kaltër, me flokët e verdhë e të ngatërruar, që në ditët me diell i shëndritnin si petale luledielli, djaloshin që e thërrisnin Bastri.

Pela vrapoi atje, afroi fytyrën e saj të gjatë, e ngrohu me avullin e vakët, lëshoi një pikë lot, pastaj hingëlliu, hingëlliu si e trembur. Dhe rrahu tokën me potkua.

Po erdhi një vit tjetër. I thoshin viti i parë i Çlirimit. Atje në fshat i kishin djegur shtëpitë. Po kasollja e ulët, mbuluar me llamarinë, ishte ende. Andej përsëri dilte tym. Edhe ajo nëna ishte. E plakur, e përkulur, po ishte. Ishin edhe dy djemtë e rritur. Njëri kishte ardhur me leje.

Po njëri, ai më i vogli, nuk ishte. Nuk ishte kthyer ende nga Udhë e Malit. Nuk ishte Bastriu. Nuk ishte as Rita, pela. Edhe ajo s'ishte. Ata s'ishin kthyer ende... Nuk ishin kthyer.

Njëri djalë u ngrit dhe, i dridhur, hapi derën. O, ç'heshtje dhe ç'belbëzim i dridhur i atyre të treve!

Në kornizën e hyrjes shquajti koka e gjatë e një pele. Ajo heshtte atje te hyrja e kasolles dhe nuk rrihte dheun me potkua, dhe nuk hingëllinte. Kishte shumë gropa në krye ajo pelë me fytyrën e gjatë tërë kokalla.

Ata qasën kandilin dhe dalluan se nga një anë ajo kishte një gropë në sy. Ata e shikuan pelën me kujdes dhe i folën në emrin Ritë, i bënë zjarr të ngrohej dhe u munduan të merrnin me mend se ç'rugë kish-te hequr ajo e gjorë tërë ato kohë derisa mbaroi lufta, derisa ra edhe ai bisht armiqsh.

Ajo avullonte nëpër brinjët e dobëta dhe ata kujtuan kohën dhe armiqtë.

* * *

Nata rrihte. Era grindej nëpër hatulla. Më kot ata e lanë derën hapur atë natë. Më kot. Pas pelës Ritë askush s'po vinte. Më kot nënokja u këput tërë natën te parvazi i dritares së vjetër. Më kot. Buzëqeshja e njomë e Bastriut, sytë e kaltër dhe flokët e verdhë kaçurrelë, të lëshuar mbi ballin e kërcyer, asaj iu qasën vetëm nëpër ëndrra.

Bastriu kishte rënë në luftë dhe dita po çelte si buzëqeshja e Bastriut në atë çast që shkëputej nga gjumi i lodhur dhe ndeshej me sytë e ëmbël të nënës.

Lufta kishte mbaruar dhe tymi i saj davaritej dhe njerëzit lidhnin plagët. Vendi nuk i harronte njerëzit e rënë.

Në atë fshat të largët, te kasollja e mbuluar me llamarinë, kishin frikë ta zinin në gojë Bastriun e vogël. Se gjithë fisi shkrihej në kuje. Edhe në fshat e kujtonin, e sillnin në mend djaloshin, Bastriu me sytë e kaltër. Ishte ende i freskët, ishin të freskëta lojërat e tij, ishte e freskët fërshëllima e tij dhe dashuria e tij për atë pelë. Ndaj s'e zinin në gojë. Se gjithë fshati e qante, se gjithë fshati e donte. Atë dhe pelën e tij Ritë. Po atë s'e pa askush nga fshati kur e shpuan me plumba. Dhe eshtrat e tij të njoma, të mbuluara me dëborën e bardhë të dimrit, si gjeti askush pas kurrizit të asaj shpelle.

Nënokja priste e priste, atje te gardhi, me kokën

të kthyer nga rruga e malit. Po nuk dukej as ai e as pela. Jo. Nuk dukej.

Kishte rënë muzgu një natë pas shumë kohe. Dhe ishte dimër. Dhe era thyente drurët e vjetër, dhe era shtynte me mjekër llamarinat e kasolles.

Ata rrinin pranë zjarrit dhe ngroheshin, dhe piqnin misra, dhe bisedonin e bisedonin. Të dy djemtë së toku me nënën, që s'kishte flokë të zez në kokën e mbuluar me shami. Dhe mendonin. Ndoshta mendonin për djaloshin dhe për pelën, për sytë e kaltër dhe flokët e ngatërruar që i binin mbi ballë si petale luledielli, për hingëllimën... Ndoshta mendonin të gjithë për të njëjtën gjë. Veç e veç. Po nuk flisnin. Mbase nënës i dukej sikur ja, do të hapej dera dhe do të ndiente dihatjen e lodhur të Bastriut, të shpirtit të saj të njomë. Po dera nuk hapej. Po dera nuk hapej...

Kur befas te dera e kasolles, përbri themeleve të shtëpisë së re që po ngrinin, u ndje një gërvimë. Gërvima u ndje përsëri sikur dikush që vinte nga errësira dhe që s'kishte duar, donte të hynte brenda. Nëna me flokët e bardhë shikoi nga hyrja dhe ngriu. Të dy djemtë shikuan nga hyrja dhe u stepën.

Po askush nuk hynte. Jashtë kafshonte era.

Gërvima u ndje përsëri mu te pragu i derës. Pastaj një rrahje e baltës te hyrja.

BURRI I VOGËL QË...

I

1

Rrija te dritarja dhe pija cigare. Atëherë pija shumë cigare. Parvazet e dritareve të mëdha ishin lyster pa kujdes dhe ato ishin brejtur. Shihja një peizazh të zhveshur, lakuriq. Qielli ishte i errët dhe i ulur. Ndihehin gjëmime të largëta. Era e ftohtë shtyhej nëpër qoshet e shtëpive dhe përplasej në xhamat e dritareve. Xhamat dridheshin.

Nuk shikoja asnjë njeri nëpër rrugë. Unë doja të shikoja dikë. E ndieja se pas meje, nëpër dyert gjysmë të çelura, shtyheshin nxënës për të shikuar nga unë. Por unë doja të shikoja njerëz nëpër rrugë. Rrugët qenë të lagura dhe të shkreta. Pas ca, te kthina e një gardhi, nxori kryet një kalë i vjetër, gërdallë, i lartë. Një plakë e shtynte nga pas. Kali bënte pak

cape dhe ndalte përsëri me kryet e ngritur, sikur kundronte përballë. Era ia ngatërronte jelet e varura dhe plaka i binte atij me të dy grushtet e mblodhura shuk në vithe.

Mandej kali ra përtokë dhe plaka humbi te shtegu.

Pas meje rrahu zilja dhe mua m'u qas nëndrejtoresha.

— Këto dy orë do të hyni në klasën e gjashtë, — tha ajo.

Ne hymë në klasë dhe nëndrejtoresha u foli nxënësve me ato rregullat e zakonshme. Pastaj iku.

Nxënësit e klasës së gjashtë lëvizën supet dhe i shtrinë përsëri duart mbi banka. Nuk e hapa regjistrin, po e mënjanova atë nga e djathta e tavolinës. Një nxënës, i lartë e i bëshëm, veshur me një pallto të lehtë që i avullonte, u ngrit më këmbë atje te rreshti i i fundit.

— Ç'është? — i thashë dhe u mundova të bëja kindin e buzës në gaz.

— Mungesat, profesor, — tha ai, — unë jam kujdestari.

— Jo, ulu, — i thashë.

I shtriva të dy bërrylat dhe fillova të luaja me gishta në tavolinë. Pastaj bëra përsëri buzën në gaz dhe thashë:

— Domethënë ky është fshati juaj, ë?

— Jemi këtu nga katër fshatra, — tha kujdestari, ai i bankës së fundit, që u ngrit të jepte mungesat.

— Ëhë, mirë, mirë.

Nxënësit lëvizën përsëri. Unë heshta një hop. Vëreja tej te qoshja e murit në fund të klasës.

Një pëllëmbë ere goditi dritaret dhe xhamat u drodhën. Unë pyeta nxënësin e bankës së parë në rreshtin e majtë. Ai u ngrit në këmbë. E quanin Anefi. Ishte nga një fshat fqinj. Për të ardhur deri aty, bente një orë e një çerek rrugë. Anefiu kishte kokë të vogël. Ishte me çizme. Çizmet ishin të mëdha. Në krah

të djathtë, te banka kishte një trastë të vogël dhe një copë mushama.

Anefiu më tha se këtë vit do të merrnin mbi dy-mbëdhjetë lekë për ditë pune, po një tjetër, tri banka më tej, kërceu e tha:

— Jo, profesor, këtë vit do të marrim pesëmbëdhjetë lekë.

Ai foli me rrëmbim. Pastaj lëvizi çadrën që mban-te pranë këmbëve dhe u ul.

Anefiu nuk e ktheu kokën prapa. Ai përplasi qepallat, i përplasi disa herë, mandej belbëzoi:

— Posi, posi!...

— Pse, nuk bëmë edhe problemë në aritmetikë me pesëmbëdhjetëlekëshin! — foli pa u çuar nga vendi ai që rrinte tri banka më tej.

— Unë nuk thashë gjë, — tha Anefiu, — problemën e bëmë, s'thashë gjë për problemën.

— Po ja, atë the, — pëshpëriti ai i tejmi dhe prishi fytyrën.

Anefiu tha edhe se kishin katër dhi në shtëpi, po sivjet dimri kishte marrë keq dhe kishte lëshuar shumë bubullima. Kështu që tri dhi deri tani kishin shtirë, domethënë kishin bërë keca të ngordhur. Po lopën e kishin mbart dhe e kishin mirë.

— Pse s'shtinë edhe dhinë e mia! — tha ai i bankës së teyme, — apo...

Anefiu përplasi qepallat, kaloi dy-tri herë lukthin dhe lëpiu me gjuhën e hollë të kuqe buzën e sipërme. Pastaj u ul me një shprehje të qetë e të patrazuar, duke belbëzuar:

— Janë të fisme ato!

Tjetri, atje tej, lëvizi sytë, gërvishti mbi bankë me gishta, mblodhi hundët dhe tha, sikur i foli vetes:

— Ashtu, po... po...

— Ja, sot shtiu edhe gomari i Hankos, — pëshpëriti një djalë i paktë në rreshtin tjetër. — Kërricën e bëri të ngordhur.

Unë e kuptova cila ishte Hankoja, sepse ajo lëvizi si e goditur papritur.

— Pshe, pshe, jo, profesor, pshe, pshe të thotë ashtu ai!

Dhe lëvizti kryet e pakënaqur.

Kishte veshur një triko jeshile dhe ishte fshehur atje prapa bankës. Ngjante si një njollë dielli, e cila regëtin përmes gjelbërimit. Kishte flokë të verdhë, lëkurë të imët e sy të kaltër.

— Jo, profesor, pshe... — pëshpëriste ajo akoma.

— Po unë s'thashë gjë, unë thashë që shtiu gomar, pse, nuk shtiu?

Hankoja nuk shikonte nga tavolina. Ajo kishte fshehur kokën te banka dhe pëshpëriti:

— E shtë duhet ty, dërmaneee! Pshe shtë...

— Jo, po...

Jashtë dita ishte mbledhur dhe në dritare, parvazet e së cilës i kafshonte era, po mblidhej drita e errët.

Mua kjo më ngushtonte dhe nuk doja që të mbaronte ora e mësimit, nuk doja që të iknin nxënësit.

Në korridor rrahën këmbë dhe tringëlliu zilja, po ne nuk lëvizëm. Edhe orën tjetër kisha mësim unë në atë klasë.

U ngrit të fliste një nxënëse. Ishte me trup të hedhur e me supe të gjera. E quanin Hatije. Ajo heshiti një hop pastaj shikoi pëllëmbët e saj që i kishte mbi bankë, dhe nisi të fliste.

— ...Ne e kemi shtëpinë këtu afër, ja, aty nën shkollë. Një dhomë e kemi bërë me tavan. Po të gjej më dhogë, nga behari o ta bëjmë edhe dhomën tjetër, se sivjet do marrim më mirë. Ja, aq sa tha Anefiu.

— Po, aq, po, aq, do ta shihni! — tha përsëri nxënësi atje tej, që ngulte këmbë dhe nervozohej, se besonte që do të merrnin mbi pesëmbëdhjetë lekë për ditë pune e jo dymbëdhjetë.

Hatija heshti. Nuk shikoi nga ai që i preu fjalën.

— Po rri ti, Gjite, njëherë, rri, ç'të kërruan, — i tha një nxënëse, që s'kishte folur asnjëherë.

Ai që quhej Gjite dhe që nervozohej papritur, sa

flitej për vlerën e ditës së punës, uli kokën dhe pëshpëriti:

— Jo, po t'i thonë drejt. Jo... se kështu i folën edhe atij gazetarit!

Hatija shikonte te gishtat e saj, shtruar mbi bankë. Heshtje.

— Nënë e kam... — tha Hatija, — tashti është ngarkuar dhe do të lindë përsëri. Njëmbëdhjetë fëmijë jemi. Motra e vogël, Merzua, ka mbushur katër vjeç dhe është me këmbë të hapura. Po këmbët i ka në allçi, katër muaj i mban në allçi. E dërguan edhe në Tiranë. Ai doktori i Tiranës na tha se pas gjash-të muajve Merzos do t'ia heqë allçinë dhe ajo do ecë. Kështu tha, profesor, kështu...

Dëgjoja Hatijen, dhe mundohesha të përfytyroja Merzon e vogël, që kishte dalë në këtë botë tek ai fshat, mandej kishte shkuar te kirurgu në Tiranë dhe tani rrinte atje, me këmbët e vëna në allçi, pranë nënës që turrte.

Në krahun e djathtë, pak më tej, ishte një dritare. Era nuk ndihej. Befas jashtë nisi shiu, një shi i dendur. Nisi edhe era. Ajo e përplaste shiun në dritare. Parvazet e brejtura kullonin ujë edhe brenda në dysheme. Jashtë ishte nxirë pothuaj krejt.

I erdhi radha një vajze tjetër të fliste. Atë e quanin Mihiri. U ngrit, po rrinte përkulur përgjysmë me bërrylin e majtë të thyer në bankë. Ishte mjaft e gjatë, me flokë thekre të shkurtër, të kthyer te veshët. Kishte sy të mëdhenj dhe buzë disi të ardhura e të përthyera, me një ngjyrë të ëmbël paksa portokalle. Nën hundën e drejtë i rridhnin dy viza. Trupin e kishte të gjatë, aq sa ajo dukej sikur e ndiente se dilte më tepër se ç'duhej përmbi të gjithë. Andaj përkulej. Ngjyrën e fytyrës e kishte në të verdhë e në të bardhë. Edhe ajo nuk të shikonte në sy, kur të drejtohej. Atje te banka ndiqte gishtat e saj të hollë e të gjatë dhe fliste.

— Kemi bërë shtëpi të re. Lopa na ka pjellë, po

babai nuk është i kënaqur. Thotë se polli shpejt dhe dimri i egër do t'ia mbledhë gjinë. Edhe neve na shtiu një dhi. Nga bubullimat. Kemi shtatë. Një vëlla punon në gjeologji. Ka ca kohë. Me leje të kooperativës. Kryesia i shikon këto dhe jep leje sipas arsyes. Bejkushit i dhanë leje të punojë atje në gjeologji dhe ne kemi tani edhe një rrogë shteti. Nusja i punon në kooperativë. Kemi bërë dy dhoma me tavan. Kemi edhe pelë. E japim në kooperativë me ditë pune... Në verë punoj edhe unë. Vitin që shkoi, kreu gjash-tëdhjetë e shtatë ditë pune. Veja në duhan. Me gjashtëmbëdhjetë vargje ditën... Në aritmetikë jam më e dobët.

Këtu ajo heshti. Dhe nuk vazhdoi më tej.

— Sa lekë do të merrni këtë vit? — e pyeta unë.

U mendua një çast, ngriti kryet dhe me shikimin në tavan tha:

— Vjet dështoi duhani. Muarrtim pak.

— Po këtë vit, sa, si?

Tani heshti më gjatë. Lëvizi buzët dhe kombi i grykës i regëtiu.

— Ë, Mihiri, ç'thua, ç'kupton ti?...

— Po ja, të mos dështojmë...

— Si babai, hə, hə, si babai, — thirri papritur një zë.

Ishte nxënësi që e thërrisnim Gjite. Ai lëvizi në bankë. Kishte krye të rrumbullakët, të vogël, me flokë të verdhë në të bardhë, lëshuar poshtë. Po vetullat i kishte të bardha dhe faqet të rrumbullakëta e të kuqe.

Atij i lëviznin sytë dhe fliste sikur breronte nofullat nga inati. Ai rrëmbeu buzën e poshtme thellë nën buzën e sipërme dhe, duke nxjerrë përpara mjekrën e vogël, heshtte në një përgjim kërcënues e hakmarrës:

— Po ti prit njëherë, prit, dale, ouu, — i thashë unë, duke u munduar të sillesha sa më i qetë e i njëzëshëm.

— Pse, jo, si, pse?!

Thoshte kështu dhe lëvizte supet herë para e herë prapa.

Mandej, me një lëvizje nervoze, futi njërën dorë në xhep dhe nxori që andej një stilograf. Po zbërthente stilografin.

Kishte rënë heshtja. Shiu çukiste kanatet me tërsëllim dhe dyshemeja anës mureve po lagej. Mihiria kapërceu pështymën, shikoi nga unë, shikoi te gishtat e saj të hollë e të gjatë, pastaj tej në krahun e djathtë dhe tha:

— E ke të blerë ti, o Gjite, s'e ke të lerë.

Dhe përsëri shikoi atje. Pastaj u ul.

Djaloshi atje tej foli ulët:

— Je edhe në estradë ti, bën edhe vjersha, ëhë!

Po Mihiria shikonte në bankën e saj.

U ngrit të fliste një djalë tjetër. Kishte trup të ngjeshur dhe vështirim të egër. Duke folur, kalonte nëpër duar një fletore.

— Atje lart, profesor, do bëhet një fshat. Se atje ka qenë fshati i vjetër. Atje ka shumë toka për të punuar. Mund të mbillet thekër, mund të bëhen edhe vreshta. Do vejë kush të dojë. Baba pranoi. Ne vijmë që andej. Kam edhe dy motra, njëra në klasën e katërt, tjetra në të pestën... Në verë mbledhim bimë mjekësore për kooperativën. Bora na ka zënë shpejt. Po kur të ngrihet fshati, do kemi maqinë, se do bëhet edhe rruga. Në fund të vitit morëm shtatëdhjetë mijë lekë. Po kishim marrë edhe gjatë vitit. Kur bën dimër i madh, ne që vijmë në shkollë, s'ngjitemi lart. Kemi njerëz këtu. Kur të ngrihet fshati, do ketë edhe shkollë...

Një vetëtimë, një gjëmim dhe xhamat u drodhën, dhe shiu u bë më i egër e më i dendur.

Shiu kish ndaluar. Po përrrenjtë dhe rrëketë që zbritnin nga malet bubullinin. Askush nuk priste që të çelte koha. Përkundrazi. Të gjithë e ndienin se nga çasti në çast do të derdhej përsëri shi. Po kjo fshatit nuk i bënte shumë përshtypje. Kështu ngjante. Ndoshta se ai fshat i vogël e i përhapur në ato dy anë lugine të zhveshura, përfund atij mali që ngjitej gjer lart e përhapej tej maleve të Labërisë, ishte mësuar me dimër. Me dimër të egër që hidhte borëra. Në krye, po të ndodheshe atje befas, në një ditë të errët dimri, kur qielli i rrihte shtëpitë me kamzhikun e lagur të shiut dhe i fshikullonte me erërat e pandalura e të hazdisura, do të ndieje dridhmë dhe përbrenda do të të kapërthente e do të të rritej ajo ndjenjë e vogël që të kap shpesh, kur ndodhesh në një vend të huaj në kohë dimri.

Po kjo s'ngjante me fshatarët. Ata përsëri turrnin jetën. Turrnin e turrnin. Përsëri shkonin poshtë në fushë dhe hapnin kanale në atë copë kohë që qielli mbante frymën, përsëri nxirrnin bar nga kavaletat për në stalla... përsëri i binin kuajt nga kullotat dhe përsëri oxhakët e ulët ngrinin tym. Përsëri:

Dera e kryesisë hapej dhe brenda kishte plot burra që pinin duhan, brenda ishte një grua që diç shkruante në bllokun e brigadieres, dhe mushama të gjata të zeza që kullonin ujë.

Nga tragat e faqes së malit që në mëngjeset e errëta ende pa zbardhur mirë niseshin nxënës. Dhe dera e shkollës hapej përsëri, dhe sobat ndizeshin

përsëri, dhe ajo Hurmaja, që ulej në atë bankën e parë të klasës së pestë, ngrihej e recitonte një vjershë për malësoren. Përsëri, përsëri.

Unë hyra në shkollë, kur kishte rënë zilja. Nuk kisha mësim ato dy orë. Në hyrje, në krahun përbri, ndjeva zërin e kolegut tim me atë gjoks të gjerë e trup të shkurtër. Pastaj zërin e mësueses së aritmetikës. Duke ecur nëpër korridorin e gjatë, goditnin nga të dyja anët zërat e arsimitarëve që pyesnin e shpjegonin.

S'kisha hyrë ende në dhomën e mësuesve, kur hasa një zhurmë dhe ngatërrim këmbësh në krahun e majtë. Një zë që qante dhe një zë që kërcënonte e hakërrehej.

Hyra në klasën e gjashtë. Nxënësit ishin rrëmujë. Ata vraponin nëpër banka dhe mundoheshin të ishin të qetë e të rrinin drejt, kur hyra unë.

Mbylla derën dhe u qasa te tavolina. Pashë për-qark. Ai nxënësi te banka e parë e rreshtit të majtë, ai që e thërritnin Anefi dhe vinte aty që nga ai fshat i largët, kishte mbështetur faqen te banka dhe mundohesh të fshinte lotët. Të tjerët rrinin në këmbë. Anefiu përtypej në ngashërim të zemëruar. Në një ngashërim të pandaluar, që të ngrinte një ndjenjë zemërimi, keqardhjeje e dhembjeje. Lëvizte.

Djaloshi i fshinte hundët me rizën e dorës dhe pëshpëriste fjalë të përgjysmuara. Lëvizte supet e voga dhe mundohesh të mbyllte jakën e këmishës te gjoksi. Pastaj qasi edhe më ndanë vetes atë copën e mushamasë, shikoi në krahun tjetër dhe tha:

— Posi, hë, posi.

Klasa heshtte. Xhamat e dritareve i qëlloi shiu.

— Ç'ka ndodhur, ç'është?! — thashë unë.

— Me leje, profesor!

U ngrit një nxënës i shkurtër, me trup të ngjeshur, me atë fytyrën e vogël e të njomë që shprehte seriozitet dhe vendim të prerë, kategorik. Prapa shpinës kishte një llabane të dhirtë.

— Me leje, profesor, — tha ai, — me leje! Dy orët e para ne kemi pushim. Mungon zonjushë Zhani dhe profesor Jorgua. Ne rrinim në klasë, se kështu na porositi nëndrejtoresha. Kjo Mihiria këtu, ja, ajo vizatoi një ari të vogël në dërrasë të zezë. E vizatoi me shkumës, profesor, sipas librit. Ne shikonim të gjithë ariun e vogël që vizatonte Mihiria. Pastaj u ngrit Anefiu. Anefiu nuk bëri gjë, profesor. Ai mori shkumësin dhe vizatoi një sopatë. E vizatoi në dërrasë të zezë. Sopata binte mu në qafë të ariut. Ashtu po e vizatonte Anefiu. Mirë bëri, profesor! Po Gjitja i tha nga banka: «Mos, mos e vizato sopatën». (Anefiu nuk fliste, po vazhdonte.) «O të të ngordh», — i tha Gjitja. «Pse, — i tha Anefiu, — unë s'të ngas ty!» Dhe vazhdoi. U ngrit Gjitja, shkoi, e shtyu me bërryl Anefiun dhe nisi ta fshinte. Po Anefiu nguli këmbë që të mos e fshinte Gjitja sopatën.

Atëherë, profesor, Gjitja i hodhi dorën në grykë Anefiut dhe e vuri poshtë. Ai qëllonte Anefiun, po edhe Anefiu e godiste. Mirë ia bënte që e godiste Anefiu. Ç'kujton ai! Tani që i doli gjak, thotë: «Pse më qëlloi Anefiu!» Pse të mos e qëllonte, profesor?! Edhe unë e qëllova, kur deshte të pështynte Anefiun. Pse, profesor, pse!? Ai e ka bërë shumë herë këtë. Pse?!

— Po, ja, hë, hë! Të shohim, të shohim!...

Nga mesi i rreshtit, ai nxënësi me trup mesatar, i veshur mirë, me jakën e xhakaventos të hapur, me krye të rrumbullakët, të vogël dhe me flokë të verdhë në të bardhë, të lëshuar poshtë, ia bënte: «Po ja, hë, hë!... të shohësh, të shohësh!»

Ai ishte ende i njomë në moshë, po fliste me një inat e siguri të atillë, që të çudiste. Vetullat e bardha i dukeshin të shprishura, sytë i rrotullonte tërë mllef

dhe muskujt e vegjël të nofullave i ishin tendosur e i lëviznin vazhdimisht.

E ndiente që po shikoja atë, po ai nuk shikonte nga unë; kishte ulur kryet në bankë dhe shikonte nga Anefiu, duke breruar:

— Hajt, po do më shosh, hajt pa...

Po e humbisja durimin dhe e ndjeva se ai nervi i padukshëm atje në tëmthin e djathtë nisi të më rrihte fort.

— Çohu, i thirra me zë të lartë, — ti, Gjite, çohu këtu!

Ai nuk lëvizi, po rrëmbeu thellë buzën e poshtme nën buzën e sipërme dhe, duke nxjerrë përpara mjekrën e vogël, qëndronte në një përgjim kërcënues e të dyshimtë. Klasa heshtte. Po e kuptoja se ndodhesha përballë një situatë të vështirë.

— Çuhoh! — thirra përsëri dhe bëra dy çape përpara.

— Do të ta shtyp kokën, — tha ai dhe shikoi nga Anefiu.

Anefiu e vodhi me bishtin e syrit dhe mblodhi hundët.

— Çohu, po të them!

— Pse, profesor?!

Djaloshi shikoi nga unë. Iu mblodh ajo viza tek ndahen vetullat, iu thelluan vija në ballë dhe sytë iu errën.

— Ngrehu — i pëshpëriti dikush nga prapa.

Djaloshi ktheu kokën me rrëmbim dhe iu kërcënua.

Xhamat po i qëllonte shiu më me tërsëllimë.

Unë u çapita gjer te banka e tij dhe e zura për krahu. Ai tundi krahun në shenjë proteste. Unë e kapa me të dyja duart dhe e nxora nga banka. Ai nuk më shikonte në sy.

— E di ligjin e diktaturës së proletariatit? — thirra dhe e ndoqa nga pas. E ndieja se ai nervi te tëm-

thi po godiste fort dhe se po flisja gjëra të çuditshme.

— E, e di apo jo!?

— Ëhë, — ia bënte ai dhe tundte bërrylin.

— Ec me mua, — i thashë dhe i vura dorën në shpinë.

Ai kishte xhakavento meshini, kishte kilota dhe çizme. Atë çast më ngjau si burrë i vogël që kërkonte sundim.

E nxora jashtë derës. Në korridor më kundërshtoi energjikisht dhe m'u duk sikur më kërcënoi. E qëllova fort në fytyrë. E qëllova përsëri. E qëllova disa herë. Kur e qëlloja, ai s'bënte zë. Befas kjo më çuditi. Ai nuk kundërshtoi, kur iu derdh fuqia ime prej të madhi me një inat të hazdisur. Mësuesja e aritmetikës doli te dera e klasës.

— E, po tani? — i thashë dhe e lëshova.

Ai bëri për në klasë dhe tha prerë me zë të qartë:

— Ec, pa do ta shohësh te baba.

Dhe hyri në klasë.

«Te baba! Te baba!...»

Ç'desh të thoshte ai me këtë: «Te baba!».

Unë ndala në korridor. Isha i huaj në atë fshat dhe s'kisha veçse një javë që kisha ardhur aty, kur papritur të plekste jeta në mënyrë të tillë.

U mundova të mblidhja veten. E kuptova se duhej të qetësohesha dhe të veproja më me gjakftohësi. Tani i duhej shkuar deri në fund kësaj pune. Kur u ktheva për nga hyrja e klasës, ndjeva nxënësit që u larguan për në banka. Ata ishin qasur te dera.

— Po tani!... — tha një zë vajze që brenda.

— E çë? Atë s'e rrahu njeri, — tha një tjetër zë.

— Mos ngatërron profesorin!

— Mirë ia bëri, — thirri dikush.

— Profesori s'e preku.

— Jo, s'e preku», — tha dikush.

Hyra në klasë. Nxënësit heshtnin. Shiu godiste

parvazet që kishin nisur brejtjen. Gjitja ishte ulur në bankë dhe rrinte e sillej tërë inat, me asnjë fije ndjenje pajtimi. Përkundrazi. Ai shfrynte. Unë u ula në karrige. Mblodha të gjitha forcat për t'u qetësuar. Këto ishin përpjekje të tendosura. Nxënësit mbase e ndienin këtë. Të mirët nxënës! O, ç'krijesa të pastra e të sigërta! Ata e ndienin këtë. Po, po. Dhe u vinte ligisht për mua. Të mirët nxënës!..

— E! — thashë unë.

Askush nuk foli.

— E! — thashë përsëri.

Përsëri askush nuk foli.

Në të majtë Anefiu, me ballin të ulur, shikonte vrerët nën qepallat që i kërcenin vazhdimisht. Ai nuk mblidhte më hundët. Në fytyrë kishte ngurosur një shikim të vrenjtur.

Heshta. U mundova të shikoja nxënësit me radhë. Ata më shikonin një çast, pastaj ulnin sytë. Shikimi im ra në bankën e parë, në radhën e mesit, mu përballë tavolinës tek rrinte ai nxënësi i shkurtër, me trup të ngjeshur, me fytyrën e vogël e të njomë që shprehte seriozitet dhe që, prapa shpinës, në mbështetsen e bankës, kishte një llabane të dhirtë.

Ai më shikoi në sy dhe foli ulët:

— Të gjithë me babën i tremb!

— Ç'është baba? — e pyeta edhe unë ulët.

Djali u përgjigj pa lëvizur:

— Nuk e ka babë, e ka gjysh; xha Saliu, po i thërrasin Babë në shtëpi.

— Cili xha Sali?

— Sali F., profesor, ai luftëtari, s'e njeh?

Unë kërkova të flisnin të gjithë për familjen e Gjitës. Në krye nxënësit ngurruan. Mandej ata nisën të flisnin pak nga pak qartë dhe ashtu si i dinin gjërat. Shpesh kundërshtonin njëri-tjetrin, po jo për gjëra të rëndësishme.

Mihiria tha:

— E përkëdhelin shumë Gjiten, edhe të tjerët.

Para ca ditësh Gjita shau mësuese Hafizen mu në korridor. I foli edhe ajo. Po të nesërmen erdhi gjyshja e Gjites dhe i tha mësuese Hafizes: «Ti, moj, e shave Gjiten tim?» «Jo, — i tha ajo, — ai u soll keq, ne duhet të kemi kujdes për të». Po gjyshja e Gjites, i tha, profesor: «Ti, moj, që nga Veriu të shpëtoi xha Saliu ynë? Ë? ë!» Unë e dëgjova vetë, profesor. Ajo i tha këto dhe iku. Pse, ç'është Gjijtja këtu që na shan kur të dojë?! (Atë çast Gjijtja bëri një gjest përgmues). Pse, se gjyshi i tij ka luftuar! Pse!...

U ngrit nxënësi që ishte përballë meje në bankën e parë. Ai fliste prerë.

— Jo po ka qenë me Ballin! — breroi Gjijtja heshturazi.

— Ne, profesor, kemi bërë dhe hartim për Babën e Gjites. Ai ka qenë luftëtar i madh. Po Gjijtja... Ja, profesor, do të të them dhe një gjë. E mora vesh nga nxënësit e klasës së tetë. Po është e vërtetë. Kushëri-
ra e Gjites, Nurka, që është mbesa e Babës, e ka mbiemrin Dape, se ashtu e ka baba i saj mbiemrin, se nëna e saj është vajzë e Babës. Ajo nuk mëson, profesor. Kur e pa keq, si duket, në provimin e algjebrës nuk shënoi mbiemrin e saj, domethënë Dape, po atë të Babës. Pse? Pse shënoi këtë mbiemër, profesor?... Shënoi mbiemrin e ungjit e jo të vetin?!

Po kthjellohesha. Shtriva bërrylat në tavolinë dhe brodha shikimin nëpër klasë. Klasa heshti. E ndjeu se do të flisja unë.

— Nxënës, nxënës, — thashë me një ton të qetë, të afrueshëm e të menduar. — Unë sot rraha Gjiten. Gjijtja vërejti vetullat e vogla, të bardha.

— Edhe ne kishim vendosur ta rrihnim, — tha ai djali i bankës së parë në rreshtin e mesit, — jemi bërë nja pesë vetë.

— Druri është i ndaluar. Ne e përdorim forcën kundër armiqve, po kundër Gjites jo, kundër nxënësve jo. Masat fizike nuk i edukojnë njerëzit tanë. Kush është Gjitja, kush jemi ne? Baba i Gjites, xha Saliu i Labërisë, është një figurë e dëgjuar, patriote, që të ngjall krenari e respekt. Në moshën tuaj, e ndoshta një apo dy vjeç më i madh, ai ka marrë pushkën, e ka shkrehur, doja të thosha, që më 1914, më 1920, më 1939 dhe kohën e Luftës Nacionalçlirimtare udhëhoqi një batalion të tërë partizanësh. Trim i dëgjuar e komunist i mirë për atë kohë. Ai luftoi kundër të huajve e feudalëve. Që të huajt të mos shkelin këtu dhe që feudalë të mos ketë vendi ynë. Prandaj luftoi tërë jetën xha Saliu dhe prandaj u bë invalid. Që Gjitja të ketë xhakëtë e këpucë, që shkollla të jetë e Gjites dhe jo e feudalëve. Këtë donte xha Saliu, prandaj luftoi. Që të mos ketë feudalë dhe që askush të mos bëhet feudal. Gjitja nuk sillet mirë, nxënës! Faji është juaji. Xha Saliu do mërzhitet shumë, po mori vesh këto gjëra. Pse të ndodhë kështu? A mund të jenë komunistët e ardhshëm kështu? Si thoni ju?

Pse sillet Gjitja në këtë mënyrë, kaq keq? Nëse duhet të gjykojmë Gjiten, duhet t'ju gjykojmë ju, duhem gjykuar edhe unë. Ne... Ky duhet të jetë gjyq i rreptë dhe i pamëshirshëm.

Nxënësit nuk shikonin drejt dhe dukej sikur s'merrnin frymë. Anefiu më shikonte në fytyrë me sytë e zmadhuar.

Suaza e dritës u mbyll, u bë më e errët. Shiu i dendur, i fortë godiste xhamat. Natyra gjëmonte dhe vetëtimat që shponin gjindjen, dukej sikur do ndanin ngjyrën e errët të ditës më dysh.

Me çdo kusht kisha vendosur të miqësohesha me Gjiten. Tani i vinte druajtje nga unë. Ndoshta edhe e bezdisja. Mudohesha të ruaja sensin e masës, që të mos e rëndoja dhe të mos i bija në sy. Atë dhe nxënësën e bankës së parë në rreshtin e mesit përballë tavolinës, i afrova më shumë. I merrja edhe në dhomë.

Nisa të vizitoja edhe xha Saliun, xha Saliun e Labërisë.

I thashë një ditë:

—Unë rraha Gjiten.

Xha Saliu i Labërisë heshti, heshti duke trazuar prushet e vatrës, pastaj thirri plakën, dërgoi e thirri edhe të birin, që ishte në një shtëpi më tej, thirri edhe nusen. Ata e dinin që ai do të thoshte diçka. Ai trazonte prushet. Të gjithë ndiqnin atë.

Pastaj foli pa na shikuar:

— Domethënë ti rrahe Gjiten? — më tha mua.

— Po, — belbëzova.

— Domethënë e rrahe fort?!

— E rraha, — i thashë unë.

Plaka lëvizi dhe shikoi nga unë e çuditur. Xha Saliu i Labërisë trazonte prushet.

— Ti ke bërë gabim, — tha ai dhe ngriti kryet. Po, ke bërë gabim! — Më shikoi drejt e në sy, më shikoi gjatë, pastaj shikoi të brin, edhe atë e shikoi gjatë, shikoi plakën dhe nusen. I dridhej dora dhe ana e një lape të hollë të plakur që varej te gusha.

— Ke bërë gabim, — tha, — se ke rrahur Gjiten. Se s'ke rrahur atë zdapin atje, atë, atë. (Dhe me dorën e dridhur tregonte të birin). Pastaj edhe ne duhet të na rrahësh! Ç'bëjnë mësuesit e tjerë? E?!...

Sytë e tij ishin ndezur dhe fytyra iu ngrit e lëvizi.

Nga libri

«DADEMADHJA»



1976

Page 100
DADAMADHIA

1970

ANIKA

Tej shtëpisë vinin zëra sikur qante një fëmijë.
— Ç'dëgjon? — tha halla.

Nuk fola. Prapa meje ishte dritarja. Mënjanova perden dhe u mundova të shikoja jashtë. Po përjashta ishte errësirë dhe errësira fshihte gjithçka në tempullin e vet.

— Nuk ka njeri, — tha halla dhe vazhdoi të tirrte.

Ajo ishte ulur në dysheme mbi qilim. Shpinën e kishte mbështetur anës krevatit. Sipër në krevat ishte Lonka. Lonka kishte ulur kokën dhe zgjidhte problema të fizikës. Në dhomë ishte qetësi. Dëgjohej vetëm bubullitja e zjarrit në sobë.

— Ndihen zëra, — thashë.

Halla ktheu kokën për të dëgjuar më mirë dhe pas pak qeshi.

— I lodhi dasma, — tha. — Edhe gëzimi të lodh.

Ne folëm përsëri për dasmën. Atë ditë ishte e hënë. Të dielën qe martuar një kushëriri ynë. Dasma u bë në vatrën e kulturës dhe vazhdoi gjer në të gdhirë. Të hënë tërë ditën fjetëm. Na gjëmonin veshët. Na bëhej sikur prapa shtëpisë apo tej në anë të fshatit, ashtu përhumur, dëgjohehin sazet. Oshë-

tima e daulles binte sipër mbi tavan: Bum, bum, bum.

U zgjuam kur muzgu ishte ulur kudo. Gjëja e parë që bëmë, pimë kafe.

— Më mirë në vatër të kulturës, — tha halla. — Atje ka vend dhe mund të rrijë tërë fshati. Kjo dasmë doli e mirë dhe tani të gjithë atje do t'i bëjnë.

Pastaj tha se kjo ishte një dasmë socialiste.

— Morëm nuse të mirë, — tha.

I tha këto fjalë sikur të pinte diçka që e ngopte. Pastaj halla foli për martesat e hershme. Atëherë vajza me djaln nuk shikoheshin hiç me njëri-tjetrin. Anika (nëna e Ladit, e kushëririt tim që u martua të dielën) është martuar pas Çlirimit. Atëherë hiqej një zakon tjetër: Dilnin diku në qytet dhe e shikonin njëri-tjetrin. Vetëm sa shikoheshin dhe këmbenin dy fjalë. Tani ndryshon. Ladi e gjeti vetë vajzën që do të merrte. U dashuruan. Na pyeti edhe ne, dhe ne u gëzuam.

— Edhe ti me dashuri do ta marrësh, — tha ajo.

Ajo më shikoi në sy dhe qeshi.

— Tani është turp të bësh ndryshe.

Soba bubullinte dhe uji në depon e saj valonte me një zhurmë monotone. Halla e lëshoi boshtin që dridhte dhe ngriti kryet. Gusha e saj ishte e bardhë, dhe për një çast unë mendova se sa e bukur duhej të kishte qenë ajo.

— Nga ai, nga ai Këno trembeshin atëherë.

Halla shikoi përballë në faqen e murit, sikur atje të ishte Kënoja. Ajo i tha edhe një herë tjetër këto fjalë. Unë e di: sa herë që ka një gëzim, ajo patjetër do të kujtojë të kaluarën. Ky fenomen ndodh shpesh me të moshuarit.

Nisi të tirrte përsëri. Flokët i kishte të zbuluar. Më shikoi drejt. Edhe unë e shikova drejt. La furkën mënjanë dhe ngriti kryet. U pamë sy më sy.

Që atëherë kanë kaluar njëzet e katër vjet. Ishte vjeshtë e dytë. Sapo kishim mbyllur bagëtinë, kur më erdhi në shtëpi Zarua, nëna e Anikës.

— Të dua një çikë, — tha.

Dola përjashta.

— Eja, — tha.

Ajo ecte përpara. Dolëm tej shtegut. Kishte frikë se mos na dëgjonte njeri.

— Ç'ka ndodhur? — i thashë.

— Hesht, nuk ka ndodhur gjë.

— Po pse s'vjen brenda?

Ajo ndërroi rrugë. U afruam pranë një gardhi.

— Dëgjo këtu, — tha dhe më vuri duart në gjoks.

Më kujtohet si tani. Ishte vjeshtë e dytë dhe nata pllakosi shpejt. Unë, të them të drejtën, u drodha. Kushedi, thashë, mos ka ndodhur gjë e ligë.

— Mbaje fjalën, — tha mëna e Anikës. — Fshihe edhe këtë herë.

— Mirë, — i thashë.

— I doli një fat Anikës, — tha.

— Ku?

— Në Ploktë.

Nuk fola.

— Dëgjo tani, — tha ajo.

Më hoqi nga dora dhe shkuam më tej. Duart m'i vuri përsëri në gjoks. Dridhej.

— Dëgjo, — tha. — Është një djalë. Këno e thonë. Baba nuk ka. Ka xhaxhanë dhe një vëlla poshtë në Qytet. Ka edhe mëmën. Bëri një vit që është kthyer nga ushtria. Tani kërkon nuse. I futën në vesh këtë tonën dhe na dërguan fjalë ta kërrejme nesër.

— Ku? — i thashë.

— Në kasaba, — tha ajo.

Nuk fola.

— Të ngriheni nesër ti dhe Thodhoriu dhe ta merrni e ta shpini. Hë, bijë, pa shpjereni njëherë. Mbase

do zoti! Ai do dalë me një kunatën e tij. Te Ambulanca do shikoheni. Mirë?

— Mirë, — i thashë.

— Mos ju shikojë njeri, —tha. — Se ç'të bëhemi pastaj! Aman e aman mos ju shikojë njeri!

— Do ruhem, — i thashë.

— Se vajza është si qelqi, — tha, — po u thye...

Ajo iku. Më bëri njëqind herë porosi, e shkreta. Kishte frikë mos e merrnin vesh fshatarët. Kish të drejtë.

Të nesërmen u ngritëm në mes të natës. Isha me të ndjerin babanë tënd, me mavrinë Thodhori. Anika vinte pas, me një trastë në dorë. Te Bregu i Pulës dëgjuam këmbët e një kafshe. Babai tënd na bëri shenjë të uleshim. U fshehëm. Ai që vinte, ishte Foni Liti. I kishte thyer këmbën lopa dhe bënte zahire nga fusha. Nuk na pa. Babai tënd ndërroi rrugë, që të mos na shihte njeri. Ç'kemi bërë gjithë atë udhë nëpër ato gjemba e ujëra anës lumit! Ai ecte përpara dhe herë-herë kollej. Ne e ndiqnim nga pas. Na dukeshin drurët njerëz, kaq shumë ruheshim. Kishim të drejtë. S'ishte gjë e paktë të merrnin vesh që e nxore vajzën dhe ta kthyen. E gjora Anikë! Më kujtohet si tani; të them të drejtën, hiqte nga zemra, psherëtinte. Ishte vajzë, po vinte e paktë në trup. Po ka qenë si engjëll. Te Ura e Vjetër e zuri një kollë që e mbajti shumë. U shqetësuam. Ajo u ul në gju një dhe kollej. Unë i fërkoja ballin. Ç'të bëja? Babai tënd sillej përçark. Pastaj u afrua. Nxori diçka nga xhepi i palltos së leshtë dhe tha:

— Jepi të pijë.

— Pi, — i thashë unë.

— Ç'është? — tha Anika.

— Raki.

— Nuk e pi, — tha ajo.

— Pije, — tha babai.

— Nuk e pi, dajko, — tha ajo.

Ai ndali këmbët. Anika ktheu shishen. E ktheu dy

herë. Pastaj kroi zërin dhe pas një çikë u ngrit. Nuk u koll më. Fundrat e këmbëve na ishin lagur dhe, tani që ndenjëm, kishim ftohtë. Ai pinte duhan dhe ecte shpejt.

Kur arritëm në xhade kishte zbardhur. Ndalëm. Atje pranë ishte një krua dhe u lamë. Nxorëm rroba nga trasta dhe u veshëm. Veshëm edhe çorape. Anika kishte një palë çorape të mira, të holla. Po ishte e paktë në trup, e gjora. Ashtu ka qenë. E gjatë dhe e hollë. Si thekër e egër, thoshin në fshat. Po ka qenë gojëmjaltë që atëherë.

Në xhade bëmë gjysmë sahat. Pastaj arritëm në fund të qytetit, në postbllok. Babai tënd ndaloi para se të hynim në postbllok. Unë iu afrova. U afrua edhe Anika.

— U lodhe, dajko? — tha ajo.

Ai e shikoi në sy. Po ajo uli kokën.

— Sido që të bëhet, unë pres te rrapi përpara kafenesë, — tha ai. — Një sahat, dy sahatë, pesë sahatë. Atje më keni.

— Mirë, — thashë unë.

— Ke marrë lekë? — pyeti Anika.

Ai e shikoi në sy dhe mërmëriti:

— Kam.

Ajo përsëri uli kokën. Ai ktheu krahët.

— Mirë, — tha.

Bëri disa hapa dhe ndaloi. U qasa pranë tij.

— Ata të flasin më shumë, — tha ai dhe iku.

Një copë herë nuk luajtëm. Ai kishte humbur, kur ne u nisëm drejt qytetit për nga ambulanca. Po te postblloku ndalëm. Ç'të të them, o bir! Na doli përpara Miho Tali. E ke njohur Miho Talin? Ka marrë nuse nga fshati ynë. Është martuar përpara luftës. Ai është nga Rebasi. Rebasi është larg sa të pish një cigare nga fshati i Kënos, nga fshati i dhëndrit që prisnim ne. Miho Tali na doli përpara.

— Erdhët? — tha.

Ai kishte dalë për të na thënë diçka. Kuptohej. Unë s'dija ç'ti thosha. Anika u drodh si një fletë.

— Mirë, — tha. — Ti, vajzë, ç'bën?

Anika i zgjati dorën.

— Mirë, — tha ai përsëri dhe doli në anë të xhadesë. Drodhi duhan dhe e ndezi. Unë u afrova atje. Ai piu dy-tri herë duhan, pastaj tha:

Dëgjo.

— Dëgjoj, — i thashë.

— Bëra tërë natën udhë që t'ju arrij. Do keni mendjen.

— Po ja, — i thashë, — si të kemi mendjen?

Ai piu përsëri duhan dhe bëri më tej. Unë e ndoqa nga pas.

— E njeh atë Vjeno Leçen?

— E njoh, — i thashë.

— Ajo ka sharë vajzën.

U drodha.

— E ka sharë, qenia, e ka sharë! Ka thënë se i ka këmbët të holla. Për këtë llafosin në fshat tani. Prandaj... kini mendjen. Ai ka ardhur. Ka me vete një kunatë, dhe ajo do ta shikojë nga këmbët... Unë këtu do të jem, je, aty përtej. Kur të ktheheni, do t'ju dal përpara.

— Mirë, — i thashë.

— Me kë keni ardhur?

— Me Thodhorinë, — thashë.

— E pashë, — tha. — Mirë, kini mendjen.

O perëndi, thashë. Më rëndoi gjoksi. Ç'të bëja? Anika më shikonte në sy dhe dridhej. Kishte ftohtë. Edhe unë kisha ftohtë. Frynte pak erë. U kthyem nga e majta.

— Rri këtu dhe pritëm mua, — i thashë.

Ajo më shikoi në sy, sikur të më pyeste.

— Mirë, — tha dhe fërkoi duart.

U ngjita në qytet. Me një frymë arrita në tri-katër shtëpi të këtyre fshatareve tona që janë martuar atje. Gjeta pesë palë çorape, i futa në gji dhe u kthe-

va. Anika nuk ishte atje. Shikova përqark, andej-këtej. Po ajo s'dukej.

— O grua, — tha një fëmijë dhe më ra në bërryl. U ktheva nga ai.

— *Ankën* kërkon?

— Anikën, — thashë dhe ndjeva se si m'u drodh diçka përbrenda.

— Eja pas meje, — tha ai.

Ai iku përpara dhe unë i vajta pas e hutuar.

— Kishte ftohtë *Anka*, — tha ai, — dhe ne i kemi bërë zjarr. Eja.

Nuk fola. Ai hyri në një rrugicë të ngushtë e të shtrembër. Anëve kishte ca shtëpi të ulëta me gurë të zinj (tani nuk janë më ato shtëpi). Ai fërshëlleu dhe unë u tremba. Atje tej doli një djalë tjetër pak më i rritur. Edhe ai ishte jevg. (Kështu u thoshim atëherë, o bir.) Pas atij djali ngrihej tym. Ndala.

— Ec, — thirri ai që ishte përpara. — Ec ngrohu edhe ti.

Ai u kthye dhe më mori për dore. Dora e tij e zezë ishte e përzbardhur, sikur mbi të të kishte rënë çaf. Nga të ftohtët ishte plasaritur. Unë shkoja pas tij. Pak më tej, në anë të asaj rruge të ngushtë e të shtrembër, kishte vërtet zjarr. Pranë zjarrit dallova Anikën dhe rreth saj tre-katër djem të tjerë të vegjël lëkurëzinj. Anika u ngrit në këmbë dhe qeshi.

— Eja, — tha ajo. — Më morën këta.

Ajo mblodhi supet e vogla dhe foli sikur të ishte fëmijë.

— Janë të mirë, — tha ajo. — Në fillim më ngacmuan, po pastaj ndenjën me mua. Njëri më pruri bukë. Unë nuk e mora, po ai ma lëshoi në prehër. Njerëz janë edhe këta!

Ata shikonin nga ne, sikur të ishin të huaj dhe të mos e dinin gjuhën. Po vërtet ishin të mirë.

— Ku do veni? — tha njëri nga ata.

— Do ikim, — thashë unë.

— Në doni, vishuni këtu, — tha ai. — Fshatarët

vishen aty poshtë, po ju vishuni këtu, dhe ju ruajmë ne.

Anika qeshi dhe më shikoi në sy.

— Ke frikë, Anka? — tha tjetri. — Mos ki frikë.

Anika më kapi nga bërryli.

— Ku? — thashë unë.

Njëri nga ata u afrua dhe tha:

— Këtu pranë zjarrit.

Të tjerët morën gurë nëpër duar dhe u përhapën.

— Aty, — tha ai dhe u largua. — Mos kini frikë.

Atje ishte vend i heshtur, i shtruar me kalldrëm. Në të dy anët ishin dy shtëpi, po nga ato s'doli njeri. Tani atje është ngritur kinemaja e madhe dhe përqark ka apartamente. Anikës i veshja gjashtë palë çorape njëra mbi tjetrën dhe ia lidha fort, që të mos i mblidheshin rrudha.

— Pse gjashtë palë? — belbëzoi ajo me zë të dri-dhur dhe u skuq.

— S'ka gjë, — i thashë.

Ajo nuk foli, po u skuq shumë.

— Mbase nuk do të ketë shi sot, — thashë unë.

Ajo nuk foli. Te kthesa dolën të katër jevgjit.

— Do shikoheni me burrin? — tha njëri nga ata.

Anikës iu drodh buza dhe qeshi me dhembje.

— Ç'të bëjmë, — thashë unë nëpër dhëmbë dhe nxitova.

— Janë të mirë, — mërmëriti Anika.

— Mos kini frikë, — thirri ai që ishte më i shkurtër.

Si tani e kam në sy. Kishte kokë të rrumbullakët dhe flokë të qethur shkurt, se të lashë fjalën përgjysmë. Këtë djalë e pashë edhe herë të tjera. Po më vonë e humba. Nuk e pashë më. Më duket se luan top atje në stadium. Mbase... Ne jse. Ne nxituam.

— Mos u tremb, — i thashë Anikës.

Ajo u koll. Unë mbajta këmbët. Njëqind çape më lart ishte Ambulanca. Atje ishin ata. Unë e njihja veshjen e fshatit të tyre. Ngjitëm të përpjetën. Dhe

vërtet, në anën e majtë, përpara nesh, ishin *ata*. Unë i shqova. Thashë një herë mos ishin të tjerë, po jo. Ata ishin: Kënuar dhe ajo. Ajo ishte kunata. U tremba shumë nga kunata e tij. Ata na panë, dhe kunata menjëherë doli më përpara. Ai mbeti te vendi.

— Këta janë, — i thashë Anikës me zë të ulët.

Anika uli kokën.

— Ngrije pak kokën.

Kunata ishte atje tej. Ecnim ngadalë. Ajo shikonte nga ne me një sy të sprovuar. Edhe mua më drodhi ai sy. Më dogji diçka përbrenda në stomak. Vajzës sikur iu prenë gjunjët.

— Ec, — i thashë.

— M'u prenë gjunjët, — tha.

— Bëj gajret, — i thashë.

— Turp, — mërmëriti Anika. — Uh! Turp, hallë!

— S'ka turp, jo, — i thashë. — Se mos janë *ata* më të mirë!

Ç'të thosha, o bir! Atje në pazar, përpara nesh, ai vërtet ishte si një lis i rritur në tokë të majme. Gjithë ai Këno! Edhe sot ashtu është, dhe ca më i trashë akoma. U tremba sa s'thuhet dhe solla ndër mend gjithë atë udhë që kishim bërë natën, dhe kujtova fatin e vajzës. U munduam kot, thashë, dhe më erdhi në mend Vjeno Leçja. Ula kokën dhe shikova këmbët e Anikës. Ato dukeshin të bëshme, të shëndetshme dhe i pashë gjithë gëzim. Ato çaste Anika m'u duk e bukur. Po menjëherë m'u kujtua se kishite veshur gjashtë palë çorape njëra mbi tjetrën dhe ndjeva të ftohtë. Kunata me siguri shikonte këmbët e saj. Ajo ishte afruar edhe më pranë udhës. Anika u koll lehtë. Nuk u koll për herë të dytë. Kaluam pranë tyre. Unë i shikova ata të dy. Kunata as më shikoi fare. Ajo ishte vërtet si xhambaze. Shikonte Anikën nga këmbët. Kurse ai shikonte me turp, jo drejtpërdrejt. Po edhe ai sikur shikonte te këmbët. Si vetëtimë më kaloi në kokë fytyra e Vjeno Leçes. Po pse, o Vjeno Leçe i re më qafë vajzës! Pse, o...

I pashë përsëri në sy. Përsëri kunata nuk e ngriti kokën. Kurse ai sikur shikoi ashtu butë. M'u duk që në atë kohë i butë e i afërt.

Vazhduam të ngjiteshim. Tani ata i kishim lënë prapa dhe patjetër që na shikonin ne. Po ne për atë punë kishim dalë.

— E pe? — i fola ulët Anikës.

Asaj iu drodh kombi i grykës dhe mërmëriti:

— Hallë!

Ktheu kokën e më shikoi drejt në sy.

— E pe?

— Jo.

Nuk fola. Rruga kthehej në të djathtë. Kur po ktheheshim, ndala. Shikova prapa. Ata nuk dukeshin.

— Do kthehemi prapë, — i thashë.

Anika nuk foli. Mezi merrte frymë.

— Anka, — thirri papritur dikush.

Pranë nesh ishte ai djali, ai jevgu me kokën e rrumbullakët dhe me flokët e prerë shkurt.

— Mos u tremb, — tha ai.

Anika u shkri në fytyrë dhe qeshi. Ka të qeshur të dashur, të ëmbël. Ai shikoi prapa dhe fërshëlleu lehtë. Atje doli njëri nga shokët e tyre.

— E? — tha ky.

Ai lëvizi gishtin, sikur të thoshte: «Jo».

— Nuk po vijnë, — na tha ai. — Nuk po vjen as ajo, as dhëndri.

Anika i lëmoi kokën si motër e madhe. Ai uli kryet. Aty u qasën edhe dy të tjerë.

— Trastat na i jepni neve, — tha ai.

Unë u druajta. Nuk guxova. Po Anika më shikoi në sy dhe i zgjati trastën. Ai tërhoqi edhe trastën time dhe ia dha një shoku. Ngriti kryet lart dhe na shikoi drejt. Qerpikët e shkurtër të murmë i lëviznin paprerë.

— Mos kini turp, — tha ai dhe u nis të ikte. Po u kthye dhe ndaloi në vend. Shikoi Anikën drejt dhe tha:

— Anka! — dhe uli kokën si fëmijë. Fëmijë ishte.

— Fol, — thashë unë.

— Nxirri flokët nga shamia. Ti i ke të bukur.

Ai tha këto fjalë dhe nxitoi. Ne shikuam njëra-tjetrën në sy. Anika psherëtiu dhe hoqi shaminë. Flokët i kishte vërtet të bukur. Ata iu derdhën supeve. Unë mora shaminë e saj dhe e futa në gji.

Ata kishin ikur të gjithë. Ne u kthyem përsëri. Kunata dhe ai ishin përsëri atje. Unë e dija që duhej të ktheheshim patjetër.

Ndaj u kthyem. Ata na panë dhe u larguan pak nga njëri-tjetri. Kunata u afrua buzë udhës me kall-drëm. Ajo na ndiqte me kujdes të madh, me shumë vëmendje. Unë tani e dija se si shikonte ajo. Ishte ulurimë, të them.

Ngrita pak kokën. Ai ishte më tej. Kish kthyer njërin krah dhe shikonte përtej supit. Ishte si lis. Shikova përsëri kunatën. M'u duk më e zbutur. Ajo lëvizi dhe iu qas pranë Kënos. Seç i tha. Ai nuk lëvizi fare kokën. Ne kaluam më të poshtë.

— Tani do të kthehem edhe një herë, — i thashë Anikës.

Ajo ndali në vend dhe uli kokën në gjoks.

— Edhe një herë! — i thashë.

Ajo ngacmonte flokët e saj dhe tha:

— Ooo, kjo...

E tha këtë sikur të thoshte: më mirë të vdes.

— Edhe një herë dhe ikim, — thashë.

— S'më pëlqen... — mermëriti e pikëlluar.

— Mos kështu, — i thashë.

— Nuk dua as... — tha ajo.

(Ajo donte të thoshte: «Nuk dua as burrë»).

— Ti je e zgjuar, — i thashë.

— Ç'e zgjuar!

— Hë, bijë, — i thashë. Asaj iu lagën qerpikët. Iu lagën, sikur të kish rënë vesë mbi ta. Vajza atë kohë m'u duk si jetime. M'u dhimbs. E mblodha veten dhe i thashë:

— Ja, tani ikëm. Hera e fundit që do dalim.

Ajo belbëzoi diçka. Belbëzoi e lodhur. Kishte një lodhje të madhe, sikur të kishte kthyer me plug tërë fushën. Ishte e zgjuar Anika dhe i vinte rëndë. Po ç'ti bësh: koha! Ashtu i bënim martesat atëherë. Ishte fill pas Çlirimit. Tani ndryshuan kohët, o djallë!... Unë eca përpara. Ajo fshiu lotët dhe më ndoqi. U mundova ta bëja për të qeshur. Tani më vinte edhe mua inat. Vërtet kishim dalë si në pazar të kafshëve. Ky zakon kishte kohë. Po atë ditë na rëndoi shumë. Ne ishim njerëz pa fis. Në fshat sundonte fisi. Anika...

Këtë radhë vendosej. Mbase nuk do të bëhej gjë. Shikova fshehurazi Anikën. Këmbët i kishte të mbushura. Tani sytë e atyre të dyve ndiqnin këmbët e Anikës. Po këmbët ishin të mbushura. Pas pak do të kalonim pranë tyre. Kunata do të largohej. Po mbase... Mbase edhe mund të afrohej dhe mund të na fliste. Po të afrohej dhe të na fliste, domethënë që ata e kishin pëlqyer vajzën dhe pas kësaj do të shkonim në klub të pinim kafe e të zinim duart. Jo kafe, po të hanim llokume. Zakonisht kështu bëhej. Djalli ishte i mirë. Mua më pëlqeu, po Anikës nuk i thashë asgjë, se s'dihej si mbaronte puna. Po të mbaronte keq, djalin do ta shaja. Ç'të bëja!

Po afroheshim. Unë shikova përpara. Kunata kishte dalë në mes të udhës dhe bënte buzën në gaz, sikur të njiheshim. U ngroha. Nuk kisha kohë të mendoja. Një plakë e veshur me të zeza kaloi pranë dhe ndali.

— Ndhimë një çikë, — thirri.

Ajo kishte një çantë të thurur me copa meshini. E kishte të rëndë. Anika iu afrua dhe ia ngriti.

— Nga je? — e pyeti plaka.

Unë i fola Anikës. Kunata vazhdonte të buzëqeshte. Anika erdhi pas meje. Kunata u afrua, zgjati duart dhe m'i hodhi në sup. Më shikoi drejt dhe tha:

— Halla?

— Halla, — i thashë.

— Unë jam kunata, — tha.

Ajo ktheu kokën prapa dhe i foli djalit. Ai s'luante nga vendi. Pastaj ajo më puthi mua fort. E putha edhe unë.

— Eja këtu, — i tha Anikës.

Anika u qas dhe kunata e shikonte me vëmendje të madhe, sikur do ta hante. Ne gratë jemi të prapa. Mirë thonë, që futim shejtanin në shishe.

Anika u drodh. Ç'të të them si u drodh!

— Fol një fjalë, — tha kunata.

Anika u skuq dhe bëri buzën në gaz. Edhe unë u drodha. Kunata ishte si ata që shikojnë kuajt nga dhëmbët.

— Fol një fjalë, — tha kunata.

Anika tundi kokën. M'u duk sikur do të fliste, po fjala i mbeti nëpër buzë.

— Pa gojë e keni këtë vajzë? — tha kunata.

— Akoma është mëngjes, — thashë unë.

— Më mirë të na i thotë ca tani, që të mos na i hedhë të tëra kur të vijë te ne, — tha ajo.

Anikës sikur i këputej koka. Kunata qeshi me të madhe dhe ia mori kokën në gjoks. Pas kësaj ajo na shpuri te djali. Ai na zgjati dorën e na shikoi drejt. Shikonte egër, po mua më hyri në zemër dhe doja të rrija pranë tij.

— Mirë jeni? — tha ai.

— Mirë, — thashë unë.

— Vajzën e kemi të turpshme, — tha kunata. — S'ka mësuar të flasë akoma.

Kunata qeshi me të madhe dhe mënjanoi kokën për të shikuar më mirë Anikën.

— Bie shi andej? — tha djali.

— Ka rënë, — thashë unë.

Kunata më pa në sy dhe ma bëri me shenjë që unë dhe ajo të largoheshim.

— Tani vijmë, — tha kunata dhe qeshi. — Nuk të ha; nuk e kemi të lig djalin.

Anika më shikoi në sy. Unë ika. Filloi të binte shi me pika të mëdha.

— Do vijmë, — i thashë Anikës.

Ikëm. Dolëm poshtë te një udhë tjetër e ngushtë. Kunata s'pushonte. Ajo më pyeti se ç'fëmijë kisha dhe më tha se jemi fshat i keq. Unë e kuptova se ku e kishte fjalën. Vjeno Leçja, që kishte thënë për Anikën se i ka këmbët të holla, ishte vajzë nga fshati ynë. Mjafton një njeri i lig, që atje larg të shahet gjithë fshati.

Shiu u bë më i dendur. Hymë te streha e një porte.

— Le të llafosen me njëri-tjetrin, — tha ajo.

— Nuk e lë vajzën udhëve, — ia ktheva unë.

Më dukej sikur Anika ishte atje në udhë dhe lagej nga shiu. U drithërova.

— Nuk është vetëm, — tha ajo.

Unë blova diçka nëpër gojë.

— Hallë, mos u zemëro, — foli prapë kunata. — Mua më pëlqeu.

Unë nuk fola.

— Po ti? — tha ajo papritur.

— Qysh unë?

— Të pëlqeu djali?

— Ne nuk e pamë, — thashë.

Ajo qeshi, sikur thyente arrë, dhe tha:

— E ç'ti shikosh djalit?!

Nuk u ndjeva.

— Keni tabiat të rëndë, — tha.

— Bie shi, — thashë.

— Ka kohën, — tha.

— Dalim?

— Prit edhe një çikë, — tha. — Nuk është sheqer e do të shkrijë.

— Sot erdhët?

— Djali erdhi sot.

— Dalim, — thashë përsëri.

Nuk më rrihej. Dola e para. Ajo më ndoqi nga

pas. Shiu nuk kishte pushuar. Në mes të udhës më zuri nga krahu.

— Do të kalojnë jetë të mirë, — tha.

Ata të dy ishin atje nën strehën e dyqanit. Dyqani ishte i vogël, me dërrasa dhe me strehën përpara si të kapelës. Ishin pranë njëri-tjetrit, po nuk i pashë të flisnin. Anika më pa dhe u llahtaris. Hy më të katërt nën atë strehë. Kunata qëndroi pranë Anikës.

— Ke ftohtë? — i tha.

Anika nuk foli. Nuk i tha që s'kishte ftohtë. Ajo nuk di të gënjejë. Po kunata ishte dhëlpër. E shikonte në fytyrë, në trup, në këmbë.

Pikat e shiut u rralluan. Unë e pyeta ashtu kot djalin. Ai më kthente fjalët shkurt dhe më shikonte drejt në sy. E pyeta përsëri. Pastaj më foli ai:

— Ke të mardhur?

— Një çikë, — i thashë.

— Unë e kam bërë ushtrinë në Veri.

— Sa vjet?

— Tre.

— Epo mirë, — tha kunata. — Bëjmë më këtej ne?

Ajo mori djalin dhe doli nga streha. Ktheu kokën dhe bëri një shenjë që të pyesja Anikën.

— Si ishte? — pyeta Anikën.

Anika s'foli.

— Ç'të tha?

Ajo ngriti kokën.

— Nuk më tha gjë.

— Asgjë?!

— Më pyeti për emrin?

— Vetëm për emrin?

Ajo uli kokën.

— Po thuaj de, nuk të tha gjë tjetër?

— Më tha.

— Ç'të tha?

— «Më do mua?» tha.

- Po ti ç'i the?
- Unë s'fola.
- S'fole?
- Ai tha: «Unë të dua. Po ti?»
- Ç'i the ti?

Anika s'foli.

- Po ç'i the, moj?
- Thuaja ti, hallë.
- Po si thua ti?

Ajo ngriti supet.

- Si t'i them? — e pyeta prapë.
- Si të thuash ti, — mërmëriti ajo.

Kështu thoshin njëherë: «Si të thuash ti». Nga kjo kuptohej që vajza pranonte.

- Po si t'u duk djali? — i thashë.
- Pse të jetë i keq?
- ... ? !

Erdhi kunata. Ai rrinte më tej. Ajo qeshte. Shikoi Anikën dhe tha:

- Ç'thoni?
- Ç'thoni ju? — thashë unë.
- Të shtrenjtë jeni, — tha ajo.

Unë bëra buzën në gaz.

- Neve na hahet llokume, — tha kunata.

Anika bëri një lule atje te këndi i buzës. Mbase këtë e shqova vetëm unë. «Neve na hahet llokume». Kështu thuhej kur takoheshin në qytet dhe kur të dy palët e pranoinin njëri-tjetrin. Shkonin në kafezinin duart, për besë dhe hanin llokume.

- Neve na hahet llokume, — tha ajo prapë.
- Edhe neve, — thashë unë.

Ajo puthi Anikën në të dy faqet. Unë e shikova Anikën në sy, po Anika nuk e puthi atë. Këna dridhte duhan.

- Kur do t'i hamë llokumet? — tha ajo.
- Kur të doni, — thashë unë.
- Pas gjysmë ore, — tha djali.

Ai shikoi Anikën me bisht të syrit.

- Mirë, pas gjysmë sahati takohemi te Kafja e

Rrapit, — tha kunata. Ata na zgjatën dorën dhe u larguan. Ne mbetëm atje. Shi nuk binte. Aty-këtu nëpër kalldrëmin e prishur kishte pellgje. M'u kujtuan ata fëmijët.

— Ç'mendon, moj hallë? — tha Anika.

— Ku do t'i gjejmë ata?

— Kë?

— Jevgjit.

— Gjynah, moj hallë. Janë të mirë, pse t'u themi «jevgj»?

— Po ku t'i gjejmë?

— Do të vijnë, — tha Anika.

Unë shikova te kreu i rrugës. Ata nuk dukeshin. Dolëm nga streha.

— Në kafe do vemi?

— Në kafe, po duhet të bëjmë një gjë, — thashë.

— Çfarë?

— Ajo kunata është dhelpër.

Anika ndali dhe më shikoi në sy.

— Është dhelpër, — thashë, — po ai është djallë i mirë.

— Pse të jetë dhelpër? — tha ajo sikur t'i fliste vetes dhe dukej se i vinte keq që në botë kishte edhe dhelpëra.

Asaj i zbriti të kuqtë dhe uli kryet.

— Kështu bëhen këto punë, — thashë. — Çorapet do t'i heqësh.

Anika ngriti kokën dhe më shikoi drejt me ata sytë e përhimtë.

— Të mbash veshur vetëm një palë, se ajo do ulet atje pranë teje dhe do të të shikojë sa palë çorape ke. Mirë?

Ajo hoqi thellë nga gjoksi, dhe unë e ndjeva që ishte e pakënaqur. Nuk i kanë pëlqyer Anikës këto gjëra, nuk i treste dot...

Po ngjiteshim udhës me kalldrëm. Kur do të ktheheshim nga e djathta, ai djali i vogël me kokën e rrumbullakët dhe flokët e prerë, ndali përpara nesh

dhe na shikoi në sy. Nuk të them dot sa m'u ngroh zemra dhe sa i mirë m'u duk ai djalë! Kështu është, o bir. Mos i shih njeriut bojën, thoshin njëherë pleqtë e parë. Ai djali na shikonte në sy. Nuk fliste. Dukej sikur priste që t'i flisnim ne. Unë i ula pëllëmbën mbi kokë. Anika më shikoi në sy dhe bëri buzën në gaz e kënaqur.

— Mirë, — thashë unë.

— Do veni te Kafja e Rrapit? — tha ai.

— Do vemi.

Ai shikoi Anikën dhe qeshi. Anika vaisi kokën.

— Duhet trasta?

— Ku e keni?

Ai u kthye nga e majta dhe bëri një shenjë me dorë. Njëri nga shokët e tij solli trastën.

— Kërreji çorapet, — i thashë Anikës.

Ajo shikoi përçark.

— Do visheni? — tha djali.

— Do vishet, — thashë unë.

— Eni aty tej, — tha ai.

Dhe bëri përpara. Ne shkuaam pas tij. Diku më tej ishte një gjërmadhë.

— Aty, — tha ai. — Mos kini frikë.

U largua. Ne hymë brenda në gjërmadhë. Anika rrinte qiri në këmbë.

— Hiqi, — i thashë.

Ajo nuk lëvizi. M'u dhimbs. Unë e kuptoja, por e shtypja dhembjen. Fundja, atje në kafene do të bisedonte edhe babai yt dhe ai do ta gjykonte më mirë. Po këta kishin pyetur për djalin. Unë iu luta përsëri Anikës, dhe më në fund ajo uli shpinën dhe nisi të nxirrte çorapet. Pesë palët e çorapeve i futëm në trastë. Dolëm në rrugë.

— Sille trastën, — tha ai djali. — Ne atje në Lagje jemi.

Ai e mori trastën nga dora ime dhe u largua. Ne ecëm shpejt. Arritëm në kafene. Në një tavolinë më

vete ishte babai, babai yt. U ulëm atje. Ai më shikoi në sy.

— Mirë, — i thashë.

— Takova Miho Talin, — tha ai.

— Edhe ne e takuam, — i thashë.

Ai nuk foli. Shikoi Anikën në sy.

— Ke ftohtë? — i tha.

Ajo uli kokën dhe mërmëriti:

— Jo.

— Do një ëmbëlsirë?

Ajo tundi supet për të kundërshtuar. Babai shikoi nga hyrja.

— Do hamë llokumet, — thashë.

Ai më shikoi në sy me dashamirësi.

— Djalë i mirë, — tha.

— Edhe ne e kemi vajzë të mirë.

Ai u kollit. Në kafene hynë ata. Kunata u ul në krahun e majtë të Anikës. Në krahun e djathtë u ul djali. Në fillim biseduam për gjëra në përgjithësi. Djali, papritur fare, i foli kamerieres. Na pyeti se ç'dëshironim dhe porositi. Kunata e shikoi në sy, po ai vazhdoi bisedën me babanë tënd. Që atë kohë i foli *dajko*. Unë e kuptova që ishte djalë i mirë. Ma deshi gjaku.

Kunata mënjanoi karrigen dhe u largua pak nga Anika. Ajo kishte ulur dorën në supin e saj. Pastaj kunata ia mori dorën dhe ia lëmonte. Dora e kunatës më futi frikën. Ajo i prekte të gjitha me radhë. Pastaj tha:

— Sa të mira i ke këto çorape!

Uli kokën dhe i preku çorapet. I preku dy-tri herë.

— Sa të mira!

Anika u mblodh një grusht dhe u skuq si asnjëherë. Babai nuk shikonte andej. Unë mendova përsëri shumë keq për kunatën. Sidoqoftë nuk ma hodhi. Ajo e besoi se Anika kishte dalë me një palë çorape. Unë atë çast mendova që në fund të mos ngriheshim

menjëherë nga tavolina, po t'u thoshnim atyre se prisnim dikë. Gjeta rastin dhe ia thashë këtë babait tënd. Ai nuk më shikoi në sy, po më kuptoi.

I hëngrëm llokumet dhe ne të katërt pimë kafe. Ata caktuan ditën se kur do të vinin në fshat për të shkelur shtëpinë e nuses, dhe ne pranuan. Pastaj folën që të ngriheshim, po babai yt tha se ne do të rrinim edhe ca që të prisnim dikë. Djali na shikonte në sy, sikur na lutej që të mos ndahej. Të piqet ylli i ballit, thotë populli. Iu poq.

Ikën. Ne u ulëm përsëri.

— Djalë i mirë, — thashë unë.

Babai i shtrëngoi dorën Anikës. Anikës i shkanë lotë. Ai porositi përsëri ëmbëlsira. Kamerierja na uroi. Babai pagoi edhe një ëmbëlsirë për të. Unë bleva gjashtë copë llokume të mëdha dhe i mbështolla me një letër. Pas ca u ngritëm. Zbritëm nëpër një sokak të verbër. Tani ai sokak nuk është më. Pa arritur në postbllok, u kthyem nga e djathta. Nuk bëmë as pesë çape, dhe ata të katër jevgjit u mblodhën menjëherë. Më tej ishin edhe dy të tjerë.

— I hëngërt llokumet? — pyeti njëri.

Unë qesha. Anikës i ndritën sytë.

— Jeni të ftuar në dasmë, — u thashë.

Ata nuk folën. Të gjithë shikonin Anikën, sikur ajo të ishte e tyrja dhe jo jona. Pastaj njëri nxori frastën. Unë i zgjata llokumet e mbështjella në letër. Anikës iu lagën sytë. Mbeta e ngrirë në vend. Pastaj u kthyem. Në postbllok babai yt ishte takuar me Miho. Talin.

Vuajtëm shumë derisa arritëm në fshat. Ishte natë e zezë dhe fusha kishte llucë. Këta në fshat kishte rënë për të fjetur, po gjumi nuk i kishte zënë.

Pas dy ditësh Kënuja erdhi vetë. Ne u çuditëm. Ai erdhi vetëm, pa kumatën, dhe mua m'u duk edhe më i mirë. Kështu...

Kanë kaluar shumë vjet që atëherë. Rri e mendohem ndonjëherë, se nuk harrohen ato kohë. Kujtoj

edhe ata fëmijët e Lagjes. Dhe që atëherë më ka ardhur keq që këtij Kashos që kemi në fshat i thonë nganjëherë: «evgjit».

Eh, o bir! Ndryshuan kohët, ndryshuan shumë. Një herë e një kohë njerëzia martoheshin pa u parë me njëri-tjetrin. Pyeti pleqtë të të thonë. Më vonë, ca vite pas Çlirimit, dilnin atje në Ambulancë dhe shikoheshin. Po tani erdhën ditë të tjera dhe s'mjaf-ton vetëm me një të parë në udhë. Tani të rinjtë njihen në punë, në shoqëri dhe për martesat s'ngatërrohen më hallat e kunatat. Nuk para ngatërrohen. Bëri dasmë Anika, bëri dasmë. Martoi djalin e madh. U gëzua ajo, u gëzuam ne, gëzoi edhe fshati. Nusen e gjeti djali me dashuri; e gjetën vetë njëri-tjetrin. Domosdo e njohëm edhe ne, po ai e gjeti vetë atë që do të shkonte jetë dhe e mori. Tani edhe ne e kemi për turp t'u gjejmë nuse fëmijëve. Kanë ardhur kohë të tjera. Ti e ke gjetur?

Halla kishte mbaruar së treguari. Tani më shikonte drejt në sy. Unë mendoja për Anikën. Fytyra e Anikës shkëmbehej e përzihej me fytyrën e Kënos.

Përjashta akoma lehte qeni. Njëpër fshat po lëviznin njerëz.

PO TI SI THUA?

Ç'TREGOI MËSUESI PËR RAMNIUN:

Kisha një muaj e ca që jepja mësim në atë shkollë. Në klasën e tyre shkoja më shpesh, sepse jepja edhe gjuhë edhe letërsi. Ramni u rrinte atje në bankën e parafundit, në rreshtin e anës së majtë: Nuk ishte shumë i gjatë, po as i shkurtër. Kishte pulover të leshtë, me jakë, nga ato që punojnë vetë fshatarët. Ramni nuk dallohej për shëndet, po kishte qafë të derdhur elastike. Kur shpjegoja mësimin, më ndiqte me kujdes dhe s'm'i ndante sytë. Kishte raste kur dyshoja në se ai më ndiqte. Shumë prej nxënësve të klasës më shoqëronin duke lëvizur kryet, duke pohuar a duke folur edhe me zë të lartë. Po Ramni nuk fliste. Rrallë përplaste qepallat e vogla nën vetullat e holla, të drejta. Duart i mbante gjithmonë shtrirë mbi bankë. Qëllonte shpesh që merrte notën dhjetë pikërisht kur të gjithë ata që pyeteshin, ishin të papregatitur. Kjo ndodhte të hënave apo pas ditëve të festave. Një gjë e tillë më pëlqente, po ki-

shte edhe raste kur ndieja një revoltë të brendshme pikërisht nga kjo gjë.

Një ditë Ramniun e vlerësova me notën tetë. E motivova përgjigjen e tij dhe u mundova që ta bindja, sepse e kisha edhe vetë me dyshim. Pastaj e përgjova me sy, me kujdes. Ai përplasi njëherë qerpikët e paktë dhe u ul në bankë. Atëherë m'u kujtua Luljeta Krasniqi. Luljetën e kam pasur shoqe në shkollë të mesme, në Tiranë. Ajo mbante syze të bardha dhe, në fillim, unë që isha nga fshati, e kisha vështirë t'i afrohesha. Kisha një ndjenjë të keqe dhe pështirosje ndaj atyre që mbanin syze dhe sidomos syze me skelet të bardhë. Pas ca kohe u afrova me Luljeta Krasniqin. Qysh e si, nuk di ta them. Në pushimin e gjatë ajo hante bukë të bardhë me gjalpë. Më jepte edhe mua. Luljeta Krasniqi ishte e çuditshme. Në çdo pushim hapte librin dhe lexonte. Edhe kur hante bukë të bardhë me gjalpë, lexonte librin. Ishte nxënëse shumë e mirë, domethënë merrte nota shumë të mira. Po qëllonte që merrte edhe ndonjë notë mesatare apo të ulët, apo pakaluese. Dhe këtë e merrte për faj të saj, se ngatërrohej në dërrasë. Kur ulej në bankë, qante me dënësë, dhe unë shihja se si i hidheshin përpjetë supet dhe shpina. Ajo qante edhe në pushim. Mua atëherë më kujtohej se si i mbetej gjalpi i shkrirë nëpër buzët e squllura, dhe ndieja neveri për të.

Po nga ajo nuk u ndava. Kjo kishte arsyen e vet. Ajo vinte nga qyteti në shkollë së bashku me një vajzë tjetër. Vajza tjetër, që vishej me përparëse të zezë, kishte lëkurë gruri dhe shikonte si e druajtur. Ajo quhej Marjana. Ishte në paralelin përbri. Djemtë e klasës sonë thoshin që ajo s'ishte e bukur. Mua nuk më trishtonte ky fakt. Ndoshta ky s'ishte një fakt. Unë vazhdoja ta prisja Luljeta Krasniqin, megjithëse më neveritej kur mendoja se nëpër cepat e buzëve të squllura i ngelej gjalpi.

Unë rrija atëherë pranë Marjanës dhe gjeja ras-

tin të flisja me të për filma, për artistë, për teatrin dhe pikturën. Marjana nuk donte që unë të bëhesha artist i teatrit. Nuk donte. Unë dhe Marjana...

Ja, pra, se si m'u kujtua pikërisht sot kjo Luljeta Krasniqi, që bëri të më sëmbojë e të më godasë në zemër diçka e largët, që u krodh thellë në ndjenjat e mia të njoma. Tashti Marjana dhe Luljeta Krasniqi m'u kujtuan nga shkaku i Ramniut. Luljeta Krasniqi qante kur mernte një notë mesatare apo të ulët.

Ndërsa Ramniu nuk qau. Ai shtriu pëllëmbët e hapura mbi bankë dhe ndiqte lëvizjet e mia. Mua kjo më bëri përshtypje.

Ra zilja dhe të gjithë dolën përjashta. Dola edhe unë. Pas ca hyra në klasë. Atje, në rreshtin e anës, te banka e parafundit ishte Ramniu. Kishte ulur kryet dhe po lexonte librin e gjuhës. Ishte dhënë i tëri pas librit, dhe fytyra e njomë i kishte marrë një ngjyrë të errët. U hoqa sikur hyra krejt rastësisht dhe dola duke tërhequr pas derën. Ai me siguri kontrollonte përgjigjen e tij. Kjo më bëri të mendohesha dhe për një çast më revoltoi. U çudita. Edhe unë shkova e hapja librin dhe kontrollova përgjigjen e tij.

Pas shumë kohe, Ramniut i qëlloi të merrte notën katër. Unë i thashë: «katër» dhe ai heshti. Vetëm përplasi një çast të vogël ato qepallat e pakta. Pastaj u ul në bankë, ndenji drejt, shtriu pëllëmbët e vogla dhe ndoqi lëvizjet e mia.

Ra zilja dhe nxënësit dolën përsëri për pushim. Pas ca hyra në klasë dhe befas u gjenda në dhomë vetëm me Ramniun. Ai kishte hapur librin dhe lexonte.

Bisedova edhe me mësuesit e tjerë. Ata thoshin se Ramniu ishte nxënës serioz. Ai e ndiqte me seriozitet çdo lëndë. Po me atë seriozitet që ndiqte dhe përgatitej në gjuhë dhe matematikë, po me atë seriozitet ndiqte edhe lëndët e vizatimit dhe të ekonomisë shtëpiake. Mësueses së muzikës i vinte keq që ai Ramni aq i mirë s'dinte të këndonte. Shpesh ai ngri-

hej mëngjeseve dhe shkonte te kompleksi fizkulturor atje në fund të fshatit dhe bënte ushtrime në hekur dhe paralele.

Po Ramniu nuk ishte ndër nxënësit që vazhdimisht qëndronte në tabelat e të shkëlqyerve. Për ta, drejtori i shkollës, Avniu, me atë hundë të lyer si me yndyrë, pasi ul kryet mbi ca lista, që vetë ai i ruan me kujdes, thotë: «Ky dhe ky dhe ky janë për tabelë nderi; ky dhe ky dhe ky duhet t'i japin lule udhëheqjes. Ja tek i kam të shkruar emrat e tyre këtu». Pastaj drejtor Avniu thotë: «Prit, se po flas në telefon». Dhe zë e troket mbi xham, siç troket ai shoku i Komitetit Ekzekutiv që jep në filiale leksionet e pedagogjisë, por që vazhdimisht lexon vetëm pedagogjinë e shkollës së mesme dhe që vazhdimisht thotë: «Jam duke përgatitur një kapitull të rëndësishëm të pedagogjisë shkencore të universitetit». (Në qytet atij i thonë: «Njeriu shkencor»). Dhe drejtor Avniu, pra, thotë: «Pëst, pëst, të lutem, Mësuesi! Të vijë pak në drejtori». Në fshat Avniut i thoshin: «Njeriu me hundë të lyer me vaj». Një mësues më tha se këtë nofkë ia paskësh ngjitur Ramniu, po unë nuk kërkova se kush ia kishte ngjitur (përderisa në qytet i kishin vënë shumë nofka: «Njeriu i madh», «I TËRRASHI», «Ai që kërkon të rrijë vetëm me shefa», «Avuvuu...» e tjera).

Dhe ai mësuesi ngulte këmbë që atë nofkë e kishin thënë i pari Ramniu. Po mua nuk më mbushej mendja që Ramniu të ngjiste nofka, sidomos t'i ngjiste nofkë drejtorit! Ramniu kalonte i heshtur e pa bujë. Ja, kështu... Mbase mund të thuhet edhe shumë gjëra të tjera për Ramniun, po unë nuk mundem, sepse ndjenja pak kohë në atë fshat. Mbaj mend që, kur u largova, nxënësit dolën e më përcollën. Aty nga fundi ishte edhe Ramniu. Ai uli kokën, m'u afrua dhe më zgjati një lule. Shokët e ndoqën me kujdes. Ata u habitën se si mund të dhuroheshin edhe lule,

kur largohej një mësues. Në atë stinë lulet ishin të rralla dhe vështirë t'i gjeje. Po Ramniu e kishte gjetur një lule, dhe mua m'u ngroh zemra.

Atëherë nxënësit e vërejtën me zili e habi përzier bashkë dhe shikuan se ç'do të bëja unë. Unë shikova lulen dhe përqafova përsëri Ramniun, që i mbante kryet ulur. Pastaj ai u kthye dhe humbi në turmën e nxënësve.

Unë ecja, dhe ajo lule e vetme me kërcellin e hollë që mbaja në duar, më shtinte vazhdimisht në mendime.

DHE Ç'TREGOI BARIU GUÇE:

Në mbrëmje ai dilte dhe rrinte atje te ndonjë shkëmb apo tej në bregore. Unë harrohesha në punë. Se darkave kemi shumë punë në stan. Darkave dhe mëngjeseve.

E shihja që rrinte atje dhe e merrja me mend se lexonte ndonjë libër. Ai vazhdimisht lexon. Unë i thosha: «Ç'bën kështu?» Në të vërtetë, thellë në shpirtin tim, unë doja që ai të lexonte. Më ngacmonin barinjtë e tjerë, dhe unë u thosha: «O, lëre dermanë, lëre». E thosha kot këtë. Ndieja kënaqësi të jashtëzakonshme, besomë. Dhe puna s'më dukej fare. Ne dëshirojmë që të tjerët të na flasin vazhdimisht mirë për fëmijët tanë.

Kur zinin këto biseda, flisnim për librat dhe njerëzit e kënduar të këtyre anëve. Dhe, kur nisim një histori ne, barinjtë, atëherë sikur shpojme të gjithë diku. Ne i nxjerrim fundin një muhabeti. Ashtu e kemi. Tregojmë sipas mënyrës sonë. Tregojmë në pushime, kur kopeja mërzen e sidomos natën, pas punës, atje pranë zjarrit në kasolle.

Pas këtyre punëve ktheja kokën për të parë Ramniun. Ne s'e vinim re se si ngjitej nata në ato anë. Ajo mbështillte gorricat, mbështillte nometë, kodrat,

malin. Mbështillte edhe Ramniun. Atëherë më bëhej sikur ai ndodhej atje te kreu i kodrës, sikur qëndronte i pështetur pas një shpelle, sikur ishte përulur dhe lexonte. Më dukej sikur i frynte era, sikur e qëllonin degët e qelbësit dhe të cërmëdellit, sikur i rriteshin përqark lulët e malit. Dhe ai ngelej atje midis malit, midis drurëve, midis erërave dhe natës. Sesi më zgjohesh një drithërimë dhe më kapte një ndjenjë frike. Dreqin! Më bëhej sikur Ramniu do të mbetej atje përgjithmonë, sikur s'do të lëvizte më, sikur do të shikonte muzgun, do të na shikonte ne që do t'i shkonim përqark dhe s'do të lëvizte. Ne do t'i flisnim, do të shqetësoheshim, dhe ai nuk do të lëvizte, nuk do të fliste. Po atje ishte mal, dhe mali ka edhe dëllinjat, edhe erëra lulësh, po ka edhe borëra edhe shira. Ato çaste më kapte një agushti që ç'të të them! Vrapoja atje. Atë vërtet e gjeja pranë shpellës, të pështetur. Kujtoja se do të vraponte sa të më shihte mua, kurse ai shikonte përballë, sikur kërkonte të mbushej me erërat e mbrëmjes. Nuk mbaj mend ç'i flisja. Po ai më thosh:

— Sa mirë!

Dhe heshte.

Në verë ai vinte shpesh në mal. Vinte pas nesh, sepse i kishte qejf dhentë. Natën i bëhej në ëndërr sikur trembej kopeja dhe thërriste. Ai shikonte në ëndërr ujgër të uritur në muajt e shkurtit, dhe unë trembesha mos më dobësohej djali. Kur flisnin çobenjtë, ai dëgjonte dhe s'bënte zë, po natën thërriste në gjumë. Kjo qëllonte dendur. Unë paguaja racionin e qumështit të tij në llogari atje në fshat dhe e mbaja në mal një muaj apo më tepër. Çobenjtë e donin shumë, ja tek i ke, pyeti. Edhe na ndihmonte. Jo se është evlati im, po, për nder, na ndihmonte.

Mbrëmjeve milnim njëqind e pesëdhjetë krerë dhen, po na takonte të milnim edhe dyqind a më tepër për çdo njeri. Sa qëllonte që ikte njeri apo tjetri nga ne, Ramniu futej në nome dhe i ngiste. Se

është një punë më vete edhe të ngarit e deles, që të vijë te gurët e shtrungës dhe atje ta zësh ta mjelësh.

Kur lodhej shumë, në mëngjes herë ngrihej e herë s'ngrihej. I vogël, i njomë! Delet i do për ditë të gametit dhe ua ka marrë anën. Di ku t'u rrijë e si t'ua zërë anën. E kam kuptuar, për nder!

Një shelege njëherë na e kishte zënë kroma. Shelege u thomi miloreve, atyre të vjemeve, të papjellave. Kromën e djegim me duhan. Ne e kishim djegur, po shelegia ndihej e pamundur. Unë e gjeta një drekë Ramniun tej kopesë, në një hije të fshehur. Rrinë shtrirë pranë sheleges.

— Pse s'erdhi veterineri? — më tha.

Pastaj e gëzoi në kokë, në turi dhe te plaga. Ka zemër të dhembshur Ramniun! Një gjyshi ynë ka thënë bejte nëpër fshat. Thonë se i kërrente vetë. E mbaj mend edhe unë. Plaku im thotë se Ramniun bie në gjysh. Ku di unë?! Bejte!...

Çoç shkruan, çoç shkruan. A bejte, a mësimë, nuk e di. Zogjtë i do shumë. Gjithmonë kërkon të rritë zogj në shtëpi. Edhe qentë i do shumë. Ç'të të them, se s'është për të zënë ngoje. Po ajo gruaja ime është e pamëshirshme. Për qentë dhe macet flas. Po është derre e derrit ajo grua! Nuk i do për ditë të gametit. «Atë që ta hajë qeni, e ha pula», thotë. Dhe ç'bëri një herë! E la qenin e shtëpisë pa ushqyer. Ai qen u mësua e hante vezët në katua. Ajo e kuptoi dhe donte ta vriste. Po si ta vriste? Ç'të them, o djallë! E lidhi qenin me zinxhirë dhe e nxori tek ato bokërimat mbi lumë. Dhe e lidhi atje. Një ditë, dy ditë, tri ditë, pesëmbëdhjetë ditë... Ç'të të them! Mes i beharit. Vapa digjte. Qenit të shkretë as i hidhte njeri të hante, as i jepte njeri të pinte. Po s'kishte dhe rrujë andej, dreqin! Sesi rastis që shkuan ca fëmijë dhe ranë më të.

Vate Ramniun dhe e mori. E solli në shtëpi. Qeni i shkretë që bërë kockë e lëkurë. I hodhi bukë e i dha ujë, po qeni hëngri shumë, vulli dhe ngordhi. Unë

erdha në shtëpi në darkë dhe desh i hapa kokën
gruas, për nder. Dhe më t'u sëmur djali pastaj! Kaq
shumë iu dhimbs qeni. Iu dogj koka, dridhej në ethe.
Ç'ti thuash gruas së shejtanit...

Ja, si sonte ishte. Ca më vonë. Kishte rënë nata.
Një natë nga ato të verës. Me ato erërat e lehta, që
ngatërrohen nëpër qershitë e egra (pranë stanit tonë
në mal ka qershi të egra), me ato yje që t'i presësh
në pëllëmbë e me ato çuqurima zogjsh. Se ka edhe
zogj që çuqurijnë natën.

Ne kishim futur dhentë në shtrungë dhe po i mil-
nim. Vjet qumështi ishte i mbarë. Akoma s'kishim
rënë nga pesëqindgramëshi. Atë natë na takonte që
të milnim dyqind e ca krerë secili, se një shok nga
tanët kishte zbritur në fshat. Ramniu i ngiste. Atë
natë ishte shumë i gëzuar. Kishte zënë dy zogj thë-
llëze, dhe ajo shelegia me kromë ishte shëruar e i
shkonte nga pas edhe atje në shtrungë, tek ngiste
dhentë.. Kishte filluar të mblidhte çaj. Atij njeriu i
vjen keq të shkelë mbi lule. More, sa lule ka mali!
Ku ta hedhësh këmbën! Unë e vija re se si prishej ai
në fytyrë, kur opinga ime e madhe, — shih sa e kam
këmbën! — shkelte mbi lule. Dreqi! E, atë natë ai
futej midis dhenvë që shtrëngoheshin në anë të va-
thës dhe i merrte me të mirë, që ato të vinin te
vedrat.

— Dëgjo, baba, — më tha dhe ktheu kokën anash.

— Çë? — i thashë.

— Dëgjo si këlthet një kukumjaçkë! «Këlthet» i
thonë?

— E, — i thashë.

S'dija ç'ti thosha! Ai ngeli një copë herë ashtu
i humbur e i ngatërruar. Pastaj u dëgjua një zille,
dhe qeni i bardhë, ai me bishtin të ulur, që e thë-
rrisnim Korbec, ulëriti. U ngritën edhe qentë e tjerë.
Unë dola tej dhe pashë një njeri. Ai bëri zë. Ishte
Shemshua. Shemshua ishte kryetari ynë. Tani nuk
është kryetar. Me bashkimin, ngritëm një tjetër. Ti e

di, se ndenje një copë kohë te ne. Shemshua bëri nja dhjetë a pesëmbëdhjetë vjet kryetar. Nejse, erdhi Shemshua. Ne u gëzuam. Jo që na erdhi Shemshua e do t'ia qanim një hall, po sepse edhe një njeri tjetër të na vijë atje në mal, na gëzon. Çobani i do shumë njerëzit. Se e ha mali tërë ditën e tërë natën. Kështu që ne u gëzuam shumë.

Ai na përqafoi të tërëve me radhë. Atë kohë po i jepnim fund mjeljes. Shemshua shkoi e takoi edhe Ramniun.

— Po ky? — tha dhe iu afrua, i dha dorën dhe e përkëdheli në kokë.

— Shumë mirë, shumë mirë, — pëshpëriti Shemshua, pa marrë përgjigje. — Si ta thonë emrin, more? — e pyeti.

— Ramni, — tha djali.

— I kujt je?

— I Guçes.

— Eëë, i Guçes!

Shemshua shikoi nga unë. Djali kishte ulur kryet.

— Vete në shkollë ti? — e pyeti Shemshua.

— Vete, — tha Ramniu.

— Në ç'klasë je?

— Mbarova të shtatën.

— Hëë, shumë mirë, shumë mirë. Edhe një vit, dhe këtu ndër dhen, hë, do të bëhesh bari si babai?... Çoban, shumë mirë, shumë mirë!

Pastaj Shemshua i ra në shpatulla dhe erdhi te ne. Ne rregulluam qumështin dhe u qasëm nga kasollja. Kryetari na pyeste për atë e për këtë. Një çoban nga tanët e vumë të priste një sheleg. (Ne mbanim tre-katër të tillë pas kopesë dhe i përdornim herë pas here për mish e sebepe. Me lekë, po na i linte kryesia, si çobenj. Tani s'lejohet të mbajmë.) E rropëm dhe e vumë në hell. Pastaj bënim muhabet rreth prushit, brenda në kasolle, që të mos ngiste zjarrin era.

Rumniu atë natë s'foli. S'foli asnjë fjalë. Është lo-

dhur, mendova. Ai shkoi të flinte. Unë e lashë të flinte. Ndodhte që në mbrëmje këputej nga lodhja dhe s'hante shumë ose s'hante fare. I njomë, thosha, fëmijë, do gjumë.

Ne ndoqëm muhabetin gjer në mesnatë. U kënaqëm atë natë. Sikur na kishte ardhur një pjesë e fshatit aty në stan.

Mbase që ora 12 e ca, kur shkua për të fjetur. Dolëm jashtë. Ç'net të bukura ka mali ynë në verë! Unë dhe djali flinim aty nja pesëdhjetë metra tej kasolles. Kishim bërë pranë e pranë nga një vend si magje dhe pështilleshim në bërruce, mu ndën një qershi të egër. Ishte një qershi e madhe që tundte degët dhe herë i mbulonte, herë i zbulonte yjet. Si ngjajnë yjet e qiellit netve të verës, si ngjajnë! Sikur i shkund njeri dhe ata rrëzohen nëpër gjethet e qershisë...

Unë ecja ngadalë. Kisha hall se mos shkërmoqja gurë dhe zgjohej djali. Është gjynah t'ua prishësh gjumin atyre në këtë moshë! Se tani rriten ata.

Eca ngadalë dhe shkova e u shtriva pranë Ramniut, te vendi që kisha bërë si magje. U shtriva në shpinë dhe shikova sipër te degët e qershisë. Ajo fërfërima e tyre të kujton shumë gjëra. Të kujton atë erën që çikë e nga një çikë nis e na prish kasollet e malit kur vjen vjeshta. Mua m'u kujtuan shumë gjëra. M'u kujtua...

Befas pranë meje ndjeva dikë.

— Erdhe, baba? — më tha.

— Ti Ramni, je?

— E.

— S'ke fjetur?!

— Jo.

— Akoma?!

— Nuk më zë gjumi.

Edhe ai kishte rënë në shpinë dhe kishte nxjerrë nga sharku vetëm fytyrën. Nuk shikonte nga unë, po lart, nëpër degët e qershisë.

— Pse s'fle, bir? — i thashë.

— Nuk kam gjumë, — tha.

— Mos ke uri?

— Jo.

— Je sëmurë?!

— Nuk kam gjumë.

Nga mënyra se si i tha këto, e kuptova që nuk donte ta ngacmoja. M'u prenë kujtimet në mes. He-shtja. Era rrëshqiste nëpër degët e qershisë, dhe yjet sikur ngatërroheshin nëpër gjethet e drurit të egër.

Nuk di se sa mund të ishte ora dhe sa kishte shkuar në atë çast që unë s'folja më me djalin. E ka zënë gjumi, mendova, kur edhe mua po më lodhte gjumi.

— Baba! — tha ai.

Nuk dija nga erdhi ky zë. Se atë kohë isha midis zgjuarjes dhe gjumit. Sapo këputesha.

— Fjete? — belbëzoi djali.

Unë u përmenda.

— Hë, bir, — i thashë dhe u ktheva nga ai.

Ai nuk lëvizi.

— Ç'ke?!

Një copë kohë nuk foli.

— Baba, — tha pastaj, — pse më tha Shemshua ashtu?

— Ç'të tha, bir?!

— Ja, më tha: «Edhe një vit dhe do të vish këtu ndër dhen; do të bëhesh bari, çoban»?...

— Po...

— Pse nuk më tha: «Edhe një vit dhe të shkosh në shkollë të mësosh të bëhesh kryetar»??

— ...

Mua sikur më goditi diçka.

— Unë i dua dhentë, baba, — pëshpëriti ai me një zë si t'i kishte dalë nga fundi i shpirtit. — Po pse?...

Pastaj lëvizi pak, sikur më thoshte se nuk donte që t'i flisja.

Kaloi shumë kohë. Nata po bëhej më e freskët.

Yjet po shuheshin. Unë tashti e dija që atë nuk e kishte zënë gjumi. M'u godit gjumi. M'u godit. Më dukej sikur vazhdimisht im bir më pyeste: «Po ti si thua?»...

Çobani e mbaroi tregimin për të birin, më pa drejt në sy dhe belbëzoi:

— Po ti si thua?

MOS E PËRPLASNI ÇIZMENI!

1

Në qafën e tij të trashë qëndronin tri jaka njëra mbi tjetrën. Peliçja ishte e gjerë dhe i varej gjer përmbi gjunjë. Kishte çizme të zeza, të mëdha, prej meshini dhe qillota. Kishte edhe kokore me push si gëzofi i lepurit.

Qëndronte në trotuar me duart futur thellë në xhepat e peliçes dhe heshte. Hera-herës shikonte sa në një anë, në tjetrën.

Pastaj mori një pamje edhe më serioze.

Aty u afruan pesë vetë. Njëri kishte pardësy të hollë, të djegur në dy-tri vende dhe të ngrënë në xhepat. Të tjerët ishin veshur me shajak. Dy prej tyre i kishin lënë zbërthyer kopsat e kreut, dhe era e lehtë e prillit luante me qimet e gjoksit nën lukthin e grykës...

Ata u qasën pranë tij dhe po bisedonin me njëri-tjetrin. Ai i shkurtri, me fytyrën e hollë e të zeshkët, u ul dhe nxori opingën nga këmba.

— T'emën, — tha dhe e përplasi në trotuar.

— Ç'të zuri? — i tha njëri.

— Seç më ngatërrohet në opingë, a i vrarë.

Ai e përplasi përsëri majën e gjerë të opingës në trotuar, pastaj futi pëllëmbën brenda dhe kontrollloi.

— Një gur i vogël! — pëshpëriti dhe e goditi përsëri.

Pastaj ngjeshi opingën në këmbë dhe u ngrit.

— T'emën!

Burri me kokore shikoi mugët nga ai që u ul e nxori guriçkën nga opinga.

— Më vrau, a i vrarë.

Tjetri nuk foli, po ktheu kryet nga e djathta.

— Mos e pe Rizanë?

Burri me kokore s'foli.

— Nuk erdhi gjë Rizai? — pyeti përsëri ai i opingës.

— Shoku Ali! — pëshpëriti si i llahtarisur burri me kokore dhe befaf buzëqeshi e shikoi nga ata që kishte pranë.

Ata nuk folën. Ai buzëqeshi edhe më dhe sërish shikoi nga ata që kishte pranë. Po ata përsëri nuk folën.

— Shoku Ali! — tha dhe zbriti nga trotuari.

Fshatarët shikuan andej për të dalluar se ku ishte shoku Ali.

— E ç'e gjeti këtë tonin, a e vraftë! — tha fshatari me fytyrën e hollë e të zeshkët. — Ptu! Ku e njohu edhe këtë!

Burri me kokore kaloi rizën e dorës nën hundë dhe mënjanoi një kalimtar që i doli përpara.

— Mirëmëngjes, shoku Ali.

Burri i ndëri dorën dhe i zgjati kokën e madhe me kokore.

— Mirëmëngjesi, — tha edhe Aliu dhe i zgjati dorën.

Burri me kokore qeshi, i ra në shpatullën e djathtë shokut Ali dhe diç i tha, duke treguar me do-

rë fshatarët që rrinin bashkë atje në anë të rrugës, në trotuar.

— Diç të dërgova, — i tha burri me kokore. — E more?

— Çfarë?

Shoku Ali e shikoi drejt dhe përplasi qerpikët.

— Ha-ha-ha! — qeshi fshatari dhe i ra përsëri në shpatullën e djathtë.

— Më dërguat mua? — pyeti shoku Ali.

— S'të kujtohet? — tha fshatari me kokore.

Shoku Ali ngriti supet.

— E, — tha fshatari, — ta dërgova me atë profesorin që e ka babanë në Degë.

— Po çfarë?

— Drodha një duhan, ashtu, cigare, dhe i thashë: «T'ia japësh në dorë shokut Ali, pa e kupton vetë ai se kush ia dërgon».

Fshatari qeshi përsëri dhe përsëri e qëlloi në shpatulla e i zgjati të dy pëllëmbët në supet e lartë të shokut Ali.

Ai e shikoi në fytyrë fshatarin që qeshte dhe dalloi menjëherë ca dhëmbë të gjatë, gjysmë të zverdhur.

— I thashë, — vazhdoi fshatari, — «Mos e prish. Thuaj shokut Ali, e ke nga kunati i shokut tënd, nga fshati, nga Ruza, pa e gjen vetë ai se kush ia dërgon».

Shoku Ali u kthye përgjysmë nga trotuari dhe pëshpëriti:

— Miqtë e mi e dinë që unë nuk e pi duhanin.

Fshatari nxori përsëri dhëmbët e gjatë, gjysmë të zverdhur. Shoku Ali përshëndeti ata që ishin në trotuar dhe shkoi e i përqafoi një nga një. Burri me kokore i qëndronte prapa supit dhe buzëqeshte. Shoku Ali lëshoi dorën mbi supin e shajaktë të njërit prej tyre dhe, duke qeshur, e pyeti në e kishte hequr më barku apo jo. Ai që ishte bari, u skuq dhe tha:

— Nuk kemi më dhi, shoku Ali, i pastruam.

— Nashti hamë mish të delmur, — tha fshatari me fytyrë të hollë e të zeshkët.

Pastaj, së bashku me shokun Ali, ata qeshën. Në fund qeshi edhe burri me kokore.

— Po hä, — tha pastaj shoku Ali dhe hodhi të dyja duart mbi fshatarët e u ngjit më mirë në trotuar.

— Kemi ardhur të këndojmë, — tha ai me trup të pakë, me fytyrë të mprehtë e të zeshkët.

— Jo, ore! — tha shoku Ali dhe qeshi.

Qeshi edhe burri me kokore.

— Do këndojmë, — tha edhe një fshatar tjetër.

Burri me kokore lëvizi kryet, sikur të pohonte, dhe shikoi në trotuar.

— Do të inçizoni këngë, ë? — tha shoku Ali.

— Po, — tha fshatari. — Do t'u këndojmë atyre dy vëllezërve jetimë, që mbanin hamshorët e agallarëve dhe pastaj dolën në luftë e u vranë që të dy. Ne u ngritëm këngë.

— Po, — pëshpëriti burri me kokore dhe përsëri shikoi pllakat me viza të trotuarit.

— Shumë mirë, shumë mirë, — tha shoku Ali.

— Kemi vendosur, — tha burri me kokore.

— Po kush ia merr? — pyeti shoku Ali.

— Ai.

— Po ti, ia hedh?

— Jo, unë mbaj iso: ia hedh ai, — tha fshatari zeshkan dhe i vuri dorën në bërryl një tjetri.

— Po gra? — tha shoku Ali.

— E, dreqin! — tha fshatari zeshkan.

— Apo s'dinë të këndojnë gratë?... — tha shoku Ali dhe qeshi me dinakëri.

— Duhet menduar, duhet menduar, — pëshpëriti burri me kokore.

— Ç'do të bëni, mbledhje? — tha shoku Ali, i vrenjtur, dhe nuk e shikoi në sy.

— Me mbledhje e ka ky! — pëshpëriti fshatari zeshkan.

Burri me kokore uli kryet dhe shikoi nën vetulla fshatarin që tha: «Me mbledhje e ka ky!»

— Mirë, mirë, shumë mirë, — foli ngadalë shoku Ali.

— Po ju duhet të organizoni edhe një grup mikst. Të këndojnë edhe femrat. Kështu.

Pastaj ai i shikoi të gjithë në sy, një nga një, u buzëqeshi dhe tha:

— Shumë mirë. Do t'ju dëgjojmë në radio.

Ai qeshi dhe u shtrëngoi duart miqësisht. Pastaj zbriti nga trotuari dhe u largua. Zbriti edhe burri me kokore dhe e ndoqi nga prapa, i qasi dorën te bërryli dhe, kur i doli përbri, i tha:

— Si do të bëhet ajo puna e tubave?

— Ç'tuba?

— Ja, duam ta biem atë ujin e Dëllënjës.

— Aha!

Shoku Ali ndali përsëri. Ai e shikoi nga kryet në fund burrin me kokore, u mendua një çast dhe tha:

— Po, jam në dijeni. Me ç'di unë, sikur është biseduar me Komitetin Ekzekutiv. Këtu ishte edhe kryetari i kooperativës, edhe kryetari i këshillit. Kjo çështje u shikua dhe do zgjidhet nga këta shokë. Pse? Ë?

— Jo, po thashë të interesohem. Probleme, helbete...

Burri me kokore thoshte kështu dhe qeshte, duke u përpjekur që të zgjonte buzëqeshje edhe në fytyrën e shokut Ali. Po shoku Ali nuk fliste atë kohë. Ai shikonte poshtë te këpuca me lëkurë të zezë që shndriste. Shikoi atje një copë herë, pastaj belbëzoi:

— Ëhë, ëhë...

Fshatari kishte rrëzuar kryet prapa dhe e shikonte drejt në fytyrë shokun Ali. Një çast ai ktheu kokën në trotuar. Ata të pestë ishin atje. Ai fshatari i pakë me fytyrën e mprehtë dhe të zeshkët i bëri një shenjë duke hapur krahët, sikur i thoshte: «Po lëre, ore, t'u mbylltë!» Burri me kokore mori një pamje serioze e të rëndë dhe i hodhi përsëri sytë nga fytyra e shokut Ali.

— Mirë, mirë, — tha shoku Ali, sikur i foli vetes dhe përsëri nuk e pa në sy. — Do ta shikojmë, do ta shikojmë.

— Të shikoj edhe një herë atë plumbin, — tha-
shë, — se sikur më lëviz.

— Ç'plumb?

— Atëherë, në luftë, kur u plagosa... Kur ftohet
koha, sikur më ngacmon.

— Ashtu?!... Je plagosur në Luftë?!

Heshtje. Shoku Ali lëvizte gishtat e njërës dorë
në pëllëmbën e hapur të dorës tjetër.

— Të ftohtë, ë?... Po tani presim të ngrohtë,
tani...

Fshatari qeshi dhe fytyra iu bë krejt idiote. I vu-
ri të dyja duart te bërrylat dhe, si të kujtonte një
shok të hershëm të radhës së tij, tha:

— Po dilna një herë, dilna. Edhe Naqja të bën
të fala.

— Cili Naqe!

— Kunati im; ai që punon lart, në Tiranë. Ai ju
njuh dhe...

— Ëhë...

Shoku Ali i zgjati dorën dhe u largua.

Fshatari rregulloi më mirë kokoren, shtiu duart në
xhepat e thellë të peliçes dhe eci i menduar. Kur
arriti te shokët, pëshpëriti tërë nervozizëm:

— Probleme!

Dhe nuk foli më. Hapi këmbët dhe qëndroi atje
te trotuari me pllaka tërë viza, me duar të lidhura
prapa.

— Erdhi Rizai, — tha njëri.

— Shkojmë, se u vonuam, — tha burri me kokore.

2

Drejtori i Radios u tha edhe diçka, pastaj i çoi
në studio.

— Kujdes këtë vargun këtu, mos e ngatërroni.

— Nuk e ngatërrojme, — tha fshatari zeshkan,
duke ia bërë me dorë, si të donte ta siguronte drej-

torin e Radios se gjithçka do të shkonte mbarë. Burri me kokore lëvizi kryet në shenjë pohimi dhe mori nga duart e drejtorit atë copë letër ku ishin shkruar vargjet që do të këndonin për dëshmorët.

Pastaj drejtori vendosi se ku duhej të rrinin, u dha përsëri porosi dhe doli për në dhomën e inçizimit...

Të gjithë prisnin që ata të fillonin. Po ata ende s'po fillonin. Ai burri me kokore seç po u thoshte. Ata që ishin në dhomën e aparateve të inçizimit, e shikonin që ai lëvizte duart dhe kryet, po zërin nuk ia ndienin. Një vajzë e re, që ndodhej midis aparateve, shikoi nga drejtori. Drejtori tha:

— Gati! — Dhe ngriti e uli dorën.

Atëherë vajza lëvizi një çelës dhe foli:

— Gati! Një provë.

Ata u kthyen me fytyrë nga dhoma e inçizimit, dhe drejtori i Radios, së bashku me vajzën që qëndronte pranë çelësave dhe disqeve të aparateve, shikuan përmes kornizës së xhamit që komunikonte me të dy dhomat. Atë kohë ktheu kryet edhe burri me kokore. Në çastin e parë fytyra e tij ra e vrenjtur dhe e menduar në kornizën e veshur me xham. Po ndërroi menjëherë. U zbut dhe i buzëqeshi edhe drejtorit të Radios, edhe vajzës. Mandej u kthye përsëri dhe në kornizën me xham doli shpina e tij e ulët dhe e gjerë. Ai kishte hapur krahët dhe diç u fliste atyre. Nga mënyra se si lëviznin shpatullat dhe se si rrudhej e shtrihëj lëkura e zezë e peliçes, edhe drejtori edhe vajza e kuptuan se ai po jepte porosi. Ai mbase do të fliste gjatë, po njëri nga fshatarët, ai i gjati me flokë të ngritur përpjetë si gjemba, bëri me dorë një lëvizje nervoze dhe u qas më pranë kuadratit të xhamit. Edhe fshatarët e tjerë u kthyen nga suaza me xham, duke e lënë kështu pakëz mënjanë burrin me kokore.

— Gati! — tha përsëri vajza dhe përsëri lëvizi çelësin.

Njeriu me kokore nxori kryet më këtej dhe uli e ngriti kokën, sikur po thoshte: «Tashti po». Mandej u kthye nga ata. Fshatarët as që panë nga ai, po nisën të këndonin.

Vajza e dhomës së inçizimit mbante gishtat te një çelës i vogël dhe ishte përqëndruar te kuadrati me xham. Fshatarët kishin humbur në këngë, duke rrokullisur dhembje për ata varfanjakët e livadheve të tyre që prishnin gjumin e mëngjesit të thellë duke ndjekur hamshorët e agait, që lageshin nga vesa dhe rriheshin nga shirat e dimrit në atë kasollen e shpuar me thupra, që dolën në luftë e shkrehën mitralozin, që u puthën me plumbin si trima dhe ranë në një mëngjes të njomë, kur bubullonin ujërat e pranverës që zbritnin nga lart.

Drejtori e prishi tërë atë përqendrim dhe harmoni me një lëvizje nervoze që bëri dhe u afrua te aparatet. Burri me kokore u kthye nga ata që këndonin dhe diç u foli me inat. Po asnjë nga ata nuk e shikoi në sy. Ata ndien një lloj hutimi dhe diç folën midis tyre.

— Na falni, u këput shiriti, — tha drejtori i Radios.

Burri me kokore largoi mollëzat, zbuloi dhëmbët e vjetër dhe qeshi.

— Po ky me këtë kokore e këto çizme, ç'është ky? — tha vajza.

Drejtori mblodhi buzët dhe shikoi te shiriti. Korcorja tej xhamit u afrua më pranë kornizës. Ai i mbante nofullat të mbërthyera fort dhe kishte një vështrim të papërcaktuar ato çaste. Me atë pamje, me ato duar të shkurtra, të lidhura prapa, dukej sikur po dëgjonte me vëmendje, që pastaj të jepte mendim e të bënte konkluzione. Në fytyrën e tij me atë njohtë mustaqesh të zeza shfaqeshin e shuheshin ca re-

flekse që këmbenin në çast njëri-tjetrin. Ngriti lart nofullën katrore dhe bënte kështu t'i tërhiqej lëkurat e gushës.

Ata këndonin, dhe ai përplaste majën e çizmes. Ata që ishin në dhomën e aparateve e ndienin këtë edhe nga mënyra se si lëvizte.

Vajza u nervozua, uli çelësin, u afrua te mikro-foni dhe tha:

— Ju lutem, mjaft, mos e përplasni çizmen!

Burri me kokore një çast heshti i hutuar, pastaj u përqendrua te vajza, që kishte fytyrë të bukur, flokë të lëshuar dhe supe të rrumbullakëta, të njoma. Ai buzëqeshi. Vajza rrëzoi sytë në aparat. Njëri nga fshatarët seç tha dhe, me fytyrë të hakërryer, i tregoi burrit me kokore daljen. Të gjithë fshatarët u kthyen nga ai. Po ai hiqej sikur s'ndodhi asgjë me rëndësi, sikur nuk i thoshin atij që të dilte përjashta.

— Për inçizim! — tha drejtori.

Burri me kokore u tha të fillonin dhe ngacmoi veshin nga prapa.

Kënga vinte si një gjëmim i thellë. Befas ra zilja e telefonit. Po ata të dy nuk u kthyen nga telefoni. Zilja ra përsëri gjatë, dhe drejtori bëri me kokë që ta merrte vajza.

Ajo ngriti receptorin dhe tha:

— Si urdhëron. Një minutë, ju lutem. Drejtor, ju kërkon shoku Ali.

Drejtori afroi receptorin te veshi.

— Mirë faleminderit. Siurdhëron! Ja, ata po inçizojnë... Shumë të bukur e kanë këngën. Ashtu, edhe me dhembje, edhe burrërore, edhe heroike... Po, po...

— ...

— Siurdhëron! Dhe nga ai fshat. Do të kujdese-mi. Nga ajo krahinë kemi grupe femrash. Po, po.

— ...

— Po, është. Me peliçe dhe me një kokore; pooo... Kit Lukati e quajnë.

— ...

— Jo. Ai thotë se është caktuar si përgjegjës. Si t'ju them! Thashë të mos i ngatërroja.

— ...

— Ai thotë se ka ardhur të ketë kujdes mos bëjnë gabime ideologjike! Kështu tha. Edhe ne u çuditëm.

— ...

— Jo, jo, vetë nuk këndon, seç bën!... Ja, siurdhëron... Po, po, në gazetë. Unë vetë do të shkruaj një shkrim për ta demaskuar. Siurdhëron, tungjatjeta!

Ai e uli receptorin dhe shkoi pranë kornizës me xham.

— Ejani të dëgjoni edhe vetë, — tha drejtori. Fshatarët hynë në studio njëri pas tjetrit.

3

Në mbrëmje fshatarët shkuan në dhomën e djalit të Birçes. Djali i Birçes kohët e fundit ishte emëruar në atë qytet dhe banonte në hotel. Ata e donin shumë.

U ulën përçark dhe nisën të bisedonin me zë të lartë.

— E si të mos flasësh, a i vrarë! Të pish verë e të mos flasësh! Ne s'dimë të rrojmë! E krrejme tërë rrushin raki e s'bëjmë një bocë verë!

— Burrat pinë raki, — tha tjetri.

Ata qeshën.

— Po ai ku shkoi? — tha fshatari me fytyrën zeshkane.

— Ç'e do?

— Të na jepte mëndje, të na drejtonte, se mos gabojmë nga ana ideologjike.

— Pse s'erdhi? — pyeti djali i Birçes.

— Se nga do t'i jetë bërë pas ndonjërit të Komitetit.

— Sekujt iu qep.

— Sot iu ngjit atij sekretarit të ri.

— Mbase e pret te shkallët e zyrës që t'i tregojë atë historinë e plumbit, — tha me të qeshur ai me fytyrë të hollë dhe ngjyrë zeshkane.

— Pse, si është ajo puna e plumbit të Kit Lukatit? — pyeti djali i Birçes me kureshtje.

— Po ja, a derëzi, ka marrë një plumb në luftën italo-greke, — tha fshatari zeshkan me të qeshur. — Dhe thotë se e ka marrë në luftën partizane. Hiç, ore, s'ia ka bërë bamp në luftën tonë! Ka qenë nja dy muaj në komandën e vendit në prag të Çlirimit dhe e mban veten sikur xheç ka bërë. Kur hodhi ai pushkën krahut, Rizai me Rrapin, — dhe zeshkani sakaq hodhi sytë nga dy fshatarët që kishte në krah, — kishin nja dy vjet që bridhnin maleve. Po ka llafe ai malukat! Dhe mburret poshtë e lart, larua!... Hë, pa do t'ia ndreqim mirë samarin këtë radhë, se na e ka bërë borxh!... Hajde, gëzuar! Të ardhshim në gëzime! — Zeshkani ngriti gotën dhe e çoku me djalin e Birçes e pastaj me të tjerët.

PURAVEL DUKA

Ishte ditë e enjte, 18 shtatori i këtij viti. Atë kohë në drekë dielli sundonte me një sovranitet solemn. Ai ishte i zjarrtë dhe të përvëlonte kokën. Vjeshta ndodhi e thatë dhe e kthjellët. Pas të korrave të be-gatshme toka sikur kishte ulur supet e çlodhej.

Ai doli prapa ndërtesës së gjatë të zdrukthëtarisë, që në fshat i thoshin kombinati i drurit. Në njërën dorë mbante një pagur të lidhur me spango të trashë. Vende-vende paguri ishte i shtypur dhe me zift. Ai thirri fort dhe po vinte drejt meje, duke lëvizur dorën e duke qeshur.

Ishte Puravel Duka. Kisha shumë kohë që pata ikur nga fshati, po Puravel Dukën s'e harroja. Atë e kujtonim, në bisedat e mbrëmjes, kur venim në fshat, apo në qytet, kur vinte dikush nga fshati. Në krye, kur dëgjoje që tallte dikë, ia kishe frikën, i druheshe. Po kur e njihje, të ngrohete si diell, të gëzonte.

— Ndal! — thirri ai — Kthehu këtu.

Zëri i tij u bë i egër dhe pas asaj rreptësie të shtirur ai qeshi përsëri me të madhe.

— Pa qasu dhe më jep një çikë pashaportën, të lutem!

Ai doli në të majtë, pranë një ndërtese të vogël me gurë.

— U mblodhe në burim? — tha.

U përqaftua nxehtësisht. U ul në hije dhe fërkoj ballin e dirsur.

— Shtëpi kemi, — tha. — Këtu do të banosh?

Ai tregoi shtëpinë prapa shpinës së tij. Ajo ishte një ndërtesë e vjetër e braktisur dhe në të tani banonin merimanga plaka, që fëmijët e fshatit i quanin dado. Ato kishin endur pezhishka dhe qëndronin pa lëvizur pranë mizave të thara që i lëkundte era në pëlhurë. Ajo ishte e vetmja ndërtesë që kishte mbetur nga koha e paraluftës. Dhe atje tani s'banonte askush.

— Mos u tremb, — tha Puraveli. — Nuk të futim aty, se do ta bëjmë muze dhe trupin e agait do ta ngremë me baltë. Do t'i vëmë shkopin në dorë dhe do ta vëmë aty. Si thua, bëhet? Do ta bëjmë; do na hajë edhe ca lekë, po do ta bëjmë.

Unë i thashë se tani do të banoja në fshat dhe në fund ai më ftoi në vreshta. Ai qeshi dhe tha se para njëzet vjetësh kishte bërë lutje që ta vendosnin rojë në vresht. Dhe ata të kryesisë mënuan ca, po e caktuan.

— Zonjën ku e ke? — tha.

— Te nëna, në shtëpi, — i thashë.

— S'e kam këtu makinën, po do të dërgoja ta merrnin, — tha.

Unë qesha. Edhe ai qeshte. Kishte fytyrë të lartë dhe ballë të dalë, si poçe. Sytë i kishte të vegjël dhe me rrudha, hundën të shtypur dhe mbi buzën e sipërme mustaqet i ngjanin si njollë me bojë zmalto gri. Kishte buzë të trasha tallëse dhe qafë të ardhur

si të kaut. Ndërsa barku i tij ishte i madh e i rrum-bullakët, sa një fuçi.

— Eja në darkë, — tha. — Të pres, ndryshe vura tellallin të dëgjojë tërë fshati.

— S'i le shakatë, — thashë.

— Sado që ta ushqesh ujkun, ai i kthen sytë nga mali.

Hoqi gozhitën e misrit nga paguri dhe piu ujë. Mjekra e skuqur me rrudha dhe e parruar u lag, dhe një rrëke e vogël i zbriti poshtë në gjoksin me qime të bardha të dendura. Ai psherëtiu gjithë kënaqësi, fshiu buzët dhe tha:

— Kështu të paça, o jetë!

— O Puravel Duka! — thirri dikush nga udha.

— Ç'është ky zë që më dredh, — tha.

— Si e ke plëncin, o mbrojtës i vreshtit?...

Dhjetë metra tej tij ndalën dy fshatarë dhe e pyetën përsëri si ishte rrushi në vresht dhe si shkonte shëndeti i tij. Ai nuk u përgjigj, po hapi këmbët, uli pak qafën e trashë si të kaut dhe nisi të zbrazte pagurin në majë të kokës. Njëri nga ata e ngacmoi akoma, dhe Puravel Duka e bekoj me ca të shara popullorçe.

Në shtëpi nëna ime qeshte me vete nëpër oborr dhe tha se Puravel Duka s'plakej kurrë. Ajo kujton-te atë dhe qeshte e s'mbahej.

Puravel Duka kishte vetëm njërin vesh. Para Çlirimit, kur ishte akoma i ri dhe pononte argat te agai, mbeti me një vesh. Ishte ulur të zgjidhte një dem të lidhur në krye të arës, po demi e kishte goditur fort me brirë. Atij i kishte kërcitur kokalli nga ana e djathtë e kokës dhe kishte ndër dhembje therëse. «Pa shikomë veshin», i tha atë pasdite plakut të moçëm të Kërrajve. Plaku i moçëm i Kërrajve kishte ulur llullën dhe e kishte vështruar me kujdes. «Tani e ke si zebë, i tha plakut, po ruaj tjetrin». «U nxi?! Do priset», kishte mërmëritur Puraveli dhe ishte rrëzuar nga të fikëtit. Plaku i Kërrajve kishte prerë

një domate në dy pjesë dhe ia kishte mbuluar gropën e veshit. Pastaj kishte pjekur të bardhë veze në mëshë dhe përsëri kishte mbuluar gropën e veshit, po veshi u shua.

«Shikoni këtu!», thoshte agai i fshatit një vit më vonë. Ai u fliste për të tretat burrave të fshatit. Dhe, duke folur, shpesh thoshte: «Shikoni këtu!» Puravel Duka kishte një pasqyrë të vogël dhe, me kokën mënjane, shikohej në të. «Po ti ç'shikon?» tha agai. «Shikoj veshin», tha Puraveli. «Ç'vesh», tha agai. «Më duket se m'u hap ky veshi i prishur», tha Puraveli.

Dikush nga fshatarët klithi dhe një çast më vonë turma qeshi. «Gëzohu», tha agai gjithë mllef. «Ç'të gëzohem! — tha me mërzi Puraveli dhe u kthye nga ai. — Me një vesh dhe s'i dëgjoj dot tërë këto të zezat, jo më të hapet edhe tjetri»...

Nëna tundte kokën dhe qeshte. Dhe tërë jetën s'i shuhet gazi, tha ajo. I pjell mendja. Nëna kujtoi shumë bëma të tjera të kësaj natyre të Puravel Dukës. Një natë ai kishte hyrë në kasollen e bagëtive të një fshatari dhe kishte buluritur si lopë e sëmure. Të zotët kishin hyrë në kasolle të shqetësuar dhe te grazhdi pranë lopës gjetën Puravelin që pinte duhan në errësirë. «Lopa shfryn avull nga hundët dhe më ngroh gjoksin», kishte thënë ai. Pastaj, shumë i qetë, kërkoi t'i sillnin një kafe taze. Gruaja e shtëpisë kishte sharë e shfryrë e alarmuar, po Puraveli pinte duhan dhe pak më vonë tërë njerëzit qeshnin me të madhe.

— Po ne kemi të bëjmë me të? — pyeti gruaja ime.

— Jo, — tha nëna.

— Mirë, do të shkojmë tek ai në vresht, — tha gruaja.

— Në mbrëmje, — thashë unë.

Gruaja ime është e re; ne jemi martuar rishtas dhe në fshat ka qenë vetëm dy herë. Tani do të jetonim këtu.

— Ai e ka gojën plot me fjalë, — tha nëna për Puravel Dukën.

— Sa vjeç është? — pyeti gruaja.

— Mbi gjashtëdhjetë.

Deri vonë gruaja më pyeti disa herë se kur do të niseshim për te Puraveli. Ajo dилte në ballkon dhe shikonte tej në perëndim nga vreshti i sektorit se mos e shquante. Po ai nuk dukej. Nuk duket, thoshte ajo.

Në mbrëmje, pas buke, nëna solli rrush të freskët nga të kopshtit.

— Hani këtu, — tha, — pastaj shkoni në vresht.

Gruaja kontrolloi stacionin e qytetit tonë, kontrolloi edhe stacionin e Radio-Tiranës, po përjashta dëgjoheshin këngë të tjera. Nëna tha se ishin mbledhur në vatër të kulturës dhe po përgatiteshin për festivalet e kooperativës.

Përjashta ishte bërë natë. Mbi shpinat e maleve kishte mbetur vetëm një pluhur dielli dhe një avull drite nga ana e perëndimit. Në lindje, te Qafa e Botës, pyjet po ndryshkeshin; mbi to po binte myku i verdhë i hënës. Zogjtë kishin fjetur. Vetëm qukapikët vërshellenin rrallë në përgjumjen e parë. Pastaj u platitën. Edhe aromat e kishin humbur forcën e tyre, ishin zbutur e dobësuar.

— Atje tej vreshtat dhe kodrat janë nën hënë, — tha ime shoqe.

Dolëm nga fshati. Para se të arrinim në krye të përroit, kaluam në një urë me thupra, që hidhej mbi një kanal të thelluar, nga erozioni. Përqark, më të rrallë, binin gjethe dhe shqetësoheshin zhurma misterioze. Pemët nën dritën e hënës dukeshin të zeza.

— Shiko tej, pemët duken si njerëz, — tha ajo.

Erë nuk frynte. Arat e korrura herët dhe barërat e murme zbardhnin nga drita e hënës. Qielli ishte i pastër dhe ngrihej madhështor mbi kokat tona. Tej përroit nisnin udhëza të shumta të lëna pas dore. Pas kodrës, te rezervuari i madh, klithnin krillat.

Ne nxitonim në një tragë që ngjitej butë nëpër faqen e kodrës. Përçark kishte dardhë dhe gorrica të pashartuara.

Arritëm në periferi të vreshtit. (Më parë thoshin vreshtat. Tani thonë: vreshti.) Të gjitha gardhinat që ndanin vreshtat nga njëri-tjetri, kishin humbur. Nga ana tjetër, përbri tyre, kishin mbjellë një sipërfaqe të re me hardhi. Dhe tani atij plantacioni të tërë i thoshin: vreshti..

Po kërkonim ndonjë shteg të përkohshëm. Gruaja më tërhoqi nga krahu. Një zhurmë, tha. Mbajtëm vesh. Nuk u ndje asgjë. Ashtu m'u duk, tha gruaja. U afruam fare afër gardhit. Gardhi ishte sajuar krejt pa kujdes. Më tepër se një gardh, aty ishin gjurmët e një mundësie gardhi. Me gjemba, me ferra, me trëndafila të egër, me drurë gorricash të vogla, me drurë dardhash të papastruara.

Unë gjeta të shtrirë një degë të thatë gorrice. E mënjanova dhe shkela me kujdes.

Hymë në vresht. U ndjemë krejt ndryshe. Na përshkoi një dridhmë e lehtë dhe e freskët. Hardhitë e ulëta shushurin ngadalë. Dukej sikur ato ishin grumbulluar aty që tamam tani, në këtë kohë të thatë, të vazhdonin të rritnin kokrrën e rrushit dhe të shtonin glukozën.

Gruaja më shtrëngoi krahun, dhe unë i pëshpërita të mos kishte frikë. Aty-këtu, midis detit të hardhive, ngriheshin degët e shtrira të drurëve të tjerë: të bajameve, të ullinjve të rrallë, të dardhave e të fiqve. Ishte errësirë dhe qetësi. Vetëm pranë le dhit, te rrugina e gjerë, kishte dritë. Ecnim. Në të dyja anët e rruginës kishte kokrra dardhash të ver-

dha, të rrëzuara. Atje nën dritën e hënës ato dukeshin akoma më të verdha dhe mua sepse m'u kujtua ajo kënga popullore *Pse je verdhur, je bërë ftua...* Diku pranë janë varret, tha gruaja. Unë qesha. Vërtet, në anën tjetër të plantacionit ishin varret. Në trurin tim, poshtë nën kafkën e ngrohur, m'u kujtuan bashkëfshatarët e mi që s'ishin më, që ishin atje nën muranën e madhe të varrezave. Nuk më bëhej të qeshja. Atje janë, tha gruaja. Unë nuk pushë andej nga tregoi ajo. Doja të mos mendoja për varret dhe për të vdekurit. Lart digjej një botë e tërë me yje. Përqark binin gjethe të rralla dhe tek-tuk ndonjë kokërr dardhë. Poshtë, midis gjetheve të hardhisë, hehshnin veshulët e rrushit, sikur t'i fshiheshin dritës së hënës. Ata ishin të verdhë e të arrirë dhe shija e lëngut të tyre më rrëshqiti nëpër grykë. Unë kisha qenë në shumë vende, po rrush të tillë s'pata shijuar. Toka është ranore e argjilore. Mendova për ngjyrat e tokës ranore, të tokës argjilore, për ngjyrat e gjetheve të hardhive dhe të të tëra gjetheve që ishin tani atje në vresht. Unë i shikoja të gjitha ato ngjyra të ndryshme, të gëzueshme që ishin përqark. Dhe yjet i spërkatin me shiun e kuq. Shpesh më duket sikur nata është më e gjallë dhe më e pasur në ngjyra, sesa dita. Dhe kjo mrekulli është pikërisht këtu në fshat.

Midis rruginës, mbi degët e dardhave, te sheshi sa një lëmë që ndodhej përpara nesh, mbi një dardhë të lartë me trung të trashë, mbi një vozë, dhe akoma më tej, mbi një kasolle të ulët me kashtë thekre, pushonte drita e butë e hënës.

— Sa bukur! — klithi përbrenda ime shoqe.

— Bukur! — mërmërita.

— Ua! — thirri ajo dhe lëvizte kokën, duke zgjatur mjekrën. — Sikur digjet diçka.

— Po, sikur digjet diçka, — mërmërita edhe unë.

— Ndal! Duart lart!

Gruaja u shtrëngua edhe më pranë meje. Pas pak me qeshëm.

U bëmë tre vetë. Te dardha e lartë me trungun e trashë, që ishte në mes të truallit, dukej sikur kishin varur një petromaks. Në degën e majtë, nga lindja, hëna kishte pështetur gjoksin e bardhë dhe yjet silleshin sikur ciasnin.

— Na kanë ardhur miq, na kanë ardhur miq, — bërbëliste Puravel Duka duke u sjellë rrotull. — Ulu-
ni aty, — tha. — Prisni.

— Sikur digjet diçka, — thashë.

— Fole gjë?

— Sikur diç digjet.

Ai qeshi.

— Po, — tha. — Digjet eshkë. Këtu, nën këtë dardhë, grumbullojmë rrushin kur e vjelim, dhe natën qëllon që vijnë mushkonja. Unë djeg eshkë dhe fiu! ato largohen. Kështu i dëbojmë.

Prapa nesh ishte një stavë e ulët. Aty ishin fida-
në hardhish të krasitura nga vitet e kaluara. Pura-
veli solli një velenxë ngjyrë portokolli dhe e hapi mbi
stavë. Ne u ulëm mbi të dhe gruaja ime zuri të vësh-
tronte rreth e rrotull plot kureshtje.

— Nga kjo trembet ujku, — tha Puraveli dhe tun-
di një cep të velenxës. Ai u koll. Binte erë lëng rru-
shi, erë toke e djerse dhe ishte i madh, sa një shpellë.

— Mos qesh, evlat! — tha Puraveli. — Në kohën
e parë, këtu e dyzet vjet të shkuar, isha poshtë në
fushë. Ishte kohë e bostaneve, gusht qe. Flija në anë
të bostanit dhe pranë kalonte vija e ujit. Isha mbu-
luar me një velenxë të vjetëruar në bojë të murme.
Se nga zbret djalli i ujkut dhe, pa u ndier, hap go-
jën e fut dorën time brenda. Gjer në bërryl dora ime
në gojë të ujkut. Po dora ishte pështjellë me velenxë
dhe ai s'e kafshoi dot. U zgjova dhe thirra i lemeri-
sur. Më braniti ca, po, si ulërita e u përdrodha, më
lëshoi dhe kaptoi zallin e lumit. Për atë bukë! Ishte
një ujk tërë rrodhe.

— Beja bëhet për t'u mbrojtur kur s'thuhet e
vërteta, — thashë.

— Jo ngaherë, jo ngaherë.

Befas ai nxori duart përpara, theu bërrylat, i bëri shuplakat si kthetra dhe hungëroi sikur të qe ujk. Unë u drodha dhe qesha; gruaja u bë një grusht. Ai qeshi akoma më fort, më qëlloi në sup, qëlloi te gjuri i tij, kroi gurmazin, pështyu dhe u ngrit.

— Më ngjan si ujk, — tha gruaja.

Qeshëm të dy. Ai çapitej, dhe ne shikonim mesin e tij të gjerë dhe qafën e trashë si të kaut.

— Shiko atje, — tha gruaja.

Atje tej ishte kasollja e vogël, mbuluar me kash-të thekre. Përballë saj ishte një tog me kokrra dardhash. Akoma më tej ishte një vozë e përlyer me ngjyrë gurkali. Puraveli erdhi me një arkë të vogël në duar.

— Tërë fshati ka rrush dhe të tërë e dinë që nëna juaj ka rrush dhe që ju keni ngrënë, po provojeni edhe këtë. Stani dhe bostani s'prishen nga të ngrënë.

— Po qysh?

— Nga të vjedhurit.

Ai bëri shenjë për të treguar se s'duhej futur në trastë. Lëvizjet e tij ishin të gjalla, dhe neve na u krijua menjëherë imazhi i njeriut që vjedh. Qeshëm me gjithë zemër. Ishte natë aq e bukur, sa na vinte keq që na kishin kaluar net të tjera si ajo... Kur fliste Puraveli, gruaja ime e shikonte drejt në sy, duke pritur që të përpinte shakatë e tij. Ai na afroi kokrra dardhash, dhe ne i sillnim ato nëpër duar. Nxori qesen e duhanit dhe mbushi çibukun. Ai çibuk ishte bërë me baltë të pjekur. Vetëm gjysma e bishtit ishte prej briri. Goja e çibukut ishte e gjerë dhe nga fundi akoma më e gjerë. Anës kishte zbukurime me rra-thë të ndryshëm dhe, po ta ktheje përmbys, ngjante si kokë burri me qafë të gjatë, të lëmuar, elegante dhe pakëz të përkulur. Puravel Duka s'e kishte bërë vetë atë çibuk. Dhe askush tjetër në fshat s'kishte çibuk prej balte. Atë e kishte gjetur një fshatar kur po gënmonte themelet e shtëpisë, dhe Puraveli i ki-

shte modifikuar pjesën e fundit të bishtit. Me këtë kanë pirë pleqtë tanë, thoshte Puraveli.

Ai përpoqi gur e uror dhe eshka çeli syrin e kuq. Gruaja ime kërkoi një copë eshkë të ndezur që t'i merrte erë. Goja e çibukut u ndez flakë e kuqe. Puraveli e thithte dhe duhani kundërmonte lule behari.

— Ç'do ta bëni rrushin? — e pyeta.

— Kemi kontratë me shtetin, — tha.

Ai foli pastaj për hardhitë dhe llojet e tyre. Fshati ynë e kultivon shumë hardhinë dhe Puravel Duka është nga më të apasionuarit.

— Më parë s'kishim, — tha Puraveli. — Ç'ti bësh!

Ai rrotulloi qafën dhe shikoi përçark. U bë heshtje. Një gjethe e madhe e një hardhie të ngjitur në ulli u këput dhe po binte ngadalë nëpër degë. Ne pritëm që të binte fare. Ajo u ul me një zhurmë të përhumbur. Puravel Duka kroi grykën, sikur do të bënte hatanë. Flokët e murmë të ngatërruar dhe të dendur iu drodhën. Atij i lëvizën zhubrat në faqet e përskuqura, dhe hapësira e gojës iu mbush me ajër. Pastaj shfryu ajër me zhurmë. Gruaja ime u bë gati të qeshte, po ndaloi papritur, si e mbetur në mëdyshje. Puravel Duka, krejt ndryshe nga ç'e prisnim atë natë, nisi të tregonte për të kaluarën. Tregonte për atë pjesë të mërguar të jetës, që i vinte si një kumbim i largët. Fliste sikur të tregonin tërë brezat njëherësh. O! thirri ai. Iu ngritën përsëri zhubrat në faqet e rreshkëta, të përskuqura, dhe guva e gojës iu mbush me ajër. Ajrin e shfryu nëpër buzët e trasha dhe përsëri thirri: O! Nuk thirri, po ofshau tërë guva e zgërbonjës së gjoksit të tij. Ai dukej i moçëm dhe i rëndë. Në atë rrokje të vetme që iu shkëput nga guva e gjoksit ishte grumbulluar tërë vreri i së kaluarës dhe britma ngadhënjimtare e së tashmes: O!

U bë shumë kohë që s'e thurim më vreshtin. Ka mbetur ai gardh i vjetër, dhe mbi gjambat e kalbura të tij janë rritur ferra e shkurre. Njerëzit s'vijnë të vjedhin, po tani arat janë korrur dhe bagëtitë kullo-sin natën. Çoku kaptojnë kuajt dhe bëjnë dëm: i ndjekin shumë kokrrat e dardhëve që bien përdhë. Kjo vjeshtë bëri e thatë, dhe toka nën pemë mbushet me kokrra. Qëparë dola tej dhe tremba nja dy kuaj të penguar, pastaj sesi më hoqën këmbët te ato varre dhe u ula e piva duhan. Atje dergjet edhe Lame Guma. Ja, pas krahëve të vajzës ishte vreshti im. Ka dyzet vjet ai vresht. Unë tani kujdesem për vreshtin, kujdesem për tërë këto vreshta, dhe Lame Guma është atje poshtë në baltë. Dyzet vjet më parë kishte këtu dy vreshta nga një dynym. Këto vende ishin të manastirit. Ti e di fshatin Rebas, se këtej je... Ai fshat, ai atje, ngjitur në të shkarën e malit, ishte fshat i manastirit. Fshati ynë kishte dy agallarë. Arat dhe pylli ishin të agallarëve. Prapa krahëve tanë, në Rebas, ishte një aga tjetër: manastiri. Tokat e tij vinin gjer këtu. Kishin këto vendet e vreshtave, kodrat nga pas dhe vendet në të kaptuar të fshatit. Po pse s'kishin arritur agallarët gjer atje? Hë, në e gjeçi. Mbase ngaqë ai fshat ishte tepër lart, në të shkarën e malit, dhe ata s'para ngjiteshin në male. Po atje mbiu manastiri. Kudo pillte aga ky drej vend! Edhe manastiri si aga që rritej e majmej ishte. Dhe na shiste për kullota këto musha, këto vende përreth. Ai manastir kishte një doktor. Jatro, i thoshim. Mësuar jashtë vendit ai. Ishte bërë edhe pítrop dhe jep e mirr për manastirin.

Dy fshatarë nga tanët u kthyen prej mërgimit. Kishin mbledhur ca lekë dhe blenë vend e bënë vresht. Mua m'u bë syri çanak! I doja shumë pemët, po isha i varfër. Për çudi, ahere qe puna kështu: unë me fëmijë, për shembull, flija te konaku i agait. Doemos. Dhe punoja me të tretë tokat e tij, ose merrja me të tretë tokë te agai dhe te manastiri. Po më ngrihej

mendja dhe doja të ngrija një shtëpi timen. Para, që të blija vend, s'kisha. Në ishe i zoti të zaptoje një vend, të hapje bina dhe, gjatë natës, të arrije të ngrije murin një metër mbi themele, ahere vendi mbetej yti. Kështu ndodhte, po të mos të diktonin. Po agai nuk ishte budalla. Ai caktonte njerëz që e informonin dhe paguante një beqçi. Kur të kapte, të futnin në burg. Nga kjo e kishim vështirë. Edhe lëviznim, xhanëm. Ndryshe ishte me manastirin. Tjetër aga ai, tjetër ligj mbi të. Po të zaptoje natën një copë tokë, ta mbillje, ta thurje dhe t'i mbaroje këto punë pa u diktuar, toka e mbjellë me pemë mbetej jotja. Pas asaj, paguaje vetëm të tretën. Kështu s'mund të bëje me pronat e agait. Joo. Po edhe manastiri mësonte nga agai tjetër, edhe ai kishte nxjerrë beqçi dhe përgjonte.

Mirëpo mua më qante zemra për vresht. Do bëj edhe unë, e mblodha me mendje, dhe ngrihem e vete te Lame Guma. Ah, i shkreti Lame, që s'rrojti edhe ca! Të dua përjashta, i thashë. Ai doli dhe e llafosëm bashkë. Mos bëjmë ndonjë proçkë, tha. Hyri brenda, mori dyfekun, i foli Macikut dhe të dy dolën në krye të fshatit, nëpër tokat e manastirit. Unë kërcëva te shtëpia e xhaxhait. Eja të zëmë vresht, i thashë. Ku? tha ai. Në arën që kemi marrë me të tretë nga manastiri, i thashë. Punë që s'bëhet, tha ai. Mos ke lojtur? Vajta te dy vëllezërit e mi. Ata ishin më të vegjël se unë dhe kullosnin qetë e agait. Erdhën të dy. Hyra në shumë shtëpi. U bëmë tetëmbëdhjetë vetë, burra e gra. Rreziku i afron njerëzit. Nisëm punën. Bam-bum, bam-bum. Beqçiu i manastirit s'po vinte. Lame Guma dhe Maciku s'na njoftuan asgjë. E punuam. Kalamat e hardhive që do të mbillnim, i kishim prerë më parë te një vresht këtu. I ngulëm dosido me qysqi. Punuam bot e qit dhe, akoma pa rënë dielli, e kishim thurur vreshtin. E karfosëm vendin. U duk Lame Guma e Maciku. Ata e kishin zënë hapazës beqçiuin që në mbrëmje; e kishin lidhur dhe e

mbajtën tërë natën rrëzë një shpelle. Nuk e rrahën. Në mëngjes e lëshuan.

Kishte dalë dielli kur erdhi këtu doktori i manastirit. Një njeri tjetër e kishte nisur për në komunë. Doktori nuk zbriti nga kali dhe shikonte arën e thurur, të punuar e të mbjellë. Iu rrudhën buzët mavi, iu çakarritën sytë dhe foli sikur shkumëzonte kali: «Do ma paguani! Ti e bërë këtë?», më tha mua. «Ja u zgjerova një çikë», i thashë. «Në arë të babait u zgjerove, o brekëçjerrë?! Turp!», tha doktori. Ai zbriti nga kafsha dhe hyri në vreshtin e porsambjellë, uli mesin dhe nxori një kalem hardhie. «Aaa, doktor, mos lajthit! Është vresht i ri, akoma s'ka hedhur rrënjë», i tha Maciku. Doktori hungëroi dhe thirri: «Do të më shihni!» Dhe ecte si i çalltosur. «Mos shkel në ugar, doktor», i tha përsëri Maciku. «Ptu! — pështyu doktori. — Ptu!» Maciku kishte dalë matanë gardhit në anën e tejme. «Të mos shkel në ugar, ë? Në ugarin e sat ëme, ë!» Kështu fliste doktori. Bënte si i tërbuar.

I hipi kalit të bardhë dhe nxitoi në udhën që zbriste anës përroit. U nis për në xhandarmëri, thashë me mendje dhe shikova përçark. I thirra Macikut. Po ai ishte bërë fir. Më ra në kokë menjëherë dhe e kuptova se nxitoi t'i zinte shtegun doktorit.

U sollëm shumë me Lame Gumën gjersa ramë në të. Ai e kishte rregulluar paq. Doktori ishte bërë pulë, sikur të mos kishte kocka. Në gojën e enjtur i luante gjuha mavi dhe sytë i kishin kërcyer, i ishin shtrembëruar e çakërritur. Njëpër buzët e lëshuara i rridhnin jargë. Pas kësaj, Maciku e kishte ngritur, e kishte hipur në kalë, e kishte lidhur me litar pas samarit me rrobë të bukur, që të mos binte, dhe e kishte porositur të mos hapte gojën. Kali ngjitej për në Rebas dhe koka e madhe dhe e rrjepur e doktorit lëkundej, sikur të tundte trutë. Kapellua me rreth si hënë i kish rënë te shtegu në mes të ujit. E kish kalbur në dru Maciku.

Ca ditë më vonë më thirrën në gjyq. Ato para që kisha, i dhashë nën dorë. Pse zure vresht? më thanë. Vresht kishte qenë si vend, u thashë. Ua! thanë. Ku e ke gjetur ti të zaptosh arën natën dhe të hash rrush ditën?

Më dënuan ca napolonë flori dhe më thanë t'i jepja manastrit të tretën e rrushit.

Vetëm një vit pagova. Dhe ç'bëri doktori, thoni ju? Hiç, futi veshët në lesh, mori njëzet e pesë okë rrush për strem dhe s'u ndje. Huri rregullon botën...

Ne shikonim tej vreshtit nga murana e madhe e varreve. Në krye ishte një dru i vetëm valanidhi që bënte hije. Kur të frynte erë, atje do të shkundeshin gjethe. Tani ishte qetësi. Puravel Duka u ngrit në këmbë. Lëvizi mjekrën, sikur të ndiente se ku frynte erë.

— Dikush hyri në vresht, — tha pastaj dhe hodhi duhan në çibuk. Nuk shikonte asgjë.

— Nuk duket, — tha ai, — po dikush hyri.

Qafa e tij ishte shtrembëruar përgjysmë dhe ai akoma ndiqte zhurmat që kishte diktuar.

— Ky nuk është vjedhës, — tha dhe u ul.

Qeshi me të madhe dhe para nesh tani u përtëri një Puravel tjetër. Nga e djathta midis drurëve të dardhave, poshtë hijeve endacake, u shfaq një njeri. Gruaja ime u drodh, dhe mua më shkuan të rrëqethura.

— Pa hajde, hajde, — thirri i pari Puraveli.

— Ama, rojë! — tha njeriu që tej nga hijet.

— Pa hajde, hajde.

— Unë kam një sahat të gjatë që vjedh.

— Vjedh, po të bëhet topi uthull! — tha Puraveli dhe qeshi përsëri.

Burri atje tej lëvizi dhe qeshi. Ai ishte i lartë, me këmbët jashtëzakonisht të gjata, si të shkallmuara.

Hoqi pushkën nga supi dhe u ul përballë. Ai tha se do të dilte poshtë nga fusha dhe foli me mërzi. Ishte beqçiu i sektorit.

— Nuk duhet beqçiu, jo, — tha ai, sikur i fliste vetes i penduar.

Puraveli hidhte duhan në çibuk.

— Në vjeshtën e fundit, kur zbresin kopetë nga mali, le të nxjerrin dy vetë që t'i shoqërojnë, se mos prishin barërat. Po tani, jo, mo, jo, s'duhet beqçiu. Këndova në gazetë se në ca fshatra të Kurveleshit po i heqin. Ndryshuan shumë kohët, Puravel!

Beqçiu hoqi shapkën nga koka, dhe koka pa qime e gjithë domka shpërndau erë djerse. Ai fërkoj me pëllëmbën e rreshkur ballin e thekur.

— Unë kam folur, — tha Puraveli, — po s'më keni dëgjuar.

Tjetri u koll dhe rregulloi më mirë pushkën mbi kofshët e veshura me shajak.

— Dëgjojeni tjetrin kur flet, — tha Puraveli, — Vetëm agai kërkonte të mbanin ujët në gojë. Kemi dy vjet që e themi, po ju e hiqnit zvarrë dhe s'dilnit as në një shteg. Vinit vërdallë si bajga e lopës mbi ujë.

Puraveli lëvizte dorën tutje-tëhu, sikur të tregonte peizazhin. Përqark vinte erë pemësh. Një puhizë e lehtë që shtyhej nga fshati, sillte erë lëngjesh të ziera.

— Dëgjohet një zë, — tha Puraveli dhe ngriti kokën.

— Ndien ujku plak, ndien, — mermëriti beqçiu. Ai shtroi me pëllëmbë mustaqet e rritura, të zverdhura nga duhani, dhe qimja e dendur, e hirtë e faqeve dukej sikur bënte tym.

Puraveli u ngrit në këmbë.

— Sekush këndon në fshat, — belbëzoi.

Beqçiu qeshi me të madhe dhe kroi sheshin e kokës.

— Ç'ke që hingëllin? — tha Puraveli dhe u ul pranë beqçiut.

— Ç'të mos qesh! — tha beqçiu. — Këndon Niko Liti!

Niko Liti është fare plak. Së shpejti në qendrën e kooperativës do të zhvillohet festivali folklorik midis fshatrave të kooperativës. Atje do të paraqitet edhe grupi i pleqve të fshatit. Dhe Niko Liti, kur kishte dalë vonë në mbrëmje nga vatra e kulturës, pas provave, kishte arritur në shtëpi dhe ia kishte shkrehur këngës vetëm. Plaka ishte grindur e kishte thirrur, po ai nuk dëgjonte. Po qepe, o ditëprerë, se zgjove fshatin! i thoshte plaka. Po ai bënte shenjë me dorë që të largohej plaka dhe këndonte. Bëhemi gati për festival, i thoshte:

Dhe një nga një kishin vajtur në shtëpinë e Niko Lilit edhe pleqtë e tjerë. Kishin dalë në ballkonin e shtëpisë dhe këndonin. Njerëzit i dëgjuan, mësuan kush ishin, u ngazëllyen dhe nuk i shqetësuan. Nata shkante dhe ata këndonin.

Një çast kënga nuk u ndje. Ishte qetësi e madhe. Befas në veshët tanë sikur thirri një si ulërimë e largët, e pikëlluar. Drurët e tharë nën këmbët e sime shoqeje kërcitën. Na u duk sikur u përkund ajri dhe sikur yjet u kërlëshën me njëri-tjetrin.

— Dëgjon? — tha bekçiu.

— Qan sorkadhja në Qafën e Botës, — tha Puraveli.

Ne u lehtësuam dhe Qafa e Botës na u duk si një përrallë. Tymi i duhanit ngrihej ngadalë-ngadalë. Nata shkante akoma më thellë, dhe qielli përndritej edhe më. Degët e hardhive mërmëritnin lehtë si qindra melodi fyejsh të përgjumur. Yjet vazhdonin rendjen e tyre të bukur si një kope e madhe, e shpërndarë në livadh. Kënga e pensionistëve u zgjua përsëri dhe vinte gjer te ne sikur dilte nga plasaritjet e tokës së ngrohtë të shtatorit. Atje më tej ishte afruar manari i Puravelit dhe shikonte me kureshtje. Ai shikoi një copë herë me vëmendje, pastaj blegëriu, sikur të pyes-te për ne. Puraveli i foli fjalë të ëmbla dhe e prezantoi me gruan time. Manari iu afrua, i lëpiu duart, i shfryu avull të ngrohtë dhe bënte sikur i përtypte jakën.

— Do kripë, — tha bekçiu.

Puraveli e përkëdheli manarin në gjoks, dhe manari pas pak theu këmbët e holla dhe uli kokën në prehrin e të zotit. Dy minuta më vonë ai gërhiu. Puraveli shikoi lart.

— Ç'bëhet në qiell! — mërmëriti.

Qielli ishte i kthjellët, i thellë dhe yjtë ishin të shkëlqyer. Fyejt e hundës të Puravelit fërgëlluan, dhe ai thithte ajër me tërë mushkëritë.

— Unë do të ngrihem, — tha bekçiu dhe e uli tërë peshën e trupit mbi njërin gju.

— Kuajt! — thirri Puraveli.

Tej nesh ishin qasur dy kuajt. Ata kishin ngritur kryet dhe shikonin nga ne. Ishin barkmëdhenj, shumë barkmëdhenj dhe leshtorë. Kishin ardhur gjer aty, duke gjëmtuar kokrra dardhash nëpër rruginën midis vreshtit.

— Sidoqoftë duhet thurur, — mërmëriti Puraveli. Ai nxitoi dhe kuajt u kthyen prapa dhe kërcyen me këmbët e para të penguara. U përhap erë djersë kafshe. Bekçiu iku duke u kollur në grushtin e dorës. Puraveli kishte humbur tej me kuajt, dhe ne dëgjonim si u fliste. Në fshat kishte rënë heshtja dhe përgark zotëronte qetësia.

— Shumë bukur! — tha gruaja ime.

Puraveli erdhi. Ai ecte dhe mua më dukej sikur s'e kishte ndier veten kurrë kaq të gjatë e kaq të gjerë.

— Njëllor janë pleqtë, — tha. — Nuk bëhen më të urtë, po më të matur. Unë jam akoma i ri. S'dua të plakem.

Ai foli edhe diçka tjetër të nxituar e të ngatërruar, që ne s'e morëm vesh, po qeshëm me gjithë zemër. Gruaja ime qeshte akoma dhe hidhte kokën prapa me një lloj ngutjeje. Unë e kuptova se Puraveli s'kishte qejf që ne të largoheshim, ndaj ajo lloj ngutjeje e gruas sime sikur e trembi. Ndofta ajo ngutje ia bënte vizitën tonë një vegim.

— Është akoma shpejt, — tha.

Ai tregoi diçka për dhelprat. Ato hynin çdo natë

në vresht, hanin rrush dhe, kur ngopeshin, si për inat, dilnin tej te varret dhe lehnin sikur talleshin. Puraveli ishte përballur disa herë me to, po dhelprat nuk trembeshin, nuk nxitonin, sikur ta dinin se ai nuk do t'i qëllonte (ai s'kishte çifte dhe stina e gjuajtjes së tyre vononte), dhe iknin ngadalë, sikur të dilnin nga vreshti i vet. Tani u ndërrohet qimja, tha Puraveli, dhe, ashtu lakuriq, duken fare të vogla e përçmimë. Puraveli foli me pasion, rrjedhshëm, me ngjyra dhe me frazeologji jashtëzakonisht të pasur.

— Si flet kështu ti! — belbëzoi gruaja ime, krejt e hutuar dhe e mpirë.

— Ashtu si këndon zogu, — u përgjigj menjëherë dhe buçiti duke gurgulluar së qeshuri.

Ajo e shikonte drejt dhe përpëliste qerpikët. Në fshat u zgjua përsëri kënga e pleqve. Kënga u ngrit e shtruar, shtretër-shtretër, si të hovte nga thellësitë. Ajo kishte nota tragjike, ngjyra të thella dëshpërimi. Pastaj ajo u lëkund akoma, u bë më e fuqishme, dhe tani grupi i pleqve dukej sikur këndonte përjashta, mbi honet e guvave.

— Këndo, o Gunar Buxheli, këndo! — tha Puraveli, sikur foli me vete — Pse të mos këndosh! Erdhi Partia dhe i hodhe hallet në thes.

Gunar Buxheli ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç më i madh se Puraveli. Dikur edhe Gunar Buxheli kishte dashur të hapte themele në truallin e agait, po agai e diktoi, dhe Gunari bëri burg. Se nuk e thirri fshatin ta ndihte, se desh të jetonte i vetëm. Sonte, në këtë natë shtatori, ai këndonte. Shkonte akoma në punë të kooperativës. Kur bëhen dasma në fshat, ai ulet në trappezë, pi dhe është plaku që flet më pak ose aspak. Kur mendon se ka pirë mjaft, ngrihet dhe shkon atje tek bëhet vallja. Njerëzit thonë: «Doli Gunar Buxheli, hapuni, hapuni». Burrat e tjerë, ashtu si pa u kuptuar, zihen për dore njëri pas tjetrit. Ai qëndron në krye dhe hedh këmbët sikur s'shikon asnjë, asgjekundi, sikur shikon vetëm brenda vetes. Pastaj ndalon, me do-

rën e djathtë të ngritur, të thyer përgjysmë, me këmbën e djathtë të ngritur e të përkulur, sikur mendohet, sikur do të vendosë se ku do ta godasë truallin. Dhe gojën krejt pa dhëmbë e mban të hapur. Ai qëndron ashtu shumë kohë, lëviz mjekrën e thinjur, vë dorën prapa veshit, sikur pret të dëgjojë zhurma të largëta, të ardhura nga thellësira kohësh. Ndërkohë gazet janë afruar pranë tij, fare pranë, dhe njeriu me gërnëtë ia ul veglën te kërcelli i veshit me qime. Gunar Buxheli rrezon ngadalë qerpikët e rrallë, dhe fytyra e tij e tharë shkrihet e tëra. Çdo gjymtyrë e trupit të tij lutet që të fryjë gërneta dhe të qajë violina, të goditë daullja dhe të tjerët të heshtin. Të heshtin zërrat, të heshtin lëvizjet e opingave, fëshfërimat e gjetheve, cicërimat, gjithçka.

Ai lëviz me kujdes të madh qafën, lëviz mesin, dredh gjurin, dhe njerëzit përçark shikojnë të nemitur. Një çast ngjan sikur melodia e sazeve del nga gjymtyrët e tij, nga lëvizjet e tij, ose sikur ai del nga ato melodi të dhimbshme. Hera-herës ai ia bën «ha!» (Nuk merret vesh nga ç'pjesë e trupit i del ajo thirrme.) dhe zhvendoset një çap më tej, pastaj përsëri qas veshin pranë gërnëtës, dhe gërneta dridhet e dërsin, dhe ai ul akoma qerpikët e zbardhur, si të bërë me miell, dhe tund kokën, sikur do të qajë.

Më në fund qan, dhe tamam kur i burojnë lotët, nis e këndon të njëjtën këngë për dëshmorin e fshatit, duke i thirrur herë pas here në emër, sikur ai të ishte diku tej gardhit të ngritur me listela. Pas kësaj, gazet gjëmojnë melodi të gëzueshme. Gunar Buxheli kthehet në trapezë, pi edhe një gotë, belbëzon nëpër buzë urime, del te dera, merr plakën për krahu dhe arrin në shtëpi. Të nesërmen, të pasnesërmen, çdo ditë ai del në punë dhe hesht si pus.

Po sonte, gjer tani në mesnatë, ata janë mbledhur te shtëpia e Niko Litit dhe këndojnë. Do vemi në festival, thonë.

— Këndo, o Gunar Buxheli, këndo! — tha përsëri

Puraveli. — Më parë jetoje fill i vetëm si një kishë dhe tani këndon me shokët.

Ne heshtnim.

— Ky vend është i bukur, o fëmijë, dhe ky popull i fortë si shkëmb. E ruajti këtë vend, — mermëriti Puraveli.

Ai vështronte zemërçelur. U ngrit.

— Doni të shikoni vreshtin?

Manari i vente nga pas. Ai i foli diçka, e përkëdheli në kokë, dhe manari uli kokën të qëmtonte bar.

— Vreshtin e punon brigada e frutikuturës, — tha. — S'e ka tamam kështu emrin brigada, po unë s'e shqiptoj dot. Tani e punojmë ndryshe hardhinë, i bëjmë shërbime agroteknike; bëjmë punim dimëror, i hedhim pleh kimik dhe pleh të bagëtive. Më parë u bënim krasitje tjetër dhe ne të moshuarit kujtonim se i dinim të gjitha, po ja që s'është ashtu. Është viti i dytë që i bëjmë një krasitje tjetër. E lamë krasitjen mono e dopjo gyo. Punojmë një krasitje me ngritje në kordon. Kjo punë doli e mbarë që vitin e parë dhe ca më tepër tani. Brigadierin e kemi djalë me institut dhe presim që të ngremë të tërë vreshtin në kordon. Mor po ky djalë na bëri edhe ne specialistë! Dimë të krasitim kështu në mënyrë të re dhe i bëjmë vetë spërkatjet. Sivjet arritëm që të kryenim dy prashitje me shat në tërë vreshtin. Me krahë s'arrihej, po futëm edhe kuajt e qetë. Në të tëra parcelat shkon uji. Ujin e ngjitim me motopompë nga përroi, po kësaj vere s'i ujitëm. Se uji që i paktë dhe e përdorëm për misrin. E si ta mundnim thatësirën, thoni ju? E mundëm. E mundëm me prashitje. Dhe m'u shoftë edhe veshi tjetër, po s'volëm njëqind e dyzet kuintalë për hektar. Mbase edhe më shumë.

Ai fliste dhe ne ecnim midis hardhive. Atje midis tyre zgjohej një botë e mistershme, që jetonte në vetmi e në heshtje. Puraveli ndaloi. Mbante vesh.

— Tani s'po këndojnë, — tha.

— Jo, s'dëgjohen.

— I mundi gjumi, — tha dhe qeshi.

Kishim arritur në skaj të vreshtit në perëndim. Atje ishin varret. U këput një yll dhe ne ndiem së brendshmi një lloj vajtimi.

— Tani është lindja e tyre, — tha ai dhe lëvizi mjekrën drejt varreve.

U kthyem nga e majta. Në fshat u përhap përsëri kënga e pleqve dhe për një çast ajo sundoi kudo. Kënga ngrihej e ulëj rishtas e rishtas dhe sillej në hapësirën e natës si një balon i mbushur me helium. Puraveli qeshi dhe tundi kokën. Te kodra përballë kalaja e lashtë dukej si perçe kali. Ecnim dhe ndienim një rrëqethje të ëmbël në zemër. Pak nga pak lëvizën hovet e erës që po zgjohej. Kalemata e gjatë të gjelbër të hardhive guduliseshin e sikur bisedonin me zëra të ulët. Puraveli tha:

— Sikur nata është bërë që të jetojnë këto, drurët, që të flasin sendet.

Gruaja ime ndali dhe e shikoi në sy me habi. Unë lëviza kokën.

— Ditën lëvizin njerëzit, gjëja e gjallë, sikur...

Ai ndaloi pranë një hardhie në fund të parcelës.

— Shiko, — tha. — Këtu janë dy hardhi pranë e pranë. Shiko sa afër janë. Njëra e ka zverdhur rrushin, e ka pjekur, tjetra e rrit akoma, e ka jeshil. S'të bën çudi? Është një burrë i shkurtër nga Liçani që mbush gropat e xhades. Shkoi një ditë afër shtëpisë sime dhe tha se do më sillte dy kalema hardhie. I solli. Ishin kalema të shëndoshë. I shartova. Njëri është zgjatur nja gjashtë metra, tjetri ka mbetur, i hollë, i dobët, si fëmijë i paarrirë. Ç'i thua kësaj? Çudi! Të shohim se ç'rrush do të japin! Në tokën personale që kemi rrotull shtëpisë, kemi hardhi. Sa ka një shtëpi tani, s'kish i tërë fshati njëherë e një kohë. Po verën akoma s'kemi mësuar ta ndërtojmë mirë. Ne ishim dhënë pas rakisë. Do t'ia gjejmë hilenë edhe asaj.

— Nuk të duket sikur vërshëllen diçka? — më pyeti gruaja.

Puraveli ndaloi dhe mbajti vesh. Unë s'fola. Vërtet, nëpër natën e kaltër shponte vërshtëllima e një shpendi.

— Vërshtëllejnë shapkat, — tha Puraveli. — Tani erdhi vjeshta dhe pas ca ato do të mërgojnë këtej.

Diku më tej Puraveli ndaloi përsëri. Ai tregoi me dorë kufijtë e hershëm të një cope vreshti. Ajo ishte një parcelë fare e vogël, si një armë në një rrobë të madhe.

— Po tani humbën kufijtë, — tha ai. — Vetëm si-vjet mbollëm tetë hektarë vreshtë të ri dhe vetëm në sektorin tonë.

Unë këputa një veshul dhe ia zgjata sime shoqeje.

— Diku gjetkë i thonë verigë, — mërmëriti ajo.

Në qiell, akoma pa aguar, doli Ylli i Bariut dhe lëshoi përçark zjarrin e tij të gjelbër.

— Ylli i Bariut i themi, — foli Puraveli. — Ai ndriçon në mbrëmje dhe ndaj të gdhirë, kur zgjohet kopja për kullotë.

Zbritëm nëpër një tragë në të shkarën e kodrës dhe arritëm buzë përroit. Kuakitja e bretkosave paralajmëronte shiun që toka e priste aq shumë. Në bregun e tejme drurët e rinj të përgjumur ëndërronin akoma. Atje thellë, nëpër gjelbërimet e përroit plak, të shtrembër e të thellë, rrëketë e shumta dredhonin e treshin me zhurmë. Që andej ngrihej freskia e natës. Në ujin e errët të burimit ndriçonin yje, dhe burimi këndonte qartë atje në botën e tij intime. Pellgoret e shumta lëshonin flakë të vogla. Pranë rrëkesë përhapej freski dhe blerim i bollshëm. Gjethe të mëdha bimësh të egra harliseshin si në festë.

U freskuam dhe dolëm në anën tjetër të përroit. Puraveli ndali dhe zgjati dorën.

— Jua shpërblefshim në shtëpi, — tha.

— Mbetë pa gjumë, — i tha gruaja ime.

Ai u kthye nga lindja, zgjati krahun e djathtë dhe tregoi në qiell.

— Kur hyn ai yll atje, më vyshket syri, — tha.

— Si?

— Po, tamam, kur hyn ai yll atje, më vyshket syri.
Ai humbi tej përroit. Ne të dy ngjiteshim pa folur.

— «Kur hyn ai yll atje, më vyshket syri», — thashë unë me zë të ulët.

— E pra! — mërmëriti gruaja, sikur edhe ajo të mendonte të njëjtën gjë.

Binte vesë. Ajri u bë më i dendur. Toka po njomej, gjethet përçark po lageshin dhe po zgjoheshin tinguj. Kishte filluar freskia e shqetësimit të ditës. Mesnata e kaltër me hënë kishte humbur dhe po ngrihej para-gimi. Në hapësirë silleshin fërfëllima, dhe ajri i lagët buçiste nëpër kopshtet e vogla, të ngjeshura njëri pranë tjetrit.

— Kanë vuajtur këta njerëz, — thashë duke bërë njëfarë meditimi. — Kanë vuajtur pranë kësaj natyre të bukur. Dhe sepse kanë vuajtur nga uria, e kanë parë këtë me sy të turbullt. Edhe qielli më i ndritshëm u dukej i ngrysur. Nga kjo, mbase, i ka marrë frika e fshatit shumë njerëz. Kjo natyrë, ky peizazh është gazmor vetëm kur njeriu është i lirë. Tani që Puravel Duka është zot dhe tërë këto prona janë të tij, ai mund të bëjë gjithçka, mund të trembë edhe pleqërinë. Ai është ngazëllues dhe është besnik ndaj punës.

Dolëm në udhën kryesore të fshatit. Atje mbretëronte një heshtje e zbrazët. Mbi rrugën e tharë binin që nga shtëpitë hije të mëdha, të shformuara.

— Një njeri, — tha gruaja.

Në skaj të udhës një burrë i vjetër i përkulur hidhte çapet e mëdha të çakërritura dhe herë-herë ndalonte, sikur të vriste mendjen akoma për një mendim të gjatë. Ishte Gunar Buxheli.

— Po, — tha, — këndojmë, po sonte s'e rregulluam dot mirë.

Goja e tij ishte e zbehtë dhe e shtrembëruar. Ai

na pyeti në do të rrinim përgjithmonë në fshat dhe, kur ne i thamë se do të rrinim, pëshpëriti:

— Mirë, o bij.

Ai flet pak dhe ky është një zakon i lashtë për të. U çapit. Ca hapa më tej ndaloi, lëvizi kryet ngadalë, si bisha që nuhat erën e ndien motin, dhe tha:

— Sa këndon sahati?

Unë i tregova orën e saktë, dhe ai u çapit përsëri. Para Çlirimit ai ka jetuar shumë kohë i vetëm, i heshtur, i papërzier, dhe pikërisht nga ky shkak duket sikur e ka humbur dhuntinë e të folurit. Dhe atë mungesë të madhe të jetës sikur është ngritur që ta mbushë me këngë tani në pleqëri.

Në ajrin e fshatit përzihej era dehëse e frutave dhe e lëngjeve të ziera. Drurët afër shtëpive ishin bërë grumbuj hijesh. Poshtë në fushë, mbi tokën e freskët e të zezë, ngrihej britma e shqetësuar dhe e hidhur e krillave. Po nxitonte vjeshta e dytë. Që tej oborrit sikur na thërriste oxhaku i shtëpisë dhe një degë qershie, që lëkundej ngadalë e dilte përmbi avlli. Unë dhe ime shoqe ecim drejt shtëpisë. Vazhdonte akoma lëkundja e paraagimit. Yjet në qiell u zbehën. Binte vesë.

Ngjitëm shkallët dhe qëndruam në ballkon te stoli. Ula çelësin, dhe drita elektrike ndriçoi ballkonin dhe shtratin e hardhive mbi oborr. Në një kënd të oborrit nëna kishte lidhur lopën. Bagëtia lëvizi, u ngrit ngadalë, u shkund dhe kurrizi i sheshtë iu drodh. Ajo ngriti bishtin e gjatë dhe përçark u përhap erë bajgë. Barkun e kishte të rrumbullakosur. Viçi, që rrinte zgjidhur pranë saj, nuk u ngrit. Ai tundi kokën me ballë të gjerë. Trupi i tij ishte i bëshëm si i një demi, ishte i gjatë e i fuqishëm, me këmbë të trasha e të shkurtra. Rrinte shtrirë si një kavaletë. Tej oborrit, në kopsht, një dash i madh dyvjeçar me brirë, me bisht të rëndë e të ngjallur, kishte ngritur kokën e po shikonte me kureshtje. Kopshti dergjej në heshtje. Prej tij vinte erë barërash të thara, hasëlli dhe vese.

— Kur hyn ai ylli, më vyshket syri, — mërmërita.

— E pra, — tha gruaja.

Unë kujtova fjalë të tjera të Puravel Dukës. «Si flet ti!» i tha gruaja ime. «Si këndon zogu», tha ai.

Pashë gruan drejt në fytyrë. Ajo m'u duk më e re, me sy të ndritur, të thellë dhe pak si të errët. Në rrugë kalonte dikush.

— Përsëri një plak, — tha gruaja.

— E kaluara ishte një gjumë i madh për ta, — thashë. — Dhe tani duan të flenë sa më pak.

— Po shpërndahen, — tha ajo.

Edhe ai plak kishte qenë për këngë në shtëpinë e Niko Litit. Ai ishte tepër i moshuar dhe ecte me kokën ulur e me shpinë të përkulur, sikur kërkonte diçka në udhë. Ndërsa duart e mëdha, të gjata, gjithë kockë e lëkurë i nxirrte prapa, si të bëhej gati për t'u hedhur në ujë. Ishte plaku Macik. Edhe ai vuan nga një zakon që e ka sjellë që nga largësitë e kohërave: çdo të folur e përcjell me të sharë. Dhe këtë zakon s'mund t'ia çrrënjosësh. Aq sa mund t'u çrrënjosen çobanëve disa zakone të tyre.

Po ngrihej mëngjesi që do të niste të bridhte e të lëvrinte. Mbi supin tim ndjeva të lëshohej lehtë diçka e freskët dhe e butë. Ishte koka e sime shoqeje, e rënduar nga gjumi. Unë lëviza ngadalë, dhe ajo mërmëriti diçka nëpër buzët e fryra e të dashura.

PASI DËGJOVA KËNGËN E NJË GRUAJE

Ajo ishte nata e dytë e festivalit. Unë qëndroja në rreshtat e parë, afër podiumit. Në krahun tim ishte nusja e xhaxhait. Ajo kishte ardhur atë pasdite nga fshati. Nga fshati kishin ardhur edhe njerëz të tjerë. Nusja e xhaxhait u takua me mua, dhe ne ndenjëm bashkë. Shoqet e saj, gra e të reja nga fshati, u ulën grumbull diku pas nesh. Në fillim nusja e xhaxhait ktheu disa herë rresht kokën prapa. Ajo shikonte shoqet e saj dhe bënte buzën në gaz.

— Janë atje prapa, — tha ajo.

Unë nuk fola.

Ajo tha kështu dhe shikoi diku në rreshtin para nesh.

— Po këta me mjekra? — pyeti ajo me zë të ulët.

— Janë të huaj, — thashë.

Grumbulli i shoqeve të saj nuk shikonte nga të huajt që ishin në rreshtin para nesh.

— E pamë mbrëmë në televizor, — tha ajo.

Ajo ndodhej e tëra në gjendje festive. Ishte me të vërtetë e gëzuar si fëmijë. Lëvizte dhe donte të fli-

ste vazhdimisht. Kur konkuruesit u ngjitën në podium, ajo heshti. Këngët dhe vallet papritur filluan të ndiqnin njëra-tjetrën, dhe ajo shikonte gati e hutuar.

— Oh, oh! — mërmëriste ajo.

Unë ndiqja programin që kisha në dorë, dhe ajo pëshpëriste herë pas here, sikur të ndodhej para një mrekullie:

— Po ato të Lezhës do japin sonte?

— Jo, — thashë. — Ato dolën mbrëmë.

— I pamë në televizor, — tha.

Nusja e xhaxhait nuk ishte llafazane, po atë natë donte të fliste shumë.

Në fund, në skenë dolën një grup grash. Ato ishin me veshje karakteristike të krahinës nga vinin. Njëra prej tyre, një grua mbi dyzet vjeç, shikoi me vëmendje përçark dhe bëri disa hapa përpara. Ishte qetësi. Dyzetvjeçarja shikoi përsëri shoqet përçark, dhe të gjitha shoqet e saj që kishin dalë për të kënduar, u kollën lehtë dhe ulën duart më mirë diku në rripin e mesit. Gruaja e parë ktheu kryet paksa nga e djathta dhe shikoi diku nga majat e plepave që lëkundeshin ngadalë. Pastaj lëvizi dorën e majtë, mori frymë thellë dhe nisi këngën. Pamja e saj përnjëherësh u bë mjaft e tronditur. Puliste sytë, shtrëngonte nofullat, dhe duart e ndera përpara i dridheshin, sikur ta kishin pushtuar ethet. Qepallat nuk i regëtinin më. Sytë e saj tani nuk vështronin, po depërtonin. Në fytyrë i dukej një lloj egërsie e fisnikërie bashkë. Shpesh ajo merrte ngjyra përbuzëse. Nga njëri varg te tjetri gruaja pushonte gjatë, po në ato pushime ne s'arrinim të ngopeshim me frymë. Pas vargut të katërt ajo u zbeh. Edhe nusja e xhaxhait ishte zbehur; ishte tulatur pranë meje dhe s'pipëtinte.

Gruaja këndonte një këngë të tillë, sikur kishte dalë atje që të tregonte biografinë e saj. Ajo i thërriste babait, që e kishte lënë fare të vogël, se ishte vvarë në hasmëri; tregonte për fëmijërinë e saj të varfër e të mjerë dhe për kasollen e vogël të shtruar me baltë, që

ua kafshonte era në netët me acar të dimrit. Bashkë me këngën e saj ne ndienim si na derdhej në shpirt një copë dramë e rëndë si errësira dhe e ftohtë si një copë hekur në dimër. Pastaj kënga bënte fjalë për agallarët dhe dëshmorët e Luftës. Gratë e tjera mbushnin këngën, dhe një zë që ia hidhte, dukej sikur thërriste me ngulm dëshmorin e fshatit të tyre të vogël.

Pjesa e dytë e këngës ishte për zakonet prapanike, dhe këtu fytyra e gruas që ia mernte këngës, u egërsua edhe më, u bë e pamëshirshme; ajo dukej sikur rrëmbente zakonet e këqija dhe i shkelte me tërbim. Diç tregonte për rininë e vet, kur e patën martuar me mblesëri, po ajo kishte zgjatur dorën te Partia e shoku Enver, kishte ndarë një burrë të gjymtuar e kishte dalë në jetën e madhe.

Nusja e xhaxhait shikonte me vëmendje fytyrën e saj, dridhej dhe diç belbëzonte.

Pas atyre vargjeve të dhimbshme, fytyra e gruas që këndonte mori dritë. Ajo këndonte për ditët e reja, për Partinë, për diellin. Diku prapa nesh, atje ku ishte grumbulli i grave të fshatit tim, u bë një zhurmë e turbullt. Nusja e xhaxhait u çlirua nga ai ankth dhe ngriti kokën. Më shikoi drejt, dhe sytë e saj, që po qeshnin, sikur më pyesnin. Pastaj nusja e xhaxhait ktheu kokën prapa dhe shikoi nga shoqet. Fytyrat e tyre komunikuan me njëra-tjetrën. Nusja e xhaxhait u kthye përsëri përpara dhe gëzohej si fëmijë e hutuar.

— Ajo! — tha.

— Kush?

— Ajo, ajo...

Nusja e xhaxhait ishte e papërqendruar, dhe unë akoma s'po e kuptoja se ç'donte të thoshte.

— S'të kujtohet?

— Jo, — thashë.

— Shikoje në sy, — tha. — Në sy njihet.

Unë shikova drejt atë që këndonte. Kënga tani ishte bërë e gëzueshme, sikur brenda saj të rrokulliseshin rreze dielli, burime, ylbere, cicërima zogjsh. Nusja

e xhaxhait qeshi, shikoi nga podiumi dhe u kthye prapa për t'u parë me shoqet.

— Ajo, — mërmëriti përsëri nusja e xhaxhait.

Tani, sytë e asaj që këndonte, edhe mua m'u dukën të njohur. Na lidhte me ta diçka e largët, intime. Kush ishte ajo?!

— Ti ishe i vogël atëherë, — foli papritur nusja e xhaxhait. — Me këtë ishte martuar Vacoja ynë, Vacoja i hallës sate.

Unë shikova në podium.

— Këtë nuse i dhanë Vacos, po kjo iku, e la.

Kënga mbaroi. Grupi i grave që këndoi po zbriste nga podiumi. Ai ishte grupi i fundit i asaj mbasditeje. Nusja e xhaxhait u ngrit në këmbë dhe shikoi prapa. Njerëzit dilnin. Gratë e fshatit tim erdhën pranë nesh dhe të gjitha, pa radhë, nisën të diskutonin për atë gruan që ia merrte këngës...

(Dikur atë e kishin sjellë nga larg dhe e kishin martuar me djalin e hallës sime, me Vacon. Po ajo kishte ndenjur në fshat vetëm pak ditë dhe pastaj kishte ikur, e kishte braktisur Vacon. Ishte vjedhur me një teknik pyjesh.)

Gratë, të gjitha grumbull, shkuan prapa podiumit. Nusja e xhaxhait u afrua e para ndanë atyre që kënduan pak më parë. Njëra nga këngëtarët u shkëput nga shoqet dhe iu afrua nuses të xhaxhait.

Ishte pikërisht ajo. Në fillim ato diç folën me njëra-tjetrën, pastaj zgjatën duart, u shikuan në sy dhe u puthën. Sytë e këngëtares u lagën me lot. Gratë e fshatit tim u afruan të gjitha atje dhe u përfaquan me këngëtares e festivalit. Pastaj bënë më tej dhe filluan të flisnin me zë të lartë.

Unë shikoja këngëtares në fytyrë dhe mundohesha të kujtoja atë natë të largët dasme kur ajo u martua për herë të parë. Pranë grupit të grave u çapit një vajzë flokëverdhe, e gjatë, me mollëza të ngritura, që i bënin hije në faqet e pjerrëta. Këngëtarja e mori nga dora dhe tha:

— Vajza. Është në universitet.

Gratë e fshatit e shikuan me vëmendje, pastaj u puthën edhe me të me radhë, një nga një. Dy gra nga të fshatit qanë.

— Si është ai? — mermëriti këngëtarja më në fund.

Të gjithë e kuptuan se pyeti për Vacon. Edhe Vacoja tani është i martuar. Ka marrë një grua që çalon pakëz dhe kanë lindur fëmijë e jetojnë mirë. Atëherë... Kishin rrjedhur shumë ujëra që nga viti 1948. Sonte është tjetër mbrëmje, tjetër vit. Unë u krodha për të zbritur tek ajo natë e një të shtune me dasmë pikërisht në atë vit të largët.

Po ktheheshim në shtëpi dhe mendonim për ato vite dhe veçanërisht për atë dasmë të asaj nate, kur Vacoja ishte martuar për herë të parë. Edhe kur u shtriva në krevat, një kohë të gjatë mendova për atë dasmë, për Vacon. Ai...

I

Ai gjithnjë shkonte bari me lopë, dhe neve të gjithëve na dukej sikur kishte lindur atje në kopenë e lopëve, ose diku nëpër cërmédelle dhe pastaj, kur ishte rritur, kishte shkuar përsëri pas lopëve. Unë kisha shumë dëshirë që të shkelja nëpër vende të tjera, tej udhëve të ngushta si hendeqe të fshatit tim dhe të sillesha andej nëpër burime e të ndiqja zogj. Po isha akoma i vogël, dhe babai dhe nëna nuk më merrnin nga pas. Qëllonte shpesh që babai të tregonte për ca vrima të thella andej nga brinjat e lumit dhe për ca biseda që ai i kishte bërë diku, te vendi që quhej Qafa e Demit. Kur në shtëpi sundonte errësira, unë rrija me sy hapur brenda në shtroja dhe mundohesha të ecja nëpër ato traga që të ngjitnin

te Qafa e Demit, apo të zbritja nëpër vrimat e errëta, të cilat jetonin diku poshtë shpellave të murrme dhe drurëve të shtrembër. Pastaj nata bëhej më e zezë dhe në trarët e në errësirën përçark shtrihej një botë tjetër, që shponte nëpër qetësi; më dukej sikur dikush brente trarët nga brenda dhe jashtë vinin rrotull qenie të tjera. Atëherë më pushtonte një frikë e madhe dhe, me shumë vështirësi e i qullur në djersë, shtrija dorën anash derisa prekja nënën ose babanë. (Unë flija midis nënës e babait). Dhe, kur sigurohesha se ata ishin aty, ulja kapakët e syve dhe tulatesha edhe më. Në përfytyrimin tim vinin lloj-lloj qeniesh, si për shembull, insekte me krahë të mëdhenj, kafshë të tjera tërë lesh dhe fëmijë lakuriq e të njomur, të cilët dilnin në muajin e shkurtit e qanin e thërritnin përmes mjaullimës së maceve. Kështu ata shëtitnin nëpër natë, ngjiteshin nëpër pullaze dhe qëndronin në trarët e shtëpive. Unë e dija se tërë këto qenie dilnin nga ca vrima të fshehura të nëndheshme diku anës lumit, të cilat ishin të errëta dhe pikonin; ato dilnin andej, rrinin një copë herë te hyrja e guvës dhe fshinin sytë, duke lëvizur poshtë e lart kryet e tyre të çuditshme. Pastaj ato ngjiteshin në rresht me një zhurmë të pazakonshme dhe shpërndaheshin pllajës me shpella, duke ikur në drejtime të ndryshme.

Nata ishte e tyrja, dhe unë kisha shumë frikë nga errësira. Kurse djali i hallës sime gjithnjë shkonte me lopë dhe asnjëherë nuk dëgjuam që ai të ishte trembur. Ai ikte në mëngjes herët dhe kthehej vonë natën. Halla e kishte shtëpinë tej, në anë të fshatit, nga lindja, kështu që ai dilte dhe hynte në fshat pa u takuar ndoshta me asnjeri.

E quanin Vaco. Edhe të tjerë njerëz në fshat kishin emrin Vaco, po neve të gjithëve na dukej sikur emri Vaco për atë shqiptohej me një theks të veçantë dhe se ai ishte një Vaco krejt ndryshe nga ata Vacot e tjerë që kishte në fshat. Kur përmendnin emrin e tij, fshatarët lëviznin kokën në mënyrë të atillë, sikur

donin të tregonin pikërisht për atë Vaco që ishte djali i hallës sime dhe që e kishte shtëpinë tej në anë të fshatit, në lindje.

Halla kishte edhe fëmijë të tjerë, po të gjithë ata i shikonim në fshat tek shkonin me bagëti ose me qe, për të punuar në arë. Ndërsa ai shkonte barë me lopë. Dhe të gjithëve, veçanërisht neve fëmijëve, na ngjante krejt i huaj për fshatin, ndoshta edhe sepse ai asnjëherë s'kishte shkuar barë pas lopës dhe demit të tij, apo pas bagëtive të fshatit. Ai shkonte bari me lopët e një fshati tjetër të vogël, shtëpitë e të cilit ishin në fund të malit, pranë një pylli të dendur, dhe arat e të cilit zinin kufi me tokat e fshatit tonë. Kështu, ai ikte në mëngjesin e thellë dhe kthehej vonë pas muzgut. Hynte në shtëpi, ulej pranë vatrës dhe nuk dilte. Nëna ime fliste pak për të, dhe ne kujtoheshim rrallë. Vetëm kur në shtëpi vinte halla, atëherë në biseda flitej edhe për Vacon, dhe ne të vegjlit e përfytyronim si një mister. (Pikërisht atëherë nisa të mendoja se ai kishte lindur diku në pllakat e pjerrëta me çermëdelle apo në hyrjen e ndonjë guve). Halla e lëvdonte shumë, ndërsa babai im, që e kishte motër hallën, e dëgjonte me sytë ulur poshtë dhe trazonte prushin. Nëna mblidhte buzët e holla me njëfarë dinakërie dhe tundte kokën. Më në fund, kur halla kishte folur shumë dhe ndihej tepër e kënaqur, nëna tregohej e pamëshirshme dhe ngrihej në këmbë e, duke kthyer krahët, mërmeriste e pakënaqur.

— Mos e ndaj nga fshati.

Nëna atë kohë kishte dalë jashtë, dhe halla shikonte akoma me inat andej nga kishte dalë ajo.

— Po kjo? — ia bënte halla, duke lëvizur nofullën e vogël.

Babai pinte duhan me llullë dhe nuk ngrinte kryet. Nëna pastaj vinte brenda, dhe halla nuk e shikonte në sy. Ajo merrte atë drunë e vogël me të cilin babai trazonte prushin dhe zinte e fliste prapë për Vacon. Ajo ngulte këmbë në të sajën dhe thoshte se ai, dome-

thënë Vacoja, nuk ishte ndonjë i humbur, se ai kishte parë shumë njerëz kur kishte qenë në ushtri dhe se njerëzit e atij fshati tjetër ishin të mirë dhe Vacoja tani kishte mësuar shumë gjëra. Ajo tregonte për këtë një copë kohë të gjatë, kurse nëna, sikur të mos kishte dëgjuar asgjë nga ato, thoshte:

— Mblidhe djalin në shoqëri, se do ta pësojë si Nexhua. Mblidhe burrin në fshat, se s'ia shikoj punët mirë!

Nexhoja kishte qenë argat në fshatin tonë, kishte ardhur diku nga larg, shumë kohë më parë. Ishte njeri i heshtur e i papërzier; nuk fliste, shkante pas bagëtive dhe kishte ngelur pa u martuar. Ndërsa burri i hallës... Po. Ai ishte burri i hallës sime. Dikur halla nuk kishte qenë hallë; ajo kishte qenë e vogël, domethënë kishte qenë si shoqja ime, Zaroja, dhe atëherë e thërritnin Ano. Po ajo u rrit dhe, pasi e fejuan, u martua dhe lindi fëmijë. Më vonë nëna ime më lindi mua, dhe unë tani i thërritja asaj hallë. Burri i saj ishte i gjatë, shumë i gjatë, me një fytyrë në ngjyrë të dheut. Ai ecte i përkulur dhe, ashtu i përkulur, anonte nga ana e djathtë. Unë nuk e doja. Sidomos nuk e doja kohët e fundit. Ai ishte i gjatë e i rëndë, dhe ndoshta nga kjo ai s'vinte shpesh në shtëpinë tonë. Apo sepse shtëpia jonë dhe shtëpia e tyre komunikonte me hallën. Po ato net të turbullta, ato net me humnera resh, me bubullima e shira, gardhi ynë nga prapa shtëpisë u shkel shumë herë, dhe opinga e madhe e burrit të hallës shumë herë hapi gropa në dëborën e re që binte përjashta. Sepse atëherë ai vinte dendur në shtëpinë tonë, dhe të dy me babanë rrinin përballë njëri-tjetrit pranë kllanikut dhe bisedonin e pinin duhan. Ata flisnin e flisnin atje pranë zjarrit, dhe zjarri shuhej shumë herë, po prapa shpinës së babait nëna linte dru, dhe babai e përtërinte zjarrin. Ne shkonim më tej, në fund të odës gjysmë të errët, dhe mbuloheshim në shtroja. Më mundte gjumi dhe zgjohesha përsëri,

dhe përsëri ata të dy ishin të pështetur pranë kllanikut përballë njëri-tjetrit. Mua akoma më gjëmon në vesh gjuha e trashë, paksa e belbët e burrit të hallës, veçanërisht kur shqiptonte fjalën «kooperativë». Sikur ai e afronte me kujdes këtë fjalë, pastaj e fuste në gojë dhe, para se ta kapërdinte të tërë, e sillte midis dhëmbëve. Ndoshta nga kjo, bulçitë e burrit të hallës ishin të ulura poshtë. Apo...

— Jo, jo, — thërriste babai dhe godiste njëren dërrasë të kllanikut me mashë.

— Mos u rërmbë, — thoshte burri i hallës. — Kooperativë! Eja, tha macja, të bëjmë mbledhje. Po miu kollovo nuk shkoi. Dhe të tjerët e pësuan. Ti...

— Jo, — thoshte babai.

Pas kësaj, shumë net të tjera ra dëborë, dhe shumë net burri i hallës erdhi në shtëpi te ne. Natën vonë ne mbuloheshim në shtroja, po ata të dy, burri i hallës dhe babai, qëndronin atje dhe bisedonin.

Kishin kënduar kokoshët e parë një natë. Unë isha zgjuar. Babai thirri:

— Unë asnjëherë s'ta pëlqej mëndjen ty.

— Unë kështu do bëj, — tha burri i hallës.

— Bëhu ballist atëherë, — tha babai.

Burri i hallës (e kam vështirë që i vë pranë e pranë këto dy fjalë: burrë dhe hallë) heshti.

— Ti bëhu ballist, unë do bëhem kooperativë, — tha babai.

— Ç'të duash? — tha burri i hallës. — Vacon e kam të rritur.

— E pastaj?

— Do ta dërgoj në fshatin tjetër, në Maniq. Ai fshat s'bëhet kooperativë.

— E pastaj?

— Dhe kur të prishet kooperativa e kur të japin llogari ata që e bënë fshatin kooperativë, unë vë krahët në Maniq.

— Përjashta! — thirri babai.

Ne u llahtarisëm. Qeni lehu në oborr. Burri i ha-

llës ishte i lartë, i bëshëm, i anuar. Babai ishte i vogël, i imët. Ai dridhej. Burri i hallës mërmëriste fjalë të ngatërruara.

— Ç'është kështu! — tha nëna, duke ulur flokët e shprishur.

Burri i hallë iku. Qentë e fshatit lehën njëri pas tjetrit. Babai hodhi dru në zjarr. Nëna u ngrit, piu ujë nga bucela dhe u ul përballë babait.

— S'ta dua fjalën, — i tha babai.

— Ballisti! — shfryu ajo.

Babai ngriti mashën. Përjashta akoma lehnin qentë. Po të nesërmen në mbrëmje halla erdhi përsëri në shtëpi. Nëna shau ballistët. Halla shikoi babanë me sytë e vegjël, pastaj shikoi nënën. Ajo e bëri këtë disa herë.

— E pastaj? — tha më në fund, ashtu e trazuar dhe tepër e pakënaqur.

— Pse çuditesh? — tha nëna.

— Si pse çuditëm? Vacoja do katandiset si ballistët!

— Ai yti, burri, — tha nëna. — Ai që sillet për të prishur fshatin.

— Ai merret me shtëpinë e tij, — tha halla dhe nuk e shikoi në sy.

— Të merret me shtëpinë e tij dhe të mos ngatërrojë fshatin, — foli nëna.

Halla shfryu e pakënaqur.

— Dhe zjarri do bjerë në pragun tuaj, — tha nëna. Halla nuk foli.

— Do nxirrni sytë tuaj me këto që bëni, — mëmëriti nëna.

Sytë e vegjël të hallës lëvizën me nxitim.

— Ne s'nxjerrim sy, — belbëzoi halla.

— Shikoni djalin, — tha nëna.

— Ç'djalë?

— Vacon.

— Vacoja është si veshka në dhjamë, — tha halla. Nëna qeshi.

— Mos qesh, — tha halla, e zemëruar.

— Ç'të mos qesh! — tha nëna. — Djali yt mbeti si i harruar në shkarpa.

— Pa shih djemtë e fshatit.

— Jo, — tha halla.

— Si jo?! — tha nëna.

— Jo, — thirri halla me zë të hollë dhe u mbloodh pranë kllanikut.

— Pse jo? — tha nëna. — Ikën natën, vjen natën. Tërë ditën me bagëti në hon, pa njeri. Me kë ndërrojnë një fjalë?

— Po ai di plot, — tha halla.

— Nga i mëson? — tha nëna.

— Ata të fshatit tjetër janë njerëz të mirë, — tha ajo.

— Vacoja nuk është çoban me ta, po me bagëtinë e tyre, — tha nëna. — Ata janë një grusht shtëpi në anë të pyllit dhe kooperativë nuk janë.

— Kuprativën mos e zër në gojë, — tha babai, i mugur, dhe ngriti lart me nervozizëm drunë me të cilin trazonte prushin.

Halla uli sytë e vegjël dhe shikonte në vatër.

— Ata bëjnë dasma dhe këndojnë, — mërmëriti halla pas heshtjes.

— Bagëtinë nuk e ftojnë në dasmë, — pëshpëriti nëna, me sytë të ulur poshtë. — Mos e bëj argat të tyre, — tha nëna prapë dhe shikoi fshehurazi babanë.

— Nuk është argat, — tha halla.

— Argat është, — tha nëna.

— Mos fol për argatët, — tha babai, i zymtë.

— Ai fshat është i varfër dhe këtë e kanë argat, — mërmëriti nëna.

— Kjo nuk është fjalë, — belbëzoi halla.

— Se s'dëgjoni mirë nga ky vesh, — tha nëna, sikur t'i kishte hedhur poshtë ato fjalë dhe mori shtizat të thurte.

— Edhe ne bukë hamë, — mërmëriti halla.

— Në ha bukë dhe ti, bjere djalin këtu, që të vijë darkave e të dëgjojë harmonikën.

— Edhe për harmonikën mos fol, — tha babai me një zë të ulët si gjëmim i thellë. — Mos fol.

Babai mbushi përsëri llullën.

— Harmonika! — tha halla. — Çdo mësojë në harmonikë me cipëdalët?

— Po ku do mësojë? — tha nëna, duke vështruar boshtin që lëshohej e dridhej.

— Mendja është udhëve, — tha halla.

Nëna s'foli.

— Kalliu i rëndë e mban kokën poshtë, — mermëriti halla dhe u ngrit.

— Mos ik, — tha nëna.

Po ajo iku e pakënaqur.

Babai nuk fliste. Ai ngrinte re të vogla tymi me llullë. Unë përfytyroja Vacon e imët, pak të kërrusur, me ato pantallona të mëdha doku ngjyrë dheu dhe me opinga. Ai mbante gjithmonë një shkop në dorë dhe pinte duhan e nuk fliste. Kur fliste, i merrej goja dhe ngjante sikur mermëriste i penguar.

Nëna çeli gojën pas tërë asaj heshtjeje dhe tha se Vacoja ishte katandisur sa një kec dhe kishte dy gisht ballë, po atë kohë babai e vështroi nënën me inat dhe i tregoi urën e zjarrit. Nëna nuk e tha më atë fjalë.

Më vonë halla erdhi përsëri në shtëpi, po ajo dukej më shpesh kur ishte vetëm babai. Burri i saj nuk erdhi. Ai nuk erdhi shumë net me radhë. Dhe babai u shmangej bisedave me të. Po në udhë ata të dy i ndiznin llullat njëri-tjetrit. Doemos, ne ishim fis dhe...

Babai pinte duhan me llullë dhe këmbët i shtrinte në vatër pranë hirit. Halla zgjaste duart e vogla dhe fërkonte këmbën e tij, ndërsa ai pinte duhan. Pastaj ajo i fërkonte këmbën tjetër. Babai vazhdimisht pinte duhan. Më shpesh, duhanin e thante pranë zjarrit, pastaj e shkërmoqte në pëllëmbë dhe mbushte llullën. Llulla ishte bërë me dru piksi, dhe unë e kisha parë kur ai e lyente

me gjalpë. Pas kësaj llulla pastrohej dhe mernte një ngjyrë të pjekur e të bukur.

Ai fliste rrallë, sidomos kur pranë vatrës uleshin gra. Halla i rrinte shpesh pranë, i hiqte çorapet e leshta dhe i fërkonte këmbët. Babai nxirrte thikën e lidhur me rrip në brez dhe priste thonjtë e ndyrë në ngjyrë të thellë blu. Ajo rrinte gjatë pranë tij, e fërkonte dhe e shikonte drejt në sy, sikur të priste me padurim e të lutej që ai të fliste një fjalë të mirë. Ndërsa ai hiqte llullën dhe mbushte mushkëritë me tym duhani. Qëllonte që ai vetëm heshte, dhe halla vetëm i fërkonte këmbët, Ai nuk fliste asnjë fjalë ose thoshte vetëm: «Mund të bjerë shi» dhe, pas kësaj, përsëri nuk fliste asnjë fjalë. Halla atëherë ngrihej dhe ikte. Unë kujtoja se ajo nuk do të vinte më në shtëpinë tonë të gërvishte te dera e jashtme, sikur të kuisëj një kone e vogël natën në të ftohtë, dhe të hynte brenda e të ulej si një hije e paktë. Kështu kujtoja, por unë isha tepër i vogël ndoshta, se edhe shumë gjëra të tjera nuk i kujtoja.

Halla ulej përsëri pranë vatrës sonë, përballë babait. Ajo e shikonte drejt në sy, kurse ai pinte duhan e zgjaste këmbët. Mua atë kohë më kujtoheshin thonjtë e ndyrë, në ngjyrë të thellë blu të këmbës së tij. Ata tani do të zbuloheshin dhe...

Kurse Vacoja dukej shumë rrallë te ne në shtëpi. Kur ngjiste shkallët e gurta, ai hynte te dera dhe një copë herë qëndronte i stepur e i hutuar, sikur s'dinte ç'të thoshte, apo sikur pyeste në duhej të hynte apo jo. Atëherë, dikush nga ne ngrihej në këmbë dhe i fliste që të hynte. Ato çaste të krijohej përshtypja sikur përnjëherësh i çelej fytyra, dhe ai tani do të qeshte e do të fliste diçka, po papritur rrudhat që kishin nisur të zbritnin, uleshin përsëri, dhe Vacoja nxirrte nga goja vetëm një «e». Babai duhej të ndihej ngushtë, sepse ulte kokën, sikur ngatërronte diçka në zjarr dhe i thoshte:

— Ulu.

Nëna lironte kreun, po Vacoja s'donte kurrsesi të ulej në krye. Babai atëherë thoshte:

— Ulu atje!

Toni ishte urdhërues. Nëna e kuptonte, kur inatosej babai, dhe i hapte rrugë. Ajo e hiqte Vacon nga bërryli, dhe ai mëmëriste diçka e ulej në krye.

Një ditë Vacoja dhe babai po rrinin përballë njëri-tjetrit. Vacoja sikur nuk dinte se si të rrinte dhe ku t'i humbte duart.

— Dridh duhan, — tha babai dhe i afroi kutinë prej llamarine.

— Kam, — tha ai.

— Dridh këtej, — tha babai, pa e shikuar në sy.

— Kam, kam, — belbëzoi Vacoja, duke iu marrë goja.

Babai ia hodhi kutinë në prehër, po Vacoja e ngriti dhe e lëshoi mënjanë.

— Kam timin, — mëmëriti ai.

Nëna qeshi pa zë prapa krahëve. Babai e shikoi me inat nënën.

Të dy ata pinin duhan. Unë kënaqesha që Vacoja dhe babai pinin duhan përballë njëri-tjetrit.

— Po si je, bir? — i tha nëna.

— Mirë, — tha ai dhe e shikoi drejt në sy.

— Të jesh mirë, — tha nëna.

— Ka bar? — e pyeti babai.

— Nuk të dëgjova, — tha ai.

— Ka bar për kullotë? — thirri më fort babai.

— U ngushtuan kullotat, — tha ai.

Pastaj heshtën. Babai foli dhe një herë, po Vacoja vetëm tundi kokën dhe piu duhan. Natyrisht ishte tepër e vështirë të thyeje vazhdimisht atë heshtje. Ato çaste mërzia ngrihej si një qenie e përhimtë dhe ulej në vatër në çdo qoshe të shtëpisë.

Nëna shtroi darkën, po ai u ngrit. Ne e lutëm të rrinte për darkë, po Vacoja s'pranoi kurrsesi. Ngjeshi në këmbë opingat e trasha. Doli jashtë, dhe unë

e ndjeva që nuk i zbriti shkallët. Pas ca u kthye prapë brenda.

— Hë? — tha babai.

Vacoja rrinte të hyrja, duke mbajtur në njëren dorë shkopin dhe në tjetrën shapkën e dalë boje.

— Harrove gjë?

— Jo, — tha ai dhe shikoi drejt.

Babai e pa në sy.

— Të desha, — tha ai pas një ngurrimi përpëlitës.

Babai u ngrit në këmbë, po, pa dalë akoma nga dera, ne e dëgjuam që Vacoja foli me një renditje të shtrembër, të fjalëve.

— Mëma gjë, të tha gjë mëma? — belbëzoi ai.

— Kërkon nuse, — mërmëriti nëna ime dhe buzëqeshi me një lloj djallëzie e dhembjeje përzier bashkë.

Vacoja kërkonte nuse.

Tani halla dhe burri i saj vinin te ne në mbrëmje e bisedonin dhe, pas bisedave të tjera të shkurtra e të çoroditura, që patjetër ishin krejt pa rëndësi, e kapërcenin fjalën dhe e turrnin gjatë se si ta fejonin Vacon me një vajzë. Ata bisedonin me orë të tëra, duke folur për nëna dhe baballarë të ndryshëm të fshatit, dhe halla e burri i saj ktheheshin shumë prapa në të kaluarën dhe kur dikush zuri në gojë vajzën e Koto Gjobarit, halla prishi fytyrën e rrudhur e të zeshkët dhe tha se Koto Gjobarit kishte qenë në Amerikë, po që andej kishte sjellë vetëm një harmonikë dhe nisi t'i binte darkë e mëngjes vend e pa vend, tek kulloste hamshorët e agait, derisa një ditë harmonikën ia lagu shiu dhe pastaj bënë me lëndën e saj shumë krehra, se tërë fisi i tyre ishte i pahair dhe ishin mbytur në morra dhe ata tani, shyqyr që u lag harmonika, dhe bënë krehra për të nxjerrë morrat nga koka. Kështu që asnjëri prej tyre nuk e zuri më në gojë vajzën e Koto Gjobarit dhe nuk e qasën fjalën hiç te fisi i tyre.

Më në fund, babai diç tha për një vajzë tjetër të fshatit. Po halla i tha babait që ai të mos bënte shaka e të zinte në gojë një vajzë të çalë. Ata u menduan

shumë dhe zunë në gojë edhe dy vajza të tjera, po halla përsëri e gjykoi se njëra prej tyre shikonte vëngër dhe tjetrën e kishte parë dikush në qytet me pallton hedhur në kokë dhe se, kur e kishin pyetur se pse e hidhte pallton e vjetër në kokë, vajza ishte përgjigjur shkurt, duke u ankuar se e vriste dielli.

Këto biseda vazhduan edhe shumë net të tjera, dhe kllaniku ynë përtypi shumë trungje të zeza, që babai i kishte prerë diku larg gjatë muajit shkurt dhe i kishte sjellë në shtëpi me gomar e me kalë. Babai disa herë kishte mërmëritur se nga ato trungje të rënda gomarit i ra ujët në këmbë. Po tani trungjet ishin tharë dhe gomari përtypej poshtë në katua, ndërsa në vatër gjëmonte zjarri dhe përqark rrinin babai, burri i hallës, nëna, halla dhe unë (vëllai tjetër i madh ishte ushtar) dhe bisedonin përsëri për një vajzë që të fejonin Vacon.

Në të vërtetë, me sa kuptoja unë, ata deri tani kishin kërkuar në katër familje nuse për Vacon, por duket se të katra s'kishin pranuar, ose e kishin kthyer fjalën sipas një riti të përpunuar nga të gjithë, dhe që, sipas rastit, e kishin përdorur apo e përdornin shumë familje, kur kthenin mbrapsht kërkesën ose, siç i thoshin ndryshe, dorën, pra, duke mos e thënë drejt-përdrejt që nuk e jepnin vajzën të djali i huaj. Kjo mund të kuptohej tani dhe nga iritimi i hallës dhe nga fakti se me ç'pasion ajo shante jo vetëm vajzat e atyre familjeve, baballarët, pendët e qeve që kishin pasur dikur, dhe nënat, po edhe gjyshet e stërgjyshet. Atje pranë vatrës halla ime, me atë fytyrë të vogël, të errët dhe me vrimën e gojës si kamare, ishte e pamëshirshme kur shante, veçanërisht kur dera ishte e mbyllur dhe askush tjetër prej atyre që shaheshin, nuk dëgjonte.

Por pas tërë këtyre, pas bisedave të gjata dhe passionit me të cilin fliste halla, trungu në vatër digjej i heshtur përbrenda, ndoshta, ngaqë të gjithë ishin të lodhur e u vinte për gjumë. Dhe erën e marrë, që

vërtitej jashtë duke shtënë pullazet, e zinte gjumi mbi degën e ftoit. Në fshat qentë duhej të ndienin uljen e lukunisë së ujëve nga mali, se nishin të gaunisnin e të ulërinin edhe ata derisa zbardhte dita dhe pastaj shtinin turinj të leshtorë midis këmbëve të para të shtrira dhe flinin duke parë ëndrra atje poshtë stelës.

Halla dhe burri i hallës iknin përsëri pa vendosur asgjë, dhe ne e dëgjonim se si u gërmusheshin qentë e fshatit. Ata ecnin nëpër udhëzat me ujëra dhe, me siguri, ngaqë ishte natë dhe ata ishin të lodhur e të hutuar, futnin këmbët nëpër pellgore.

Të nesërmen, kur muzgu mbinte tej në skaj të fshatit, Vacoja çapitej e vinte edhe ai tek ne. Linte shkopin mënjanë, ulej të shkallët dhe hiqte shapkën e fshinte djersët nga qafa e nga koka gjysmë e rrjepur. Pastaj pinte duhan. Unë ulesha përballë tij. Ai më shikonte pakëz drejt në sy dhe buzëqeshte vetëm një çast, pastaj përsëri ulte kryet, sikur shikonte diçka atje midis gjunjëve dhe pinte duhan. Më vinte shumë keq, që ai kishte një fytyrë aq të vogël, që ishte i pakë, që kishte atë qafë të hollë dhe që vazhdimisht vinte i djersitur. Më vinte akoma më keq kur e shikoja ashtu me kokën e vogël të ulur poshtë, duke shikuar përherë diku midis gjunjëve. Ai shikonte në atë mënyrë shumë kohë, aq kohë, sa unë çuditesha se si një njeri mund të ulë ballin e të shikojë poshtë midis gjunjëve për një kohë aq të gjatë.

Tani vinte pothuaj çdo mbrëmje, ulej atje te shkallët, pinte duhan dhe mua më ngjante i mbushur me maraz e i pikëlluar.

— Erdhe? — i thoshte nëna ime.

Ai mërmëriste diçka që s'merrej vesh. Nëna, sikur të mos priste të dëgjonte se ç'do të thoshte ai, hynte në kasolle, nxirrte që andej sëpatën e madhe dhe niste të çante një trung. (Kurrë deri atëherë s'e kisha parë nënën të çante trungje). Vacoja shikonte nënën, thithte me nxitim cigaren e dredhur në letër

të trashë dhe, duke përpëlitur qerpikët e hollë e të pangjyrë, ngrihej e i merrte sëpatën.

Ai çante një tog të madh me shqisa gjer vonë, gjersa kthehej babai nga fusha.

— Vjen për nuse, — belbëzonte nëna nëpër buzë dhe tundte kryet.

Pastaj ai ndihte nënën për t'i futur shqisat e druve në kasolle dhe, kur nëna e ftonte për kafe, Vacoja largohej, sikur ta trembnin befasi.

Vinte pothuaj çdo mbrëmje në shtëpinë tonë dhe nuk hynte brenda, po linte shkopin mënjanë, hiqte shapkën, fshinte djersët dhe pinte duhan e shikonte midis gjunjëve. Kështu rrinte derisa vinte nëna. Ajo pastaj nxitonte në kasolle, nxirrte sëpatën e madhe dhe niste të çante trungje të mëdha, të forta. Vacoja flakte bishtin e cigares, merrte sëpatën dhe ngrinte një tog të madh me shqisa. Pastaj, bashkë me nënën dhe me mua, i futnim në kasolle.

— Një nuse të mirë do gjejmë për ty, — i thoshte nëna.

Ai e shikonte drejt në sy, po ajo i mënjanohej shikimit të tij të përunjur, të mirë, dhe Vacoja më kot priste t'i thoshin diçka tjetër për nusen, për ndonjë vajzë.

Mugej, dhe ai ikte.

Unë shikoja shpatullat e tij që vazhdimisht e më tepër zvogëloheshin dhe nëpër trup më shkonin drithma kur humbiste tej shtegut ajo silueta e tij e kërrusur. Më kujtoheshin atëherë kopeja e lopëve, ai fshati lart në rrëzë të malit, pllaja me çermëdelle, Qafa e Demit, guvat dhe qeniet e errëta, të frikshme. Nesër Vacoja do të ngrihej pa gdhirë dhe do të dredhonte midis kaçubeve dhe pastaj tërë ditën do të endej i ulur diku buzë honeve apo përballë guvave të errëta dhe në mbrëmje, para se të binte muzgu, do të vinte të ulej te shkallët e shtëpisë sonë të gurtë. Nëna do të nxirrte sëpatën e madhe, ai do të çante trungje dhe, kur t'i mbaronte ato së çari, do të shikonte nënën në sy, po nëna do t'i druhej atij shikimi, dhe ai pastaj do të

pikëlluhej, do të merrte shkopin, ashtu i përhumbur, i plogët e i pikëlluar, dhe do të humbiste tej shtegut.

Nëna ime ishte e pamëshirshme. Ai vinte që të pyeste për nuse, po as ajo dhe askush tjetër nuk i thoshte gjë për nuse. Dhe ai ikte përsëri i heshtur dhe i pikëlluar pa masë, duke tkurrur trekëndëshin e vogël të shpatullave të pakta... Nëna ime ishte e pamëshirshme. O, sa e pamëshirshme ishte ajo!

Unë tronditesha mjaft nga këto ngatërresa dhe dredhi të njerëzve të rritur dhe ikja nga oborri e fshihesha prapa kasolles së mbushur me bar. Atje çdo çast mendoja për Vacon dhe e ndieja se si më përshkonte dhembja për Vacon e mirë e të urtë, që ngrihej pa gdhirë, që kthehej në muzg dhe vinte e ulej te shkallët e shtëpisë sonë dhe pastaj niste të çante trungje. Ai kishte çarë shumë trungje. Ulesha atje prapa kasolles me bar dhe ndieja tek lëviznin bulkthet dhe, duke shikuar kopënë e përhapur të yjeve që kullotnin në livadhin e qiellit, mendoja për Vacon. Mendoja e dridhesha dhe më mblidhej diçka që më shtrëngonte në kafazin e vogël. Mendoja shumë për Vacon, mendoja me tërë pasionin dhe do të dëshiroja që të isha një vajzë e mirë dhe e bukur që të martohesha me të, dhe të dy së bashku të ngrinin një shtëpi më vete; të kishim një kasolle të mbushur me bar, të uleshim rrëzë saj e të shikonim kopënë e yjeve. Po (yjet sikur përpëliten qerpikët, sikur diç donin të thoshin) unë s'isha vajzë. Nesër do të gdhihej përsëri dhe në mbrëmje Vacoja do të vinte prapë, dhe nëna ime... o, sa e pamëshirshme ishte ajo!

Qaja me lot të nxehtë atje pranë kasolles, qaja për krijesën më të butë dhe më njerëzore në botë, për Vacon. Pastaj zëri i nënës thërriste disa herë dhe, kur ajo dilte tej shtegut për të më gjetur nëpër rrugët e fshatit, unë mundohesha të shterja dënesën dhe fshija lotët. Natën bëja gjumë të frikshëm e të shqetësuar.

Një ditë ai erdhi si zakonisht dhe m'u afrua pranë.

Ishim të dy vetëm në oborrin e ngushtë të shtëpisë. Vuri dorën në kryet e mi dhe më ngatërroi flokët.

— Pi, duhan? — tha.

— Jo, — i thashë.

— Unë e pija që i vogël, — tha.

— Unë nuk e pi, — i thashë.

Ai mëmëriti dhe u ul te shkallët. E shikoja drejt në sy që të fliste diçka tjetër, po ai nuk foli më.

II

Vacoja papritur ngeli në fshatin tonë dhe nuk shkonte më bari pas bagëtive të atij fshatit tjetër që ishte i vogël dhe kishte zënë shtroja thellë në rrëzë të malit, pranë pyllit të dendur. Ai punonte këtu përsëri si bari, po këtë herë me lopët e kooperativës sonë. Në mëngjes largohej herët dhe kthehej fare vonë pas muzgut. Një copë kohë ai nuk na erdhi në shtëpi. Unë u shqetësova dhe kujtova se mos ishte i zemëruar. Për këtë arsye dola jashtë nga fundi i fshatit disa herë rresht. Doja që t'i dilja përpara dhe t'i lëshoja pëllëmbët në mes e t'i thosha se e doja shumë.

Më në fund, një mbrëmje e takova. Ai ngjitej me nxitim nëpër udhën e ngushtë me gjemba, po, kur më pa, ndali. M'u qas pranë dhe u bë gati të fliste diçka, po iu drodh buza dhe nuk foli. Lëshoi si me druajtje pëllëmbën e tij të vogël mbi leshrat e ngatërruara të kokës sime, dhe të dy u shikuam sy më sy. Ai kishte sy të vegjël, të përhimtë, si të një zogu.

— Mos pi duhan, — tha.

— Nuk pi, — i thashë.

— Mirë bën që s'pi, — belbëzoi.

Kur arritëm pranë shtegut të shtëpisë sime, ai më ngatërroi përsëri flokët, dhe iku. Nuk erdhi në shtëpi

as atë mbrëmje. Kurse halla vinte. Ajo tani mblidhej veç me babanë, dhe të dy bisedonin fshehurazi nga nëna.

Një mbrëmje babanë e thirrën te halla në shtëpi. Unë doja të shkoja pas tij, po ai nuk më mori.

U kthye natën vonë. Atë mbrëmje kishin fejuar Vacon. Në mëngjes nëna mësoi shumë hollësi për fejesën. Burri i hallës kishte shkuar një javë rresht në krahinën prapa maleve, te ca miq, dhe më në fund kishte gjetur një vajzë. Një herë mori me vete edhe Vacon, dhe të dy u kthyen po atë ditë në mbrëmje.

Tani Vacon e fejuan. U gëzova shumë dhe mundohesha të përfytyroja se si mund të ishte nusja.

U vendos që dasma të bëhej po atë muaj.

Dasma nisi një të shtunë me mot pak të vrenjtur. Babai im ishte poshtë në qilar dhe ndante mishrat në copëra të vogla. Lermëni, tha ai, lermëni. Nuk dua ta shikoj. Më del përpara. Nuk dua. Unë e dëgjova kur i tha ashtu hallës, motrës së tij. Dhe i tha ashtu për burrin e saj. Përsëri ata ishin grindur, dhe tani babai i shmangej shumë. Ndaj kishte zbritur poshtë në qilar. Halla shikoi midis këmbëve të saj dhe nuk foli asnjë fjalë.

Kishin sjellë gazet, dhe njerëzit kërcenin sipër në dhomën e mirë. Vacoja sillej nëpër shtëpi, sikur nuk dinte ku të zinte vend. Ai kishte veshur një kostum blu nga ai stofi i shtrenjtë, të qepur dopjo. Kostumi kishte supe të gjera, dhe ato i vareshin përpara sikur ia shtynte njeri, ndaj nuk më pëlqente i veshur me atë kostum. Halla e gjente nëpër shkallë apo në korridor dhe e ndalonte, sikur do t'i hiqte ndonjë qime prej kostumit. Ajo kalonte pëllëmbën e vogël, të rreshkur nëpër stofin e butë blu dhe shikonte përçark.

— Mirë bëre që e bleve, — thoshte ajo me kënaqësi.

Vacoja e gjeti dy herë shapkën e tij të vjetër dhe e ngjeshi në kokë, po halla e hoqi veç dhe i foli me inat. Pastaj e mori shapkën dhe e fshehu.

Sazexhinjtë e kuptuan që Vacoja nuk dinte të vallëzonte. Kushërirat e merrnin një pas një dhe i hidh-

nin këmbët ngadalë që ta orientonin disi se si mund të kërcente. Shpesh ai ngrinte kryet lart dhe shikonte trarët, herë të tjera ulte kryet dhe harrohej, kurse kushërira e shtynte, sikur të trembej se mos e zinte gjumi.

Në mëngjes herët u nisën pesë vetë për të sjellë nusen. Katër burra dhe një grua. Nga dreka ata erdhën, dhe shumë vetë, edhe ne të vegjlit, dolëm tej dhe i pritëm.

Nusja ishte mbi kalë e mbuluar me vello të bardhë. Ne afroheshim pranë kalit dhe mundoheshim të dallonim fytyrën e saj. Po fytyra nuk i dukej. Vacoja qëndronte prapa gjithashtu mbi kalë. Ai shtrëngonte frerin dhe kafshonte buzën e poshtme. Shpeshherë bënte buzën në gaz po shikonte diku anash dhe përsëri merrte një pamje si tepër serioze.

Në oborr të shtëpisë nusja ndenji shumë mbi kalë, pa zbritur. Burrat diskutonin se kush do ta zbriste dhe në fund u vendos që ta zbriste Mihal Budi. Dikush hodhi oriz.

Kur e zbritën, nusja leu gishtin në mjaltë te dera e shtëpisë, pastaj atë e humbën diku në një dhomë tjetër. Atë e humbën andej shumë kohë, dhe unë më kot u vërtita për ta parë.

E nxorën kur kishte rënë mbrëmja. Do kërcëjë nusja, thanë gratë. Shumë fëmijë i nxorën jashtë, po mua nuk më ngacmuan. Unë ndenja me nënën te këndi i dhomës.

Shtëpia ishte mbushur më zhurmën e sazeve dhe të njerëzve. Veshët kishin kohë që më gjëmonin, po isha nemitur krejt duke shikuar nusen. Tani ajo e kishte ulur vellon, dhe nuse më të bukur në botë unë nuk kisha parë. Sikur të ishte gatuar me ujërat e burimeve, me ylbere dhe dritë. O zot! Buzët e saj ngjyrë trëndafili, gjysmë të hapura, dukeshin të gjalla e sikur diç thoshin. Sytë e kaltër e delikatë ishin të kthjellët si vesa dhe të qartë e të shkëlqyeshëm, sikur të qenë hapur për herë të parë. Ajo tani kërcente dhe më dukej sikur nëpër dhomë përhapej freskia e ngjyrave

të saj, hijeshia e trupit të derdhur, vijat e të cilit lëviznin ngadalë brenda veshjes së hollë, dhe e ndjeva se, ashtu papandehur e në mënyrë të çuditshme, isha magjepsur pas saj. Ngjyrat e ndezura e të buta njëkohësisht të fytyrës dhe të qafës së saj dukej sikur lëshonin refleksë, dhe në qenien time u drodh e u shemb diçka e njomë.

Të shikoje atë, ishte njëlloj si të soditje një lule a një bukuri tjetër të natyrës. Ajo... Tani më dukej sikur atje, në dhomën e mirë të hallës, pranë fshatarëve dhe sazexhinjve, ajo nuse do të shpaloste shushurimën e jetës së largët e të panjohur që dilte andej nga malet, dhe e shikoja i çelur, i tëri si lulja, duke u frikësuar se mos ndërpritnin atë shushurimë që po shpalosej. Ajo...

Të gjithë shikonin andej. Unë u afrova dhe më pranë nënës dhe i shtrëngova dorën fort. Nënës i dhembti gishti, se e shtrëngova në unazë dhe më pyeti se ç'kisha. Po unë nuk e shikova në sy dhe nuk i tregova. Kisha në vetvete një shqetësim, të bukur e tronditës njëkohësisht.

— Yll, — mërmëriti nëna, — yll!

Dhe shikonte nusen. Edhe unë vazhdoja ta shikoja dhe po deheshja prej bukurisë së saj, prej *yllit*.

Nusja, sikur ta kishte kuptuar ç'tha nëna për të dhe që unë mendoja vetëm për të, shikoi nga ne dhe qerpiku i saj i madh e i gjatë na mbuloi. U mundova të fshihesha prapa nënës, po ajo më gjuajti me atë shikim madhor dhe, kur u afrua, më shikoi drejt, buzëqeshi në mënyrë të veçantë dhe tundi shaminë. Ajo kishte në dorë një shami të vogël, të bardhë, të mëndafshtë. Atë shami e tundi aty para meje, siç tundin një degë kur duan të ndjellin një sheleg. Unë u drodha dhe duhet të jem skuqur pa masë. Po ajo ishte këmbëngulëse dhe vazhdonë akoma të ngulmonte, dhe gratë thërritnin ngadalë që unë të hyja në valle.

Vacoja kishte zënë për dore nusen e tij e edhe ai, shikonte nga unë. Shapken nuk e kishte, po çuditërisht

ato çaste më ngjau si një trastë e vjetër, e dalëboje dhe e lagur. Kur e shikoje përkrah saj, ai dukej i mjerë. Dukej i plogët dhe i palëvizshëm.

Nusja seç foli. Unë nuk e mora vesh ç'tha, po zëri i saj më erdhi i këndshëm, i brishtë dhe tingëlles dhe e mbuloi krejt figurën e Vacos, që ndodhej fare pranë saj.

— Jetime, — pëshpëriti tërë dhembje një nga gratë e fshatit. — Babai i është vrarë në hasmëri, dhe kjo...

Nëna më nxori përpara, dhe nusja më kapi nga dora.

Nuk mbaj mend si i hodha këmbët. Kur heshtën gazet, ajo më shikoi drejt në sy, më kaloi dorën e saj të butë në qafë dhe buzëqeshi ashtu siç mund të buzëqeshte vetëm ajo. Babai na kishte treguar për disa njerëz në Veri që ushqeheshin me borë dhe me qumësht dhe që këtij ushqimi i thoshin lasmas. Pikërisht kjo ishte ushqyer me borë dhe me qumësht. Jo. Kjo duhej të ishte rritur me vesë.

Unë tani isha atje pranë nuses, po nuk e shikoja. Mendoja vetëm për të. Gjithë trupi më regëtinte, dhe ajo kishte bujtur tek unë si një shqetësim i bardhë, i befasishtëm.

Nëna më ra në bërryl, dhe unë ngrita kokën.

— Babai, — tha ajo.

Babai kishte hyrë te dera dhe shikonte gratë që ishin zënë dora-dorës. Nusja menjëherë shikoi nga unë dhe lëvizi kryet, sikur të pyeste se ç'kërkoja. Unë s'dija ç't'i thosha dhe shikoja nga babai. Ai shikonte nusen dhe kafshoi me dhëmbë njëren anë të mustaqes.

Vonë pas mesnate, babai më mori dhe ne ikëm. Nëna nuk erdhi. Nuk binte shi dhe në qiell kishte yje. Nata ishte e ngrohtë si fryma e njeriut. Babai pinte duhan. Daulla ia bënte bum-bum, dhe mua më kujtohej nusja, më kujtohej fytyra e saj, vetullat, sytë, qafa e bardhë, supet e vogla, të rrumbullakta, dhe pranë saj...

Në shtëpi ramë të flinim. Nuk më zinte gjumi. Babai tha se do të shkonim përsëri atje. Po mua gjumi nuk më zinte dhe prisja gjersa të zgjohej babai, që të shkonim te nusja.

Dëgjohej ushtima e lumit dhe vërshëllima e zogut të natës që të kujton lotët. Shikoja lart nga trarët e zinj. Shtëpia ishte e mbuluar me plloça. Midis plloçave reflektonte drita e kaltër e yjeve. Mua më përfytyrohej vazhdimisht nusja. Fytyra e saj ishte e qeshur, dhe buzëqeshja e saj ishte tepër e ëmbël e mahnitëse. Ajo qeshte me tërë qenien, dhe të qeshurit e saj ishte i kthjellët e melodioz. Ajo...

Në gjoks m'u mblodh një lëmsh dhe pas ca nisa të qaja.

Nusja ishte tepër e bukur dhe atje në dhomë ajo shpërndante një dritë të butë, të kaltër. Pikërisht atë kohë nisën të më sulmonin imazhet, për bisedat në Qafën e Demit dhe për ato vrimat e thella andej nga brinjat e lumit: Nata tani u bë më e zezë dhe e turbullt, dhe dikush nisi të brente trarët e zinj të shtëpisë, dhe nga jashtë ngjiteshin në strehë fëmijë lakuriq, që ishin shndërruar në lugetër. Macet mjaullinin me zërat e tyre, dhe dikush sillej nëpër dhomë. Trajtat e asaj qenieje s'munda t'i dalloja. Papritur, midis tyre, hyri djali i hallës. Vacoja, pa dyshim, ishte ngritur nga shtrojat, e kishte lënë nusen e tij të re e të njomë dhe tani, së bashku me babanë e tij të lartë e të bëshëm që ecte duke anuar paksa nga e djathta, kishte ardhur aty e ishte përzier së bashku me ato qenie të natës.

Vacon e kishte ndihmuar babai i tij të vinte. Patjetër babai. Unë e dija këtë. Se dhe atëherë, në netët e gjata të dimrit, kur binte borë dhe gjerdhet uleshin nga pesha e saj dhe kur fshatarët e mi, pleq me kollë të thellë dhe burra me kapota ushtarake, mblidheshin në shkollë që të ngrinin kooperativën, babai i Vacos, pikërisht burri i ha... vinte rrotull, që të mos bëheshim kooperativë. Dhe më në fund tërhoqi për dore edhe Vacon dhe e shpuri me lopë atje tej, në një fshat tjetër

rrëzë pyllit, në një fshat që akoma s'ishte kooperativë. Ndërsa fshati im u bë kooperativë. Dhe më vonë këta njerëz as që e përfytyronin dot veten jashtë saj. Po Vacoja ishte tej, larg, atje në skaj të pyllit. Dhe përsëri ai, babai i tij, ashtu i përkulur e paksa i anuar, e kishte sjellë aty, dhe tani të gjithë bashkëfshatarët e mi flisnin për nusen që ishte si dritë. Vacoja e ndiente veten mirë midis atyre krijesave të zeza, kurse ata të gjithë bisedonin që të merrnin nusen. Unë u trondita e u tremba shumë dhe i thirra nuses, po ajo ishte larg dhe zëri im nuk arriti, ndaj ajo s'u përgjigj. I thirra përsëri, po përsëri ajo s'u përgjigj, dhe mua më preku heshtja si mur i ftohtë.

Tani mundohesha shumë atje te shtroja pranë babait, sepse doja të thërritja më fort, po nuk mundesha, se diçka më pengonte në fyt. U mbyta në djersë dhe me mundim u qasa më pranë babait dhe tërhoqa dorën e tij. Doja patjetër të ulërija, të ulërija me tërë fuqinë e zërit, për të shpëtuar nusen, sepse atë do ta rrëmbenin krijesat e zeza. Ato po turrehin dhe tani ishin mbledhur nëpër strehët e trarët e shtëpisë dhe diç kërkonin. Ndërsa nusja, e bukur, e njomë, e thjeshtë, e afërt dhe e pambrojtur, më siguri shikonte ëndrra dhe buzëqeshte me pafajësinë e saj të madhe.

Më mundonin pa masë vizionet si në ethe. Ajo vinte para syve të mi me ngjyra dhe tinguj. Babai lëvizi e u koll, dhe unë u zgjova me një përshtypje të frikshme, sikur shtrojat e mia të qëndronin përmbi humnerë.

Tani gjumi nuk më zinte dhe sytë nuk i mbyllja. Nga të çarat e çatisë hynte drita e yjeve. Unë mendoja vetëm për nusen. Një dhembje therëse dhe e padurueshme më përshkonte zemrën vazhdimisht.

Një çast m'u bë sikur nusja ishte ngritur dhe më foli që nga larg e më tundi shaminë e bardhë. Po unë

s'munda t'i flisja, dhe shamia e bardhë e saj më ngjau si vel i këputur në blerim.

U përmenda përsëri. Isha i pikëlluar që ajo do të bëhej nusja e Vacos. Njëpër faqet e njoma më rridhnin lot.

— Pse qan? — tha babai papritur.

Atë kohë ndjeva cicërimën e druajtur të zogjve të pazgjuar mirë, që nisën të prishnin qetësinë e natës.

DADEMADHJA

1

Plaka ndjeu përsëri t'i thërrisnin, po zëri shponte, sikur të ngjitej nga thellësitë e humnerave. Pse nuk leh qeni? mendoi ajo. Pikërisht atë kohë qeni lehu për herë të fundit. Mjekra e saj me majë dhe e thelluar, si një e çarë mali në mes, qëndronte akoma e ngritur. Pastaj uli mashën dhe trazoi prushin. Prushi kërciti dhe anës hekurit të perostisë parakaluan mornica të zjarrita. Te dera gërvishti dikush, dhe ajo e mori me mend se do të ishte qeni. Dera u hap dhe në suazën e saj u vizatua një vajzë e vogël. Plaka ngriti mashën përgjysmë dhe shikoi andej. Qeni hyri në kuzhinë, poshtë nën dhomën me dysheme, dhe erdhi rrotull, duke zgjatur turinj të nëpër raftet e dollapeve dhe në enët e palara.

— Dademadhe! — mermëriti vajza që rrinte te dera.

— Ç'je ti? — tha dademadhja.

Vajza u ul në gjunjë pranë plakës, dhe plaka ngriti

mjekrën e madhe me një tufë qime të gjata në anën e majtë.

— Kush të dërgoi? — tha dademadhja me zërin e saj që gjëmoi.

— Mamaja; Do vish?

— Dademadhja e shikoi drejt dhe nuk foli. Pastaj nderi dorën e gjatë e të rreshkur dhe e zuri te mënga e fustanit.

— Mëndafsh?

— Jo, — tha vajza. — Po edhe prej mëndafshi kam.

Plaka e shikoi te gjunjët e zbuluar dhe mërmëriti:

— Mishi përjashta!

Ajo uli buzë vatrës pëllëmbën me gishtat e shtrembër, si zgarbuj të nxirë, dhe u ngrit përgjysmë. U kthye prapa dhe diç zuri të kërkonte në një sënduk të vogël poshtë krevatit të hekurt.

— Merri, — tha.

— Nuk i dua, — belbëzoi vajza.

— Merri, — tha plaka dhe i lëshoi në prehër të vajzës.

Arrat krokëllitën, dhe vajza u skuq. Qeni u afrua midis tyre dhe uli putrën mbi prehrin e plakës.

— Jashtë! — thirri plaka.

Qeni hapi gojën fort, sikur të ishte pa gjumë, nuhati vajzën te supi dhe nxitoi përjashta.

— Ç'të tha mamaja? — foli plaka.

— Që të vish ti. Ka pjekur kafe.

— Unë s'pi kafe, — mërmëriti plaka dhe rufiti hundët. — Njëherë pinim kafe me elb të pjekur; — tha ajo.

Vajza nuk foli. Plaka u rufit përsëri dhe iu drodh kocka e hundës, si një kërcell i përtharë që e tund era.

— Kanë ardhur plot, — tha vajza dhe mblodhi kokrrat e arrave në shuplakat e vogla. — Do të vij në.

— Do dukem edhe unë, — tha plaka, sikur mërmëriti.

Vajza u ngrit.

— Ulu, — tha plaka.

Vajza u ul në gjunjë dhe plaka e puthi në të dyja faqet.

— Ik ti, — tha plaka. — Unë vij vetëm.

— Mamaja më tha të kthehem në shtëpi me ty.

— Vij vetëm, — tha plaka.

Plaka ngriti mashën dhe trazoi prushin. Vajza qëndronte para saj në këmbë.

— Po ti, dademadhe, nuk vjen dot vetëm, — tha ajo me një ton lutës, fëmijnor.

— Vij, — tha plaka dhe vazhdonte të trazonte hirin.

— Një njeri që s'vjen dot vetëm, nuk jeton, — belbëzoi ajo.

Vajza lëvizte e hutuar qerpikët. U bë heshtje. Te xhami i vogël i dritares u përplas diçka, si një shuk me bar të njomë. Vajza iu afrua plakës dhe e shikonte e shqetësuar. Plaka trazonte akoma me mashë dhe tha:

— Lakuriq i natës. Vijnë e përplasen në penxhere.

Pas kësaj nuk foli as plaka, as vajza. Në dhomë ishte heshtje. Vajzës iu duk dhoma e zezë, dhe rrobat e leshta, që ishin shtruar përçark plakës, i ngjanë si troje përrallash. Ajo ndjeu të dridhura në trup.

— Ik, vij vetëm, — tha plaka.

— Ku fle ti, dademadhe?

— Këtu, — tha ajo. — Nuk ngjitem lart.

Vajza ngacmoi diçka te vrima e hundës dhe tha:

— Sa vjeç je ti, dademadhe?

— Pas të nëntëdhjetave s'numëruam më.

Vajzës iu hapën sytë vetvetiu dhe doli. Plaka ndjeu derën që krisi dhe u mbyll.

2

Ata kishin katër dhoma. Poshtë dhomave të shtruara me dhogë pische kishin rregulluar dy dhoma të tjera. Njërën e përdornin si qilar, kurse në tjetrën rrinte plaka. Ajo kishte kërkuar oxhak, dhe ata i kishin bërë

oxhak. Aty kishin sjellë dy dollapë dhe një krevat hekuri. Në netët e dimrit të gjithë mblidheshin aty. Plaka rrinte në krye dhe shpeshherë heshte, sikur të mbante vesh erën që këndonte në oxhak.

Tani atje ishte qetësi, dhe plaka rrinte vetëm. Asaj i qëllonte shpesh të fliste me veten. Ishte mësuar me këtë zakon dhe ndiente kënaqësi të madhe kur niste të bisedonte. Jeta e saj kishte qenë e gjatë, dhe ajo mund të kujtonte shumë gjëra. Shpeshherë ajo kthehej në të njëjtat kujtime. Prapa saj, nën krevatin e rëndë prej hekuri, ajo mbante një shkop të gjatë, të lehtë. Kur kërkonte diçka, godiste me shkop sipër në tavan, dhe ata që ishin lart, zbritnin shkallët. Ajo ishte një plakë e lashtë, që kishte kaluar mbase një shekull dhe nuk ishte bërë grindavece e maniake. Ajo është flori, thoshin nuset e tjera të fshatit. Ato rrinin pranë plakës, dhe djali e nusja bënin muhabet me to, ndërsa ajo dëgjonte.

Kur ndiente sulmin e pranverës, ajo dilte në kopsht dhe niste të thërrmonte dheun nëpër rrënjët e pemëve e të perimeve, ndërsa dielli e lyente me ngjyrë të verdhë. Ditët e para rrinte një kohë të gjatë në kopsht, duke qëndruar kështu pranë asaj poezie krejt të gjallë, që dukej sikur avullohej nga toka. Ulej atje pranë dheut që thërrmonte, sikur diç i thoshte atij. Sythat sikur enjteshin e hapeshin që të shihnin miken e tyre të hershme, dhe drurët lëkundnin lehtë degët, dhe zogjtë cicërinin me nxitim e të gëzuar. Në atë stinë asaj ia kishte qejfi edhe të dilte natën përjashta në oborr. Ulej mbi plloçat që lëshonin nxehtësi dhe humbiste, e tërhequr nga magjepsja e ëmbël e natës dhe nga ai ndriçim i veçantë avullues i pemëve dhe i kodrave përçark. Ato orë të natës së kthjellët e të vakët e ngacmonin në kujtime, e turbullonin, e mallëngjenin dhe i zgjonin, tërë poezitë e fshehta të shpirtit. Kur barin e mbulonte vesa dhe në veshët e plakës trokitnin yjet që shëtitnin pullazeve të shtëpisë, atë e përshkonte një rrëqethje freskie dhe, ashtu e plakur, e madhe, e hershme, hynte brenda

dhe flinte deri vonë. Nÿsja e djalit thoshte se ajo zgjohej në atë krah që binte.

Ajo ishte e urtë si dele dhe s'grindej. Forca e saj e madhe dhe dobësia e saj e madhe ishin mirësia. Si plakë që ishte, ajo ndiqte shumë zakone dhe kujtohej për të gjithë nipërit e mbesat, për të gjithë kushërinjtë dhe fisin. Ajo pyeste për të largëtit, për martesat e reja që ishin bërë, për ata që kishin lindur dhe ata që kishin vdekur dhe, duke u munduar t'i sillte të gjithë në mend, plotësonte kështu pemën gjenealogjike që ruante me kujdes të madh në kujtesën e vet. Ajo i kujtonte të gjithë, dhe fshatarët e respektonin, dhe tani që kishte jetuar kaq shumë, askush s'mund të besonte se ndoshta vinte një ditë që ajo të mos ishte. Ajo s'ndryshonte. Dukej sikur tani s'vepronte asnjë ligj mbi të. Rrënimin e saj nuk e ndienin më. Nuk ankohej nga dhembja e kyçeve dhe bënte gjumë të paqhtë.

Plaka psherëtiu dhe mbuloi zjarrin me hi. Zbriti kandilin nga oxhaku dhe e ndezi. Macja u zgjua dhe iu shtriq te këmbët. Futi shkrepësen diku në një xhep në gjoks dhe arriti prapa derës. Mori një shkop të bardhë, të bërë me dru piks, dhe u kthye përsëri pranë vatrës. Mbuloi edhe një prush që skuqte mbi hi dhe uli çelësin e dritës. Në dhomë ishte përhapur erë vajguri. Në oborr iu gërmush qeni. Te gardhi këndonin bulkthet. Te shtegu i kopshtit ishte varur kopeja e Harushës së Vogël. Ylli i Mbrëmjes vazhdonte të qeshte si fëmijë. Përqark vezullonin yjet dhe hëna e re pranverore. Drurët, arat, kodrat, malet ishin të buta e të urta.

Asaj iu duk sikur shkrofëtiu mushka. Mbase erdhën, tha ajo. Përgjoi, po nuk ndjeu potkonj mushkash. Jo, mërmëriti, nuk erdhën. Qeni iu gërmush përsëri, sikur i lutej që ta merrte me vete. Nuk të marr, jo, tha ajo dhe kapërceu shtegun e oborrit.

Shtëpia e saj ishte në periferi të fshatit. Përballë, midis pemëve, ishin kredhur shtëpitë e tjera. Ajo çapitej nën hirin llamburitës që binte nga yjet. Qeni

e ndiqte pas, dhe ajo ndali. Kthehu në shtëpi, i tha. Qeni kishte ndalur dhe e shikonte në sy. Diku nga mesi i fshatit lehte një qen tjetër. Kthehu, tha përsëri ajo. Kafsha uli kokën dhe u kthye prapa.

Dhjetë metra më tej ai u ul në bisht dhe nisi ta ndiqte me sy plakën që po ikte. Ajo u kthye në të majtë, në rruginat si hendekë, midis kopshteve që ndodheshin për-bri fshatit. Anës gjerdheve të vjetra, të mbuluara nga barërat e egra, që dukeshin të heshtura e të shkreta, shurukonte gurgullima e ujërave që dredhonte e humbiste nëpër errësirë. Dritën e dobët të kandilit e sulmonin insekte, dhe ajo ecte duke u munduar që të mos njomej nëpër pellgoret e ujërave. Ecte dhe nisi të fliste me vete për fshatin, për shtëpinë e saj, për njerëzit, duke hyrë nëpër hollësi të vogla, që janë të shtrenjta për njerëzit e atyre viseve. Dhe të gjitha këto: njerëzit, fshati, drurët, rrugët, oborri i shtëpisë, pullazet, bagëtia, zakonet, e tërë lashtësia dhe ditët e saj ishin aq të afërta e të njohura për të, si t'i ishin gdhendur në sy e në shpirt.

Plaka arriti pranë oborrit, dhe qeni i tyre vazhdon-te të hungërronte e të lehte. Vijnë njerëz, mendoi ajo, vijnë njerëz, ndaj e mbajnë lidhur.

Përballë kërciti një derë, dhe përjashta te pragu doli një grua. Plaka, atje në kufi të dritës së verdhë që vinte nga hyrja, ngjante si një qenie e madhe që ishte shfaqur papritur në oborrin e asaj shtëpie. Gruaja zbriti shkallët, ndërsa te korniza me dritë e derës ndaloi një fëmijë me një copë bukë në dorë.

Përjashta qeni lehu akoma, edhe pasi e kishin mbyllur derën.

Plaka la shkopin në korridor dhe u çapit mengadalë, që të mos i ngatërroheshin këmbët te këpucët dhe opingat. Korridori ishte i lyer me gëlqere dhe anëve kishte vazo me lule të vogla, të bardha e të lehta si shtëllunga. Atje gjithçka dukej e pastër, dhe plaka ngjante e mugët, sikur tërë jetën të kishte ecur nëpër katonj. Ajo deshi të shikonte në dhomë, për-

qark, sikur të kërkonte me këmbëngulje një ambient të saj, me orendi të njohura e të dashura, që bënin pjesë në jetën e saj e të fshatit të saj.

Plaka u ndje e përhumbur dhe, duke u munduar të shkujdes, tha me mendje se kështu si po mblidhen sonte, mblidhen në muhabetet e mëdha, në prag dasme apo në netët pas vdekjeve. Dera e dhomës ishte e hapur, dhe të gjithë ata që ishin brenda shikonin atë. Ajo kishte ndalur te hyrja dhe akoma shikonte me vëmendje, pa folur. Vërtet, aty kishte sende që asaj s'i kujtonin asgjë të trashëguar nga gjyshërit. Aty...

— Eja, dademadhe, — tha njëri nga ata që ishte brenda.

Ajo nuk lëvizte. Kishte shtrënguar buzët e rru-dhura, të fishkura dhe tundte kryet e lidhur me shami të zezë të çngjyrosur. Qeni përjashta lehu përsëri.

— Nuk më njohu, — mërmëriti ajo.

— Se i harrove nipat, andaj, — tha ai që foli i pari.

Ai ishte i gjatë, me shpinë të kërrusur, me çehren e zymtë të një tuberkulozi dhe me ballin tullac, që i lëshohej vrullshëm mbi hundën e kthyer nga e djath-ta. Këmbët i kishte të gjata e të shtrembra. Bulçitë i kishte të mbushura dhe akoma përtypej.

— I harrove nipat, — belbëzoi përsëri dhe qeshi.

— S'e harron gjakun kjo, — tha e zonja e shtëpisë dhe bëri një gjest bujar, po fare të panatyrshëm, sikur të stërvitej që atë kohë të priste njerëz të tjerë, të rinj. Pas kësaj ajo rrahu shpatullat e mëdha të dademadhes dhe qeshte me pahir, me një të qeshur historik, sikur të hidhte ca thërrime. Deri në atë kohë dademadhja kishte qenë për të një nga ato krijesat e harruara, një krijesë që jeton diku, lëviz, po s'përbën asnjë qëllim.

— Hyr zotrote, dademadhe, — tha ajo.

Plaka nuk lëvizte. Kandilin e mbante akoma në dorë, dhe ai vazhdonte të digjej, duke shpërndarë një zhurmë të lehtë, sikur një mace që bënte gjumë pranë

vatrës. Ajo hodhi një çap dhe ndali përsëri. Shikonte në të majtë. Zonja e shtëpisë i tha:

— Frigorifer.

Plaka tundi kokën. Mbi frigorifer ishte një luan i bërë me allçi.

Luani ishte i madh, i verdhë dhe agresiv. Plaka e shikonte me vëmendje, dhe shprehja e fytyrës i ndërroi. Luani e shikonte drejt, sikur do t'i turrej.

— Aty brenda mban qumësht, kos, mish; aty bëhet akull, — tha burri i gjatë, me shpinë të kërrusur dhe këmbë të gjata e të shtrembra. Ai zgjati dorën dhe ngjeu gishtin në një pjatë me salcë kosi. Plaka e shikoi vetëm një çast. Pastaj shikoi përsëri luanin, dhe sytë e futur thellë në gropat me rrudha i lëvizën.

— Njohim një jevg, — tha gruaja e Buxhelit. — Do ta bëjë më të madh akoma. Do ta lyejmë me bojë dhe do ta vëmë në korridor mbi lavatriçe. Dhe sa të hapet dera, bup! luani...

Plakës iu drodh nyja e gushës dhe rrudhat. Zgjati buzët, i fryu kandilit dy herë, dhe ai u shua. Përqark ajri u përzie me erë vajguri.

— Na shpoi hundët era e vajgurit, — tha burri me shpinë të kërrusur. Ai ngriti dorën dhe qëlloi gjurin e Buxhel Zherdit. Buxhel Zherdi ishte ngritur në këmbë dhe rrinte sikur të ishte zgjuar nga një dremitje e thellë.

— Ti na prure dritat elektrike, — tha burri me shpinë të kërrusur dhe përsëri e qëlloi me pëllëmbë të këmba të zotin e shtëpisë.

— Alitrik ka, po unë e marr këtë, — tha plaku dhe tregoi kandilin.

— Mirë bën që e merr, — tha motra e madhe e Buxhel Zherdit.

Atë e quanin Vergullë, dhe përherë kishte një pamje të shqetësuar, sikur të dilte nga grindjet apo nga vendet ku grindeshin erërat. Plaka ktheu kryet dhe shikoi prapa. Një çast ajo shikoi sipër mbi platformën e frigoriferit, po befas e tërhoqi vështrimin me

nxitim. Pastaj hyri në dhomë. Ata lëvizën përsëri kolltukët, dhe motra e vogël e Buxhel Zherdit hoqi dy bishta cigaresh që kishin rënë mbi qilim. Plaka rrinte e përkulur. Në mes kishte ngjeshur një brez të bollshëm. Kishte fytyrë të madhe në ngjyrë të bukës së misrit, po të një buke të pjekur shumë, gati të djegur. Sytë i kishte të futur thellë, të mbuluar nga dy palë vetulla që dukeshin si pullaze të vjetra, të rrënuara e të shtrembëruara nga koha. Vetëm hunda e madhe si e shqiponjës kishte një gjallëri të veçantë dhe dukej si karakoll i tërë asaj krijese.

— Nuk i shoh të tërë këtu, — mermëriti zëri i saj, si një gjësim i përhumbur që ngjitet nga thellësia.

— Sonte nuk kanë ardhur të gjithë, — tha gruaja e Buxhelit. Gruaja e Buxhelit ishte e shëndetshme, me vithe të gjera dhe fytyrë të madhe, të kuqe. Ajo ishte 44 vjeç.

— Po dadja donte t'i shikonte të tërë këtu, — tha plaka.

Gruaja e Buxhelit psherëtiu si e harruar. Plaka hodhi dy çape e shikoi në të djathtë.

— Ti këtu je?

— Këtu, — tha ai.

Ky ishte nipi i Buxhelit dhe e quanin Çefo. Ishte djali i Vergullës dhe punonte zëtorist. Flokët i kishte të kuq, të shprishur, sikur të ishte bërë nervoz dhe të ishte ngritur për të ikur.

— Mirë, — tha plaka.

Buxheli vuri një cigare tjetër midis buzëve dhe e ndezi. Ai ishte 48 vjeç dhe, po të rrinte drejt, gjatësia i arrinte 1.82 m. Ishte i shëndetshëm, po atë ditë s'ishte rruar dhe fytyra i dukej më e vogël dhe e pushtuar e tëra nga një shprehje mërzie.

— Të ka pllakosur mërzia, — mermëriti plaka dhe ngriti kryet poshtë mjekrës së tij dhe e shikoi drejt me vëmendje.

— Ule kokën të të puth, — i tha ajo.

Pastaj i puthi të gjithë me radhë.

Ceremonia kishte mbaruar dhe ata po uleshin. Ngulën këmbë që dademadhja të ulej në një kolltuk pranë Buxhelit, po ajo u ul në shesh, mbi qilim.

— Po ai atje? — pyeti ajo.

— Televizori, — tha Luke Gjoshi. Luke Gjoshi ishte njeriu i gjatë, me shpinë të kërrusur, me çehre të zymtë të një tuberkulozi, me këmbë të larta e të shtrembra. Në fshat ai ishte me nam si njeri që hante shumë. Hante shumë sidomos kur gjente qyl. Megjithatë Luke Gjoshi ishte i thatë e s'shëndoshej kurrë. Një dreq e di ku i shkonte gjithë ai ushqim...

— Tilivizori, — mermëriti plaka.

Gruaja e Buxhel Zherdit afroi edhe më pranë tavolinën e vogël të rrumbullakët dhe solli dy pjata të tjera me meze. Pastaj solli tabakanë për të gostitur dademadhen. Dademadhja shikonte gotat me lëngje mbi tabaka dhe pjatën e vogël me llokume. Tabakaja, gotat dhe pjatat e vogla me llokume ishin të gjitha shumë të bukura.

— Po kjo? — tha dademadhja.

— Pije për gra, — tha gruaja dhe qeshi.

Njëra nga pijet kishte ngjyrë jeshile të thellë, si gjethja e kumbullës, ndërsa tjetra ngjyrë të kuqe të thellë. Plaka i shikoi me vëmendje dhe mori vetëm llokumen. Ata ngulën këmbë që ajo t'i provonte të gjitha, po plaka s'ndërroi.

— Të bëj kafen, — tha gruaja e Buxhelit dhe doli.

Dademadhja kishte ulur shuplakën e rreshkur te gjuri i Buxhel Zherdit dhe mundohej t'ia fërkonte. Ai kishte marrë një pamje mallëngjyese dhe, me tërë atë pamje, të ngjallte mëshirë. Ajo i pyeste mengadalë, dhe ata i shpjegoheshin me kujdes. Plaka lëvizti shpinën dhe Buxhel Zherdi tha:

— Mbylle dritaren.

Luke Gjoshi mënjanoi perden e rëndë dhe mbylli dritaren.

— Ke humbur, u bëre firar, — tha dademadhja dhe e shikoi në sy Buxhelin.

— Punëra, plakë, punëra shteti, — nxitoi e tha Luke Gjoshi në vend të Buxhel Zherdit. Plaka nuk foli. Djali i Vergullës shpuri buzën në gaz dhe thyente gishtat. Motra e vogël e Buxhel Zherdit afroi taketuken pranë Luke Gjoshit dhe tha:

— U branit poshtë e lart. I iku mendja për këtë fshat. Puno natë e puno ditë, dhe tani bëjnë këto!

Ajo fliste një lumë fjalësh, sikur t'i kishte mësuar përmendësh.

— Doni shtëpi të re? Na shtëpi. Doni shkollë? Na shkollë. Doni drita elektrike? Na... Na radio, na edhe televizor. Na, na, na...

— S'dinë ç'kërkojnë, — tha motra e madhe.

Buxhel Zherdi mbushi gotën me raki dhe e ktheu në gojë. Ai shikonte në tavolinë, te pjata e mezeve.

— Duan dru, dru, — tha Luke Gjoshi.

— U bë fshati ynë me traktorë e me makina. Tani hop! ngritën kokë. Ç'kërkojnë?! U ngrit ky Buxhel e bëri luftë, u lodh, e ngriti kooperativën dhe tani hop ca e ngatërrojnë. Popull është ky?!

— Ky s'është populli, — mermëriti Buxhel Zherdi.

— S'është popull, — tha motra e vogël.

— Janë ca njerëz, jo populli, — tha Buxhel Zherdi.

— Kjo mendje të ka marrë më qafë ty, — tha ajo. — Rri, o ditëzi në punën tënde! Rri e mos u llahtaris për këta! Prehu. S'u ngope një herë me gjumë. Mbe-te zyrave e makinave e prish gjumin për popull.

— E kemi detyrë, — tha Buxhel Zherdi. Ai pshe-rëtiu dhe qëlloi gjurin me pëllëmbë.

Dera u hap dhe brenda hyri gruaja e tij. Ajo uli në tavolinë tri kafe. Pas kësaj u ul pranë dademadhes dhe i afroi filxhanin. Dademadhja shikoi një kohë të gjatë pjatën e vogël me zbukurime. Ajo shikoi gjith-ashtu në faqet e murit sixhadetë orientale, të cilat e mbushnin dhomën me personazhe të çuditshme. Në shtëpi kishte orendi të ndryshme e të panjohura për të. Plaka vërente e topitur. Ajo u ndesh befaz me një elegancë që s'e njihte. Po ta pyeste dikush se ç'e kishte

Buxhel Zherdin, plaka do t'i thoshte se e kishte nip. Në të vërtetë ajo nuk e kishte djalë të vëllait apo djalë motre. Ai ishte djalë i një kushëriri të saj. Po ishte nga i njëjti fis dhe plaka e pranonte si nip. Është djalë në gjakun tim, thoshte. Ajo kishte shumë kohë pa hyrë në shtëpinë e tij.

— Shikon? — i tha gruaja e Buxhel Zherdit.

— Kjo të shikon në vrimë të gjilpërës, — tha Luke Gjoshi.

Plaka u koll, mbërtheu shikimin në një fotografi në mur dhe tha:

— Keni ngritur shtëpi në bina të agait.

Ajo lëvizte kokën, sikur donte të zgjonte dikë.

— Kemi qenë të varfër, po luftuam, — tha motra e vogël e Buxhel Zherdit.

Plaka nuk foli. Zonja e shtëpisë ngriti lart pjatancat e vogla të filxhanëve dhe tha:

— Të kujtohet, Buxhel? T'i solli ai shoku nga jashtë shtetit, — tha e shoqja dhe shikoi edhe vetë një pjatëz.

— Përsëri shkoi jashtë, — tha Buxheli.

— Kush? — tha motra e madhe.

— Ai shoku që ka sjellë këto.

Motra e madhe la filxhanin në dorën tjetër, pastaj e vuri në tavolinë. Kaloi pëllëmbën në ballin me rru-dha dhe u ngrit përgjysmë. Ajo lëshoi ca zëra, sikur të ankohej a të shahej me dikë dhe përqafoi Buxhel Zherdin. Ai vaisi kryet dhe vazhdonte të heshte. Ajo e puthi fort në të dyja faqet dhe qau. Lotët i rrodhën të bollshëm dhe një tufë flokësh të zinj i shkanë nga shamia. Kishte ngritur kryet dhe e shikonte drejt në fytyrë. Buxhel Zherdi vështronte midis gjunjëve, i merakosur e i dërrmuar.

— Vëlla? — klithi ajo dhe lëshoi përsëri duart në qafën e tij dhe e puthi disa herë rresht, Gruaja e Buxhel Zherdit shau dikë dhe fytyra iu skuq. Motra e vogël rrinte drejt, e nemitur, me dy pika lot në sy.

— Kokën e tyre do hanë, — tha gruaja e Buxhel Zherdit. — Zabërhanët!... Ty të ka në gjí Partia.

Buxhel Zherdit iu skuq veshi. Motra e madhe i hoqi një qime prapa shpinës. Motrës së vogël iu drodh nyja e grykës dhe dy pikat e lotit i rrodhën nëpër mollëza. Djali i motrës së madhe shfryu ajër nga buzët e trasha. Lake Gjoshi mërmëriti: «Ku ka si motra!» Ai afroi shishen dhe mbushi gotat me raki.

— Pi edhe ti, — i tha zetoristit.

— Nuk pi, — tha djali i motrës së madhe të Buxhel Zherdit.

— Pi, tani s'do ndezësh zetorin.

Po zetoristi e shtyu gotën më tej, dhe fytyra i mori një shprehje të pakënaqur. Ai kishte pamjen e një fëmije inatçi.

— Pi, — mërmëriti Buxhel Zherdi.

— Nuk pi, — mërmëriti Çefo zetoristi.

— Kur të thotë dajkua të pish, mos ia kthe, — i tha mamaja e tij dhe i afroi gotën.

Ai e zbrazi gotën dhe nuk shikoi në sy asnjë. Luke Gjoshi i mbushi përsëri gotat. Përrjashta lehu qeni.

— Vjen populli, — mërmëriti gruaja e Buxhel Zherdit.

Ajo u ngrit dhe doli. Dademadhja i fërkoj dorën Buxhel Zherdit. Dera krisi, dhe brenda hyri një burrë i shkurtër me kokë të vogël dhe shapkë blu. Ai kishte supe të pakta, të ngushta, dhe pullat përpara pantallonave i kishte të zberthyer. Sytë e vegjël të përhimtë i lëvizte pa pushim dhe vetullat e çngjyrosura dukeshin sikur t'i ishin spërkatur me miell. Shtrinte e përdridhte buzët e holla dhe fytyra i lëvizte sikur të vuante nga spazma. Buxhel Zherdi u ngrit dhe tha:

— Eja, Açi!

— Që-që-qënëri! — tha Açi dhe mjekra iu spërkat me pështymë.

Zetoristi qeshi. E ëma e shikoi me inat të birin, dhe ai heshti:

— Du-du-duan të pri-pri-prishin fsha-fshatin, — tha përsëri Açi.

— Ulu, ulu, — mërmëriti Buxhel Zherdi.

Açi u çapit pranë Buxhel Zherdit, iu hodh në qafë, e puthi fort dhe qau.

— Që-që-qënëri, zoti Bu-buxhel, që-që-qënëri! — shau përsëri duke u gëlltitur dhe fshiu sytë me rizën e dorës. Ai i takoi të gjithë me radhë dhe shikoi për-qark të gjente vend për t'u ulur.

— Këtu, — i tha gruaja e Buxhel Zherdit dhe i tregoi një kolltuk bosh. Açi u fundos në kolltuk dhe, si të ishte ulur mbi gjilpëra, kërceu i shqetësuar në këmbë.

— Të të takoj ty, zonjë — tha me një ndjenjë pendimi të thellë dhe përqafoi edhe një herë gruan e Buxhel Zherdit.

Zetoristi qeshi, po e ëma e shikoi përsëri me inat. Buxhel Zherdi dha të kuptohej se nuk e shikoi të nipin që qeshi dhe hodhi raki në gota. Açi ngriti gotën dhe, si e piu, tha:

— Ashtu të pa-paçim, li-lis! Le-le të lehin! Ne pa ty s'bë-s'bëjmë. Ti-ti je gj-gjenerali, ne-ne je-jemi o-oficerë, ushtarë.

Buxhel Zherdit iu skuq përsëri maja e veshit. Gruaja e tij u ul pranë dademadhes dhe pëshpëriti:

— Popull! Vijnë të qajnë hallet.

Dademadhja fërkonte dorën e Buxhel Zherdit dhe ndiente të dhembur në guvën e gjoksit.

— Kë-kështu të pa-paçim! — tha përsëri Açi dhe ngjeu një krodhë bukë në salcën e kosit.

—U ha-hazdisën fa-fare! — tha ai. — Jo, sho-shok, jo, mo-mos i lini kë-kështu! Për perëndi, vu-vuni dorë e rre-rregulloni gjë-gjëndjen. Mblidhuani rripat. U-unë di-dilja nga shtë-shtëpia dhe...

Kur erdhi në mbrëmje në fshat, Açi lidhi gomarin në katua dhe u ngjit sipër në dhomë. Kërkoj të hante darkë shpejt, po e shoqja deshi të dinte se po nxitonte. Ai foli me inat dhe tha se do të shkonte te Buxhel Zherdi. Ajo i tha të mos shkonte. Ai atëherë u inatos dhe nisi të kthente nga ana tjetër enët e kuzhinës. Bënte aq zhurmë, saqë pulat tej në kotec filluan të kakarisnin të trembura. Një çast ai farë burri e ndali vrullin, qëndroi në këmbë në mes të dhomës, shikoi i zverdhur lart në tavan, mërmëriti diçka që s'u mor vesh, shikoi nofullat dhe koka iu drodh si e një epileptiku, pastaj lëvizi me potere të madhe dhe ngriti në duar domixhanën me raki. Kur afroi grykën e gjerë të damixhanës te goja, iu drodh e bardha e syrit dhe shau fisin e gruas me fjalët më të ndyra. Pas kësaj pinte raki, dhe lëngu i bardhë i saj i derdhej nëpër qafën e hollë, të bërë me djersë. De-desha! tha ai. Damixhanin e uli përpara këmbëve dhe, si shtrembëroi dy herë rresht nofullat, i foli shtëpisë se ky vend ka parë vetëm një burrë dhe ky është Buxhel Zherdi. Buxhel Zherdi është kuadri më i mirë i kooperativës, më i miri i tërë kooperativave. Po ca zuzarë bënë letër dhe e krrien në gazetë. Komiteti atje në qytet e di se ata që shkruajnë e flasin për shokun Buxhel, e kanë inatçe. Dhe komiteti do ta mbrojë. Do ta mbrojë Buxhel Zherdin, që s'u tremb hiç, po emëroi vetë kooperativistin Aç në kotecin e pulave, poshtë në anë të lumit, dhe se po ai shok nuk e ndaloi të thurte një kopsht tjetër atje në anë të lumit. Ai është për po-pull, tha Açi. Po ti, moj kokoshë e vjetër, di-di ve-vetëm të ha-hash do-domate!

Ai piu përsëri. Pastaj mbushi një grusht dhe filloi të lahej e të njomte flokët me raki. Kur e tërë fytyra dhe flokët i kullonin raki, kooperativisti Aç zuri të mbushte grushtet me raki dhe t'i derdhte nëpër qoshet e dhomës. Gruaja u llahtaris, u mundua t'i rrëmbente damixhanën, po Açi derdhi përsëri raki dhe nxitoi përjashta. Në oborr këndoi dy herë si gjel. E shoqja u

151

$$\begin{array}{r} 51 \\ 51 \\ 51 \\ 51 \\ 51 \\ \hline 255 \end{array}$$

drodh, se priste që ai të ngjitej në çatinë e shtëpisë dhe të niste të hiqte mbulesën.

Po këtë radhë ai nuk u ngjit në çati. Ai humbi tej shtegut të oborrit, dhe gruaja doli që të kërkonte të kunatin.

Në rrugë, përpara dyqanit, Açi e pritën ca djem dhe e pyetën për shoqërinë e ngushtë me shokun Buxhel. Ata e pyesnin dhe qeshnin, kurse ai mundohej të ikte.

— Je kuadër i kohëve të fundit i Buxhel Zherdit dhe po i vini krahët njëri-tjetrit që të mos ju çajné, — i tha njëri.

Të tjerët qeshën dhe në rrugë u bë zhurmë.

— Ku do shkosh?

— Di-di unë ku shko-shkoj! — tha Açi.

— Po domatet akoma s'janë bërë. Ç'do t'i shpiesh?

Dikush i trazoi shapkën. Açi kërkoi gurë që t'i qëllonte. Ata ngritën duart lart, sikur u dorëzuan, dhe qeshën. Açi nuk i qëlloi me gur, po nxitoi.

— Kooperativist Açi, ruaju mos të të hajë luani.

Ai ndaloi një çast të vogël, sikur të kujtohej se mos ishte futur në ndonjë rrugë të verbër ku mund ta hanin luanët, pastaj nxitoi përsëri.

— Nxito, nxito, mos ki frikë! Luani është prej allçie, nuk të ha.

Diku tej, kur po humbiste te kthina e rrugës, kooperativisti Aç ktheu kokën dhe shau djemtë, duke u thënë çapaçulë, zabërhanë dhe fjalë të tjera.

Duke thënë kështu, ai kujtonte se do ta qëllonin, po nga prapa e ndiqte vetëm e qeshura e hokatarëve të rinj. Para se të hynte në oborrin e shokut Buxhel Zherdi, kooperativisti Aç zbërtheu pantallonat, po nuk arriti t'i mbërthente, se lehu qeni...

Açi ishte fundosur në kolltuk dhe shau nga nëna kopënë e djemve të hazdisur që e kishin ngacmuar në rrugë. Kur reshti së shari, ktheu kokën nga Buxhel Zherdi, e shikoi gjatë në fytyrë dhe tha:

— Ashtu të pa-paçim! Ne si-si po-popull të duam.

Buxhel Zherdi fërkoj shpatullat e dademadhes. Mostra e madhe e Buxhel Zherdit shau një vajzë që ishte anëtare e byrosë së kooperativës. Buxhel Zherdi shikoi të shoqen në sy. E shoqja diç i pëshpëriti dademadhes, dhe të dyja dolën nga dhoma.

— Mi-mirë, ashtu të pa-paça! — tha Açi.

Kur hynë në dhomën tjetër, në sobë kishte zjarr. Dademadhja shikoi përçark dhe belbëzoi:

— Plaçkë plot.

— Është robtuar. Ka rrjedhur trutë për këtë kooperativë, — tha gruaja e Buxhel Zherdit.

Dademadhja s'foli. Shikonte me vëmendje orenditë e dhomës. Orendi si ato s'kishte parë asgjëkundi në fshat.

— Plaçkë plot, — mërmëriti përsëri.

Ato pinë dhe një herë kafe. Dademadhja tha se kafen e pinte shumë rrallë. Përjashta lehu qeni. E shoqja e Buxhel Zherdit doli. Në oborr qëlluan hapa të rëndë. Ajo u drodh, kur njohu vëllanë e të arratisurit Linkë Brumi. Vëllai i të arratisur Linkë Brumi...

Gjashtë vjet më parë, në fshatin fqinj ishte bërë një dasmë. Kur ora i ishte afruar mesnatës dhe të gjithë pinin e këndonin, kur të gjithë kishin harruar mëritë e vogla dhe grindjet e mëdha, tej oborrit, prapa portës së madhe të hapur, në udhën me gurë e bajga kuajsh, qëndronin dy vetë. Njëri prej tyre ishte Buxhel Zherdi. Të urdhërojë e të vijë brenda, tha i zoti i shtëpisë, Të vijë, thanë ata që ishin rreth trapezës dhe pinin.

Pas ca një grua qëndroi përballë trapezës dhe shikonte e shqetësuar. Të vijë, thirrën përsëri burrat. Po gruaja u drodh dhe mishi poshtë mollëzave iu bë si baltë. Ajo nuk fliste. Atëherë një burrë u ngrit dhe ndaloi përjashta nën hijen e pjergullës. Pas tij zbritën edhe dy burra të tjerë. Ata u bënë të tre bashkë. Tej portës bënte hije silueta e Buxhel Zherdit dhe akoma më tej një siluete tjetër. Dy burra nga ata që ishin në dasmë shkuan e u kthyen disa herë te Buxhel Zherdi.

Më në fund, sipër në dhomë, njerëzit lëvizën, zunë të pëshpëritnin emrin e Buxhel Zherdit dhe zgjatën kokat nëpër dritaret e hapura dhe në ballkonin me parmakë. Tani nata e fshatit ishte bërë pothuaj e qetë; buçitja e daulles dhe e violinës kishte reshtur. Pak nga pak nëpër misterin e natës zgjateshin pëshpëritjet dhe nëpër rrugina njerëzit përhapnin një shqetësim të frikshëm. Buxhel Zherdi, veshur me peliçe dhe kokore, rrinte tej portës, pinte cigare me filtër dhe nuk pranonte të hynte në dasmë. Ai pinte duhan i merakosur dhe tha se do të rrinte atje, së bashku me atë shokun tjetër, derisa të përzinin nga dasma vëllanë e të arratisurit Linkë Brumi. Në fillim, përballë këtij fakti, njerëzit u hutuan dhe u deshën disa minuta derisa hutimi të shkrihej. Tani ata filluan të mendonin gjithsecili se ç'i lidhte me vëllanë e të arratisurit Linkë Brumi. U vinte inat e maraz që nuk e kishin gjykuar më parë këtë çështje dhe se pikërisht nga kjo tani ndodheshin në udhëkryq.

Vërtet vëllai i të arratisurit Linkë Brumi punonte për dasmën poshtë në qilar dhe s'ishte në trapezë, po sidoqoftë ai ishte në dasmë dhe kudo që të ishte brenda asaj shtëpie, brenda atyre mureve të avllisë, ai ishte i pranishëm në dasmë, dhe ky ishte vëllai i një të arratisuri.

Shumë vetë u zemëruan me të zotin e shtëpisë,

që s'i kishte lajmëruar për këtë, dhe tani i zoti i shtëpisë që bënte dasmën, u hutua, ndërsa Buxhel Zherdi, me jakën e peliçes të ngritur dhe me shkopin e vogël që qëllonte çizmet e bukura, pinte duhan turizmi dhe thoshte se do të rrinte akoma atje tej portës, do të vazhdonte të pinte duhan dhe do të hynte në dasmë vetëm si të largonin andej vëllanë e të arratisurit Linkë Brumi.

Në njerëzit e dasmës atë mesnatë ndodhi një pështjellim i madh dhe pështjellimi sa vente e rritej.

Më në fund, dikush nga gratë doli në oborr, u ngjiti në dhomat dhe tha se vëllai i të arratisurit Linkë Brumi kishte ikur. Atij i kishte rënë në erë ajo punë dhe kishte dalë. Kur njerëzit u siguruan se ai kishte ikur, Buxhel Zherdi kishte hyrë brenda dhe kishte zënë vend në trapezën kryesore. Para se të pinte gotën e parë, ai foli një copë herë të gjatë për luftën e klasave, tundi kokën dhe qeshi. Pastaj piu. Po në shumë zemra të atyre që ishin në dasmë atë natë, rëndonte një gur. Dy burra u ngritën njëri pas tjetrit dhe ikën. Ne s'duam të pimë në një trapezë me vëllanë e të arratisurit Linkë Brumi, thanë ata. Po jo kështu, jo. Mund të hyje ndryshe në dasmë, o Buxhel Zherdi. Neve na rëndon kjo, ne nuk ia falim vetes këtë, po ti sillu më ndryshe, se ne e duam Partinë, jo se na e kujton ti. Këtë mos e harro. Jo, thirri njëri prej tyre. Buxhel Zherdi diç pëshpëriti. Atyre u tingëlloi keq pëshpëritja e tij, ndofta u tingëlloi si përgojim. Njëri nga të dy burrat që po iknin, ndaloi në vend dhe dikush në trapezë ndjeu frikë se mos ai kthehej e qëllohej me Buxhel Zherdin. Po burri u skuq akoma dhe i tha Buxhel Zherdit se edhe me atë s'dëshironin të pinin. Buxhel Zherdi buzëqeshi me cepin e buzës, po burri hungërroi, dhe Buxhel Zherdit i ngriu fytyra. Pastaj burri tundi kokën, sikur të thoshte «hiqmu bela!» dhe ktheu krahët.

Ndaj të gdhirë, dikush tha se vëllai i të arrati-

surit Linkë Brumi ishte gremisur gjatë natës nga një shkëmb në anë të lumit. Midis dasmorëve u zgjua përsëri përshtjellimi.

Tani, gjashtë vjet më vonë, në një natë pranvere, nën morinë e yjeve që digjnin qiellin, vëllai i të arratisurit Linkë Brumi arriti në oborrin e shtëpisë së Buxhel Zherdit, dhe e shoqja e Buxhelit, si u drodh vetëm një çast, tha: le të vijë.

Dhe ai hyri në dhomën e pritjes.

— Kush ishte? — pyeti dademadhja.

— Njerëz plot, — tha e shoqja e Buxhel Zherdit dhe u shtëmëng që të mos zinte në gojë emrin e të vëllait të arratisurit Linkë Brumi.

Në dhomë hyri motra e vogël. Ajo ishte 52-vjeçe, po s'kishte asnjë thingjë dhe i thërrisnin Tikë. U ulën të trija pranë njëra-tjetrës dhe biseduan dy orë rresht.

— Ai e do shumë, — thoshte e shoqja e Buxhel Zherdit dhe vuri duart në mes e shfryu ajër.

— Kush është ai? — tha dademadhja.

— I madhi në rreth, — tha e shoqja e Buxhel Zherdit. — Sekretari.

— Unë do flas, — tha motra e vogël.

E shoqja e Buxhel Zherdit uli vetullat, sikur të mbulononte diçka.

— Të katërt që jemi në shtëpi do flasim, — tha ajo.

— Ç'do thoni? — tha dademadhja. Ajo ndihej e lodhur.

— Do mbrojmë vëllanë, — tha ajo. — Me vota është.

— Me gjisht?

— Me të numëruar gjishtat e ngritur.

Plaka shikoi shtrembër.

— Ia bëjnë me të pabesë, — tha e motra.

— Pa çkoqmani prapë. Flasin me pabesira në kartë?

Dademadhja lëvizi këmbën e djathtë dhe fërkoj gjurin.

— Nuk kam llafosur me djalin, — tha ajo.

Kështu tha plaka, po në të vërtetë e kishte pyetur të birin një mbrëmje. Ai kishte lëvizur dorën, sikur të trembte mizat, dhe s'i kishte thënë asgjë.

Motra e vogël mbylli derën, dhe ato filluan përsëri të flisnin me radhë, që të kuptonte plaka. Ato i thanë se në fshat ishin mbledhur ca njerëz që donin përgjegjësi dhe se ata kishin bërë një letër në gazetë. Gazeta, «një copë gazetë», botoi letrën dhe ata tani donin të hiqnin Buxhel Zherdin, Buxhelin që kishte tridhjetë vjet në përgjegjësi, që ulej në tavolinë me njerëz të komitetit, që ishte robtuar. Ai pruri traktorë në fshat, ngopi popullin me bukë dhe bleu makinë të madhe. Atë që... Dhe tani thoshin se ai pak nga pak... tërë njerëzit e fisit i kishte ngritur në përgjegjësi, se gruan e kishte siguruar në punë të mirë, se kishte marrë mjaltë, se në fshat çdo gjë e bënte ai, se... se ka vjedhur... Po ata cipëdalë kanë inat që fisi ynë është i mençur dhe ka punëra të mira. Kanë inat që fisi ynë krreu në krye Buxhelin dhe që jemi të mençur. Ne e bëmë Luftën tha më në fund e shoqja.

— Ata të qytetit e duan shumë, — tha motra e vogël.

— Kush? — pyeti dademadhja.

— Të komitetit.

— Ata e puthin kur e takojnë, — mërmëriti motra dhe qau. Qau dhe e shoqja.

— U bë ëndërr nga të pagjumët, — belbëzoi ajo.

— Mbeti luftërave, mbeti me përgjegjësi zyrave.

Dademadhja u përlot dhe sytë i dukeshin si të

zbrujtur, si të njomur me ujë. E shoqja e Buxhel Zherdit fshiu mollëzat me një shami të bardhë, dhe faqet e lagura iu skuqën.

— Për këta përpiqet. Që të rrojnë si njerëz. Kush e bëri fshatin kështu qytet?

— Ky, tha motra.

E shoqja e Buxhelit psherëtiu.

— Unë do flas, do ngop gojën, — tha e motra.

— Si t'uá heqë zemra, — tha e shoqja e Buxhel Zherdit dhe anoi mjekrën nga supi i majtë. Ajo dukej e mjerë, sikur lypte mëshirë.

— Si bushtër do hidhem e do flas, — tha motra.

— Edhe dademadhja do flasë; fjala e kësaj rëndon. Atë natë do jetë vetë sekretari. Ai çmendet, s'e zë gjumi për Buxhelin.

— Ai kish dërguar fjalë që të mos mërzhitet Buxheli.

— Kush?

— Sekretari vetë, moj dademadhe.

— E duan, — tha dademadhja me naivitet, e hultuar, si të mos ishte menduar shumë që tha ashtu.

— Bën punën, ndaj. Pa këtë fshati...

— Në fillim do t'i dëgjojë, do mësojë kush janë ata, pastaj di ai ç'u punon.

— Ai e vë në mend shumë fjalën e pleqve, — tha motra. — Pleqtë i ka në radhë të parë. Sa takohet me Buxhelin, për pleqtë e për plakat e pyet.

— Po pse të bëhet mbledhje? — tha dademadhja.

Ato të dyja shikuan njëra-tjetrën dhe u morën vesh që të duronin atë qetësi të dademadhes dhe pyetjet që bënte ajo. E shoqja e Buxhelit tha:

— Është zakon, është rregull.

— E në folçin keq? — pyeti përsëri dademadhja.

— Tamam këtu do duket kush e do Buxhelin, kujt i dhimbset fshati.

Gruaja e Buxhel Zherdit fërkoj kapakun e syrit. Dademadhja kafshoi buzën e poshtme të lëshuar. Di-

kush hapi derën në dhomën tjetër. E shoqja e Buxhel Zherdit doli.

— Ti fol, dade. Fjala tënde peshon aty; ti mos dëgjo, po fol. Ngrehu e fol, se do bësh përshtypje të madhe, dhe ai do çuditet.

— Po unë s'di, moj, si të flas, sikur...

Motra e vogël iu afrua më pranë dhe nisi t'i pëshpëriste akoma.

— Kur vjen ai? — tha dademadhja.

— Nesër në darkë. — Ajo psherëtiu me vërshtëllimë dhe u ngrit.

Nga dhoma tjetër doli Buxhel Zherdi. Qepallat e syve i kishte të njomura dhe fytyrën të zbehtë. Plakës iu dhimbs. E shikoi drejt dhe gërmadhat në gropën e syve iu lagën.

— Si është ai? — i tha plaka.

— Kush?

— Për sekretarin pyet, — foli e shoqja.

— Kullot larg kali im dhe i shokut Gani, — tha ai.

— Hi-hi, — qeshi motra e vogël e Buxhel Zherdit.

Zonja e shtëpisë lëvizi kryet me një domethënie të madhe nën kafkën e kokës. Buxhel Zherdi ngacmoi një kokërr te nyja e grykës. Ata të tre mendonin për sekretarin, sikur ai të ishte i tyre, dhe flisnin për ardhjen e tij, duke u pushtuar të tërë nga ndjenja e pritjes së paduruar të asaj ore serioze dhe vendimtare që do t'i vinte në vend njerëzit që ishin ngritur kundër Buxhel Zherdit. Thellë, diku në ndonjë skaj të ndërgjegjes, ndoshta frynin erëra dyshimi, po këtë Buxhel Zherdi nuk e tregonte. Mbase edhe gruaja e tij ndiente diçka, po... Vetëm motrat e Buxhel Zherdit s'kishin asnjë dyshim.

Dademadhja u mundua të lagte me pështymë buzët e rrudhura si një arë e çarë me plug që kërkon ujë. Buxhel Zherdi e përkëdheli në faqe. Ajo uli kokën dhe e puthi në të dyja duart. Ai gjithashtu e puthi në faqet e fishkura. Asaj i dhembti në gjoks, se kujtoi që ai s'e kishte puthur kurrë. Burrat s'puthin,

mendoj ajo, po tani ndodhet ligisht dhe s'di ç'bën. Ndo-
dhet ligisht.

Plaka ndjeu dhembje dhe turbullim. Me atë dhem-
bje e me atë turbullim u çapit osh-osh deri në shtëpi.

Në dhomë krevati i saj prej hekuri krisi deri vo-
në pas mesnate. Nuk e zinte gjumi. Shqetësimi i me-
ndjes i kishte pushtuar tërë trupin. Hapi sytë. Nga
dritarja përballë hynin rrezet e hënës dhe hidhnin
mbi dysheme një pellg drite. Plaka zbriti nga krevati,
shkeli mbi pellgun me dritë dhe çeli dritaren. Për-
jashta ishte kthjellët dhe shikoje si ditën. Ajo uli bë-
rrylat në parvazin e dritares dhe zuri të vështronte
me kujdes, duke dashur të çmallej me atë vend që e da-
shuronte aq shumë, me vendin e lindjes. Në ato orë na-
te befas asaj i ishte dukur sikur kishte qenë e mër-
guar dhe tani e përpinte vendin, e malluar nga një
lektisje e madhe.

Një kohë të gjatë qëndroi ashtu si e paralizuar, pas-
taj pështeti ballin e gjerë në duar dhe pas ca ndjeu
qerpikët që iu lagën. Qau me dhembje dhe ëndje një-
kohësisht. Në mushkëritë e etura vazhdonte t'i hynte
era e freskët dhe vërshëllyese e natës. Ndiente lo-
dhje, po gjumi nuk e zinte. Plaka tha me mend se
s'do të pinte më kafe. U shtri. Pas ca hapi sytë përsëri
dhe në errësirën e mbushur me këngën e bulktheve
shquajti disa njolla të bardha që lëviznin. U mundua
t'i dallonte mirë se cilët ishin ata që donin të shkall-
monin binatë e fshatit, po ata pëshpëritnin me njëri-
tjetrin, dhe plaka shikonte përhumbur vetëm shpinat
e tyre.

«Doni të prishni kooperativën. Jo, — tha me vete.
— Jo, jo.»

Aty afër iu përqaq fytyra e zbehtë e Buxhel Zherdit
dhe asaj iu dhimbs.

«Do të flas kur të vijë ai nga komiteti, doemos që do të flas...»

Ajo ndiente ndrydhje, shtrëngim në gjoks. Po i rëndonte diçka, diçka e turbullt, si parandjenja e mër-zitjeve të gjata, e një jete tjetër që po zbulohej.

Xhamin e dritares befas e sulmuan rrezet e diellit.

Plaka doli në hajat dhe mori frymë thellë. Lugina ishte e mbytur nga mjegulla e bardhë e pranverës. Majat e maleve ndiqnin njëra-tjetrën si një tufë e madhe bagëtish.

3

E shoqja e Buxhel Zherdit kapërceu shtegun e oborrit. Në kopsht, mbi një velenxë të leshtë, rrinte dademadhja. Ajo kalonte leshin midis gishtërinjve dhe nga buzët e shpërveshura, të përthara e të fishkura i dilte një zhurmë shumë e lehtë, që hera-herës du-kej si e gërhitur.

— Kam larë leshin, moj bijë, dhe tani e pastroj nga rrodhet, — tha dademadhja.

— Prapë ikën?

— Ikën që natën, — tha dademadhja. — Ditën i pre-sin dhe natën i sjellin.

Në një skaj të oborrit ishte një tog i madh me dru të hedhur pa kujdes.

— Pa qasu, — tha dademadhja.

Gruaja e Buxhel Zherdit u ul dhe nxori diçka që kishte poshtë përparëses.

— Të solla një çikë pastiço, — tha ajo dhe la në tokë një vazo të vogël. — Të solla edhe mjaltë.

— Pse e solle? — tha plaka.

E shoqja e Buxhel Zherdit e pyeti në kishin dër-guar letër nipat.

— Njëzet ditë sot që s'kemi marrë, — tha dade-madhja.

— Kanë mësimë, — tha ajo.

Dademadhja mënjanoi leshin dhe e shikoi në sy gruan e Buxhel Zherdit.

— Do vijë në mbrëmje — tha gruaja e Buxhel Zherdit.

— Kush?

— Ai, sekretari.

— Ashtu?

— Do vijë si të jenë kthyer lopët nga kullota. Atëherë do fillojë mbledhja.

Plaka nuk foli. Pastaj tha:

— Shpjegoma edhe një herë, moj bijë.

Ajo dukej e lodhur si asnjëherë tjetër në pleqërinë e saj.

— Si të flasësh në mbledhje?

Plaka e shikoi në sy, pa guxuar t'i thoshte «po».

— Ju, dade, ju dëgjojnë shumë ata. Ka respekt të madh ai për plakat. Ti hyr brenda dhe mos prit, po thuaj: «Me leje të flas unë?» Dhe ngrihu. Mos prit, po ngrihu. Fol dhe ik. Kaq kisha, thuaj.

Një copë herë u bë heshtje.

— Shikoja leshin dhe pashë ëndërr Buxhelin. Më gjëmoi koka, — tha dademadhja.

Gruas së Buxhel Zherdit iu mbushën sytë me lot.

— Shpjegoma edhe një herë, — tha plaka.

— Si të flasësh?

Plaka e shikoi në sy. Tjetra i afroi fytyrën te gjoksi dhe nisi të fliste mengadalë, me fjalë të zgjedhura që kuptoheshin, që bënin efekt dhe i shkonin moshës së vjetër. Pastaj gruaja e Buxhel Zherdit lëvizi dhe tha:

— Të ta shpjegoj edhe një herë?

Në fund plaka psherëtiu, sikur të ndodhej pranë një thesi të rëndë që duhej ta hidhte në shpinë e ta çonte larg. Gruaja e Buxhel Zherdit ia mori fytyrën e ftikur në pëllëmbët e saj të shëndosha dhe ia puthi. Pastaj u ngrit, dhe plaka dalloj një njollë të zezë sa një pëllëmbë fëmijë te fustani, nën sqetull. Ka dirsur, mendoi ajo. Ka shëndet.

Në barin e oborrit mbi të cilin shkelte gruaja e Buxhel Zherdit, mbetej vazhda e gjurmëve të saj. Ajo ecte dhe prapa, nën supe, i tundeshin shpatullat e mëdha si pllaka mishi, që lëviznin në një hapësirë me dhjamë të trashë poshtë lëkurës së dirsur. Dademadhja shquajti vijën e kurrizit që mbulohej e zbulohet nga mishi i shpatullave. «Dosë. Si dosë», i shkrep papritur në kokë ky krahasim.

Plaka pati turp që mendoi ashtu për një grua. Në të vërtetë, ashtu shante dikur Guva Dari. Leshlëni Guva Dar! Tani nuk ishte më. Ai nuk kishte qenë nga fshati i tyre, po tërë jetën kishte punuar si çoban në atë fshat. Në fund, kur u plak, u zbardh krejt dhe në mjekrën e parruar i përthaheshin jargë. Ai u verbua dhe nuk iku nga fshati.

Asaj iu përhi Guva Dari, mjekra e tij e parruar, e bardhë, shpeshherë me ballgamë të përtharë, dhe guna e tij. Pasditeve ai dilte në fund të fshatit dhe ulej në një pllajë të vogël sa një lëmë, buzë një shkëmbi, këmbët e të cilit humbisnin në humnerën e thellë. E frynin erërat e lumit, dhe ai rrinte me orë të tëra bashkë me qenin dhe pinte duhan. Shpeshherë e dremiste gjumi atje, dhe ai ulte kokën, mbi një gur, ndërsa era rrëshqiste mbi gunë lagështi të njelmët, dhe qeni flinte pranë tij.

Pastaj ai vdiq. Atë ditë që e varrosën, binte shi. Arkivoli ku shtinë trupin e tij, ishte arkivoli me dimensione më të mëdha që kishte varrosur ndonjëherë ai fshat. Njerëzit hodhën baltë mbi të. Në krye të varrit vunë një gur dhe ikën.

Kur ishin larguar, dikush ktheu kokën dhe dalloi nëpër perden e turbullt të shiut qenin. Ata kthyen kokën përsëri dhe përsëri shquajtën qenin, që lagej nën shiun e ftohtë pranë varrit të freskët. Ku do të shkojë ai qen tani? tha dikush nga fshatarët.

Natën vazhdoi të binte shi dhe thellë pas mesnate fshatarët dëgjuan një të lehur të kobshëm tej në

varreza. Pastaj nuk u dëgjua më. Ndofta se shiu binte më me furi.

Në mëngjes kafsha kishte ngrirë, dhe shiu vazhdonte ta lagte pa mëshirë. Ai kishte shtrirë këmbët e para, kishte kthyer nga e djathta turinjtë e enjtur me qime, dhe uji i rridhte, i rridhte... Në krye, pranë gurit të varrit, ishte lagur gjithashtu një qeskë me duhan, një uror dhe një strall (Guva Dari pinte shumë duhan).

«Nuk arriti në këto kohë, ditëziu», mërmëriti plaka. Mbase ajo nuk mërmëriti, po i tha ato fjalë me mend dhe iu duk sikur i shqiptoi. Asaj iu duk sikur lehu geni i Guva Darit. Mbi kokën e saj lëvizti dega e mollës dhe ajo ngriti kryet. Një zog me një fije bari në sqep ishte ulur atje dhe po bëhej gati të fluturonte. Plaka psherëtiu thellë nga gjoksi, dhe kubeja e gjoksit të saj u duk sikur shqiptoi emrin e Guva Darit.

Nga qielli zbriste një qetësi përvëluese dhe e palëvizshme. Ajo zbriste si një avull i verdhë, i shndritshëm, krejt pa u ndier. Dademadhja shikoi nën degët e mollës. Rrezet e diellit derdheshin si shi përmes gje-theve që ishin ende të paarritura plotësisht.

Geni i shtëpisë së tyre vazhdonte të gërmushej, megjithëse gruaja e Buxhel Zherdit kishte humbur tej lesës së oborrit, dhe bari që kishte shkelur me këmbë ishte ngritur mengadalë. Ajo s'kishte arritur akoma te çesma e kreut, kur u takua me nipin e burrit, zetoristin Çefo.

— Ku shkon? — i tha ajo dhe u mundua t'i buzëqeshte, duke e shikuar me intimitet.

— Të pres një dushk që e kemi hedhur në vjeshtë, — tha zetoristi Çefo. Pastaj heshti. Ajo shikonte këpuçët e tij.

— Në darkë bëhet mbledhja, — mërmëriti ajo.

— E di.

Ajo u skuq. Sytë iu vërtitën me rrëmbim. Ngriti gishtin tregues dhe e vuri në tëmth, sikur tregonte se ku duhej të shponte.

— Vur këtu, vur këtu, — tha.

Atë kohë një gomar që ishte më tej, nën hijen e një dardhe, palli me të madhe, shfryu flegrat mbi një tog me hira, u shtri dhe goditi kurrizin pas tokës.

— Ju s'jeni në vete! — tha zetoristi.

— Ne jemi në vete, po ti mendohu, se me zetor të bëri ai Buxhel, pa tani do hapje kanale, — tha ajo dhe iku.

Katër hapa më tej ajo u kthye përsëri, ndali dhe tha:

— Edhe në shkollën e mbrëmjes në qytet ai të rregulloi.

Ajo nxitoi duke shfryrë si një kafshë e plagosur. Ai u mendua një çast, pastaj lëvizi kokën, duke e ndjekur me sy me përbuzje të egër, të fshehur nën një buzëqeshje. Gruaja e Buxhel Zherdit u kthye në të djathtë dhe hyri poshtë një porte të mbuluar me llamarinë. «Shpërndan dhurata», tha me vete zetoristi Çefo dhe mishrat e fytyrës iu drodhën nga shqetësimi.

4

«Leh qeni i shtëpisë dhe mua më duket sikur leh qeni i Guva Darit», tha dademadhja. Ajo lëshoi shtëllungën e leshit dhe shtriu mirë një cep të velenxës së kuqe. Pastaj hoqi dy rrodhe. Mbi pemët dhe kopshtin me zarzavate rrëshqiti një hije e gjatë, sikur ta tërhiqte dikush me një pé të padukshëm. «Rosat», tha me vete. Ajo kishte dëgjuar për rezervuarin e madh që ishte ndërtuar poshtë në fushë, po s'kishte qenë asnjëherë. Kur ngjitej në ballkonin e shtëpisë, në të gjitha orët e ditës, e shikonte fare qartë liqenin e ri. Në fillim ajo ngjitej shpesh atje dhe shikonte tej në

liqen. Kur shkrinin ngricat, rosat vinin përsëri dhe ngri-
nin fole anës liqenit, midis kallamishteve .

Plaka kishte shkelur në një jetë të gjatë dhe kishte
parë shumë gjëra, po me këta tridhjetë vjet ajo habi-
tej kur mendonte se sa shumë kishte ndryshuar fshati
i saj, fusha e saj, vendi i saj. Nganjëherë qëllonte t'i
sillej në kokë një dëshirë e marrë: sikur... sikur të
ngjallehin tërë të vdekurit! Të mirët dhe të ligjtë. Qoftë
edhe për një ditë. Dhe të shihnin.

Po kjo ishte vetëm një ëndërr e marrë, ndaj të vde-
kurit s'ishin zgjuar. Plaka kujtoi këtë dhe diçka e gi-
ciloi përbrenda. Dielli vazhdonte të digjte dhe sipër-
faqja e tokës mugullonte. Kjo e gëzonte plakën. Shpesh-
herë ajo rrinte atje në hije, thërrmonte kokrrat e dheut
dhe ashtu, duke u marrë me dheun, ndiente atë shpër-
thim të njëhershëm e të fuqishëm të të gjithë filizave
njëkohësisht. Asaj i dukej sikur ai vërshim i furishëm
i limfës, sikur ai lëng që qarkullon brenda trupit të
bimëve, qarkullonte tani edhe në trupin e saj. Kështu,
ajo ndizej e tëra nga dëshira e zjarhtë e të rilindurit,
dhe kjo e shtynte të besonte në përtëritjen e fuqishme
të botës.

Plaka nisi të këndonte. Këndonte pa zë shumë kë-
ngë një pas një, dhe koka i gjëmonte e zemra i gëzohej.
E kishte zakon që këndonte me vete, po në kokë i gjë-
monte e tërë kënga, e kënduar nga tërë burrat dhe gratë,
me të cilët mund të këndohet një këngë. Burrat dhe
gratë, djemtë dhe vajzat që kishte njohur gjatë jetës
së saj dhe që kishin kënduar bukur, ajo i ndillte pranë,
dhe ata këndonin. Kështu që në ato çaste, në mendjen
e saj, duke u zbuluar nëpër mjegullën e harresës, lëviz-
nin fytyra dhe hije mendimesh të humbura. Ajo shi-
jonte pasqyrimin e lehtë e të turbullt të kujtimeve.
Lëvizte vetëm buzët dhe e tërë qenia e saj gjëmonte nga
këngë të bukura.

Mbi degën e mollës, në barërat e ledhit, dy çape më
tej, uleshin zogj dhe cicërinin. Plaka nuk i dallonte,
po e tëra jetonte nën pushtetin e fuqishëm të këngës.

— Korba! — thirri befas dademadhja.

Ajo e shikonte që poshtë njeriun që bënte hije në këmbë, dhe buzëqeshte, si e zënë në faj. Ai qeshte, sikur të gurgullonin ujëra në grykën e tij të madhe. Plaka uli shuplakën në velenxë dhe bëri të ngrihej. Ai nxitoi, theu gjunjët dhe u ul pranë saj. Dademadhja e shikoi drejt në fytyrë, pastaj i hodhi duart në qafë dhe e puthi me mall. Ai binte erë dele.

— Nuk ke vajtur në shtëpi? — pyeti ajo.

— Jo, tani vij nga mali. Shkova aty dhe të pashë nga gardhi.

Ajo i puthi duart dhe u ngazëllye e tëra. Vërshimi i gjakut e godiste në mollëza dhe gati sa s'i shponte. Plaka ia puthi përsëri duart. Djaloshi i vuri dorën në sup. Ai e pyeti për shëndetin, po ajo iu përgjigj shkurt dhe e pyeti për delet. Ai pastaj e pyeti për njerëzit e shtëpisë, dhe ajo i tha, se ata shkonin që herët për të prerë ca dru dhe ktheheshin vonë pas mbrëmjes.

— Ka qumësht sivjet?

— Vjet në këtë kohë milnim gjysmën e këtij qumështi, — tha ai.

— Kohë e mbarë, — mërmëriti plaka. E shikoi drejt në sy dhe i tha: — Biri im!

Këtë njeri ajo e kishte thjesht fshatar, po i thoshte: «biri im». Pa përjashtim, të gjithëve në fshat, ajo u thoshte: «biri im» ose «bija ime».

— U bërë burrë, — tha ajo.

Ai pastroi diçka në velenxë. Dielli ishte ngjitur edhe më lart, dhe ata u ngjitën më afër mollës. Ajo u ngrit në këmbë dhe arriti gjer te shtegu i kopshtit.

— Nuk ka njeri, — tha.

U ul përsëri dhe shikoi parcelat e vogla të kopshtit. Në një parcelë të blertë patatesh ishte një bimë luledielli që shikonte diellin në sy. Plaka ktheu kokën dhe shikoi në sy bariun. Ajo e shikoi gjatë, pastaj belbëzoi:

— Ç'thua ti?

Bariu bëri buzën në gaz dhe ngriti supet. Ai nuk kuptonte se ç'kërkonte plaka. Plaka nuk ishte shprehur dot dhe atij iu dhimbs, ndaj ngriti përsëri supet dhe e

tërë fytyra i qeshi. Po fytyra e dademadhes u merakos përnjëherësh dhe buzëqeshja e tij ngriu si gur.

— Ç'fole zotrote? — i tha ai plakës.

Ajo e shikoi përsëri gjatë në sy dhe i mori dorën e madhe, të fryrë nga shëndeti, dhe zuri t'ia lëmonte.

— Je i organizatës ti?

— Jo.

Bariu qeshi. Picërroi qerpikët dhe mollëza e djath-të i lëvizi me nxitim, sikur trembte miza. Plaka tundi kryet, sikur të thoshte: «Edhe unë nuk jam».

— Sonte vjen ai, — tha plaka.

Bariu mbuloi shuplakën e dademadhes me dorën e vet dhe e shikoi në sy, sikur t'i kërkonte diçka që akoma s'e kuptonte.

— Vjen vetë i madhi, sekretari, — tha plaka dhe lëvizi kokën me kuptim.

Djaloshi u lëshua krejt, shfryu ajër nga buzët e trasha dhe kërkoj diçka nëpër xhepa. Ai nxori një qeskë prej lëkure dhe mbushur me duhan dhe drodhi cigare. Përqark ishte qetësi dhe heshtje e thellë.

— Ti s'ke frikë hiç, — tha plaka.

— Përse?

— Këta janë bërë shumë.

— Kush? — Ai shikonte cigaren që dridhte.

— Këta që duan të hedhin kooperativën.

— Ç'blegërin! — tha djali, i inatosur.

Atij i erdhi keq që tha «Ç'blegërin!» dhe lëvizi gju-rin, sikur do të qasej më pranë.

— Buxheli jonë, ... ai... Këta e luftojnë, po ai...

Plaka lëvizte kryet, sikur thoshte një gjëmë të madhe që djali s'e dinte. Veshët e vegjël të djaloshtit u skuqën dhe, ngaqë ai lëvizte nofullat, ngriheshin e uleshin, ndërsa poshtë, nën lëkurën e faqeve të kuqe, disa xhunga i lëviznin në mënyrë ritmike.

— Më-më! — i thirri ai fare pranë fytyrës dhe kokën ia mbante midis shuplakave. — Të kam mëmë! Të kujtohen agallarët, të vjen në mend beu?

Ai thirri fort me fjalë të ndara dhe theksit logjik të

fjalisë i mëshoi te fjala e fundit. Ajo e shikonte e pataksur dhe i dridheshin zhubrat rreth syve.

— Në barkun e madh të Buxhel Zherdit blegërijnë delet tona, më-më.

Ai e shikonte drejt, i inatosur, i dridhur. Ajo ngriu dhe u bë e tëra vesh, hutim, çudi. Fytyra e saj i ngjante një sahati që kishte ngecur.

Dy orë më vonë, kur do të ndaheshin, bariu psherëtiu, qëlloi në velenxë me dorën e gjerë si putër ariu, u ngrit në këmbë dhe tha:

— Hidhi gunën atij muhabeti.

Ai kaptoi shtegun e oborrit dhe akoma, nga nofulla e poshtme gjer në mollëzat e faqeve, poshtë nën lëkurë, i lëviznin disa xhunga, ngaqë i kishte shtrënguar dhëmbët, sikur kishte kafshuar fort diçka që e ndiqte prej kohësh. Koka e tij e rrumbullakët me flokë të verdhë, të yndyrshëm, plakës i ngjau si bima e lulediellit që shikon diellin në sy. Plakën e kishte pushtuar të tërën një dëshpërim i zymtë, i thellë, i pafund. Ajo ndiente nevojë të mallkonte.

U kthye krejt e dërrmuar, nxori ca krodha buke që i kishte hedhur për t'i njomur në një misur druri dhe, ashtu, me një vetëdije të turbullt, ushqeui një kllockë me katërmbëdhjetë zogj. Pastaj hyri në kopsht dhe ra përmbys mbi velenxë. Nuk e zuri gjumi, po rrinte ashtu, pa lëvizur, dhe shpina e plakur i ngrihej e i ulej ngadalë. Dy zogj dekorativë ranë lehtë mbi një degë molle, dhe molla shkundi katër petale të bardha. Ata nisën të këndonin, po mbi qiellin e tyre u vërtit hija e një skifteri, dhe zogjtë dekorativë fluturuan. Dademadhja ngriti shpinën dhe rrinte kokëvarur, duke bërë në shtrojën e leshtë shenja me gishtin tregues. «Birbo!» tha ajo me mendje, dhe figura e Buxhel Zherdit iu përhi aty në periferi të velenxës që digjej nga ngjyra e kuqe. «Birbo!» Figura e Buxhel Zherdit iu fashit.

Përçark në hapësirë binte erë diell, dhe purtekat e thurura në gardhin e kopshtit e mbushnin ajrin me

erë cermëdelesh të djegura në vapë. Plakës i lëvizi e bardha e kaltëryer e syve, dhe mbuloi fytyrën me pëllëmbët e hapura. Pas pak midis gishtërinjve i shkau një lot. Një rreze dielli që hynte nëpër gjethet e mollës, ia ndriçoi atë pikë loti dhe ia përthau vazhdën e njomë në fytyrë. Ajo qëndronte e palëvizur, me fytyrën fshehur në duar, ndërsa rrezja e diellit e ngrohte. Nga larg era e lehtë, e ngarkuar me parfumin e trëndelinës, solli borinë e një makine, ndërsa prapa saj, mbi stivën e druve të prerë, një këndes ia buçiti këngës me zë basi të thellë dhe rrihte sakaq krahët.

Plaka ia plasi të qarit, sa i dridhej tërë trupi. Dhe, ashtu e mbytur në lot, atë e ngacmonte një gëzim i fshehtë që të qante akoma dhe të binte në alivani, që të mund të harronte të vërtetën e tmerrshme, që të mund të largonte nga vetja Buxhel Zherdin, i cili lëvrinte në shpirtin e saj si një kufomë e padukshme, që kundërmonte kalbësinë.

Dademadhja ishte e tronditur dhe tani e ndiente se kishte qenë në fundin e jetës, në një fund të kanosur nga turpi. Ajo akoma po torturohej nga një ndjenjë e mprehtë që ia shkallmonte gjoksin. Ndiante lodhje të rëndë. Një boshllëk i thellë ia murrëntonte fytyrën e mbytur në lot, që i dukej si një pará e vjetër, e nxjerrë nga gërmadhat dhe e lagur.

Asaj iu duk sikur ndjeu vërshëllimën e iriqëve. Plaka shikoi përqark dhe e kuptoi se që gabuar. Atë çast drita e fortë e diellit, që binte mbi pemë, shteri. Ajo shikoi lart dhe vuri re se në mes të qiellit kishte pllakosur një re dhe se nga kurrizi leshtor i saj binte hije mbi atë copë tokë. Pak nga pak sikur po qetësohej. Filloi t'i dukej sikur ngjitej nga një ëndërr dhe tani nisi përsëri të prekte realitetin. Ajo kujtonte djaloshin që kulloste delet dhe e ndiente në tërë qenien e saj, në mish dhe në kockë, se kishte diçka të pakundërshtueshme në fjalët e tij. Ai ishte i bukur si dielli.

Plaka ndjeu të dridhur. Ishte vetëm. Tani dëshironte të fliste. Ajo ishte krijesa e paqme, e revoltuar befas

në shpirtin dhe në mishin e saj. Ndiante neveri dhe fryerje. Pas kaq kohe ishte zgjuar dhe tani ndiante frikë nga përgjumja që kishte kaluar. «Mos u rrëgjova», tha me vete. E mblodhi leshin në një thes.

U ngrit në këmbë dhe vuri në ije shuplakat e mëdha si gjethe fiku. Shikoi përçark në ara, në kodra, në male dhe tej në horizont. «Do vishem dhe do të shkoj», tha. I shkrepri në mendje të dilte nëpër fshat dhe të fliste me një të organizatës. Para se të hynte në oborr, i shkoi pas kllçoça me të katërmbëdhjetë zogjtë. Të tërë grumbull, duke kllçoçitur e ciatur, ata i shkonin nga pas, përbri, përpara. «Do të shkoj», tha përsëri. Pastaj mendoi se duhej t'i ushqente përsëri zogjtë e kllçoçës. Zogjtë duhej t'i ushqenin shpesh. Nga përvoja e gjatë e jetës së saj ajo e dinte se ata rriteshin më shpejt, po t'i ushqeje me grurë. «Të rriten edhe një çikë, — tha plaka, — dhe do t'i ushqejmë me grurë». Ajo futi duart në misur dhe nxori copëra buke të njomura. Kllçoça dhe zogjtë nxitonin mbi krodhat e përsheshura dhe ngjanin si një re e vogël në oborrin me diell.

Dademadhja hodhi ujë në muslluk dhe nisi të lahej. Kur dilte tej shtegut, ajo lahej përsëri dhe një copë herë shikohej në pasqyrë, që të mos linte papastërtira në cepat e syve. Ajo është plakë e pastër.

«I organizatës do flasë të drejtën», mendoi plaka. Një copë herë u mendua poshtë në hajat se në cilën mëhallë të fshatit të shkonte dhe kë të kërkonte. «Kë të gjej përpara», tha me mend. «Edhe ai është i organizatës», tha ajo për Buxhel Zherdin dhe u drodh. Plaka nuk donte ta shqiptonte emrin e Buxhel Zherdit.

Qeni rrinte dy metra më tej, e shikonte në sy dhe kuissej. Ajo i tha qenit të rrinte në shtëpi, dhe ai hapi gojën fort te pragu i shtegut dhe u kthye në shtëpi.

Pasдите, kur ishte kthyer dhe i kishte besuar plotësisht ato që i thanë për Buxhel Zherdin, pak nga pak ajo nisi të ndiente se si po i përhapej një zbrazëtirë e madhe në tërë trupin e saj, një zbrazëtirë e tillë, si t'i qenë shkrirë nën lëkurë mishi, gjaku dhe eshtrat.

5

Në mbërmje dademadhja ndenji në hajat dhe një copë herë shikoi nusen e djalit tek milte lopën. Lopa përtypte bar të njomë dhe nga buzët e trasha i vareshin jargë jeshile. Plaka ndjeu erën e barit të njomë, përzier me brokër e tërfil, ndjeu parfumin e freskët të bimëve aromatike që mbulojnë kodrat dhe pllajat, dhe ajri iu duk më i rëndë pikërisht nga kjo. Iu kujtua fëmijëria e largët, kur dilnin me shoqet dhe mblidhnin moskollane. Ndjeu erë moskollani dhe erë qumështi. Pyeti përsëri nusen e djalit në i sollën tërë drutë dhe kërkoi të llafosej me të birin.

U fut në dhomën e vet dhe priti. Djali, i gjerë e i lartë, me flokë të ngatërruar e të zbardhur në tëmthat e bërë gropë, hyri brenda dhe u ul pranë mëmës. Ajo e shikoi në sy.

— Si je? — pyeti i biri dhe uli shuplakën në prehrin e saj. Ajo e shikoi drejt dhe i tha:

— Unë jam gjallë.

I biri iu afrua edhe më pranë.

— Jam gjallë, — thirri ajo dhe iu drodhën zhubrat e fytyrës.

Ai ndërroi papritur dhe kuptoi se diçka kishte ndodhur tek e ëma. I ngriu nofulla e ulur pakëz poshtë dhe vërente sikur të kishte një kohë të gjatë pa u parë me të.

— Ç'bëhet në fshat? — tha ajo.

I biri qëndronte para saj si i rrahur.

— Ti, bir, duhej të më kishe folur për atë qen Buxhel.

Të birit i lëvizën muskujt nga e djathta e fleg-rës së hundës dhe bëri buzën në gaz. Fytyra e tij mori një dritë të veçantë dhe ai mërmëriti: «Aga i ri!»

Brenda hyri e shoqja. Flokët e saj binin erë qumësht të porsamjelë. Ajo i pyeti se ku do të hanin bukë. Pas kësaj solli darkën dhe, kur po hanin, herë flisnin të tre, herë flisnin dy apo vetëm njëri dhe një copë herë bëhej heshtje, dhe atëherë në dhomë ndiheshin nofullat që uleshin e ngriheshin.

Plaka shikonte me vëmendje herë të birin, herë nusen.

— Unë do të flas, — tha i biri. Gruaja e tij s'u përgjigj. Dademadhja e shikoi në sy. Gruaja tha:

— Fol.

Një orë më vonë ata ikën njëri pas tjetrit.

Plaka rrinte e vetme brenda në dhomë dhe trazonte prushin e paktë. Le të ishte nxehtë. Ajo e donte pak zjarr, fare pak. Kështu e ndiente veten në shtëpi të vet dhe mund të mendonte më mirë. Ajo kujtoi të dy nipërit që ishin në shkollë në Tiranë dhe e theri malli për ta. «Mjaltë nga mjalti», mendoi për nipërit. Iu kujtua vazoja me mjaltë që i solli gruaja e Buxhel Zherdit: «Ndaj ngordhi ky qen», tha ajo. Në vesh i çëriti zëri i gruas së Buxhel Zherdit. Ajo i tha se Buxheli ia dërgoi të nipat në Tiranë dhe Buxheli do t'ia bënte njërin doktor, tjetrin inxhinier. «Dhe më thanë se këta duan të prishin kooperativën», mendoi plaka. Ajo ishte dredhur si nga një goditje e beftë, kur i thanë se fshatarët e sulmonin Buxhel Zherdin që të prishnin kooperativën, po Buxhel Zherdi...

Plakën e trembte e kaluara. Ajo ishte mësuar me kooperativën. Fjalët që kishte dëgjuar ato ditë, sikur e trullosën. Kishte shumë kohë që s'kishte hyrë në shumë shtëpi të fshatit. Ajo jetonte e veçuar, dhe njerëzit e veçuar e kanë të zhvilluar ndjenjën e dobësisë. I dukej një gjëmë e pashoqe ajo që kishte dëgjuar: «Si bëhet kjo punë! Si bëhet kjo punë! «mendonte ajo.

Gruaja e Buxhel Zherdit i tha se ato punë i bënin ata njerëz që donin të vidhnin.

Iu turbullua mendja dhe gjoksi iu rëndua, sikur të kishte provuar hidhërimin më të madh të jetës së vet. Pas asaj ore që dëgjoji ato, ajo nuk bëri gjumë të mirë; arsyetonte me mundim dhe kthehej e kërkonte mendime që i shpëtonin, si t'i qenë hapur vrima në kujtesë.

Përjashta lehu qeni, dhe dikush shtyu derën. Ishte vajza e vogël e Buxhel Zherdit. Ajo u ul pranë plakës.

— Më dërgoi mami të të marr, — tha.

Plaka ngriti lart nofullën, që ia ndriçoi drita e kuqe e prushit.

— Babi e pyeti mamin për ty, dhe ajo më dërgoi këtu, — belbëzoi vajza.

Dademadhja u kthye si një ujk plak dhe zgjati dorën prapa shpinës, poshtë shtratit të hekurt, dhe nxori një dorë arra.

— Nuk dua, — tha vajza e vogël dhe tundi supet. Plaka ia lëshoi në prehër, dhe vajza u ngrit.

— Eja, — tha.

Dademadhja nuk foli.

— Eja, — tha përsëri vajza.

— Vij vetë, — mërmëriti dademadhja dhe psherëtiu: «Është akoma e vogël», mendoi për vajzën.

— Po mami...

Dademadhja e pyeti për djalin dhe nusen e saj. Vajza i tha se ata ishin në sallën e mbledhjes.

— Vij vetë, — tha dademadhja përsëri.

Plaka nisi të trazonte prushin. Vajza priti një çast, pastaj doli. Ajo doli me një të ecur të përgjumur.

Plaka kishte ulur kokën përmbi prush dhe ndjeu t'i ngrohej balli. I ligu, thoshin për të kur ishte i vogël. I ligu, thoshte baba mavriu. Kështu thoshin për Buxhel Zherdin dikur, kur ishte i mitur. Ajo kthente e sillte në trurin e saj të lashtë gjithë ato mendime që e mundonin, gati-gati e martirizonin.

Në fshat u dëgjuan zëra që thërrisnin dhe plakës iu duk sikur thërrisnin diku nëpër grykat e lumit. Atë

e mundoi një dremetje e beftë dhe ngadalë ra në kra-
hën e djathtë.

Bëri gjumë të rëndë, sikur ta kishin mbuluar trashë,
dhe dy herë iu duk sikur u gremis në një hon.

Krisi dera dhe vajza e vogël e Buxhel Zherdit
hyri brenda.

— Ti nuk erdhe, — tha ajo.

Plaka nuk foli dhe nuk dinte si ta zbonte atë fëmijë.

— Ata më bëjnë shenjë: pse nuk erdhi! — tha
vajza.

— Filloi?

— Ka shumë që ka filluar. Ata më shikojnë në sy
dhe tundin kokën që të të thërres ty.

Vajza fliste sikur qante, sikur i lutej plakës që
të ngrihej e të vinte. Sytë e saj të mëdhenj, të thellë
e të pikëlluar ishin gjithashtu si të trembur.

— Ç'bëjnë? — tha plaka.

— Grinden me zëra të lartë.

— Grinden, — foli plaka me vete, dhe buzët e vysh-
kura i regëtinë. — Tani vij, ik.

— Unë do fle te dajkua, s'shkoj atje.

Vajza e tha këtë me ankim, sikur të kishte tmerr
nga salla e mbledhjes dhe nga shtëpia e saj. Ajo doli.

Plaka uli pëllëmbët në fytyrë dhe një çast dremiti
përsëri. Qeni lehu. Ajo u zgjua, po brenda nuk hyri
askush. Plaka nxori shkrepësen nga gjiri dhe ndezi kan-
dilin. Qëlloi në tavan me shkop, po lart s'u ndje askush.
Qeni i shkoi nga pas, duke e nuhatur në palat e fustan-
nit, sikur ta merrte me të mirë, po ajo ndaloi dhe i foli:

— Rri në shtëpi.

Ai e shikoi drejt.

— Rri në shtëpi.

Qeni uli bishtin dhe u kthye. Dhjetë metra më
tej ai ndaloi dhe ktheu kokën, po nuk lëvizi.

Plaka humbi në të majtë dhe ecte nëpër errësirën midis kopshteve që dukej sikur flinin nën yjet. Rrugina binte erë bajgë e kakërdhi. Dritat e shtëpive dhe të rrugëve ishin tej në të djathtë, po asaj i ishte bërë zakon të çapitej nëpër rruginën midis kopshteve, ku sundonte një qetësi e patrazuar dhe e shkretë. Ajo ecte dhe përbri saj, në një vijë, rrëshqitnin ujëra të përgjumura e të trullosura. Plaka kishte prishur regjimin e gjumit dhe tani ndihej e trullosur. Tërë jetën kishte bërë gjumë të qetë dhe kishte punuar shumë. Kur u ngrit kooperativa në fshat, ajo ishte e moshuar dhe atëherë s'e kishte të shoqin. Plaka ulej pranë vatrës e priste të birin që të kthehej nga mbledhjet. «Me fshatin, me fshatin bashkë edhe ne», kishte thënë ajo. I biri hyri në kooperativë, dhe asaj i kishin thënë të mos shkonte në punë.

Nuk njihet ndoshta njeri tjetër në atë fshat që të ketë qenë i lidhur aq ngushtë me punën, me tokën. Ajo punoi shumë vjet me radhë. Puna në kooperativë i pëlqente, e rinonte. Atje ngrinin shumë këngë e shumë valle. Asaj i thoshin se ishte plakë dhe kjo e trembte se mos të nesërmen nuk i flisnin më për punë. U shqetësua sidomos kur nuk i flisnin më në emër ose hallë ose dajkël. Nisën t'i flisnin dade dhe ca më vonë dademadhe. Pas muzgut skuadërkomandantet lajmëronin për punën me zë të lartë e të zgjatur nëpër mëhallat e fshatit. Ajo tundohej nga mendimi i lig se mos nuk e thërrisnin. Erdhi një kohë dhe ajo dilte vetë në mes të fshatit, në një lëmë të vogël, rrethuar me ca gurë të mëdhenj si sëndukë, dhe e tërhiqte skuadërkomandan-ten nga fanella e leshtë.

Plaka psherëtiu dhe u mundua të kapërcente një vijë uji. Befas, tej drurëve, prapa një bregu, doli hëna e kuqe, shumë e madhe dhe si e përgjumur. Plaka shikoi rruginën e shtrembër, të veshur me rrekat e dritës së hënës dhe ndjeu t'i pëshpëriste në vesh një zë që lloçoçiste midis barërave. «Të ulem një çikë», tha. U ul në anë të gardhit, poshtë drurëve me hijet e

tyre endacake, dhe ndjeu një erë të mirë e të dashur. «Dheu», mërmëriti ajo. Atë fjalë e mërmëriti në një mënyrë krejt të veçantë, sikur e rrëfeu tërë qenia e saj, dhe ajo fjalë sikur shëtiste tani nëpër tërë gjymtyrët e genes së saj.

Midis gjerdheve filloi të këndonte era e natës.

Atëherë kishte shumë kohë që më thërrisnin dademadhe. Vetëm djali më fliste mëmë. Kur më flisnin dademadhe, unë mërzitesha. Sikur më thoshin që të mos dilja në punë, sikur më thoshin që të rrija pranë vatrës e të piqja misra për nipçet. Unë vërtet që ecja përkulur, po e bëja punën dhe natën bëja gjumë të mirë.

Katër net një pas një nuk më lajmëruan për punë, dhe unë i thashë nuses se doja të shkoja në punë. Ajo më tha se tani duhej të çlodhesha në shtëpi, ndërsa djali foli prerë: «Jo, mëmë, rri në shtëpi!» Po unë dola mbrëmjen tjetër dhe prita derisa erdhi në mëhallë skuadërkomandantja. Atëherë ishte Andrua e Lenos skuadërkomandante. E tërhoqa nga fanella, dhe ajo qeshi dhe tha të veja të prashitja qepë. Në mëngjes zbri-ta në fushë.

Plaka u ngrit dhe, e prekur nga kujtimet, bëri të nxitonte, po u pengua në një gropë me bar të njomë. Diku lehu një qen. Pastaj e lehura u zbeh dhe s'u ndje më. Ajo nxori shkrepësen që të ndizte kandilin. Në mendtë e plakës ranë njëherësh, pranë e pranë, poçet e dritave elektrike dhe flaka e vogël e kandilit. Plaka u çapit dhe hovi përsëri vite më pas...

Pikërisht atë ditë që shkova për të prashitur qepë. Ajo ditë ka qenë. Ky fshat ka qenë i dëgjuar për qepë, dhe ballistët na shanin qepërëxhinj. Atje ishin tërë gratë. Unë isha dademadhja. Nën mua ishte Maleja. Ajo ishte njëzet vjet më e vogël, po ishte më e madhe nga të gjitha ato. (Asaj s'arritën t'i thoshin dademadhe). Punaam dhe në drekë pushuam sipër te Burimi i Kukos. Ai burim ka ujë të ftohtë. Vajzat dhe gratë këndonin. Lipla u ngrit dhe tha që të më bënin nuse. Ato të gjitha thanë që unë të bëhesha nuse. U drodha, po nuk i përballoja dot. Malen do ta bënin dhëndër. Mua më përqafonin e më puthnin me radhë. Duheshim shumë atëherë. . . . Lipla u ngjit në fshat dhe solli rrobat. O Shene-premte! Më veshën nuse me të gjitha rrobat që vishet një nuse. Dhe unë rrija. Veshën edhe Malen. Maleja rrinte. Në kokë më hodhën vello. Çikë e një çikë dhe u mësova. U bëra si e lënë dhe e ndjeva veten të gëzuar. Kur dielli ra prapa Lisit të Pagurit, më hipën në kalë të bardhë dhe «krushqit» e «dhëndri» vinin nga pas. Në fshat, te sheshi pranë çesmes, vrapuan njerëz. Ata u mblodhën pranë meje e Males dhe zunë të këndonin. Unë isha nuse. Ai shesh mbase s'kishte parë dasmë më të madhe dhe nuse më të çuditshme dhe një dhëndër si Maleja. U mblodh tërë fshati. Një tufë me burra kënduan:

Tatëpjetë bregut vije,
 Jelekverdha veshur-o,
 me mëngë përveshur-o. . .

Eeeh! Më çërit në zemër ajo ditë e humbur, kur isha e re dhe zbrisja tatëpjetë me bucelë. Mbushnim ujë në Burim të Kaliiqes, ujë të ftohtë, po. . .

Ti veje tek keshe punë,
 Ika zemëruar-o
 Djalë. . .

ishim të varfër, të këputur.

*Dhe që atëherë, kur isha e vogël dhe zbrisja tatë-
pjetë me bucelë ngarkuar, disa djem kënduan:*

*Moj e vogëla në lëmë,
moj e vogëla,
shumë e vogëla...*

*Atë këngë e kënduan edhe kur më veshën nuse,
po unë isha aq e moshuar, sa shpina më ishte thyer
dhe zbukurimet e nusërisë shikonin në truall. Ca ush-
tarë ngjiteshin për në kufi dhe ndaluan edhe ata. Pas-
taj më zbritën nga kali. Nisën vallen. Më krrien në
ballë. Këngën e zuri Lipla.*

*Hidhet, luan dhelpëra,
Në grurë e në elbëra,
Moj, kujt ia bën ké...*

*Kënduan plot këngë dhe tërë burrat kërcyen valle.
Ishim bërë si të dehura. Unë s'ndihesha. Isha nuse.
Ishte bërë nuse dademadhja! Theu nata, kur lamë
këngën. Skuadërkomandantja më pëshpëriti në vesh që
nesër të dilja në punë. Pastaj u shpërndanë.*

*Njerëzit u bënë fizar nëpër shtëpitë e tyre, po mua
më pllakosi turpi. U ula te guri i madh si sënduk në
portën e Kërros. Natën ndjeva këmbë. M'u qas Lipla
me Janullën. Ato u habitën që isha atje përjashta, dhe
unë qava dhe u thashë se më vinte turp të hyja në
shtëpi.*

*Kur arrita në shtëpi, djali qeshi me të madhe. Më
kish kërkuar nëpër mëhallë...*

*Dademadhja u kujtua se duhej të nxitonte. Ajo
ndjeu jehonën e lehtë të hapave të saj që i shkrinte
heshtja e barërave, e mbushur me fëshfërima. Iu duk
sikur dalloj përhumbur se si shkitnin nga shtigjet nje-*

rëz të tjerë që nguteshin për në mbledhje. Po shtigjet ishin të heshtura e të zymta, dhe aty pranë ajo dalloi një shelg që vizatohej pranë vijës së ujit, me degët e varura si krahë kufomash. Plakës iu kujtua Buxhel Zherdi. Të djeshmen në darkë, kur kishte vajtur në shtëpinë e tij, ai rrinte i heshtur si një gropë varri, dhe ajo ishte turbulluar. Po tani ndiente inat dhe të dridhura.

...Përse punon ai? ... Për komunizëm! — «Ne punojmë vetëm për komunizëm», tha ai. Unë e shikova në sy dhe, kur ai mbaroi, e pyeta nëse komunizmi vjen me kooperativë. Ai tha se komunizmi vjen me kooperativë. Më mirë do të jetë, thashë me vete. Domosdo, gjersa vjen me kooperativë, më mirë do të jetë.

Asaj iu kujtua se njëherë kishte ardhur nga komiteti sekretari dhe ishte ulur këmbëkryq mbi një copë rrobë në anë të ugarit. Mori pranë vetes dademadhen dhe bëri shaka me të. Ai kishte pallto ushtarake dhe asaj iu duk njeri i mirë e i pëlqeu edhe era e djersës që lëshonin rrobat e tij.

Patjetër që është i mirë. Se është i mirë, ndaj është në krye të punëve. Atëherë në verë vinin nga qyteti të na ndihmonin për të korrur. Një behar erdhi edhe gruaja e tij. Këta të kryesisë e vunë në kuzhinë që të gatunte, po ajo erdhi në brigadë me ne. Edhe ajo më donte shumë dhe qeshte me mua dhe për Vit të Ri më dërguan kartë me falenderje. Ai do të mërzhitet shumë sonte kur të mësojë për Buxhel Zherdin. («Ç'pate, o ditëzi, pse e mërzhitë djalin!»)

Plaka ktheu në fillin e hollë e të shtrembër të rrujinës dhe ndjeu filladin e freskët e të ëmbël që fryu si një psherëtimë e gëzuar e tokës. Përçark tani kuaknin bretkosat. Bretkosat vazhdonin kuakjen e tyre me zell të madh, sikur të përsëritnin mësimet.

Asaj iu kujtua përsëri mbledhja. Ashtu është, tha plaka. Unë i kam ndihur partizanët, u kam dhënë bukë dhe atë partizanen e plagosur e mbajta dy muaj në shtëpi. Ajo... Edhe djali, edhe njerëzit e tjerë të fisit

luftuan. Po pse t'ia them sekretarit këtë?... Buxhel Zherdi më shtyu që t'ia them. Ai tha se Partia i dëshiron këto. Unë nuk i them.

Plaka u mundua të kujtonte të gjitha porosinë që i kishin bërë. Nuk kam harruar, tha me vete, dhe u drodh. Nëpër errësirë, midis gardheve, i shfaqej vegimi i Buxhel Zherdit.

Kur do të dilte në çairin përpara shkollës, ktheu kokën prapa. Drita e kandilit u luhet. Mizat e sulmonin pareshtur. Prapa, në rruginën me kopshte, terri iu duk gëlltitës. Hyri në oborr. Oborri kishte drita. Drita e kandilit u luhet përsëri, po nuk u fik. Plakën e sulmoi në sy imazhi i Buxhel Zherdit. Hunda e tij iu përças si kërrabë. Është ligur, tha ajo dhe ndjeu të pështirë. Ajo gjithmonë kishte ndër dridhje për të pafajshmit dhe i kishte mbrojtur. Po tani që kujtonte Buxhel Zherdin dhe pasionin me të cilin e kishin shtyrë që të fliste, i ngrihej inati dhe i ngjallej krupë. Tërë ato ditë Buxhel Zherdi dhe e shoqja kishin vrojtuar plakën, sikur të shikonin tek ajo fatin e tyre. Se plaka u ishte dukur si një llogore shumë e nevojshme, e harruar, të cilën nxituan ta pushtonin. Fshati dhe plaka e kishin harruar njëri-tjetrin, dhe Buxhel Zherdi kishte hyrë me nxitim midis tyre. Kështu, dademadhja kishte nisur të merrte anën e tij, se...

Përballë shtriheshin hijet e ftohta të kolonave të platformës së shkollës, dhe ajo shkeli mbi hije, sikur të kishte kaluar poshtë portikut të kishës. Më tej, nën dritare, herë-herë shkroftënte një kalë i ngarkuar me dy bidona bosh dhe me një gjysmë thesi me miell për qentë e stanit.

Plaka ngjiti të katër shkallët. Dera ishte në të majtë dhe asaj iu përplas zhurma në fytyrë. Befas ndjeu të ftohtë në trup. «Plakë», tha me vete. Kroi zërin e ngjirur dhe kaloi pragun e derës. Salla ishte plot me njerëz dhe era e fortë e djersës të shponte hundët. Një çast ndaloi ashtu e përkulur dhe hodhi rreth e rrotull një vështrim të ngadalshëm, gjurmues. Njerëzit kthyen ko-

kën dhe ajo plakë iu duk si një kënd i shurdhët, mbi të cilin kishte kohë që s'bridhte blerimi, sikur ajo, pas një rropatjeje të gjatë, të kishte dalë nga shekujt e harrësës.

Dikush pëshpëriti. Pastaj pëshpëritjet u shtuan si një zukatje bletësh. Sekretari i partisë atje në kreun e tavolinës ishte në këmbë. Ai shikoi nga hyrja vetëm një çast, po plakën nuk e vuri re. Fshiu ballin me shami dhe vazhdoi të fliste.

— Ulu këtu, — i pëshpëriti dikush dademadhes dhe i hodhi dorën në bërryl.

Ajo akoma s'po e shuante kandilin, dhe drita e tij e harruar, e lodhur, regëtinte e topitej, si shikimi i një miopi. Dikush i fryu kandilit dhe plakën e ulën në një stol në rreshtin e parë. Ajo mori frymë thellë dhe ndjeu lodhje. Prapa saj, diku në mesin e sallës, po fliste ai djaloshi me flokë të verdhë, që në mesditë kishte zbritur nga delet dhe një copë herë kishte ndjenjur me dademadhen në kopsht. Plaka ktheu kryet prapa. Dora e tij e gjerë dhe e gjatë lëvizte ngadalë.

— ... Ka ndodhur, posi, ka ndodhur. Këto ndodhnin pak nga pak. Të gjitha të metat e tij zvogëloheshin, të gjitha prapësitë e tij zbeheshin dhe pabesitë zhdukeshin. Përgjegjësia...

Plaka kishte ngritur mjekrën e madhe me majë e me një tufë qime në anën e majtë dhe vështronte sikur të kishte dalluar ndonjë send të çmuar.

Bariu u ul. Plaka donte të komunikonte me të duke u shikuar në sy, po ai vaisi kokën, sikur të shikonte diçka poshtë sqetullës së djathtë. Pastaj plaka shikoi në të djathtë e në të majtë për të fituar edhe më mirë ndjenjën e realitetit. Tej, pranë murit, në rreshtin e dytë, ishte Buxhel Zherdi. Fytyra e tij kishte ngjyrën e kufomës. Ai shikonte me një shprehje të zbrazur e të pikëlluar. Ngjitur me të ishte e shoqja. Ajo vërente e lodhur, me një mërzi të madhe në fytyrë, dhe disa herë rresht bëri përpjekje që t'i buzëqeshte dademadhes.

Tundi supin e djathtë dhe kodrat e gjinjve iu ngritën lart.

— Buxhel Zherdi, shoku Gani, është inkuizitor, — shpërtheu një zë nga fundi i sallës.

Njëra nga motrat e Buxhel Zherdit u ngrit dhe u kthye prapa, duke shtrembëruar trupin për të parë se kush foli. Në të vërtetë ajo i njihte nga zëri njerëzit që flisnin, po ajo apo e shoqja e Buxhel Zherdit apo motra tjetër i shikonin drejt në sy ata që flisnin sikur t'u thoshin: «Mirë, fole edhe ti!... Të mbajmë mend, të mbajmë».

Dademadhja vërejti me egërsi. Gruaja e Buxhel Zherdit nuk kuptoi se ç'ndodhi në fytyrën e plakës. Ajo u hutua dhe ca nga ca fytyra e saj u lëshua krejt, duke u mbajtur butë-butë nga palët e ardhura të qafës. Palët e fundit u ulën akoma dhe humbën poshtë kë-mishës, në detin e madh të gjoksit.

Prapa Buxhel Zherdit rrinte Luke Gjoshi, i gjatë, me shpinë të kërrusur, me çehre të zyrtë të një tuberkulozi dhe me këmbë të shtrembra. Faqet i kishte të bymyera dhe mustaqet — të mëdha e të qullëta, si qurra. Pranë tij ishte Açi dhe vëllai i të arratisurit Linkë Brumi. Açi vërtiste shapkën nëpër duar, dhe dademadhja e shikoi në sy dy herë rresht. Të dyja herët ai rrufiti fort hundën, dhe sytë e vegjël të murmë i kërcenin sikur t'i dridheshin. Motra e madhe hante me dhëmbët e vënë cepin e murmë të shamisë. Të gjithë ata së toku, atje pranë murit, në rreshtin e dytë, dukeshin si një ujdhesë.

Sekretari që ishte në tavolinën e kreut, lëvizti gishtin dhe foli:

— Po e përsëris: bëtë shumë mirë që informuat Partinë. Gazeta është organ i Partisë. Buxhel Zherdi ka mashtruar, shokë. Të sillesh kështu me besimin dhe mallin e popullit është vepra më e poshtër. Siç ka bërë ky, mund të veprojë vetëm një aga, dhe agallarët gjykohen vetëm nga populli. Edhe ne si...

Dademadhja shikonte në tavolinën përballë dhe për-

sëriti me vete në mënyrë të pavetëdijshme fjalën *aga*. Tani, tha ajo. Tani... lëvizti kokën dhe diku në rreshtin e dytë dalloj të bardhën e syrit të gruas së Buxhel Zherdit dhe supin që i lëvizte, duke ngritur lart kodrat e gjinjve. Është e shëndoshë, mendoi. Tani të ngrihem, tha. Po u tremb se ndjeu diçka që e bënte të pazonjën. Krahët, duart, këmbët, i gjithë trupi i regëtinte, i dridhej nga të brofura të njëpasnjëshme. Gruaja e Buxhel Zherdit ishte skuqur dhe, pa u ngritur nga vendi, tha se ata që flisnin ishin grup dhe se kishin inate. Ajo zuri në gojë emrin e një gruaje, njerëzit e së cilës dikur kërkuan ta martonin me Buxhelin, po «Buxheli nuk e mori atë kurrizdalë. Ç'ta bënte...» Fjalën «kurrizdalë» ajo e humbi nëpër gojë, po njerëzit në sallë bënë zhurmë.

— Mund të flisni, shoqe, — tha sekretari i partisë.
— Mund të flisni përsëri, të shohim ç'bluan ai mulli.

Motrës së madhe të Buxhel Zherdit i kishte shkarë shamia nga koka. Ajo shante dikë prapa saj dhe vazhdimisht thoshte: «Do flasim, posi! Do flasim, ja, hë! Brom, të pëlcsni!...»

Gruaja e Buxhel Zherdit u ngrit në këmbë, shikoi prapa, fshiu kapakët e syve dhe u mundua të qeshte me qesëndi.

— Urdhëro, — tha sekretari i partisë, i rrethit, — flisni.

Dikush në sallë tha.

— Fol, o brumë i ardhur.

Dikush qeshi. Motra e madhe e Buxhel Zherdit kishte ulur kokën dhe fliste nëpër dhëmbë. Në fund e ngriti zërin dhe pëshpëriti për një grua që në të ri kishte urinuar në bankë kur kishin shkuar për shkollë nate. «I dimë të tëra ne», tha ajo.

Një burrë kërkoi të mbahej qetësi.

— Po ja, — foli gruaja e Buxhel Zherdit dhe shtriu përgjysmë krahun e djathtë.

— Urdhëro, fol, de, që mos të të ngelet merak,
— tha sekretari i partisë.

Ai bëri të gjitha përpjekjet që të zbutej në fytyrë dhe të mos e ndërpriste.

— Të flasë populli, — tha ajo.

Në sallë qeshën shumë fshatarë njëherësh.

— Shumë mirë, — tha sekretari i partisë. — Ne popullin duam të dëgjojmë.

Gruaja e Buxhel Zherdit u koll.

— Të kemi respekt për të moshuarit, — tha ajo.

— Të flasë edhe një plakë. Ato janë të drejta, nuk gënjejnë, si...

Ajo nuk e mbaroi fjalën, po u kuptua ç'donte të thoshte. Pastaj ndërroi dhe lëvizi mjekrën drejt dademadhes. Njerëzit zgjatën qafën që të shihnin dademadhen.

— Të dëgjojmë edhe dademadhen, — tha gruaja e Buxhel Zherdit. — Dademadhja s'di djallëzi.

— Fol, dademadhe, fol.

Gruaja e Buxhel Zherdit u përkul, pështeti dorën në anën e stolit dhe u ul. Plaka u koll dhe la kandilin në dyshemenë prej çimentoje, përpara këmbëve të saj. Ajo shikoi gishtërinjtë e gjatë të dorës së zbehtë e të thatë dhe u ngrit. Shpina e saj ishte e përkulur horizontalisht, dhe ajo ngriti mjekrën lart. Sekretari i partisë i rrethit shikoi fytyrën me vraga të vjetra të saj dhe buzëqeshi. Ai tani e dalloi plakën që i thërrisnin dademadhe dhe i erdhi keq që s'e kishte vënë re që në fillim të mbledhjes. Këto mendonte sekretari, ndërsa ajo mundohej të shquante buzëqeshjen në fytyrën e tij të mirë.

— Biro! — mërmëriti ajo.

— Fol, mëmë, — tha sekretari dhe përsëri qeshi me përzemërsi e shtriu duart mbi tavolinën e mbuluar me beze të kuqe. Ngjyra e fytyrës së tij u bë më e bardhë dhe u ngroh.

— Fol, fol, — tha atje tutje gruaja e Buxhel Zherdit.

Plaka shikoi andej.

— Të të kllas bretkun, — tha. — Të flas!..

Dademadhja u mundua të drejtonte trupin dhe doli një çast përpara.

— Të flas!.. — gjëmoi zëri i saj, sikur përtypi gruan e Buxhel Zherdit dhe Buxhel Zherdin vetë. Ajo ishte e nervozuar dhe dukej sikur ai trup është-madh s'e mbante dot tërë atë nervozizëm. Kokat lëvizën në sallë si bimët e shëndetshme të misrit që i trazon era. U ngritën pëshpëritje zërash aprovues dhe e tërë salla ishte gati të shpërthente.

— Ashkollsun i qoftë! — klithi një fshatar dhe qëlloi gjurin me pëllëmbë.

— Unë jam plakë e lashtë. Vij nga kohë të largëta, biro...

Plaka zgjati përpara dorën e gjatë tërë eshtra. Një çast nuk foli. U kapërdi. Kooperativistët s'bënin zhurmë. Veshët e tyre përpinin çdo fjalë.

— Poo, të na kllasë bretkun, po... — fliste nën zë motra e madhe e Buxhel Zherdit.

Një fshatar me llullën e shuar, me fytyrë të murme, të mërzitur e monotone u kthye nga ajo dhe i tha:

— Vur një palë dhëmbë të tjerë e mos llomoti përçart.

Plaka vazhdonte:

— E kisha fjetur mendjen, o bir, e kisha fjetur. Po binadali u prish...

Sekretari i partisë i rrethit e ndiqte me vëmendje dhe në ballë i ishin afruar dy rrudha vertikale, si dy pikëçuditëse. Dademadhja mundohej të fliste ngadalë, shkoqur, qartë. Fjalët e saj binin në sallë, siç qëllon pika e shiut mbi një gur. Ajo tregoi për atë natë që e kishin thirrur në shtëpi, tregoi se ç'i kishin thënë, tregoi që u gënjye, tregoi për mjaltin, për pasticon, për bursat e nipçeve. Ajo tha se mallkonte veten njëqind herë që ishte gënjyer e mëkuar nga ai; ajo tha gjithashtu se i vinte turp dhe kishte prishur gjumin, ngaqë ishte trazuar e kishte humbur shtegun, ngaqë kishte dashur të mbronte atë; ajo tregoi diçka për një pasanik të dikurshëm të fshatit

të tyre, i foli me inat të birit dhe e kërkoi me sy aty në sallë. Plaka donte të dënonte veten dhe ata që s'i kishin folur më parë për Buxhel Zherdin.

— Ai hante dheun tim nën mua dhe, kur ra, kërkoi ta ndihja!

Fytyra e zbehtë e dademadhes u drodh dhe midis rrudhave iu fiksua një ankth mizor. Ajo e tëra ishte mbërthyer nga një dëshpërim i thellë e i befasishëm.

Heshti, ktheu kokën nga e majta dhe shikoi Buxhel Zherdin, shikoi syrin e skuqur jashtë mase të tij. Ajo e shikoi gjatë, me një vështrim të ngulur, të mprehtë, depërtues. Pastaj tha:

— Dhe kërkove të të ndihja, se ta kanë njerëzit me të pabesë! Kështu the.

Plaka heshti përsëri dhe fytyra e saj u mbërthye, dhe muskujt i lëviznin sikur tani po grumbullonte lëngje që ta pështynte. Po ajo hapi nofullat ngadalë dhe tha:

— S'të kanë faj njerëzit ty.

Ajo e vështronte drejt. Buxhel Zherdi vështronte gjunjët e vet. Motra e madhe e tij lëshonte klithma, sikur kllaçte.

— Ku di plaka! Ajo jeton e vetme si ujku.

Një fshatar me një vesh të prerë dhe një tufë flokësh të ngritur lart, në majën e kokës, u duk sikur shfryu hundët pranë motrës së Buxhel Zherdit dhe tha:

— Moj, ti, mblidhe një çikë atë rodhan që më ke në gojë!

Një fshatar tjetër i moshuar, me qepalla të bardha e të mëdha si strehë dhe që ia tregonin vështrimin të qeshur e tallës, belbëzoi:

— S'i mprehim me ty, jo.

Plaka, sikur të mos kishte dëgjuar asgjë, foli:

— O Balo, të hëngërt tënja, ti e ke të ligën brenda!

Syri i kuq i Buxhel Zherdit papritur sikur u lëshua nga gropa e tij dhe zuri të shëtiste në sallë mbi

kryet e njerëzve. Dademadhja tha ashtu dhe buzët iu rrëqethën nga një dridhmë nervozizmi.

— Unë të besova, o shtrig, se e dëgjova daullen nga larg. Po ti më zure shtegun e doje të të bëja hije. Dhe...

Ata që ishin në sallë, dëgjonin të nemitur, sikur s'merrnin frymë, sikur befaz, aty përpara tyre, atë kohë të ishte ngritur nëna e tyre, nëna e të gjithëve, ashtu e madhe, e plakur, si legjendë e gjallë që merrte frymë dhe i këqyrte. Ishte ngritur midis tyre figura e dashur dhe e shtrenjtë e nënës që kishin shquar që kur dolën në botë, që e dëshironin që kur hapën krahët; ishte krijesa e pashoqe, *mëma*, më e rëndësishmja nga gjithë ç'ishin zhdukur e jetonin. Ajo tani s'ishte vetëm një kujtim. Ishte pus i thellë dhembshurie e dashurie dhe, duke qenë aty midis tyre, u kujtonte se ishte, se merrte frymë dhe kollej nga të ftohtat e hershme. Se do të ishte dhe se s'do ta gënjenin kurrë.

(Një ditë, dy udhëtarë që zbrisnin nga kufiri i largët, e panë tek ecte dhe pyetën një fëmijë:

— Sa vjeç është?

— Dy mijë, — tha fëmija.)

— Dademadhja! — mërmëriti në fundin e sallës një fshatar me kokën krejt pa flokë dhe me gojën autoritare, si të ngrirë në allçi. Ai foli sikur ta shikonte për herë të parë atë krijesë.

— Si popull, — u përgjigj me oshëtimë po ai fshatar i fortë gur.

Dademadhja ktheu kokën nga e majta dhe tha:

— Doje që të lajthitja, po s'lojta.

Syri i përgjakur nga të pagjumët i Buxhel Zherdit u acarua edhe më. Vëllai i të arratisurit Linkë Brumi mudohej të mblidhej e të bëhej më i vogël. Ai u bë pleh në fytyrë dhe në sy kishte një shkëlqim të sëmurë. Luke Gjoshit i luanin duart dhe diç belbëzonte me buzët ngjyrë hiri që i dridheshin. Syri

tjetër i Buxhel Zherdit ishte shuar, qe bërë si gur i tymosur.

Dademadhja kishte heshtur. Ajo mundohej të ngrihte kryet, t'i lëvizte ngadalë dhe të voziste shikimin e heshtur mbi kokat e tyre. Atyre u dukej sikur e tërë figura e saj ishte pushtuar nga një kryelartësi e madhërisme, kryelartësi e një mëme trime, pa mëkate e pa njolla. Ajo e uli shikimin në tavolinën e kreut, mbuluar me beze të kuqe, dhe njerëzit e kuptuan se nuk do të fliste më.

— Ulu, mëmë, ulu, — mërmëriti sekretari dhe nyja e grykës iu drodh.

Ai e mërmëriti fjalën «mëmë» si ta kishte shqiptuar atje në fushën e betejës, si të ishte thënë ajo fjalë nga ushtari, që bien në luftë me gjoksin e shpuar, të bërë shoshë dhe që, para se të heshtë, thërret: «Mëmë!».

Sekretari u ngrit në këmbë dhe tha:

— Ti, Buxhel Zherdi, nuk fole, po u përtype. Ti nuk ke kurajë të flasësh, se je hipokrit. Ti jeton me të keqen dhe e ke bërë atë si një lloj feje. Shtylla e moralit tënd është kalbur. Ata që të mbrojtën, ata tre-katër aty rreth, treguan se ç'bluan akoma ti në mullirin tënd atje në shtëpi. Ata s'janë gjë tjetër, veçse ca bardë fatkeqë, të mjerë, puna e të cilëve duhet parë.

Dademadhja ishte ngritur që të dilte. Njerëzit u munduan ta ulnin, po ajo donte të dilte. Sekretari lëvizi nga tavolina, dhe ajo e puthi në të dyja faqet. Pastaj belbëzoi:

— Për pak lajthita.

Ata që ishin përçark, bënë shteg, dhe ajo humbi përjashta.

Ajo çapitej si një plagë e gjallë. Ecte e vetme, si i dehuri mbi një truall të shkarë. Ndaloi. «Do të shkoj nga udha me drita», tha. Përpara digjej fshati me drita elektrike. Plaka nuk kishte lajthitur dhe nuk u bë urë që të kalonte e liga, po akoma ishte e tronditur dhe në çdo çap që hidhte, ndihej e mjerë dhe ecte aq ngadalë, sikur të maste se sa i madh ishte mjerimi i saj. Ndjeu ujin që rridhte nga çesma. Muret anës çesmës i kishin lyer me gëlqere atë paradite. Dy drurë të lartë që ndodheshin aty pranë, hidhnin hije mbi të, dhe njollat e hijes asaj iu dukën sikur ndotnin muret e bardha të çesmës. I rrinte akoma në sy dhoma e Buxhel Zherdit: «Dhe më puthi, dhe i përmori sytë me lot, — tha ajo. — Lotët më verbuan, dhe m'u dhimbs. Andaj shtëpia jote noton në plaçkë, o ditëzi! Doje të më plaçkitje edhe mua.»

Ajo kaloi pranë pusit dhe ndjeu kundërmim bretkosash. Ato iu dukën të mërzitura dhe, ashtu të lodhura e të mërzitura, lëshonin drejt hënës kuakërimën e tyre të shkurtër e monotone. Dademadhja ndiente dhembje. Dhembja po e sulmonte në brinjët e plakura. Asaj i dukej sikur ecte mbi gërmadhat e vetes.

Shikoi tutje, në shtëpitë e fundit të fshatit. Kodrat ishin të qeta dhe vazhdonin të laheshin në kininën e hënës. Iu duk sikur ndjeu çape. Ndali. Shikoi prapa. Askush. Ata të gjithë ishin në mbledhje. Në perëndim, në majën e Lugës, po sulmonin ré. Ajo shikoi retë, dhe ato iu dukën si një përrallë e lashtë. Vazhdoi të ecte. Pemët përçark shushurinin me dhembje. Ajo po kalonte në udhën kryesore të fshatit. Hijet e natës ishin fare të papërcaktuara. Ecte e kërrusur. Përçark kishte drita, dhe nata shikonte nga përroi, nga çairret dhe gardhet e kopshteve. Në rrugën pranë shtëpive, aty-këtu, zgjateshin me kureshtje tufa degësh me gjethe të blerta, të ndriçuara nga drita e llampave. Pla-

ka qau dhe çapitej e vetme dhe e ngarkuar me një brengë që s'mund ta mërgonte.

Befas asaj iu shfaq Guva Dari. Vegimi i tij u kthye në atmosferën e tokës dhe ndaloi pranë dademadhes. Ajo u trondit për atë shfaqje të beftë e të mbinatyrshme të njeriut të vdekur. Ajo u ndesh me të kur e tëra ishte e tronditur gjer në atë pikë, sa të kishte aluçinacione. Dhe një minutë më vonë, plaka e shikoi Guva Darin normalisht. As që i shkante mendja se nga tronditja e lodhja e sforcuar truri i ishte sëmurrur dhe se atë kohë ndodhej pranë një mashtrimi optik. Guva Dari ishte legjendë dhe vegim që jetonte ato çaste në fantazinë e plakës.

Flokët ai i kishte të bardhë e të ngatërruar si shkurre, dhe nofullat e kyçura i lëviznin me nervozizëm. Atë e rrethonte të tërin një pamje e lagësht dhe e zyrtë dhe plaka ndjeu të rënët e përvajshëm të gjethëve dhe retë e përhime që i rrëmbente era. Guva Darin e kishte mbështjellë një dëshpërim i thellë dhe nga dëshpërimi ai bluante nofullat, sikur të bluante gurë.

Pas ca u trazua dhe filloi të vërshëllente era dhe ajo ia mernte fletët e gunës, po ai vazhdonte të bluan-te nofullat e mëdha, si dy mokra të rënda.

— Ç'bluan ashtu? — i tha dademadhja.

Ai akoma bluante nofullat. Plaka e shikoi e tmeruar në sy. Qeni i tij u shtriq mbi këmbët me muskuj elastikë dhe doli përpara e lehu.

— Ç'bluan ashtu? — mërmëriti përsëri plaka. Ajo dridhej.

Guva Dari liroi ngadalë nofullat dhe tha:

— *Dua të bluaj Buxhel Zherdin.*

Era vërshëlleu me të madhe dhe drurët përqark bënë zhurmë. U përhap jehona e thyerjes së një lisi dhe atij i shkau guna. Qeni gauniste sikur i lehte pyllit. Guva Dari ngriti këmbën e madhe dhe shkeli mbi një gardh.

— Do të shkoj në sallë të mbledhjes, — gjëmoi si oshëtimë zëri i tij.

Dhe Guva Dari bëri tutje, i inatosur.

Dademadhja i shikonte flokët e gjatë të thinjur, që i ngatërroheshin nëpër errësirë, dhe ngriu. Kur hodhi çapet e gjata, ai doli nga një pyll i tërë shkëmbinjtsh me forma të ngurosur, sikur ata së bashku me Guva Darin të kishin arritur aty nga një udhëtim i largët.

«C'do të bëhet sonte në atë sallë!» tha dademadhja, po zërin e saj e rrëmbeu era dhe s'u dëgjua. «Ai do ta shkelë me këmbë», mërmëriti. Ajo ndjeu përsëri t'i flisnin dhe pak më vonë e besoi se një njeri nga bota e gjallë kishte ulur dorën e njomë njerëzore mbi supin e saj.

Ishte Alketa, e bija e komshiut. Plaka kishte folur me aluçinacionin. Vajza, që sapo kishte mbërritur, uli kokën për ta parë në fytyrë dhe foli:

— Dademadhe!

Plakës iu fshinë gjurmët e aluçinacionit. Ajo e shikoi vajzën në fytyrë dhe atë kohë fitoi plotësisht ndjenjën e realitetit.

— Alketë, bijë!

— Unë jam. Kujtova se shkove nga rrugica e kopshteve dhe të kërkova andej, — tha Alketa.

— Jo, bijë, — belbëzoi ajo.

Ato ecnin të dyja. Anës udhës, pranë mureve e gardheve, ishte platitur i përgjumur shiriti i pluhurosur i barërave, i shtogjeve dhe i ferrave që ishin shkelur nga këmbët e kuajve. Duke ecur, dademadhja dalloi në krahun e djathtë, portën e Kërrajve dhe gurin e madh sa një sënduk, mbi të cilin ajo kishte qëndruar atë natë kur e kishin veshur nuse. Në platformën e gurit të madh si sënduk drita e hënës bënte njolla të gjelbra. Përballë shushurinin degët e njoma të drurëve të kopshtit.

— Aty u ula atë natë, kur më veshën nuse, — tha plaka.

Vajza i mori kokën në të dyja duart dhe i mbësh-teti faqen e saj të ngrohtë mbi fytyrë. «Faqja e gruas së Buxhel Zherdit ishte e ftohtë», mendoi plaka. Ajo psherëtiu dhe vajzës iu duk sikur psherëtiu qenia më njerëzore në botë, simboli i fisnikërisë.

— Budallaqe, — tha vajza, si t'i fliste një shoqeje të saj, me të cilën po bënte shaka.

«Të ulem një copë herë», tha plaka me mendje.

— E shporrëm, dademadhe!

Plaka ngriti kryet për ta parë në sy dhe ndjeu se përbrenda i vërshoi diçka tjetër. Asaj po i rrësh-qiste tronditja e parë dhe në shpirt ndiente vetëm përbuzje.

Akoma pa aguar mirë, i ngrehur e i turbulluar nga shpërthimi i përnjëhershëm i pranverës, pëlliste demi i lopëve personale të fshatit. Dademadhja u ngrit në mëngjes dhe nisi të thithte ajër të pastër me tërë mushkëritë. Çdo gjë përqark dukej e kthjellët dhe jashtëzakonisht reale, siç ndodh kur ke kaluar një natë pa gjumë. Ajo kishte një pamje të sigurt. I ishte ri-lindur gjithë personaliteti i hutuar e i braktisur ato ditë.

1911

1911

1911

1911

1911

I BUKURI IM

Përgjithmonë, tha Bashmeta me vete. Ai mori frymë thellë dhe u ul në anë të udhës. Prapa tij, në një shkarëzim të bardhë, dikush kishte prerë dru për dimër dhe binte erë çermëdell. Fshati ishte atje lart. Përmbi të menjëherë fillonte mali. Në fund të malit ishte një pyll me lisa, më tej një pyll me drurë të tjerë, me qershi të egra dhe me lajthi. Akoma më në skaj, mbi atë pyll, kishte dhe panja. Ato flakëronin si zjarr. Ndërsa atje poshtë, larg, qe deti. Deti ishte tjetër gjë.

Bashmeta nxori kutinë e duhanit dhe drodhi një cigare. Ai e thithte tymin me qejf të madh. Shikoi për-qark me kujdes dhe vëmendje. Përbrenda ndiente meloditë e atyre vendeve të fëmijërisë. Ishte i mbushur i tëri me dëshirën që të ulej akoma, barkas, dhe të vëzhgonte tokën. Atij i dukej sikur qe larguar nga ato dhera pa shikuar me kujdes shumë sende, të cilat tani i ngjallnin mall dhe kureshtje, i ngjallnin kaq etje për të jetuar.

Zemra iu drithërua përsëri. Kur e kishte lindur, natyra e pati lidhur ngushtë me veten Bashmetën.

Ngriti kokën. Nën të, poshtë, buzë përroit me rrape, kullotnin një kope me viça. Këmbët e tyre ishin si shkopinj bekçiu.

Në rininë e tij Bashmeta qe i fortë dhe agai e thirri për bekçi. Ai pranoi të ishte bekçi dhe sillej që të ruante pronat e agait. Po ca më vonë ajo iu duk punë e pështirë dhe e braktisi. S'mund të kallëzonte fshatarët e tij.

Pastaj përsëri vuajti. Vuajti më shumë.

Sidoqoftë ky fshat ka qenë vatha ime, tha me vete Bashmeta. Një vathë e hidhur si vdekja. Po s'e braktisëm. S'e braktisëm. Vetëm lufta na hoqi. Ajo bëhej për ne, e bënim ne. Kanë rrjedhur vite! Tani erdha më në fund të mblidhem përsëri në këtë fshat. Kam rrojtur mirë, të mos ankohej, se më zë balta, që thonë. Po ç'është më ka mbetur nga lumaturia ime, që akoma s'e kam gjetur. Ajo do të jetë këtu. Në këtë fshat. Vatha e dashur. Këtë dashuri disa e shkelin. Unë për vete s'e kam harruar kurrë fshatin. Sa vjet u bënë që nga 944-a dhe sa shumë brodha! Polla fëmijë dhe fëmijët u rritën; janë të shpërndarë andej-këtej me punëra. Edhe ata janë martuar dhe kanë pjellë. Kanë...

Bëra luftë, pastaj s'arrita të kthehesha në fshat, se hyra në organet e ndjekjes. Pastaj punova nëpër vepër. Punova në kombinatin e tekstileve, në fushën e aviacionit në Rinas, në Urën Vajgurore, në fabrikën e qelqit në Kavajë, në hekurudhën Rrogozhinë-Fier, në fabrikën e pasurimit të Kromit në Bulqizë, në hekurudhën Elbasan-Përrenjas dhe tani së fundi në metalurgji, në Elbasan. Dita e pensionit më zuri te reparti i parafabrikateve të harkoreve, këtu e tre vjet më parë. Unë isha bërë kryespecialist për to. Vetë i bënim të gjitha. Vetë e bënim shtratin e fiksuar me betonarme. Kurse dy kokat anësore, që bëhen nga katër metra katrorë njëra, janë me dërrasa. Në fillim shtronim dy shtresa teli. Njëri tel është tre milimetra, kurse tjetri një centimetër. Është në formë rrjete. Midis telave ka tetë fije hekuri tetëmilimetërshe. Dhe mbi këto shtrojmë betonin. Betoni përgatitet me dy lloje granili të larë dhe

një lloj rëre të larë në formë granili. Këtë e përgatitin punëtorët atje në vend.

Dhe ne përgatitnim harkoret. Ato dalin të gjata njëmbëdhjetë metra e dhjetë centimetra. Të gjera janë dy metra. Atje punonin gjashtë specialistë dhe dhjetë punëtorë. Harkoret e derdhura i linim në shtrat dhjetë ditë. Pas dhjetë ditësh, një vinç me kapacitet 16 tonë i hiqte nga shtrati dhe i vendoste më tej, ku qëndronin tri-katër ditë. Gjatë këtyre ditëve i lagnim vazhdimisht me ujë. Pastaj vinte vinçi dhe i vendoste në një rirmorkio me shtrat hekuri dhe i transportonin: Një harkore peshon katër tonë.

Ishte dëmtuar njëherë një harkore. Kjo ndodhi se i kishte rënë shtrati i vinçit. Erdhën inxhinierë për ta parë harkoren. E shikonin dhe mendoheshin. Si t'ia bënin? Se ishte dëmtuar dhe kushtonte. Unë dhashë mendim që të hapnim kanale të vogla midis betonit, të shtrinin hekura dhe ta betononim. Ata më dëgjuan e llafosën së toku. Ashtu u bë. Harkorja shpëtoi. Dhe mua... Po lëvdohem! Jo kështu, Bashmetë, jo kështu!

Bashmeta hodhi bishtin e cigares më tej. Një çast të vogël cigarja tymtoi lehtë. Përqark mbante erë bari vjeshtor.

Pas kaq vitesh, ai erdhi në fshat në verë, para dy muajsh. Vendosi të banonte aty, ndaj erdhi të shikonte shtëpinë e dikurshme. Atë bina që e kishte ngritur babai i tij dhe në truallin e së cilës kishte lindur, që gëzuar dhe kishte vuajtur edhe Bashmeta. Kur erdhi në fshat në verë, ndjeu përzemërsi nga të gjithë. Motra iu duk edhe më e afërt, dhe kunati, që punonte bujk i kujtonte fshatin. Ai i tha të banonte tek ata, po Bashmeta tundi kokën dhe u përgjigj se lekë kishte dhe do ta meremetonte shtëpinë.

— Sa herë të kemi parë në televizor! — i pëshpëriste e motra. Ajo gjithashtu ishte e moshuar.

Bashmeta ia bënte ëhë dhe mendonte për shtëpinë e tij të dikurshme.

— Kësaj i shkruhej të qarët, — tha kunati dhe tregoi gruan e vet.

— Pse? — pyeti Bashmeta.

— I shkruhej të qarët kur të shikonte në televizor, në presidiume me udhëheqës.

Bashmetën vërtet e thërritnin shpesh nëpër mbledhje e takime dhe e vinin në presidiume.

E motra iu turr me vrull dhe e puthi Bashmetën. Ajo e mbyti me pyetje dhe i rrëmbeu një fotografi, në të cilën Bashmeta kishte dalë me një udhëheqës qeverie. Bashmeta gjithashtu kishte shumë mall dhe donte t'i puthte përsëri të gjithë. Kur takonte një njeri të mirë, të cilin e donte, Bashmeta e puthte. Ai tërë jetën pati qenë punëtor i ndershëm dhe njeri i pagojë. Jeta e tij mbahej mend vetëm me punë. S'i qe dëgjuar asnjë paudhësi. Njeriu që punon, s'ka kohë të bëjë të liga. Bashmeta kishte prirje që të dallonte të mirën te njeriu. Edhe kur përballej me një të keqe, kur e shihte dhe e prekte, pas ca ai s'donte ta besonte. Në përgjithësi ai rrinte me njerëz të mirë dhe njihte e besonte të mirën. Sikur s'donte t'ia zbulojë të ligën. Të lig tek ne nuk ka, thoshte. Ose ka fare-fare pak. Më prishe gjakun, thoshte ai, kur i tregoje për një paudhësi. Dënimai më i rreptë që jepte, ishte përbuzja. Atë e lodhnin jashtëzakonisht ligësitë. Pas deponimit të një ligësie, Bashmeta vuante. Po në kokën e tij, më në fund, fitonte e mira. Ai e gjuante të mirën. Ndërgjegjja e tij ishte e mbushur me mirësi.

Atë të mirë që ndodhej më larg, ai e idealizonte.

Përzemërsia që treguan fshatarët e tij e ngazëlleu. Oh! Bashmeta e dinte se ky copë vend i tokës shqiptare është edhe më i dashur për shpirtin e tij. Se këtu bujaria s'kishte lëvizur hiç dhe ata silleshin me përzemërsi me njëri-tjetrin. Ata respektonin partizanin e dikurshëm dhe punëtorin e nderuar që e quanin Bashmetë. Këtë e dëshironte Bashmeta tani, veçanërisht tani në kohën e fëmijërisë së moçme, në kohën e pensionit.

Ai qe i thjeshtë. Fshati i tij i dashur qe gjithashtu i thjeshtë. Kështu i dukej atij. I dashuri fshat i tij! I bukuri im!

Rrahu gjunjët me pëllëmbë dhe rrudhat e ballit i mblodhën akoma, dhe atij iu kujtuan barishtet me kallëza e lule rreth kërcjeve. Shikonte i pangopur. Po njihte vendet e dikurshme, tragat e humbura te Shtegu i Malit, brigjet dhe rrënjët e shqopave, sfakat, gorricat. Gjithçka. Njëpër kodrat shterpa ishin çelur toka të reja. I kishin çelur me traktorë dhe me krahë fshatarët e tij. Shtëpitë atje lart dukeshin të bardha se muret i kishin lyer me gëlqere. Një gjembaç i thatë bojë hiri lëkundej lehtë dhe kërciste. Kjo kërcitje i kujtonte shtëpinë e tij të vjetër. Një pjesë e saj dukej që atje tek çlodhej Bashmeta. Ai shikonte dhe ndjeu se si iu ringjall edhe një herë dëshira që të ngulej atje. Aty kishte një bukuri të veçantë qetësie. Fshati i tij, Bojkthi, kishte shumë mollë dhe ftonj. Shtëpia e tij e anuar ishte në mes të një kopshti të braktisur. Në kopsht kishte mollë. Atij iu kujtua se si kërcitnin ato natën kur rrëzoheshin.

Para Luftës aty kishte më tepër banorë. Tani, disa shtëpi kishin mbetur bosh, të zbrazura. Kështu kishte mbetur edhe shtëpia e Bashmetës. Po ai u kthye.

Erdhi para dy muajsh, u përçark dhe shikoi shtëpinë e çarë e të anuar nga vjetërsia. Plloçat kishin shkarë. Kishte rënë suvaja e ballit dhe i qe rrënuar oxhaku. Atëherë, para dy muajsh, ai shtyu portën e plakur dhe ndjeu se si gërvinin në drurin e tharë të lisit gozhdët e ndryshkura dhe çerçivetë. Atje brenda kishte qenë shkretë. Shkretë. Bashmeta kishte ndaluar. Kishte ndaluar. Kishte kthyer kokën prapa. I qe dredhur diçka përbrenda. Ai qe shpirtbutë. I butë dhe i urtë. Atë kohë kishte rënë në thellësi dhe kujtonte. Nga kjo, shpirti iu drodh dhe u dëshpërua. Nisi të sillej rrotull me butësi, ledhatim e pëshpëritje. Nuk donte që

të zemëronte asnjë send përçark. Po i rikthehej femijëria. Kujtonte, dhe zemra i bëhej copë. Femijëria e mjerë klithte. Dilte *ato kohë* përjashta nëpër të ftohtë dhe mblydhte lëpjetë, që të mbanin shpirtin gjallë. Jo lëpjetë kali, biro, i thoshte nëna.

Bashmeta që çapitur pastaj gjer te gardhi i zi. Atje poshtë përroi vazhdonte të rrotullohej nëpër shtjella dhe nxitonte. Ishin akoma gjurmët e asaj urës së vogël gungaçe. Ja, atje përçark atij trualli ishte ajo: lindja e tij. Vetëm atë të mos ia preknin.

Atë s'ia prekte askush tani. Tani që pak nga pak nisi t'i vinte e t'i ndërtohej e kaluara ashtu siç kishte qenë.

U kthye dhe ngjiti katër shkallët. Hyri brenda në shtëpi. Shtyu derën. Atje brenda banonin merimanga plaka. Ato rrinin të shtangura nëpër dritaret, pranë mizave të thara, që tundeshin nëpër pëlhurë. Bashmeta një copë herë qëndroi pa lëvizur. Mbi oxhak ishte kandili i moçëm i bakërt. Ja, mërmëriti ai. Diku te një tra, prej vitësh, kishte mbetur e varur diçka si një dorë çaj.

Atë kohë hyrja u mbulua nga një copë hije. Ishte e motra. Ajo i lëshoi dorën e rreshkur në gjoks dhe i mërmëriti:

— S'mundëm ta mbanim dot. Merreshim me shtëpitë tona. Kur na shkrove ti, ne i thamë kooperativës që ta merre, po s'e deshën. Nuk na nevojitet, thanë.

Sytë e saj, në gropa, u mbushën me lot.

— E meremetojmë, — tha Bashmeta.

E motra përpiu me sy tërë hapësirën e dhomës me oxhak, uli ballin te faqja e murit dhe heshti. Sikur të fliste heshtas me babanë dhe nënën. Me të kaluarën. Kjo e mallëngjeu Bashmetën dhe ndjeu ligisht që kaq vite, tërë jetën, pati ikur këtej. Po këtë s'mund ta ndiente kaq thellë një herë tjetër. Vetëm tani e ndiente me aq egërsi. Gjer në palcë.

Do të ta rregulloj tha Bashmeta me vete.

Përjashta qenë dëgjuar çape dhe zallahi.

— Këtu është — pati thirrur Teberi. Ai thirri dhe

qeshi. Pastaj tha: «Njeriu i mirë gjithmonë ka mall për truallin.»

— Këtu ka lerë — foli një fshatar thatim e i shkurtër.

— Po unë të prisja në shtëpi, — i thirri Teberi. Dëgjova makinën dhe prisja. Po ti s'erdhe.

Buzët e fshatarit Teber ishin si prej gome. Ai qe i shkathët dhe nxitonte në gjithçka.

— Na ka gëzuar shumë ky gjest i lartë, — tha ai. Atij i ndriti fytyra e shëndetshme me pllanga të përskuqura. — Do të ta rregullojmë shtëpinë, — i tha pastaj.

Bashmeta s'i dëgjoi mirë fjalët e Teberit. Ai ngriti kokën dhe e shikoi drejt në sy. Djali i Gullës, tha me vete Bashmeta dhe e përqafoi.

Ata u puthën buzë më buzë.

— Të falem nderit shumë për kartolinat dhe letrat, — i tha Bashmeta, — por unë s'para shkruaj dot dhe...

Teberi e shikoi me përgjërime dhe i tha:

— Ke nderuar fshatin.

Bashmeta u bë me turp dhe shikoi të motrën. Ajo u përlot sërish. Ata po flitnin për vëllanë e saj, për atë që kishte lindur në atë ngrehinë.

— Do ta sjellësh gruan? — e pyeti fshatari thatim e i shkurtër.

— Do ta bie. Këtu do të rrojmë tani, — tha Bashmeta me nxitim.

Dolën përjashta në udhë. Ca nga ca u mblodhën shumë njerëz. Bashmeta kishte gëzim të madh. Ai gëzim, ngaqë ishte aq i madh qe njëkohësisht edhe i dhimbshëm. Qe i dhimbshëm, sepse i përngjante disi druajtjes.

Teberi bënte gjithçka që Bashmeta të mos sillej i druajtur. Një fshatar, me leshra ngjyrë shtufi dhe faqevuar, e shikoi me inat e mëri Teberin që përkujdesej në mënyrë të veçantë për Bashmetën. Ai diç i foli me zë të ulët, të mbytur e të tmerrshëm Teberit. Sikur qe zemëruar papritur dhe mërmëriste nëpër dhembë se ky Teberi rrëmbente tërë njerëzit e mirë që

vinin në fshat. Fshatari faqevarur desh thirri që të grindej me Teberin, po dy të tjerë e shikuan me kuptim dhe ai heshti. Vetëm se e mati me një shikim dërrmues. Po Teberi s'shqetësohej. Ai s'ia vinte veshin.

Bashmetës iu zgjidh gjuha. Atij i bëhej qejfi që e pyetnin.

Atë natë, para dy muajsh, kunati shtroi darkë dhe gjer vonë pinë e kënduan. Natën e dytë Bashmetën e thirri Teberi në shtëpi. Aty u bë një darkë edhe më e madhe. Teberi ftoi pothuaj tërë burrat e fshatit të vogël Bojckth, dhe kjo i pëlqeu shumë Bashmetës. Nga kjo ai qau dhe tha me vete se ky djalë ishte ballë fshati.

Natën e fundit Bashmeta qe i ftuar te fshatari faqevarur. Atë fshatar e quanin Luke.

Pas mesnate Bashmeta ra të flinte dhe u ngrit shpejt. Kur doli përjashta te trualli i oborrit, ai shihte se si vraponte mëngjesi i gjelbër.

Atë mëngjes bleu te dyqani i fshatit fibër dhe kompensatë. Bisedoi me marangozët dhe ata i thanë se pas dy muajsh dritaret e shtëpisë do t'ia bënë krejt të reja. Para se të ikte, la tek e motra lekë që t'i blinin dy dhi dhe një kalë. Ai do të bënte jetën e fshatit. Dhe iku.

Dhe tani, pas dy muajsh, u kthye. Korriera e linjës e la në fshatin tjetër, në grykë, një orë më poshtë.

Bashmeta ecte dhe i ngjishte rëndë baltën dhe gurët. Diku në një ledh në anë të udhës u ul. Qe vjeshtë. Lart ndriçonte një diell i bardhë. Sillej i përhumbur, diçka si refren monoton.

Ai u ngrit që të ngjite udhën për në fshat. Pikërisht atë kohë në veshët e tij erdhi një këngë. Ndaloi. Dëgjonte. Po këndonin ca fshatarë atje në të majtë pranë një dushku. Ishin nga njerëzit e fshatit të tij. Dikur në atë vend çeta e Bashmetës kishte luftuar me gjermanët. Qe bërë luftë e egër. U vranë atëherë dy partizanë.

Fshatarët vazhdonin të këndonin. Ajo këngë i ngjalli përfytyrime të largëta e të freskëta, të bukura e të ndryshme Bashmetës. Kënga kumbonte rrjedhshëm e shtruar. Bashmeta kishte shtangur i befasuar.

*Do të them një këngë vetë,
këngë trimi le të jetë.*

Këngës ia merrte Teberi. Ia njohu zërin Bashmeta. Ai e kishte për zemër atë burrë të gjallë dhe që pushuar prej tij ashtu përnjëherësh. E vërteta është se Bashmeta që pakëz i ngathët. Mbase nga kjo ai i ka më për zemër njerëzit e gjallë. Teberi, për shembull, lexonte edhe libra, dhe shtëpinë e kishte rregulluar aq mirë! Me gjithçka. Kjo e kënaqte pensionistin.

Burrat pushuan sa të thithje dy herë cigaren dhe kënduan përsëri:

*Bregu Detit gurë-gurë,
kreve kapedanë shumë...*

Oh, oh! Në kokën dhe zemrën e Bashmetës hyri me furi ëndshmëria e fshehtë e jetës së fshatit, nga e cila ai që larguar prej vitesh.

Ata punonin, pastaj pushonin dhe këndonin. Kush prej tyre, që ishte në moshë të pensionit, rrinte në shtëpi? Asnjë. Bashmeta solli nëpër mend të kaluarën e largët dhe iu ndez përsëri etja për punë. Se tani, që kishte dalë në pension, po të ulej e të pinte duhan nëpër kafet e qytetit, po të përkulej me orë të tëra mbi domino dhe po të ndiente nevojën e të folurit, do të rronte vetëm me të kaluarën. Po nëse i tret ditët me të kaluarën, patjetër që plakesh. Aty fillon pleqëria.

Tek dëgjonte këngën, mendonte se fshati i tij ishte shumë herë më i bukur sesa e kishte përfytyruar andej nga shtegtimet e shumta. Oh, ai nuk do të kishte mëshirë për atë që do të orvatej të gremiste këtë bukuri. Aspak. Aspak. E kush do ta gremisë?

Pushoi kënga e fshatarëve dhe atij iu duk sikur përgark gjithçka kumbonte. Sikur kumbonte edhe pëlhura e merimangës e nderur nëpër degët e mëlqinjave.

Vazhdoi të ecte duke shikuar me sytë e mendjes Teberin, flokët e tij të valëzuar, fytyrën e shëndetshme me pllanga të kuqe, gazin e bukur që i çelte fytyrën dhe mollëzat e ngritura. E tërë fytyra e tij, i tërë shtati ishin shenjë begatie. Begatia është edhe bukuri... Shpirti i Bashmetës e kërkonte atë bukuri. Bukurinë që dëshironte. Atë, fshatin. I dashuri fshat! I bukuri im!

Përballë po zbriste një vajzë me fytyrë të kuqe dhe me sy të qetë e të ndritur. Ishte e bija e Luke Faqevarurit. Bashmeta ndjeu se në atë copë udhë përnjëherësh nisi të rinohej e të bëhej më i madh.

Ai u ul përsëri. Nuk u lodh, po donte të çmallej me vëmendje. Ndjeu çapet e një kafshe. Ajo nxitonte duke shkërmoqur gurët e udhës. Kafsha ndaloj dhe zbriti një burrë i shkurtër me këmbë të trasha. Ata u përçafuan me përzemërsi. Bashmeta vuri re se fshatari s'i përkulte dot duart, për shkak të punës së gjatë me baltën dhe plehun.

Fshatari iku. Diku, më tej, te një ledh, pëlliti ëmbël një lopë.

Bashmeta e shoi cigaren përgjysmë dhe u ngrit. Sipër në fshat këndonte një këndes sikur t'i thoshte: Eja, eja!...

Përballë, midis drurëve, ishte ura. Atë urëz e kishin hedhur fshatarët, të pleksur me thupra. Kur kalonte njeri, ajo lëkundej sikur ta zinin ethet. Nga pas nxitonte një kafshë tjetër. Bashmeta ktheu kokën dhe i ndritën sytë. Po vinte Teberi hipur mbi një kalë.

— I kujt është kali, — thirri Bashmeta.

— Imi, — tha Teberi, — imi. Socializmi këtë kërkon: të jetojmë mirë. Po të punosh... Hë, e di ti si ka thënë Zhan Zhak Rusoi?

Bashmeta kishte lëshuar kokën prapa dhe përpëliste qerpikët.

— Puna është një detyrë e pashmangshme për njeriun që rron në shoqëri. Kështu ka thënë Zhan Zhak Rusoi.

— Të paça, o djalë! — mermëriti së brendshmi e tërë qenia e Bashmetës.

— Me punë njeriu i del në krye çdo gjëje. Këtë e ka thënë Virgjili. Ja, — tha Teberi.

— Të paça! Puno! — foli i habitur Bashmeta.

Teberi qeshi me zë të lartë. Ai vazhdimisht shfaqej me një pamje gazmore dhe me qëndrim krenar. Ishte i lartë dhe kishte supe katrore. Kali ishte i vogël; qafën e kishte të bardhë dhe të hollë.

Ende s'po zbriste. Po qeshte në konfidencë. Ishte 42 vjeç dhe shpinën e kishte të drejtë.

Pastaj kërceu me zhurmë nga kali, buzëqeshi ëmbël dhe iu turr Bashmetës. U puthën në buzë me njëri-tjetrin.

— Punojnë bujqit dhe u shpura një barrë kali me farë gruri, — tha.

— Si jeni me mbjelljet? — e pyeti Bashmeta.

— Shumë mirë.

— Kohë e mirë?

— E mirë, — tha Teberi.

Bashmeta heshti sikur i mbaruan fjalët. Pastaj tha:

— Dëgjova këngën.

— Këndojmë, — tha Teberi. — Kam kërryer një këngë tjetër dhe u mundova t'ua mësoja.

— Vetë e kërreve?

— Vetë, — tha Teberi. — Kërreva një këngë për jetën e re.

Gjoksi i madh i Bashmetës u mbush me behar.

— Tani nuk do të ikësh më, — i tha Teberi.

— Jo.

— Betohu!

— Betohem! — tha Bashmeta.

Teberi e përqafoi dhe e puthi përsëri.

U ulën. Kali mblidhte bar nëpër rrënjët e sfakave. Ata bisedonin me zemër të hapur. Më tej dëgjohej kuitja e një derri.

— Bli një derr, — i tha Teberi.

— Lejohet?

— Lejohet.

— Do ta blej, — tha Bashmeta.

— Kalë gjetëm, — tha Teberi.

— E paguat?

— E paguam dhe ai hyn e del në kasollen tënde.
Shtëpinë e ke gati.

Bashmeta u përlot.

— Edhe dy dhi t'i blemë.

Bashmetës i dridhej kombi i grykës.

Pastaj Teberi u ngrit dhe iu lut Bashmetës të hipte në kalë. Po tjetri s'pranoi.

— Atëherë, mos e ha fjalën, sonte je për darkë nga unë. Mirë?

Bashmeta s'foli.

— Të lutem, — tha Teberi.

— Mirë, — tha Bashmeta.

Teberi u kthye në të majtë dhe nxitoi.

Bashmeta ishte bërë gur. Ai mezi lëvizi. Në anë të përroit ishte një derr i zhytur në llucë gjer rrëzë veshëve. Derrin ngriti turinjtë e fëlliqur dhe e shikoi me habi Bashmetën, sikur të mos e priste kurrë se do të shqetësohej nga ai njeri. Ishte një derr i ushqyer mirë. Në atë fshat malor tërë shtëpitë pothuajse rritnin derra. Edhe unë do të rrit derr, tha me mendje.

Bashmeta po ngjitej. Dyqind çape më lart hyje në fshat. Atje të priste një shpellë. Binte erë drith, ftua dhe mollë.

Bashmeta hipi në shpellë dhe befasi, përsëri para tij, qe hapur e ngritur fshati i vogël si një triumf. Ndenji te shpella. Përçark s'ishte askush.

I bukuri fshat, mërmëriti ai dhe qau heshtazi. Nuk qenë lot plaku ata, jo. Qenë shprehje e një zemre të mbushur me adhurim për vatrat, oborret, udhët, brigjet, përrenjtë, shpellat, drurët, çatitë, oxhakët, shpeshët dhe... Dhe njerëzit.

1

Bashmeta s'rrinte duarkryq në fshat. Ai gjente punë. Iu kthye freskia. Çehrja iu gjallërua dhe u bë edhe më me shëndet e fuqi. E gjallëruan njerëzit e mirë, ba-

gëtitë, drurët, degëzimet e heshtura të grykave dhe kënga monotone dhe e gëzueshme e ujërave. Gjithçka. Edhe kaltërsia e detit atje larg fshatit. Shtëpia e lashtë e tij, tashmë e meremetuar, kumbonte e tëra. Jetonte së bashku me gruan dhe rregullonte kotecin, kujdesej për kalin dhe kopshtin përqark. Zgjaste jetën. Domethënë e bënte të gëzueshme. Merrte pjesë nëpër mbledhjet që bëheshin në fshat dhe mendohej të aktivizohej kudo. I kishte shkuar në shtëpi kryetari i kooperativës dhe kishte biseduar. Sekretari i byrosë i kooperativës i tha një ditë se Partia orientonte që në të ardhmen edhe lopët personale t'i bënin kope kolektive. Ata biseduan gjatë për këtë. Bashmeta e kuptoi hallin e sekretarit të byrosë së kooperativës: ai kërkonte ndihmë. Mirë, tha me vete, mirë. Tha kështu dhe vendosi të blinte lopë. Dhe unë do të ngre dorën i pari që lopët të bëhen kope kolektive, tha Bashmeta me vete. Ja ç'duhet bërë. Këtë kërkon Partia.

Ai bleu lopë.

Kur dilte Bashmeta në rrugë, përnjëherësh përqark tij formohej një rreth njerëzish. Pensionisti ishte ngjitur aty si frymëzim urtësie, ndershmërie, besnikërie dhe burrërie. Kështu e shikonin të tërë. Kështu dëshironin ta shikonin. Edhe në Luftë ashtu pati qenë. Dhe atje në fshat atij i shkëlqenin sytë dhe gjaku i ziente. Thithte i pangopur ajrin dhe bridhte vështrimin për të kapur ato që shfaqeshin nga çasti në çast.

Në shpirt ndiente shtrëngata të bukura, dehëse. Mos në vjetët e tij kishte mbetur ende rini dhe tërë ky ngazëllim e brafullim shpirtëror ishin zgjimi i saj? Ja, këtë dhuratë ia nxori i bukuri fshat nga thellësitë, ia kërreu trualli i tij. S'i qe shuar dashuria për fshatin. Se atë e kishte ushqyer vazhdimisht. Lënda dhe shpirti im janë lindur këtu, thoshte Bashmeta me vete. Ky shpirt ka kohë që e kërkon edhe këtë lumturi; ai e ka dashuruar me zjarr vendlindjen.

Kam punuar tërë jetën. Ku më kanë thënë. Kam ushtruar vazhdimisht tërë vullnetin tim, vullnetin e mbi-zemrës, që të punoja atje ku duhesha.

Kur bëhej natë. Bashmeta dhe gruaja e tij uleshin pranë vatrës së tyre atje në fshat. Po ashtu të vetëm zjarri sikur i plogështonte dhe thesi i fjalëve boshatisej shpejt. Ndaj dilnin. Kur i vinte mendimi për të dalë, që të shkonin diku, Bashmetës i përfytyrohej Teberi.

Teberi që veshur me një peliçe ngjyrë kafe të thellë me gëzof dhelpre te jaka dhe te mëngët e duarve. Përbrenda peliçja ishte e tëra e veshur me lëkurë të shëndetshme dashi. Flokët gështenjë valë-valë, jaka e peliçes dhe vetë ngjyra e saj e bënin Teberin më burrëror dhe më energjik. Ai kishte ardhur dy net një pas një te shtëpia e Bashmetës.

— Ngrehu të shkojmë nga Teberi, — i tha Bashmeta gruas.

Ajo i tha se do të shkonte të motra e tij.

— Atje ec e merrmë, — tha ajo.

Bashmeta veshi këpucët me qafa.

— Uh, se ç'nuk më pëlqen tek ai njeri, — merrmëriti ajo.

— Të dhembin kyçet? e pyeti Bashmeta.

— Nuk më dhembin kyçet, — tha ajo.

— Të bën mirë klima e fshatit.

Ai shikoi te pasqyra e madhe prapa derës. Tek anët e kornizës plaka kishte vënë fotografi nga të djalit, vajzave, nipave dhe mbesave. Në krye, te qoshja, në një fotografi ishte Bashmeta dhe Teberi. Ata kishin dalë një javë më parë në mjedisin e fshatit. Në fotografinë e vogël nisi të lëvizte, të ngjallej e të madhohej Teberi. Lëkurën e kishte të trashë po të verdhë si gjalpë lope i ngrirë dhe me pllanga të kuqe. Kishte rru-dha të cilat ngjanin sikur dita-ditës po pakësoheshin.

Ai s'qe inatosur asnjëherë në sy të Bashmetës. Sillej njerëzishëm dhe vazhdimësisht buza e tij ishte në gaz. Kishte diçka nga njeriu që përshtatet shpejt. Kishte një lakueshmëri gati të pakapshme. Nganjëherë ai Teber, që shikonte nga ajo fotografi mbante edhe qëndrim melankolik e të dergjur njëkohësisht. Kur niste të fliste, lëvizte gjithë trupin, kokën e ngrinte përpetë njëherësh dhe po atë çast zgjaste pak krahun, ngrinte

gishtin tregues dhe me mollëzën e tij lëmonte njërin dhëmb të veshur me flori. Goja e tij gjithashtu bëhej me pasion. Kjo e gëzonte Bashmetën. Këndon edhe libra, qerratai, thoshte me vete.

Bashmeta s'kishte lexuar shumë libra në jetë.

— Eja, grua, — tha ai dhe doli përjashta.

Ishte natë. Natën s'e treste dot i vetëm Bashmeta. Të dergjeshe i vetëm në shtëpi me natën e gjatë sipër mbi çati, do të thoshte të mendoje për plakjen e jetës. Jeta ishte e gjatë dhe e gëzueshme midis njerëzve. Bashmeta i gëzohej afërsisë me njerëzit e fshatit dhe e bekonte me shpirt që të mos kishte fund kurrë kjo afërsi e përzemërt dhe e ndritur. Kështu, jeta dhe fshati i dukeshin të veshur me diell. Dikur, në të kaluarën, njerëz të ligj kishin dalë sipër dhe kishin zënë diellin dhe shumë kohë kishin lënë mbi fshat dhe mbi jetën e njerëzve vetëm hije.

Bashmeta u koll. Lehu një qen, pastaj ai hungëroi me sedër. Dikush çeli portën dhe te pragu ndaloi këmbët një burrë.

— O i zoti i konakut! — thirri Bashmeta.

Fjalët e Bashmetës dilnin nga një zemër e galduar. Burri, që nxinte te pragu, nxitoi dhe u përqafua me Bashmetën. Ishte Teberi. Ai bujti me gaz e zhurmë brenda në shtëpi dhe, kur shkelën te pllloçat e oborrit, u ndez një dritë. Bashmeta ngriti kokën dhe pa edhe një herë se nuk po hynte në një konak, po në një shtëpi dykatëshe të suvatuar nga përjashta dhe të mbuluar me tjegulla marsejeze. Në krahun e djathtë që shtrirë derri dhe pak më tej dëgjonte me veshët e çulitur dhe shikonte me bishtin e syrit kali i shtëpisë. Nën kokën e gjatë të tij kishte zahire me bollëk, por ai s'e përfillte.

Oborri i shtëpisë ishte i rrethuar me mure të larta dhe i mbuluar me rrjeta teli e kavoje, mbi të cilat shtriheshin degët e shtrembra të një hardhie të madhe. Balli i shtëpisë shikonte nga lindja dhe në të dyja anët e hyrjes dy portokalle të mbrojtura nga telajo me plastmas. Në mes të oborrit ishte një hurmë. Bashmeta i

kishte parë edhe tjetër herë këto. Po përsëri ndjeu prehje në shpirt.

Doli gruaja e Teberit dhe plaka Gullë. Ata të tre së toku bënë potere dhe e gllabëruan me gaz Bashmetën. Dhoma ishte e ngrohtë dhe soba bubullonte. Mbi të kllloçiste monoton një ibrik me lule bliri.

Teberi rregulloi dritën tek ekrani i televizorit dhe shikoi në sy të shoqen. Fytyra e saj ishte e pastër, e ndritur dhe e butë. Ajo ishte brigadiere në fshat. E shikoi të shoqin në sy, pastaj kërcëu sikur të thoshte «po» dhe nxitoi. Afruan një tryezë të vogël, të ulët dhe mbi të vunë meze, raki e verë.

— Verë! — thirri Teberi.

Bashmeta shikoi përçark dhe Teberi e kuptoi se ai kërkonte diçka tjetër.

— I zoti i shtëpisë ku është? — pyeti Bashmeta.

— Plaku shkon me dhen, s'i ndahet punës, — tha plaka Gullë.

Punojnë njerëzit, mërmëriti Bashmeta.

E shoqja e Teberit solli një brokë tjetër me verë të kuqe. Lehu qeni. Dikush ishte përjashta portës. Thirri e shoqja e Teberit nga brenda. Ajo nxitoi përjashta dhe hyri së bashku me një burrë të gjatë e të përkuhur. Flokët i kishte të ngjitur pas kafkës së shtrembër. Ai ishte bariu i lopëve personale të fshatit. Teberi lëvizti pak, po e ftoi dhe e uli me zhurmë e brafullim.

— Prapë leh qeni, — tha Bashmeta.

— Shtëpia pa njerëz është varr, — tha Teberi.

Kështu të paça, o djalë, foli me mendje Bashmeta.

— Kush braktis bujarinë, godet shoqërinë, — tha Teberi.

Bashmeta ngriti mjekrën dhe ngriu.

— Diku edhe lexoj, — tha përsëri Teberi — Kup-toj me dhembje këtë: ne s'e ndihmojmë kohën. Njeriu i socializmit duhet të lexojë. Shkruan një historian i huaj se shqiptarët kanë një ndjenjë shumë të gjallë solidariteti, një ndjenjë të madhe për interesat e për-bashkëta.

— Ta lumsha! — thirri Bashmeta. — Ta lumsha,

bir! Eh! — mërmëriti ai. — Eh, të kisha punuar më pak e të kisha kënduar edhe unë ca libra më shumë...

Brenda hyri skuadërkomandanti. Ai fërkoj duart e mardhura dhe shikonte me lakmi tryezën e shtruar. Teberi i afroi gotën dhe skuadërkomandanti u përkul si rob.

— Je gjahtar? — e pyeti Bashmeta.

— Jo, jo, të shkretën! — tha Teberi.

— E ku të lënë punët! — tha e shoqja me mërzë. Ajo ende s'i kishte zhveshur pantallonat e punës.

— Gjahu është i bukur dhe në këto anë ka boll, — belbëzoi Teberi. — Po të merr nga puna dhe... do s'do e nxin ndërgjegjen.

E shoqja solli një pjatë të madhe të mbushur me mish të pjekur të bërë copa-copa. Pas saj solli një pjatë me mjaltë.

— Bletët i venë mbarë Teberit, — tha bariu i lopëve personale. — I venë mbarë, se e ka dorën të lehtë.

— Sa bletë ke, Teber? — pyeti Bashmeta.

— Njëzet e dy, — tha Teberi përhumur, sikur të mos interesohet për to.

— Bletët lejohen? — pyeti përsëri Bashmeta.

— Ohu, lejohen, — mërmëriti bariu.

— Puna bën gjithçka, — tha Teberi. — Puna e ngre socializmin. Pa punë s'ka gjë me të vërtetë të madhe, ka thënë Pishkini.

— Cili?

— Pashkin, e... ai... Pushkini.

— Të paça! — mërmëriti Bashmeta.

— Aaa! Teberi dërrmohet në punë dhe jeton mirë, në bollëk, — tha skuadërkomandanti.

— Gëzuar! — thirri Teberi. Ai qe skuqur.

— Gëzuar! — thirri edhe Bashmeta. Sytë i qenë bërë pëllg. Ti mban një dasmë, o djalë, tha ai me vete. Fjala jote, mendja jote, kënga jote!

— Nesër ju ftoj të mblidhemi në shtëpinë time, — tha bariu i lopëve personale. Ai qe i pamartuar dhe jetonte vetëm me nënën.

— Të rrosh! — tha Bashmeta.

— Të na rroni, t'i rrosh Partisë! — tha Teberi.

Bashmeta s'foli. Skuadërkomandanti i brigadës së bujqësisë të fshatit Bojkth u ngroh dhe e ndjeu veten plotësisht pjesëtar në tryezë. U bë i qeshur dhe tha me zë të ulët:

— Prapë bëra fjalë me të.

Teberi s'foli.

— Me kë? — e pyeti e shoqja.

— Me faqevarurin, me Luke Faqevarurin.

Brigadierja bëri një gjest pakënaqësie dhe shfryu me përçmim. I shoqi shtrembëroi mjekrën sikur të kishte përpara Luke Faqevarurin.

— E ç'tha? — pyeti brigadierja dhe ngriti lart har-kun e vetullës së gjatë e të hollë.

— Lëre, — thirri Teberi me bezdi. — Lëre, mos na përrallisni habere!

Ai buzëqeshi plot mendjemadhësi dhe mbushi gotat.

— Gëzuar! — thirri. — Me fund! Jemi në shtëpi. Fuçitë do të mbajnë përsëri musht këtë vit. Vetëm gaz për punë të kemi, pa bollëku s'do të reshtë.

Shpirti i Bashmetës i shpëtoi prekjes. Ai u ngroh përsëri. Mosni, tha ai me vete. I kaluan me shpejtësi përpara syve disa fytyra të poshtra, të largëta, të cilat patën bërë dëm atje tek kishte punuar ai. Po ata... Po këtu në fshatin e vogël të tij... Këtu qe ndryshe. Mosni!

— Merrja, — i tha Teberi, bariut të lopëve personale. — Shkrehja një herë.

Teberi ia shkrehu vetë dhe zgjati dorën për të thir-rur të shoqen.

U bënë përsëri pellg sytë e Bashmetës. Ata qeshën dhe pjata me meze u shkëmbye e gotat me verë u mbu-shën përsëri. Bënë muhabet të gjatë, pa asnjë para-gjykim. Teberi shikoi në sy skuadërkomandantin dhe i bëri shenjë me kokë. Skuadërkomandanti fërkoj pëllëm-bët dhe doli përjashta.

Kur u kthye, tha:

— Asgjë s'lëviz.

Bashmeta ngriti kokën.

— Për se? — pyeti ai.

— Oh! — ia bëri Teberi. — Më kanë bërë havale edhe magazinën.

— Po ti je magazinier? — pyeti pa vëmendje Bashmeta. — Ti...

— Jam magazinier, jam edhe rojë nate. Ç'tu bësh këtyre?

Teberi tregoi me kokë të shoqen.

Po Bashmetën e kishte mundur ngazëllimi. Kjo i kishte ndodhur në fshat. Ai e shikonte jetën ashtu siç ishte, tamam, duke mos ia hequr poezinë.

Jeta e ka poezinë. E ka se e kërkon edhe shpirti i Bashmetës. Dhe Bashmetën e kishte mundur ajo poezi. Poezia dhe mosha. Se herë pas here i ndërhyjnë edhe vjetët Bashmetës. Dhe ata i ngatërronin vëmendjen.

Ai përplasi qerpikët e gjatë e të trashë, të shtrirë tutje si strehë dhe tregoi diçka nga e kaluara. U ndje uturima e një makine.

— Ç'është kjo makinë, — tha Bashmeta.

— Ç'makinë që të jetë, këtu do të vijë, — tha skuadërkomandanti. Ai fërkoj duart sikur të kishte ftohtë, qeshi dhe supet iu drodhën.

E shoqja e Teberit doli përjashta. Buluriu lopa. Teberi i pëshpëriti nënës:

— Futeni në kalive dhe jepini ujë.

— S'ka nevojë për ujë, është ftohur koha, — tha bariu i lopëve personale.

Plaka doli përjashta. Brenda hyri përgjegjësi i sektorit. Ata u përqaftuan me zhurmë. Përgjegjësi i sektorit dhe brigadierja folën me zëra të lartë për çështje pune. Pas një çike u zbutën. Përgjegjësi i sektorit piu raki. Ai tha se vera i bënte dëm në veshka. Pas dy orësh, kur do të iknin, porositi edhe një herë për duhanin që ta bënin gati që në orët e para të mëngjesit.

— Nesër do dërgojmë këtu dy makina, — tha përgjegjësi i sektorit.

— Aman! — iu lut brigadierja.

Ai doli përjashta dhe, kur zhurma e makinës humbi tatëpjetë, Bashmeta tha:

— Ç'hall keni me duhanin?

— Nuk na e merr uzina e fermentimit në qytet. Nuk kemi vend, thonë edhe ata. Po ne? Ku ta mbajmë ne? E piu lagështia. Dhe fundi i vitit erdhi!

— S'kemi vend, — tha skuadërkomandanti. — Edhe drithin e shkarkojmë përjashta, te hajati i magazinës. Mirëpo, shyqyr që është ky Teber dhe e rregulloi gjendjen, pa do të dilte fishek brigada e fshatit tonë.

— Kjo s'më pëlqen, — mermëriti Teberi. — Lëri këto.

— E pse?

— S'më pëlqen. Pastaj, mbahen dy kunguj nën sqetull?

— Ti e ke edhe duhanin? — e pyeti Bashmeta.

Teberi s'dëgjoi. Ai doli përjashta dhe, kur u kthye, ia bëri brrr, zgjati duart te soba dhe ngriti gotën e verës.

— Hë, — ia bëri. — Disa mbajnë akoma bagëti të fshehura. Nuk kanë ndërgjegje. Ç't'i bësh! I ka fshati ynë edhe këta! Duhet punuar.

— Kush mban bagëti të fshehura nga pushteti ynë?

— Mbajnë, — tha Teberi.

— Mban Luke Faqevaruri, — tha skuadërkomandanti.

Përjashta nisi të frynte erë. Ajo mundohej prej kohësh, duke u kthyer shumë dimra me radhë, që t'u gjente anën tjegullave marsejeze dhe t'i shkallmonte. Po ato ishin lidhur mirë njëra me tjetrën dhe era vazhdonte të ulërinte pikëllueshëm.

II.

Era që vinte nga larg përplasej nëpër faqe muresh, çati dhe drurë. Ajo kundërmonnte shi. Burat ende s'ishin nisur për punë. Ata ishin mbledhur grumbull te

Sheshi i Burrave në mes të fshatit dhe, duke folur me zëra të lartë, pinin duhan. Aty kalonin gra dhe të reja, aty pranë gjithashtu sillnin lopët personale që i nxirrnin nga kasollet. Bagëtitë ndalnin, ulnin kokat e rënda, pinin ujë te vija që rrëshqiste midis dhe shfrynin avull. Binte erë bajgë e freskët.

Bashmeta çeli derën dhe doli përjashta. Gruaja e tij po grindej me derrin. Ai dëgjonte shuplakat kumbuese të saj dhe gërricjet e derrit që s'bindej të largohej nga misuri.

Të gjithë në fshat kishin blerë nga një derr. I blinin në fillim të vitit dhe i thernin kur shtrëngonin dimrat e mëdhenj. Therja e derrave në fshat ishte festë më vete. Bashmetën patjetër që do ta ftonin nëpër darkat e kësaj feste. Ndaj bleu edhe vetë. Donte që edhe ai t'i ftonte fshatarët për darkë. Që shtëpia e tij të kishte jetë dhe bujari. Ky derr, së paku, do të peshojë 30 kilogramë, tha me vete...

Bashmetës iu kujtua Teberi. Ai ia bleu derrin dhe ia solli me kalin e vet. E bleu në fermën e qytetit. Bashmetës iu përhi fytyra e qeshur dhe e dashur e Teberit. I mirë, mendoi Bashmeta. Bashmeta e donte Teberin. Teberi interesohej për gjithçka në fshat. Ai interesohej edhe për vatrën e kulturës, edhe për historikun e fshatit.

— Na fëlliqi ky derr, — tha e shoqja duke ngjitur shkallët me pllaka guri.

— Eh, ëh, — ia bëri Bashmeta dhe mbushi llullën.

— Na fëlliqi, se jemi në qytet ne! Rri, o grua, të keqen!

— Më mirë të mbajmë një manar, — tha gruaja.

— Manarët s'lejohen, — tha Bashmeta.

— Si të thotë shteti, — tha gruaja dhe hyri brenda.

Bashmeta mbajti vesh dhe dëgjoi zhurmë te Sheshi i Burrave. Ai njohu zërin e Teberit dhe zbriti shkallët. Tërhoqi lesën dhe hyri në kopsht. Kopshti që mbushur me degë të vjetra të kalbura, që i kishte thyer era. Ai shkeli nëpër degët që kërcitnin dhe ndaloi mbi rrënjët e zbuluara të një çerçemi. Hudhurat s'kishin mbirë

ende. Matanë gardhit, në fund të rrëpirës, përroi rrotullonte nëpër shtjella gjethet e rrëzuara që ishin bërë të errëta. Retë e zeza dhe të rënda po mbështetnin ballin te faqja tullace e malit...

Ai u kthye mbrapsht. Përsëri dëgjohej zëri i Teberit. Po grindej me dikë. I ka hipur gjaku në kokë, tha Bashmeta me vete, dhe doli përjashta në udhë. Në të dy anët përballë shtëpive apo përçark kishte kopshte. Ato ishin të vogla dhe me lagështi. Pas tij po vinte njeriu i vogël dhe i thatë, Luke Faqevaruri.

— Si u gdhive, Bashmetë? — tha Luke Faqevaruri.

— Mirë, — tha Bashmeta. — Si u gdhive ti? Kush grindet?

— Ka vënë tellall Teberi, — tha Luke Faqevaruri.

— E pse?

— Grindet me përgjegjësin e sektorit dhe i thotë se u prish duhani dhe misri.

— Pse lënë të priset duhani dhe misri?

— Hë de, pse? Pse e lënë dhe pse vjedhin?

Do të vete drejt e në komitet të partisë në rreth, tha Bashmeta me vete. Atë kohë në udhë, midis tyre, kaloi me nxitim një derr.

— I kujt është ky? — tha Bashmeta.

— Derrin im, — tha Luke Faqevaruri.

— I dobët... Kur e ke blerë?

— Në një kohë me Teberin i kemi blerë, po ky imi është ngushtë me të ngrënë.

Derrin humbi te një kthinë.

— Është prishur shumë misër? — pyeti Bashmeta.

— Jo, — tha Luke Faqevaruri.

— Po duhan?

— Jo, — tha Luke Faqevaruri. — Po Teberi thërrret që të duket e të dëgjohet. Kanë qëllime njerëzia, Bashmetë!

Sheshi i Burrave i fshatit të vogël buçiste. Teberi që skuqur. Ai shikoi pjerrtas Bashmetën dhe thirri me hove. Këto hove i ngjanin trimërisë së dëshpërimit. Përgjegjësi i sektorit i tha brigadieres:

— Të grumbulloni tërë kafshët e fshatit dhe t'i përdorni me ditë pune.

— Po ne kemi vendosur ndryshe në kryesi.

— E shohim atë vendim, — tha përgjegjësi i sektorit.

— Mirë, — tha brigadierja.

Përgjegjësi ktheu krahët dhe iku. Teberi bëri një gjest që shprehte pakënaqësi dhe foli diçka për ndërgjegjen. Bashmetës i hipi zemërimi. Pse s'e dëgjon Teberin?

Një shi i hollë dhe i përhimë nisi të binte si tym mbi tokë. Bashmeta zbriti në magazinë. Atje përskaj ishte edhe hangari i duhanit. Përballë magazinës ishte hajati i gjatë, i mbuluar me llamarinë. Atje shkarkohej misër. Gjastë gra zhvoshknin dhe seleksiononin.

— Ja, — tha Teberi. — Ja, bereqeti përjashta!

Ai pastaj e zuri për krahu Bashmetën dhe i tha të pinin nga një kafe në shtëpi të tij. Shtëpia e tij ishte njëzet metra përmbi magazinë.

Bashmetës vërtet i pihej kafe.

— Nuk i kemi siguruar magazinat, — tha përsëri Teberi. — Drithi përjashta! Kjo gjendje lë shkak për thashetheme. Malli duhet kyçur.

Hynë në shtëpi. Teberi foli përsëri për historikun e fshatit dhe lexoi disa pjesë që i kishte shkruar vetë.

Bashmeta doli. Puno, o djalë, tha ai me vete. Puno për fshatin. Bëje edhe historikun. Edhe unë do të t'i them ato që mbaj mend.

Te një degë e shtrirë mani një zog i vogël i përhimë dridhej.

Kishte bujtur dimri.

Në të majtë hungërinte një derr që nuk lëvizte. Atij i kishte rënë barku nga dhjami i tepërt. Përballë po vinte skuadërkomandanti.

— I kujt është ai derr sa një kasolle? — pyeti Bashmeta.

— I Teberit. Aaa. Teberi rrit derra të mirë! Di, — tha skuadërkomandanti dhe nxitoi.

Derri i gjatë e i shëndoshë, me barkun e varur gjer përdhe, deshë të nxitonte, po s'mundi. Ai ulërinte. Udha menjëherë u bë e shkretë.

III.

Lesim

rezervë

Atë kohë muzgu mbi fshat dukej i trashë dhe i shurdhët. Bashmeta po hynte në shtëpinë e motrës. Pas ecte e shoqja. Një orë më vonë ata u ngritën që të iknin, po atëherë trokiti dëra. Hyri Teberi.

— Bashmeta u ul përsëri, ndërsa e shoqja iku.

— Teberi e pyeti përsëri Bashmetën për përpjekjen e kompanisë së tij me gjermanët atje tek Ara e Dushkut. Pastaj Teberi lexoi një vjershë që e kishte bërë vetë për ta kënduar grupi i fshatit. Kënga bënte fjalë për atë përpjekje, për dy partizanët e vrarë atje dhe në një rresht zihej në gojë Bashmeta. Bashmeta e dëgjo me vëmendje dhe me sytë të prushi i kuq i oxhakut. Sytë e tij u rrëmbushën me lot. Atij iu drodh kombi i grykës dhe qau pa zë. E motra qau me dënësë dhe iu var në qafë Teberit. Kunati i Bashmetës doli përjashta dhe i foli një fqinji. Erdhën dy burra. Ata shtruan të pinin përsëri dhe nisën të këndonin. Këndonin këngën e re që kishte ngritur Teberi. Bashmetës i dukej sikur shikonte me radhë fytyrat e partizanëve të kompanisë, sikur shikonte fytyrat e atyre dy partizanëve që *puthën plumbin* atje tek Ara e Dushkut.

— Edhe këtë këngë do ta vë në historik, — tha Teberi.

— Vëre, — tha Bashmeta, — po emrin tim duhet ta heqësh.

— Mirë, mirë, — ia ktheu Teberi, tundi kokën dhe qeshi me vete. Pastaj tha: — Sot të erdhi sekretari i Komitetit të Partisë të Rrethit në shtëpi?

— I erdhi, — thirri motra e Bashmetës me nxitim.

— Është burrë i mirë, — tha Bashmeta. — Ndjëm plot një orë dhe biseduam.

— Hë, — ia bëri Teberi.

Njëri nga fshatarët ngriti kokën dhe shikoi Teberin. I tha:

— Nuk u kthye nga shtëpia jote, Teber?

— Njëllon, — tha Teberi. — Çë tek unë, çë te Bashmeta. Ata në familje lufte strehohen.

— U preha me të, — tha Bashmeta.

Goja e Teberit kishte mbetur e hapur përgjysmë.

— Eh, koha e Luftës! — foli Bashmeta pastaj.

U ngritën. Dolën, Yjet xixëllonin në qiell afër dheut. Tek udha, përjashta portës, Teberi i tha Bashmetës:

— Të të përcjell gjer në shtëpi?

— Bah!

Ata shkuan në drejtime të kundërta, Teberi zbriste, ndërsa Bashmeta ngjitej udhës, dhe gurët si grusht shkërmoqeshin. Nisi të zhuzhurinte shiu.

— Ej, — thirri Bashmeta befaz, — ndal!

Silueta e njeriut të vogël u çapit gjer te shtylla që mbante në krye poçin elektrik dhe ndaloi. Ai kishte veshur një peliçe të rrjepur, me njërin kind të djegur.

Ishte Luke Faqevaruri. Fytyrën e kishte zemërake.

— Ti, Luke, je?

— Unë, o Bashmetë.

— Ç'bredh natën e gjatë në shi? Apo ishe gjëkund?

Luke Faqevaruri s'foli. Ai uli kokën edhe më dhe drodhi duhan. Pastaj ia zgjati kutinë Bashmetës. Bashmeta u koll dhe lagu cigaren me gjuhë.

— Nisi të bjerë shi, — tha.

— Nisi, — tha edhe Luke Faqevaruri.

Ata ndezën cigaret.

— Sonte bëmë këngë, — tha Bashmeta. — Ka ngritur një këngë tjetër të bukur ai Teber qerratai dhe kënduam. Trim djalë!

Luke Faqevaruri s'foli, po në sy i shkëlqeu një ekzaltim komik. Pas ca ngriti kokën dhe tha:

— Teberi vjedh.

Ato dy fjalë i tha me një gjuhë të heshtur, po ek-

spresive. Bashmeta kishte zgjatur kokën, me sy të llah-tarisur. Dhe Luke Faqevaruri, që i përshpëriti ashtu, heshtte, pinte duhan dhe e shikonte me ca sy të këqinj e të dridhshëm. Sytë e Bashmetës e ndiqnin si bishë Luke Faqevarurin.

— Hë, — ia bëri Luke Faqevaruri, — Hë, — Bashmetë... të duan. Të... të... të... të duan! Teberi na vjedh. Unë e përgjoj që ta kllapos të gjallë, se s'më besojnë. Po s'bie dot në të hapasëz. Hë, pse i fisëm është derri i tij që bëhet nga një kuintal e gjysmë? Pse, tjetër fis janë bagëtitë e tij, lopa e tij?!

— Hu! Turp! Shporru! — thirri Bashmeta.

Po Luke Faqevaruri diç foli tjetër dhe Bashmetës iu duk sikur fytyra e tij bëri një ngërdheshje të vogël ironie. Hu! ia kishte bërë Bashmeta. Turp! Shporru!

Po edhe pas atyre fjalëve Luke Faqevaruri kishte folur përsëri dhe sikur e kishte kërcënuar me grushtin e thatë e të rrudhur Bashmetën. Pastaj kishte kthyer krahët dhe supet i qenë hedhur përpjetë nga lemza, si një të dehuri. Dhe ngriti krahun e lëvizi dorën në fytyrën e tij si të fshinte lotët. Po ai kishte hyrë i tëri në errësirë atë kohë dhe s'mund ta dalloje se ç'bente ashtu me pëllëmbët. Ikte duke lënë pas një kollë. Supet i kishte të varura dhe ato goditeshin nga poshtë. I godiste kolla e thatë e shkaktuar nga duhani.

Ptu! pështyu Bashmeta.

Bashmetës papritur i ranë shpella hidhërimi në shpirt. Një dhimbje e keqe ia ndrydhi zemrën. Po pse o shpifarak, pse, o Luke, përhap të keqe?! Pse na helmon? Ë? Ç'të kemi bërë, o njeri, ë?

Bashmeta ecte plogët, duke gulçuar. Ai mendonte për Luke Faqevarurin, i cili kishte vuajtur në të kaluarën dhe mbase fatkeqësitë e kishin bërë të prapë.

Udhët ishin të zeza e të shkreta. Bashmeta i braktisi dhe hyri në shtëpi. U ul pranë zjarrit. pranë oxhakut. Kudo, në të gjitha vendet, i shfaqej fytyra e Luke Faqevarurit.

Në çatinë me plloça rrapëllinte shiu. Përjashta te xhami godiste dega e mollës. Diku qante në gjumë një

kone e vogël. Mbase kishte ftohtë. Bashmeta drodhi përsëri duhan.

— Eja të flesh, — i tha e shoqja.

— Nuk kam gjumë, jo, — ia ktheu Bashmeta.

Bashmetës s'i flitej. Ai pinte duhan dhe trazonte hirrat. Maçoku rrëqetëj në gjumë, kur godiste e fishkëllente shiu te parvazet e dritares dhe te xhamat. Ajo natë papritur ishte bërë e pikëlluar atje në fshatin Bojkth. Ajo bubullonte kudo me lloqçitje shiu e vrunduj. Dimri në fshat është i këndshëm, tha me vete. Bashmeta. Tani theren derrat dhe... Unë s'jam grykës, po gëzoj, gëzoj miqësinë, o Luke Faqevaruri! Ç'pate, o i uruar, që më prishe gjumin?! Pse e tharton këtë botë?!

Bashmeta çdo ditë mendonte për fshatin. Dhe fshati vazhdimisht i bëhej më i shtrenjtë se çdo gjë në botë. I bukuri fshat i tij! Në shpirtin e thjeshtë të Bashmetës çdo ditë rritej ndjenja e lartë e bukurisë dhe e madhështisë së vendlindjes, së tokës dhe njeriut. Ky entuziazëm i bubullonte përbrenda.

Po atë mbrëmje i doli përpara Luke Faqevaruri dhe ia nxiu. Luke Faqevaruri dukej djallëzor dhe i pakënaqur nga jeta.

Ai kërkon të shëmtojë jetën në fshat, mendoi Bashmeta. Pak kam ndenjtur me të, po...

Nga mërzia Bashmeta piu shumë duhan. Ajri mavi, plot tym duhani, gurgullonte nëpër bronke.

Maçoku ishte zgjuar. Në fillim ai e shikoi me sy të egërsuar të zotin. Pastaj shëtiti përçark si rojë dhe i fërkohej Bashmetës duke i lënë qime nëpër rroba.

Po pse, o Luke Faqevaruri, po pse, o njeri i dheut...

IV.

Pasдите Bashmeta doli që të kërkonte kalin. Atje sipër pylli i tërë ishte i mbushur fshehtirë. Ktheu kokën pas. Fshati që i kuq. Kështu dukej nga sipër, sepse

qe i mbushur me tjegulla. Ai ndjeu trishtim. Dhe ndjeu trishtim, sepse e dashuronte fshatin. Po. I trishtuar dukej edhe deti atje larg.

Çapet e kalit kumbuan me zë të mbytur në heshtjen e shtegut me gurë të korijes. Në të majtë të fshatit lumi buçiste me shkumë të turbullt, duke u ngjitur lart në të dy anët e brigjeve, duke shkukur drurë e duke i vënë përpara.

Kali hingëlliu dhe iu afrua njeriut. Bashmeta i vuri kapistrën dhe ecte tatëpjetë për në fshat. Në kopshte buçiste era e lagët. Relievi i tokës po hynte nëpër mjegulla dhe errësirë. Qielli ishte i mbushur me lagështirë. Qe lagështirë dimërore.

Bashmeta lidhi kalin te grazhdi i kasolles dhe mbajti vesh se ku thërriste me të madhe një derr. Dikush po ther derrin, tha si me vete dhe hyri në shtëpi.

— Filloi shiu prapë, — tha plaka dhe shtyu derën.

Bashmeta qëndronte pranë dritares dhe pinte duhan. Tej dritares nisi të kumbonte shiu monoton. Ai të ndillte pikëllim.

— O Bashmetë! — thirri dikush nga përjashta dhe shtyu portën. Çapet ndiheshin te shkallët. Bashmeta u gëzua si fëmijë. Atë kohë, në çast e përzuri pikëllimin. Dikush po hynte në shtëpi. Eni! Eni!

— O Bashmetë! — thirri Teberi.

Bashmeta kërceu tërë gaz dhe u përqaftuan me mall.

— Gjithë kjo dashuri, gjithë kjo dashuri! — ia bënte gruaja duke u sjellë nëpër shtëpi.

Ajo nxori raki dhe ata pinë nga dy gota njëren pas tjetrës.

— Ngrihemi, — tha Teberi. — Kemi një mbledhje me tërë pensionistët. Kanë ardhur sekretari i byrosë së kooperativës dhe kryetari.

— Hopa, — ia bëri Bashmeta. — Po pse?

— Aty do ta marrim vesh, — tha Teberi.

Teberi e kapì për krahu dhe i tha:

— Sonte do këndojmë një këngë tjetër në shtëpinë time. Një këngë të re për këtë jetë të bukur. Mirë?

Kush këndon, s'bën të liga, o Luke Faqevaruri, tha me vete Bashmeta. Ah!

— Mirë Bashmetë?

— Si të doni, — tha Bashmeta.

Teberi sillej në mënyrë të njerëzishme dhe buzëqeshte ëmbël. Ai i vuri dorën në shpatulla gruas së Bashmetës dhe i tha:

— E mbolle kopshtin?

— Mbolla vetëm ca hudhra. Ç'të bëjmë?

— Po qepët i mbolle?

Gruaja s'foli.

— Ti s'ke qepujka, — tha Teberi.

— Nuk kam, — tha ajo.

— Do gjejmë, — tha Teberi.

— Po ti ç'e mbjell kopshtin? — e pyeti Bashmeta.

— Domate, qepë, hudhra, barbunga. Ç'të mbjellësh në tetëqind metra vend? Pastaj, ca është hije... bëjnë hije fiqtë, mollët e hardhitë.

— Po misër mbjell?

— Mbjell, — tha. Ai foli me nxitim.

— Po ç'mbjell më parë në tetëqind metra vend?!
tha gruaja, sikur të fliste me vete.

Teberi dhe Bashmeta dolën përjashta portës. Përjashta kudo shushurinte shiu. Një zog ia bëri fërrt dhe u largua nga huri i një gardhi. Bashmetës iu duk sikur në fshat zotëronte heshtja. Heshtjen e bënin më të thellë dy silueta që i mërmëritnin e i pëshpëritnin njëra-tjetrës me nervozizëm.

«Në goftë se ai prapë rregullon raport dhe s'do të vijë, atëherë edhe unë nuk vij.»

Ky ishte zëri i Luke Faqevarurit. Bashmeta ngatërrroi këmbët dhe i mbajti. Ai ndjeu të dhembur te kupa e gjurit.

— «Kush tha se nuk do të vijë?»

Këtë zë Bashmeta nuk e njohu.

«Kështu më flet mendja», — tha Luke Faqevaruri.

«Pa të shohim», — tha tjetri.

«Mor, jeni në vete ju?! Po ai na batërdis! Ai flet tërë ditën për socializmin dhe tërë natën vjedh. Vjedh ditë e natë. Dhe ne u mësuaam me vjedhjen e tij dhe na duket sikur i takon! Hë, qeni! Dhe kërren edhe këngëra për këtë jetë!»

«Luke, na, prit njëherë. E zure me presh në dorë?»

«Oh, oh, ç'ma hëngrët shpirtin! Po akoma?! Ai, o insan...»

Teberi shtrëngoi bërrylin e Bashmetës dhe nxitoi. Bashmetës iu dhimbs. Iu dhimbs Teberi.

— Ç'të bëj? — breroi nëpër dhëmbë Teberi.

Bashmetës i qenë ngrysur sytë dhe i dridheshin buzët. Ato iu bënë mavi dhe ajo e poshtmja iu lëshua. Atë e goditi në tru. mendimi se fshatin e bënte të vogël e të zi ky njeri, ky njeri prapa atij gardhi të zi e të rënduar, të lagështitur e të kalbur. Edhe atje thureshin thashethemet. Dhe netët e gjata të dimrit, që mund të shkonin të bukura atje në shtëpitë e fshatit, i çartallosnin këta njerëz që sillëshin si hije dhe përgjonin. Përgjonte Luke Faqevaruri, përgjonte.

Teberi ndjeu mundimin e Bashmetës dhe mendoi ç'ti thoshte. Pëshpëriti:

— Ka, ka pengesa. Do t'i durojmë!

— Ç'të bësh, o djalë, — tha Bashmeta.

— Unë s'e vë mendjen, se...

Lehu një qen. Po pse leh kështu natën, o Luke Faqevaruri, tha Bashmeta me vete.

— Po mbase edhe mund të mos vije në mbledhje, — i tha Teberi.

Mbase nuk i dëgjoji ato ligësira, i shkreti djalë, mendonte Bashmeta për Teberin.

Ky po rrëgjohet, thoshte Teberi ndërkohë për Bash-

metën. Patjetër që s'ka dëgjuar se ç'flitnin ata atje prapa gardhit.

— Po unë doja që të ishe, se ke lezet, — foli Te-beri.

— Ç'mbledhje është. Për se?

— Nesër menatë, pa gdhirë, tërë burrat do ikin tri ditë në stërvitje ushtarake. Në fshat do mbeten pensionistët dhe ata do ta marrin në dorëzim mallin e gjënë. Ja, për këtë bëhet mbledhja.

— Dhe ne?

— Pleqtë e fshatit do bëhen barinj, për shembull.

— Mirë, — tha Bashmeta, — mirë.

Në mbledhje pensionistët nuk kundërshtuan që të merrnin në dorëzim mallin e gjënë e brigadës. Ne mund të vijmë edhe në luftë, thanë ata.

Bashmeta u caktua bari i lopëve personale të fshatit.

V

Kopeja e lopëve personale kaloi Shtegun e Malit dhe doli në zabel. Shtegu ishte i ngushtë dhe i rrëpirët. Megjithatë lopët e vogla dhe të imta mundën që pak nga pak të kalonin të gjitha dhe dolën në krye.

Bashmeta pati vërtet frikë t'i nxirrte lopët sipër te zabeli përmbi shteg. Po atje ishte kullotë e mirë dimërore. Sidoqoftë ti mos i ngjit në zabel, i thanë burrat e fshatit një natë para. Mos i ngjit në zabel, burrë, i tha e shoqja në mëngjes në shtëpi. Mos i ngjit. Një lopë është barabar me një njeri këtu në fshat. Kështu pak a shumë e porositën edhe plakat e tjera të fshatit.

Po ai nuk fliste. Kishte hedhur shpatullave gunën e një fshatari dhe nisi lopët, duke rrahur herë pas here në tokë një stap të palatuar.

Lopët të tëra e kaluan shtegun e malit dhe po kullotnin me ngut. Bashmeta hodhi përpjete supin e dja-

thtë. Nën gunë kishte trastën. Atje kishte djathë, bukë dhe qepë. Kur të arrinte dreka, do të ulej diku përballë kopesë dhe do të hante.

Më tej ishte pylli. Bashmetës po i ngjalleshin kujtime të dhimbshme të fëmijërisë, Atëherë ata ngjiteshin shpesh aty. Tani drurët e zhveshur tundeshin lehtë dhe dukeshin sikur i thoshin: Ku jeshe, ku jeshe? Po *ata? Ata? Kaq kohë që s'i kemi parë!*

Atëherë Bashmeta vente së bashku me *ata* në pyll; venin në fund të verës dhe nxitonin nëpër atë shesh të vogël paksa të pjerrët, midis shndritjes së pëlhurës vjeshtore të merimangës.

Që andej nga largësia e kohës atij i vinin në vesh zërat e *atyre*, të shokëve, dhe kumbimet e ajrit e të drurëve. Iu bë sikur gjëlloi përçark zëri i Nebiut. Sikur tingëllonin fjalët e këngës së tij të dashur.

*Dy bejka çobane frënga,
iknë e vanë tek bëhej kënga,
tek gjëmonin dhogat e rënda.*

Këndonte për ato. Është e pamundur të mos dashurosh nëpër këto vende. Bashmetës iu bë sikur dëgjoi frymëmarrjen e shpejtë dhe pa fytyrën e pikëlluar të saj... Oh!

Atë ditë ajo ishte në fushë. Dhe fshatarët të gjithë ishin në fushë, nëpër arat e tyre të vogla, dhe prashitnin misrin. Po tej lumit ajo dalloi gjermanët dhe ballistët. I dalloi dhe nxitoi arë më arë dhe u thërriste fshatarëve që të nxitonin. Ikni, po vijnë gjermanët! Ikni!

I lajmëroi të gjithë, po atje tek Ura e Xanës kishte ngelur plaku Harun. Eja, i tha asaj dikush nga fshatarët. Të lajmëroj plakun Harun, tha ajo.

Pastaj... Pastaj ballistët qëlluan. Qëlluan dhe gjermanët. Plumbi e kafshoi ligisht dhe ajo u kumbis në anë të udhës. I kullonte gjaku si burim dhe xhaxhai i saj, tek e shihte, u zverdh e gati po i binte të fikët. Po Kushulla, megjithatë, bëri zemër dhe i tha: Po ti,

xhaxha, pse zverdhesh? Unë kam plumb e lëshoj gjak dhe ty po të bie të fikët. Xhaxha... Unë... Lufta, xhaxha...

Pas dymbëdhjetë ditësh Kushulla vdiq. Vuajti shumë, Vuajti! Unë e pashë herën e fundit dhe fytyra e saj e prishur nga dhembjet u mundua të buzëqeshte. Pastaj s'e pashë më. Apo... Po hiqmu, moj fytyrë e Luke Fagevarurit! Pse m'i nxin këto ditë? Pse?!...

Bashmeta shikoi kopenë e lopëve. Ato kullotnin pranë njëra-tjetrës.

Sidoqoftë atje ishte rrëpirë dhe duhej pasur kujdes që të mos rrëshqiste ndonjëra. Kjo do të ishte e papëlqyer. Zemra e Bashmetës s'do ta falte këtë dhe do të dhembte.

Po ai ua dinte anën lopëve. Ato nuk duheshin shtrënguar. Oho, ho, ho, ho! Dy, katër, gjashtë...

Në fshat çdo familje mban edhe nga një lopë. Lopa sjell bollëk. Ato më vonë do t'i bëjnë kope kolektive. Kështu orienton Partia. Po s'e kanë të lehtë të vendosin. Se ka edhe vështirësi për t'u administruar. Unë do të blej lopë. Lekë kam. Po ajo lopë atje, pse e mban kokën ngritur? Tani dita është e vogël dhe bagëtia e ndien këtë. Ajo s'e ngre kokën nga kullota. Apo...

Bashmeta shikoi përballë. Në jug të malit ndehej një re e sterrosur. Ndjeu britma zogjsh dhe buçima burimesh, sikur ato të ishin hapur përnjëherësh. Ndjeu thirrjet e Nebiut. Nebiu s'ishte më. Ai u vra dy ditë para se të çlirohej vendi. Atëherë, në rininë e parë, ata vinin shpesh së bashku në fundrat e këtij mali. Vinin për të kullotur dhitë. Bënin shkallë dhe hipnin nëpër prehura shkëmbinjsh që të mblidhnin kripëz. Atë e hanë shumë dhitë.

Bashmetës i qenë zgjuar kujtime të mëdha. Ai shihte me dhembje në to. Njeriu ka nevojë të kujtojë. Të kujtojë edhe vetveten.

Kopeja e lopëve vinte drejt tij. Atëherë u ngjiti më lart në zabel.

Po i ngroheshin dejtë. Nëpër ta i përhapej një ndjesi

e këndshme. Tani shpirti i tij ishte krejt i zhveshur nga ato defyra të largëta. Ai u bë përsëri si më parë, i varfër, si atëherë kur rritej e jetonte në fshat. Ho, ho, ho, ho! Po i rrezatonte rinia e hershme. Gjithçka, atje në atë pjerrinë të vendlindjes, po i thjeshtoj. Qe vërtet bukur të thithte ajrin gjallërues të malit. Kjo e nxiste që të rrëfehej, dhe ai po i rrëfehej vetvetes.

Iu përhi përsëri fytyra e Nebiut. Ai pati kënduar bukur dhe Bashmetës iu bë sikur dëgjoji këngën e dikurshme të Nebiut për bejkat. Ajo i vinte si kumbim. Kumbimi sikur binte nga drurët. Sikur drurët e vjetër kishin ruajtur këngën dhe tani e nxirrnin. Dëgjoje, Bashmetë! Çmally, po të flet Nebiu! Po të flet me këngë! Pse, keq këndon Nebiu? Njeriu që këndon... Po mos m'u kujto, o Luke Faqevaruri...

Bashmeta ndiente lumturi. Mos ia ngacmoni lumturinë! Ai vetë po shushatej nga lumturia e madhe që gjeti në vendlindje. Kjo ishte një lumturi më e madhe nga ç'e mendonte. Tani dinte vetëm një gjë: lumturinë e begatisë së fshatit të dashur! Ti, Atdhe, ke lindur nga fshatarë! (Kush na e ka thënë këtë? Këtë e thotë jeta, e vërteta që është e të gjithëve). Lumturia e begatisë së fshatit. Dhe e fshatit të tij. Ja, vetëm kaq. Për këtë mendonte tani. Për të tjerat ishte krejt i paditur. Donte të ishte krejt i paditur. Oh, jo... Jo. Komunisti...

Bashmeta nisi të mendonte ndryshe, të mendonte hollë për këtë.

Ho, ho, ho, ho, onaish! U fliste lopëve dhe nisi t'i numëronte të gjitha. Shikonte se si lëvizte kurrizi i tyre. Po njëra prej tyre sikur nuk kulloste. Ajo... Bashmeta do të vente dy-tri ditë rresht bari pas lopëve. Duke u ngjitur aty nëpër ato kullota, nëpër fundrat e rrëpirta të malit, ai rivendosi edhe më mirë kontaktin me të kaluarën dhe me të tanishmen. Me njerëzit, me baltën. S'do ta kishte besuar kurrë se e kaluara do të kishte aq shumë pushtet mbi të. Domethënë deri në këtë shkallë. Ajo e përpiu. Po e përpinte vendlindja.

Më tej ishte një gëmushë koftonecash. U përkul dhe pëllëmba iu shpua nga gjethet me gjemba. Bashmeta

mori në pëllëmbë kokrra të kuqe koftonecash. Qenë pjekur. Dy kokrra i hodhi në gojë. Pastaj këputi një degë. Dega e koftonecit me gjethe të gjelbra. Bashmetës iu drodh zemra. Tani gjethet e drurëve të pyllit qenë rrëzuar. Ndërsa koftonecat i kishin kokrrat të kuqe dhe degët e gjethet krejt të gjelbra. Kokrrat e kuqe shënonin fillimin e festës gazmore dhe madhështore të dimrit. Bashmeta e ndiente shumë këtë festë dhe bëhej si fëmijë.

Atij iu kujtuan mbrëmjet e dimrit, ditët kur ngjiteshin përmbi fshat që të gjenin dëllinja të bukura, të rrumbullakëta. I prisnin dhe i sillnin në shtëpi, pastaj i zbukuronin me copëra ose fije leshi të bardha e të ngjyera dhe varnin nëpër degët e saj mollë, ftonj, portokalle, shegë etj. Gjithmonë te dëllinja e Vitit të Ri do të vendosnin yje. Bënin një yll më të madh dhe e lidhnin në majë.

Ata dilnin nëpër udhë dhe, kur nata zbriste kudo dhe gjithkund bëhej xëc, ktheheshin në shtëpi që të gëzoheshin pranë dëllinjës, që dukej si një mikeshë e gjelbër, e ngarkuar me dëborë të bukur, me ngjyra. Këto mbrëmje ishin të jashtëzakonshme për ta. Këto ishin fat i tyre.

Edhe më vonë, tërë jetën, atje larg, nëpër vise të tjera të Shqipërisë, kur vinte festa e dimrit, Bashmeta e lidhte atë me dimrin e fshatit, me tërbimin e erës, me përmbytjet, dëborën dhe kokrrat e kuqe të koftonecit. Atëherë ata sillnin degë nëpër shtëpi dhe natën e Vitit të Ri i hidhnin në zjarrin e kuq që digjte kucura të mëdhenj, të zinj. Gjethet e koftonecit kërcitnin dhe në atë kërcitje kërkonin fatin, në ato kërcitje fshiheshin gazi i fëmijëve.

Bashmetës iu bë atë kohë sikur ndjeu të tingëllinte dëborë e thellë dhe e lehtë.

Nisi të frynte erë. Ajo sillte aromën e dëborës dhe të drurëve lakuriq.

Njeriu shikoi orën. Ora shënonte një pasdreke. U ul dhe hëngri bukë. Një lopë iu qas dhe zgjati buzët e trasha. Ai i dha një krodhë bukë dhe ndjeu në fytyrë

frymën e saj të ngrohtë. Kopeja kulloste me ngut, sikur të nxitonte që të mos e pllakoste muzgu, se pastaj ajo do të zbriste në fshat. Ai i numëroi përsëri lopët dhe numri ishte tamam: 18, Po njëra e mbante kokën lart. Ajo lopa e bardhë me njërin bri të thyer. Qimja e saj ishte e drejtë si tel dhe e shndritshme. Lopa shikonte sikur të mendonte e mërzitur. Perëndi! tha me vete Bashmeta, pas shumë e shumë vitesh që s'e kishte qasur në gojë fjalën perëndi. Ai e dinte nga fëmijëria se bagëtia që nuk kullot, nuk ndihet mirë.

Mos është sëmure?!

U çapit ngadalë, me druajtje. Lopa vazhdonte të shikonte drejt, pa lëvizur. Pas pak lëvizi qerpikun e syrit dhe njërin vesh.

Hoho, ho, ia bëri Bashmeta. Ajo ishte lopa e Teberit. Bariu doli në krye të tyre dhe vazhdonte të shikonte lopën. Ajo qëndronte pa lëvizur, sikur të shikonte diku në zbrazëtinë. Bashmetës i shkuan sytë nën bark dhe dalloj gjinjtë e saj të mëdhenj të mbushur. Ajo ishte një lopë e imët, si tërë lopët e tjera të fshatit, por ishte e shëndetshme dhe gjirin e kishte tepër të madh. Domosdo, një lopë e tillë s'blihej me para. Po të ngo... Të ngordhte? Atëherë... Eh, o Bashmetë!

Njeriu i foli përsëri bagëtisë. Ajo ktheu kokën ngadalë pakëz anash, pastaj ngriti bishtin dhe blup, blup, lëshoi bajga. Bajga, tha Bashmeta.

Ai e dinte nga përvoja e dikurshme se një bagëti që bajgon është mirë. Po ajo sikur s'kulloti! Sikur tërë ditën s'ka kullotur!

Lopa uli kryet e madh dhe nisi të qëmtonte hejë me përtesë. Po hante. Eh, ia bëri Bashmeta dhe piu duhan me llullë. Shyqyr! Të ngordhë një lopë? Ky do të ishte turp i madh! Turp dhe humbje.

Ajo kulloti gjersa Bashmeta u thirri lopëve me fjalë të buta e përkëdhelëse dhe i vuri përpara që t'i zbriste nëpër shtegun e malit.

Në mbrëmje, në fshat, ai bëri një mëkat: nuk shkoi në shtëpinë e Teberit të lajmëronte plakën Gullë se lopa s'kishte kullotur gjatë ditës. Tërë ditën e perëndisë

ajo kishte kullotur vetëm një orë. Ai s'lajmëroi për këtë, po fjetei vonë, piu shumë duhan dhe tërë natën priti që ta thërritnin e t'i thoshin se ishte bërë hataja: lopa e Teberit ishte shtrirë e po tundte këmbën. Ose: lopa shtriu qafën dhe ngordhi.

Por gjer në mëngjes askush s'trokiti në derë. Askush.

Bashmeta futi bukën në trastë, hodhi gunën kraheve dhe doli te Sheshi i Burrave. Atje, përsikaj, plakati sillnin lopët. Dikur lopçari i fshatit hipte te një gur i Sheshit të Burrave dhe thërriste: Kërreni lopëtooo!

Tani nuk thërritnin kështu. Kohët kishin ndryshuar. Njerëzit nëpër shtëpira kishin radio, orë, televizorë dhe orientoheshin me to.

Plakati, një nga një, vazhdonin të sillnin lopët. Dëmi po pëlliste sikur t'i thërriste pranverës, e cila kishte humbur diku larg dhe s'po buiste akoma, që ai të ngrohej e të turfullonte i tërbuar.

Atje poshtë po ngjitej nëna e Teberit. Para saj ecte Balika, lopa e bardhë me bririn e thyer. Plaka mbante mbi vithet e saj një karrthje të shkurtër, po s'e ulte që ta qëllonte. Lopa ecte sikur të ishte me barrë, sikur do të pillte ato ditë. Ajo ecte rëndë dhe e qetë, dhe Bashmeta ia dalloj sytë e freskët e të larë si xham.

Plaka e lëshoi në kope dhe hodhi romuze e qeshi pa të keq me Bashmetën.

Mirë qenka lopa, mendoi Bashmeta.

— Kur piell lopa? — i tha ai.

Plaka Gullë ndaloj, ktheu kokën, shikoi Bashmetën, pastaj shikoi lopën dhe tha:

— Në qershor e ka vitin sivjet.

— I merrni qumësht?

— Qumësht?! Posi. Një muaj para se të pjellë e pret.

Ajo iku. Katër plaka që ishin kokë më kokë dic bisedonin. Njëra prej tyre u shkëput dhe i vaiti pranë një lope të kuqe. Ajo ishte lona e saj. E qëllloi lehtë te njëra vithe. Lopa ngriti bishtin dhe lëshoi baiga. Plaka kishte hapur pëllëmbët e rreshkëta dhe i priste.

Lopa pastaj uli bishtin dhe ktheu kokën të shihte nëse plaka e shtëpisë i priti në pëllëmbë tërë bajgat.

Bashmeta e vërente dhe nëpër mend i trokiti përsëri fëmijëria, kur shkonin pas lopëve që të mblidhnin bajga dhe t'i ngjithnin nëpër pllaka, karshi diellit. Kur thaheshin i mblidhnin dhe me to nëna piqte bukën në saç në shtëpi.

— Ç'të bëjmë, Bashmetë! — tha plaka me bajgat në duar. — I mbledh dhe i kolis në katua. Helbete, kur-sejmë drunë. Bëjnë zjarr vuvo, po gjene ngrohin. Ç'të bëjmë, e shikon atë që zbret, asaj i ka pjellë kokoshi.

Ajo ishte plaka Gullë, nëna e Teberit. Po ç'keni me të, o të uruara, tha Bashmeta me vete. Ç'keni me të?!

— Ja, — tha plaka me bajgat në duar, që avullonin dhe përhapnin afsh. — Ja lopa e saj. Ha një magazi të tërë. Shih si është. A mos është e fisme thua? Dhe lopa ime bilë e saj është. Të tëra ç'kemi blerë nga ai, të tilla dolën, xhudame. Se duan bollëk t'i hedhin gojës. Po ne s'kemi kallamboq. Bashmetë! Arat ia dhama kooperativës dhe kemi një copë kopsht sa për dy zarzavate.

— Ç'thua, moj!

— Laçe, mos e përziej Bashmetën, — i thirri një plakë tjetër.

— Jo, po...

Ajo u kthye mbrapsht. Ikën të katër plakat. Bashmeta mblodhi lopët i hutuar dhe i nisi përsëri për t'i ngjitur nëpër shtegun e malit, që t'i kulloste në zabel. Po sikur të shkasë ndonjëra? tha ai me vete.

Atje vërtet ishte vendi ligshst dhe te shtegu i malit sidomos, në dimër, kishte ndodhur që kishin shkarë edhe lopë. Lopa është bagëti e trashë; ajo s'është si dhia. Sikur... sikur, për shembull, të shkasë lopa e plakë Laçes? Larg qoftë! Ç'e ka plakë Laçja Luke Faqevavarurin! Vëlla. Hë, e ka vëlla! Një grurë bluan ai mulli!

Po, sidoqoftë, Bashmeta që i turbulluar.

Lopët e kaluan shtegun në rresht, njëra pas tjetrës, dhe u shpërndanë nëpër kullotën e zabelit.

Bashmeta nisi të këndonte me vete këngën e dashur

të Nebiut. Goja i bënte këngë dhe nëpër faqet e buhavitura ai ndjeu një masë të vakët. Po qante.

Nxori thikën dhe nisi të gdhendte. Dikur në rininë e hershme, kur ishte në fshat, ai pati gdhendur. Gdhendja kërkon mjeshtëri. Ajo kërkon gjithashtu një fëmijëri të hidhur. Një copë jetë të hidhur. Në këtë copë jetë të hidhur e të vetmuar njeriu nis e gdhend. Njeriu nis e gdhend, gjithashtu, kur është vetëm me bravaret e fshatit, dhe kur është i dëshpëruar. Po pse më hidhëroi Laçja? Po pse, o djallër, e ngatërroni fshatin?! Pse...

Re të zeza turreshin me rrëmbim. Do të bëjë shtrëngatë, tha Bashmeta.

Ai u foli lopëve me zë të ulët dhe i numëroi. Njëra prej tyre përsëri s'kulloste: lopa e Teberit!

Perëndi, mërmëriti së brendshmi Bashmeta. Perëndi!

Lopa atje tej rrinte e vetme, e hutuar. Ajo qëndronte pa lëvizur, si e fjetur, sikur të bënte më këmbë gjumin e natës. Po fle, tha Bashmeta.

Ai u trondit. Një lopë që nuk kullot, nuk është mirë. Një lopë që nuk kullot, është e sëmurë. Dy ditë që nuk kullot! Dje bajgoi.

Ai u afrua dhe e qëlloi lehtë në vithe: ho!

Ajo ktheu kryet si zonjë dhe u çapit ngadalë. Ç'është kështu! tha Bashmeta me vete. Ç'është kështu!

Lopa ndaloi më tej. Njeriu i doli përpara dhe theu gjunjët. Kokat e tyre qëndruan pranë e pranë dhe përballë njëra-tjetrës. Bashmeta e shikonte drejt bagëtisë dhe i mori kokën në të dyja duart. Lopë në duar të mira, në zotë të mirë, tha ai duke kujtuar Teberin. Ja, të tillë duhet ta kenë zotin që do të kujdeset, kur të bëhen kope kolektive. Që fshatarët të jenë të kënaqur dhe të mos marrin qengja më pak, dhe të mos marrin më pak keca, dhe të mos psherëtimë të lodhur e të pakënaqur. Këtu te bagëtia e ka jetën fshatari, një pjesë të jetës domethënë. Mos ia shpjego fshatarit me shumë fjalë dobinë. Ai prej shekujsh e di se cili është përfitimi.

Lopa e Teberit s'lëvizte. Ata të dy shikoheshin sy

më sy pa lëvizur. Syri i saj ishte i përलगур, i kulluar, i tejdukshëm.

Bashmetës iu drodh lëkura e kokës. Se pikërisht atë kohë iu përқasën sytë e lulëzuar të *asaj*. Iu përқas goja e Kushullës, që sillte vetëm pranverë. *Ajo...* pranverë, *Ajo...* ëndrra e parë, dielli i parë që s'i shqitej. Buzëqeshja e *saj* e fundit.

I dhembti në gjoks Bashmetës kur mendoi se ndoshta s'ishte gjë e mirë të kujtonte Kushullën duke shikuar në sytë e një lope. Po jo, jo, tha Bashmeta. Lopa është krijesë vërtet e pastër dhe fisnike. Dhe unë, pas kaq e kaq vitesh, megjithëse e kam dashur gruan time të jetës, kam qenë në gjendje t'i gjej kudo sytë e saj, fytyrën, gojën dhe qafën e *saj* si panjë. Ranë mjaft shira e borëra, u shkrehën shumë dyfeqe dhe vendi ndryshoi, po tek unë s'u shove, moj Kushullë, s'u shove! Siç s'm'u shua dashuria për fshatin. Shikoj sytë e bukur të kësaj qenieje fisnike dhe të zhvarros. Dhe gruaja ime e jetës, që është plakë dhe tërmonë ka qenë e mirë, të kujton dhe të lëvdon, psherëtin dhe thotë: Si *ajo*, si Kushulla! Kështu thotë për ty! Unë kuptoj, moj Kushullë. se ky është nder, nder i madh për ty, për mua dhe për baltën që na mban. Që *ti* jeshë pjellë e mirë dhe ne s'të harrojmë. Po si të harrojmë vetveten?

Lopës i lëvizi qerpiku dhe figura e Kushullës ra në përumbje. Te syri i qelqtë i bagëtisë doli, sikur të qe gremisur, plakë Laçja. Në njërën pëllëmbë ajo mbante bajga të freskëta. Bajgat avullonin dhe xhami u bë me avull dhe figura e saj ecte nëpër mjegull. Në dorë kishte një shkop të shkurtër si karthje. Plakë Laçja tundte shkopin si karthje dhe fliste me nervozizëm, duke përplasur buzët e holla. *Ajo...* *Ajo* po i kërcënohej Bashmetës. Bashmetës iu tkurr lëkura diku prapa veshit e me mundim lëvizi dhe nguli shikimin te syri i djathtë i lopës. Po atje... Atje qe shfaqur e shikonte i mugur Luke Fagevarurin. Ai pinte duhan dhe duart i mbante në peliçen e rrjepur, të djegur te kindi; sytë i shpërndanin tym nga inati, dhe gulçonte mllef.

Ç'bëhet kështu! foli një zë brenda në trurin e squllur të Bashmetës. Ai filloi të shikonte herë në njërin sy të lopës e herë në tjetrin. Herë plakë Laçen e herë Luke Façevavarurin. Plakë Laçja kërcënonte. Luke Façevavaruri shikonte me mllef. Pas plakë Laçes rrinin tri plaka të tjera dhe prisnin që ajo të fliste edhe më. Fol, Laçe, fol!

Po ti s'e zure me presh në dorë, o Luke Façevavaruri. S'e zura? Po pse, derri i tij, i fisëm është që zigjas një kuintal e gjysmë? Po pse, lopa e tij, e fisme është që jep aq qumësht dhe i ndrit qimja? Po pse, aq shkollëra ka bërë Teberi që ua merr anën të gjitha punëve? Tani kërkon t'i paguhet me ditë pune edhe qeni, se e ka ortak në rojë si magazinier... Ai Teber, magazinier, si rojë te misri i papeshuar, ai në hangarët e duhanit dhe në... Në pranverë ai do të shkojë të piksë djathin. Se Teberi është edhe elektrikist! Se Teberi di të flasë nëpër mbledhje dhe...

Lopa zgjati kokën dhe deshi të çlirohej nga pëllëmbët e Bashmetës. Ajo buluriti lehtë dhe ëmbël. Po ti s'kullot, i tha Bashmeta. S'kullot dhe s'bahjon. Ë?

Ai u ngrit në këmbë dhe guna e vjetër i ra nga krahët. Atje më tej dikush kishte prerë gjashtë trupa të shkurtër lisi, që t'i zbristë nëpër rrëpirë, t'i ngarkonte pastaj në mushkë apo në kalë dhe t'i çonte në shtëpi.

Bashmetës i ranë trupa të rëndë në shpirt dhe nisën t'i rrihnin tëmthat. Lopa kishte kthyer vithet. Gjnjtë e saj sikur vazhdonin të rriteshin. Apo s'dalloj mirë, tha Bashmeta me vete. Si mund të bëjë qumësht e të rritë gjnjtë një lopë që s'kullot? Një lopë që s'kullot, pa një pa dy është sëmurë. Kjo lopë e bukur është e sëmurë. Kjo s'bahjon. Oh, ç'u turpërova dhe... Harrove fshatin, do të mendojnë.

Lopa lëvizi qafën, goditi shpatullën e majtë me noçkë dhe po ngrinte bishtin. Hë, hë, hë, ia bënte shpirti i Bashmetës. Hë! Ngrije bishtin! Bajgo! Sonte në darkë kthehen burrat dhe unë lajmëroj Teberin dhe ai vetë të sjell mjekun. Bajgo, moj e uruar!

Lopa e ngriti edhe pak bishtin dhe sytë e Bashmetës e ndiqnin sikur do ta përpinin.

Nga përçark flegrat e hundës së tij rrëmbyen afshin e bajgës së freskët e të vakët. Bllop, bllop, bllop. Barku i lopës tek ijet u ngrit dhe u ul disa herë, pastaj bagëtia rrudhi pak vithet, shtriu bishtin, e mënjanoi dhe e uli plotësisht. Ktheu kokën lehtë sikur t'i thoshte Bashmetës: Ja, bajgova, bëra bajgë.

Bajgove! thirri e gëzuar e tërë qenia e Bashmetës. Bajgove!

Thirrja e tij ishte me triumf. Lopa u çapit dhe uli kokën për të kërkuar bar. Kulloste me përtesë, duke sjellë herë pas here bishtin mbi kurrizin e gjerë e të shëndetshëm.

Edhe dje në këtë orë nise të kullotje, i tha Bashmeta.

Ai u ngrit dhe u çapit gjer te vendi ku avullonte grumbulli i bajgave. Fshatari s'e ka të vështirë t'i qëndrojë pranë dhe ta prekë të pëgërën e bagëtisë. Jo.

Ai theu përsëri gjunjët, uli pëllëmbët mbi kupat dhe zgjati mjekrën. Era e fortë dhe e njohur e bajgës u përhap edhe më furishëm.

Bashmeta shtangu. Ai zgjati ngadalë krahun e djathtë, hapi pëllëmbën dhe e afroi pranë bajgës, katër gisht mbi të. Bajga lëshonte avull të ngrohtë. Njëpër të vetëtinin ca si hënëza të vogla ngjyrë floriri. Ai s'kishte fuqi të lëvizte qafën, nuk mund të lëvizte sytë. Ato ngrinë. *Hënëza të vogla!* Hënëza të vogla ngjyrë flori. Bereqet! Bereqet! thirri me alarm tërë qenia e njeriut të mirë, të dashur e të urtuar përjetësisht. Be-ré-qet!

Ai, më në fund, lëvizi krahun, mori një copë dru dhe trazoi bajgat. Njëpër to shfaqeshin me dhjetëra kokrra misri të patretura. Misër i verdhë i pabluar, i papërtypur, i patretur. Se lëngjet tretëse s'kishin mundur të depërtonin njëpër celulozën e tyre.

Sytë e Bashmetës u ngritën dhe shikuan atje tej te lopa e Teberit. Këmbët e pasme të saj ishin të çapëlyera, dhe ajo i tërhiqte ngadalë. Midis kofshëve sikur

vazhdonte të rritej me shpejtësi të habitshme gjiri i bëshëm. Po tretej bereqeti që ajo hante para mesnate në kasollen e Teberit dhe e ripërtypte ngadalë pas mesnate gjer në të gdhirë. Pastaj, kur ngjitej në kullotë, ajo pushonte. Rrinte ashtu në këmbë dhe vende-vende lëkura e bardhë e shndritshme i dridhej sikur nëpër të t'i vraponin ëndrra dhe fshehtira; sikur ëndrrat dhe fshehtësitë ndalnin një çast dhe goditnin nga përbrenda lëkurën e fortë. Që të dilnin. Po lëkura s'çahej. Ajo vetëm dridhej.

Dhe në sytë e Bashmetës u bë errësirë.

Bubullitje sobe pranë një tryeze të bollshme në shtëpinë e Teberit. Një këngë e re për jetën e re thurur nga Teberi, *zëri dhe buzëqeshja e bukur* e Teberit, kërcitja e një dege natën nga era, mbyllja e portës dhe kërcitja e një llozi. Dhe çapet e rënda të Bashmetës me zemër të mirë, bujar e të besuar, që nxitonte drejt shtëpisë së lashtë të përtërirë, dhe ajo natën e mirë nga Teberi, dhe zbritja e Teberit për të ruajtur magazinën. Pastaj... pastaj Bashmeta shtynte nga brenda portën e rëndë që kërciste, ngjितte shkallët, shtynte derën e shtëpisë dhe binte në gjumë pranë së shoqes. Dhe diku atje në anë të fshatit një kope e vogël qensh që lehnin e grindeshin sikur dallonin siluetën e një ujku që fshehurazi rrëmbente... një ujk fshehurazi... Dhe Luke Faqevaruri që dilte i mardhur diku te një kthinë dhe thëriste: kapeni, kapeni, kapeni, ka-pe-ni! Dhe plaka Laçe që tundte gishtin përpara fytyrës së Bashmetës. Dhe sytë e fshatarëve që vërenin me kuptim të madh Bashmetën e tyre. Po, Bashmetën e tyre. Po, Bashmeta... Ah, Bashmetëëë!

Një lopë buluriti, Bashmeta ngriti kokën e rënduar dhe mërmëriti: Unë, unë!...

Atij iu duk sikur po nxitonin diku përmes kopesë Luke Faqevaruri dhe burra të tjerë, dhe... Bashmeta

trazoi edhe një herë me shkop bajgën, pastaj e lëshoi atë dhe u ngrit duke vënë duart në mes. Atij iu largua me të shpejtë diçka.

Ti vjedh, O Teber, o qen, o lugat, thirri ai si i marrë.

Po ç'të thoshte Bashmeta! Ç'të... Përgjigju, Bashmetë, përgjigju! Ti je i verbër. Verbëria, Bashmetë!... Kush fliste?

Burri i moshuar, të cilin e quanin Bashmetë, ngriti kokën. Atje përtej po nxitonin mjegullat duke mbuluar rrudhat e trasha të shkëmbinjve. Pastaj ato do të mbulonin greminat.

Te zabeli kishte qetësi dhe dritë. Atje ishte bukur. Po lopa e Teberit, më në fund, tha: «Unë ha misër. Misrin e vjedh imzot, Teberi. Unë ha grurë. Grurin e vjedh imzot, Teberi.»

Patjetër, tha Bashmeta me vete. Patjetër. Një lopë vendi, e një race me të tjerat, tërë ditën s'kullot dhe mezi zvarrit këmbët e pasme të shqyera nga gjinjtë e madhuar, demos që kullot zahire tjetër. Kullot bukë. Bukë nga magazina. He, ç'ha goja, e tregon boja! E tregon shtati i madh dhe barku i rënë përdhe i derrit, e tregon shëndeti i tyre. He! Dhe fshatarët e mi më thonë: *Shihna! Ja tuk jemi!*

Ja tuk jemi! Ngrihemi herët dhe shkojmë në punë. Vijnë në mbrëmje nëpër shtëpi dhe rregullojmë lopën, dhe derrin, dhe pulat. Mblidhemi pastaj dhe gjejmë edhe kohë të këndojmë. Dhe themi: Ja tuk jemi! Eja, Bashmetë, këtej! Eja, se Teberi s'të do! Ai të thërret për vete. Të ngre ledh, që ne ta kemi vështirë dhe të mos e kapërcejmë dot për ta goditur. Kështu vepron ai. Dhe është munduar që t'i rrëmbejë të mëdhenjtë e rrethit në shtëpi. Domosdo, s'ia ka arritur dot kësaj. Dhe tregohet bujar me darkëra e drekëra. Ato darkëra e ato drekëra janë tonat, malli ynë, djersa jonë. Ai ua shtron

si djersë të tij. Ja, kështu, Bashmetë! Teberi ka mësuar djallëzi të madhe në këta vjet dhe të miklon. Ai është grackë. Të lëvdon. Oh, si e përdor ai lëvdatën! Të thur edhe këngë: Oh! Vërja veshin mirë këngëve të tij! Janë pa shpirt. Pa shpirt. Bashmetë, ke ecur shumë në jetë dhe ke luftuar. Ke punuar me ndershmëri, pa e ngritur kokën. Po të shikoje një çikë më me vëmendje, që ta dalloje hileqarin. Ai shfaqet lloj-lloj. Të zbulosh, të godasësh një hileqar të madh, patjetër që është diçka më shumë sesa të ngresh një harkore katërtonëshë. Më tepër. Unë, Luke Fagevaruri dhe...

Bashmeta uli dhe ngriti me mundim qerpikët e trashë. Ç'binte ashtu mbi fytyrën e tij? Gjëmë?
Lot apo shi?

Njerëzit punojnë me oh, o Teber qeni, punojnë që e ardhmja të ketë më pak hidhërime dhe akoma më shumë lumturi. Po ti bën keq. Ty të ka ngjallur botë tjetër këtu. Ti sjell fatkeqësi. Mor, po pse kështu, me bot e me qit që të prishësh të mirën, të bësh të ligë?! Pse... Tani në pleqëri, ky copë vend, këta drurë, ky fshat ishin diell për mua. Të çlodhem ca. Po ti del dhe bën hije. Ptu! Pse e zë diellin e njeriut të dheut? Që të hash badihava! që të rrëmbesh punën e tjetrit dhe të pish e të vishesh pa djersë?!

Bashmeta po lagej. Shiu murmuriste i përgjumur nëpër drurë. U përkul dhe shtuposi llullën me duhan. Ndaj e kanë shpikur duhanin, tha ai. Ka pasur hidhërime njerëzia!

Ai tani e besoi këtë hidhërim dhe hidhërimi i rëndonte aq shumë, sa e tërë qenia e tij dëshironte të braktisej nga jeta, të humbte diku në thellësinë e fjetjes së gjatë, diku në gjumë borërash.

Bashmeta vërtet ndjeu një jetimëri të rëndë e të madhe.

Kur hynë në fshat, lopët filluan të nxitonin. Kujtonin grazhdin, ujin me kripë dhe krundet apo viçin. Patjetër.

Bashmeta hyri në shtëpi dhe përpara i doli macoku. Ai iu fërkua te këmbët dhe i priu për te dhoma e zjarrit. E shoqja i mori trastën dhe i foli diçka. Por ai s'iu përgjigj. Ai vazhdonte të ishte i shqetësuar dhe ky shqetësim po e zemëronte edhe më shumë.

— Je lodhur? — i tha e shoqja pastaj.

— Lodhur jam, — tha ai.

Ajo vuri xhezven e kafes në zjarr. Bashmeta piu kafen dhe u shtri te krevati pranë dritares. Drodhi duhan dhe pinte me etje.

— Nuk dua bukë, — i tha gruaja.

Ajo e shikoi e shqetësuar dhe i tha që t'i fliste motrës të vintë.

— Jo, — tha ai. — Lërmë rehat, s'kam sëmundje.

Gruaja s'foli më. Ai tha shkurt dhe prerë:

— Le të vijë *kush* të dojë. I thuaj që s'jam këtu. *Kush* të dojë.

— Mirë, o burrë.

Te porta përjashta trokiti dikush. Gruaja doli.

— Jam unë, Teberi, — tha ai që ishte tej parmakëve.

— Hë?

— Bashmeta pranë zjarrit është?

— ...

— Bashmeta, moj!

— Ka dalë, — tha gruaja. Ajo foli e shushatur.

— Ku? — pyeti ai.

— S'di.

— E gjej vetë, — tha ai.

Plaka dëgjoi këmbët e tij që nxituan. Bashmeta pinte duhan, rrinte në dritare dhe dëgjonte kumbimin e erës. Rrudhat iu bënë më të forta dhe ai, fare pa kup-tim, ngriti lart pëllëmbën e verdhë dhe e mbështeti te xhami.

Përsëri dikush trokiste nga përjashta.

— S'jam këtu, — i tha Bashmeta së shoqes.

Plaka zbriti shkallët me përtim.

— Jam unë, Teberi, — tha ai që ishte tej parma-këve.

— Hë, — mermëriti gruaja.

— U kthye Bashmeta?

— ...

— A u kthye Bashmeta?

— Jo.

— Jo?!

Plaka s'u përgjigj.

— Po ç'u bë?

— Ka dalë.

— Ku?

— S'di.

— Hë, — ia bëri ai.

Gruaja ndjeu frymëmarrjen e tij të thellë, pastaj një psherëtimë dhe Teberi tha:

— Mirë, mbase e gjej.

Ai iku sikur u zvarrit.

— Teberi, — i tha jo Bashmetës kur hyri brenda.

Bashmeta zbriti dhe nxori diçka nga bufeja e ku-zhinës. Atë çast fshati i dukej si vend i ftohtë. Tmer-rrisht i ftohtë.

U ul pranë vatrës dhe nisi të shkundte gota me raki njëren pas tjetrës. Pastaj u ngrit dhe të dy me të shoqen u mbuluan me jorganin e madh dhe me një velenxë. Plakën, më në fund, e pushtoi gjumi dhe nisi të gërhiste.

Bashmeta lëvizi dhe mbështeti bërrylat te parvazi i dritares. Iu bë sikur dëgjoi të lehurat e kopesë së qenve, që ishin zgjuar përnjëherësh. Kështu qëllon, kur ata ndjekin bishën, domethënë Teberin.

Teber, Teber!... Këtu kisha lumturinë time të fundit, që e ruaja thellë. Pse ma helmova? Pse helmon lumturinë e njeriut? Pse nuk e lë botën të urtohet?

Bashmeta e ndiente veten helm e vrer dhe pinte duhan duke u menduar. Pinte duhan. Pi helm dhe mendohem, tha me vete.

Ai vrugoi ballin dhe qau. Përjashta, në çatinë e kasolles dhe në shtegun e kopshtit xixëllonin yjet. Ishte qetësi. Gjithçka kishte vdekur. Kishte vdekur prej kohe rropama e shiut, kishin vdekur vrundujt e erës dhe të lehurat e qenve të fshatit.

Gurgullonte vetëm diçka nëpër grykën e madhe të Bashmetës.

Në mesnatë ai ende ishte zgjuar. Atëherë kudo, sipër në zabel dhe nëpër kopshtet, qe ngulur acari. Bashmeta ndiente dhembje të rëndë diku prapa kokës. Kjo për shkak të zemërimit të madh. Kishte rënë në kurth. Jo vetëm kaq. Jo vetëm kaq. Në kokën e tij, në tru, në ndërgjegje, kudo po rrëtej me të shpejtë ajo që Bashmeta s'ia donte emrin: Ishte përballur me njeriun që s'e donte socializmin. Dhe ky pati qenë miku i tij. Nga tërë njerëzit që njihte në atë fshat të vogël të dashur, nga tërë fshatarët e tij, një ditë Bashmeta, po ta lypte nevoja, atij njeriu që kishte emrin Teber do t'i thoshte: Urdhëro, po ta lë fshatin, të bukurin tim, ma ki kujdes. Se derdhëm gjak e vuajtëm për të. Se në socializëm njeriu i thjeshtë e i vuajtur lind dhe që këtej vete atje, në komunizëm.

Po sikur tani të vinin shokët e tij punëtorë dhe t'i thoshin: E, o Bashmetë, pse ky syleshllëk? E?!

Po Bashmeta... Bashmeta vuante nga e meta e fshehtë e tij, nga ajo e metë që duhej qëruar.

Kishte dalë hëna. Ajo bënte t'i shkëlqenin lotët e mbetur mbi faqet e zhubrosura dhe buzët e lëshuara e të mavijosura. Pastaj pllanga e verdhë e saj ra pas kokës së tij, se fytyra iu këput e tëra te parvazi i dritares.

VI

Bashmeta lëvizi nëpër dhomë dhe u koll. Ai u mundua ta përzinte shqetësimin, që tani i dukej sikur i mbushi të dyja dhomat e shtëpisë. Po gjithçka ishte e pikëllueshme.

Përballë tij, në pasqyrë, doli mjekra e parruar e përzbardhur. Ai qe dobësuar përnjëherësh dhe s'i ngjante më vetes.

Ktheu kokën me rrëmbim dhe deshi të bëhej me gaz.

— Kafe, grua, — tha ai.

E shoqja e shikoi në sy pa lëvizur, sikur ta pyeste.

— Po bukë, do hash? — i tha ajo.

— Vij më vonë.

— Sot s'shkon me lopët?

— Janë kthyer burrat e fshatit? — tha ai.

— Janë kthyer. — Ajo u gëzua nga dialogu.

Bashmeta piu kafen dhe hapi derën.

— Grua!

Ajo i ndenji përpara dhe e shikonte drejt, me kokën të hedhur pas.

— Ç'kujton, se është i lehtë socializmi? U plakëm ne dhe ai u ngrit, u ndërdua? S'kemi punuar aq mirë, domethënë me mend, o grua!

E shoqja picërroi sytë dhe përpëliti buzët me rrudha.

— Ai Teberi është gjë e ligë.

— Ehë, i lig, kam dëgjuar për të, — tha ajo. — I lig, po s'të kam thënë, se... thashëthemet...

— Ke dëgjuar që vjedh?

— Ngriti bereqetin dhe e futi në shtëpi, hedh ditë pune të mëdha në librezë ai. Sëmundë e ligë. Dhe kush e tregon vjedhjen e tij, duhet ta pësojë. Kështu tund gishtin?!

— Hë! — ia bëri Bashmeta.

Atij iu kujtua librezë e kursimit. Hapi valixhen, e nxori dhe e futi në xhepin e brendshëm të xhaketës.

Doli në oborr. Një krah ere me pika të rënda uji e gjethe të kalbura i goditi fytyrën.

Përrashta portës një çift gomarësh qëndronte pa lëvizur. Tek udha përskaaj pellgoreve dukej një cipë e hollë akulli. Opinga e madhe e Bashmetës shkelte pa mëshirë mbi guricëkat e udhës. Ndonjë guricëkë kërcente duke rënë mbi rripin e xhamtë të akullit dhe akulli i thyer kumbonte. Fluturonin zogj që cicëronin të shqetësuar. Katër kuaj rrinin në anë të udhës, të ngjeshur pranë njëri-tjetrit.

Te Sheshi i Burrave dëgjoheshin biseda me zë të lartë. Bashmeta çapitej për atje. U dëgjua vetëm një zë. Zëri i Teberit. Ai kundërshtoi dikë dhe heshti, sikur të thoshte: Të vrava me një fjalë të vetme, me një frazë.

Një burrë nga të fshatit tha:

— Ama, zure me dëngla ti. Akoma do të na mbrush brumë të tillë?

Atëherë arriti Bashmeta dhe burrat lëvizën e i bënë shteg. Atje më tej ishte një «Gaz» i vogël me mbulesë ngjyrë jeshile.

— Kush ka ardhur? — pyeti Bashmeta.

— Unë, — tha një burrë dhe i shtriu dorën.

Në të vërtetë ai po e shikonte që në fillim, po Bashmeta s'e vuri re.

— Jemi parë, — tha Bashmeta.

— Vetëm dy herë, — tha ai. — Unë tani kam ardhur këtu.

- Ç'ke punuar?
 — Motorist.
 — Edhe unë punëtor kam qenë, — mërmëriti Bashmeta.

Motoristi, që ishte zgjedhur rishtas sekretar i byrosë së partisë të kooperativës, u skuq. Një grua prapa tyre thirri fort «mirëmëngjesi» dhe qëlloi edhe një herë lopën te vithet. Lopët po grumbulloheshin pak nga pak te Sheshi i Burrave. Ato ishin mësuar dhe rrinin atje për-anash, ose edhe midis burrave.

Bariu i tha Bashmetës me zë të ulët:

— I ngjite sipër në zabel?

Bashmeta s'foli. Teberi tha:

— Ohu, ato kishin kullotur, ishin bërë dyshek. Po pati ndërgjegje, njeriu bën mrekullira.

— Ç'ndërgjegje, ore!? — shfryu Bashmeta dhe s'e shikoi drejt.

U bë heshtje. Një lopë buluriti. Një viç atje poshtë, i lyster me bajga te barku, avullonte dhe munguriste. Viçit i foli plakë Laçja sikur t'i fliste një njeriu.

— Po mirë jeni andej, shoku sekretar? — tha Bashmeta.

— Falemnderit, — tha sekretari. — Falemnderit, mirë.

— Qofshi mirë, — tha Bashmeta. — Po ne këtu na vjedhin dhe jemi syleshë. Ja, ç'punëtor jam unë!

Sekretari i byrosë së partisë të kooperativës e shikoi drejt në sy Bashmetën.

— Këtu vidhet, — tha Bashmeta.

Fjalët e tij kumbuan si shpallje lufte.

— Hi, hi, hi, — bëri bariu i lopëve personale.

Heshtje.

— S'është për të qeshur! — foli Teberi me nxitim dhe rregulloi jakën me gëzof si krifë bishe. — Ç'qesh me njeriun e ndershëm, që vigjilon për të mbrojtur socializmin? A ka gjë më fisnike? Kjo është punë, ja kush të fisnikëron!

Bashmeta lëvizi shpatullën e majtë dhe fytyra iu

thartua nga një shije e ligë. Ai psherëtiu. Midis burrave, te trualli bosh, hyri qetë një lopë. Pas saj hyri lopa tjetër. Kjo ishte lopa e bukur, e bardhë, me bri të thyer, e Teberit. Teberi donte ta trembte, po Bashmeta shtriu krahun dhe tha.

— Lëre, Teber, lëre bagëtinë.

Nuk lëvizi Teberi.

Bashmeta heshti. Sikur akoma po tretej njëherësh. Po dridhej. Po dridhet, tha me vete Luke Faqevaruri dhe i erdhi ligisht. Se pse! Po dridhet Bashmeta.

— Kam një librezë kursimi, — tha Bashmeta. Ai nxori nga xhepi i brendshëm i xhaketës librezën e kuqe të kursimit. — Sa e çmoni atë lopë? — tha ai pastaj dhe fytyra iu shtrembërua edhe më.

S'foli njeri. Dikush vuri dorën grusht në gojë dhe u koll.

— Sa e çmon atë lopë ti? — i tha Bashmeta një burri nga fshati.

Bashmeta tregoi me gisht lopën e bardhë të Teberit. Ajo ishte katër pëllëmbë më tej dhe rrinte e përgjumur sikur të mërzentë.

— S'ka të çmuar, — tha fshatari. — Vetëm ajo lopë këtu s'ka të çmuar. Asaj i ndrit qimja si tel!

— Tridhjetë mijë lekë të vjetër, — tha Bashmeta.

— Edhe dyzet mijë, pa frikë dyzet mijë, — tha fshatari.

— Në një shtëpi tjetër ajo s'vlen as njëzet mijë lekë, — tha Luke Faqevaruri.

— E pse? — pyeti sekretari i ri i byrosë së partisë të kooperativës.

— Se shtëpitë e tjera nuk kanë magazinë me drithë dhe nuk e ushqejnë dot badihava.

Fytyra e sekretarit u shtrembërua.

— Unë e paguaj gjashtë mijë, domethënë gjashtëdhjetë mijë lekë të vjetër, — thirri Bashmeta. Zëri i doli i ngjirur dhe me gurgullima. Sytë iu egërsuan edhe më dhe ai flaku librezën e kursimit. Ajo goditi bririn

e pathyer të lopës dhe u rrëzua te trualli i lagur. Lopa e shikoi pjerrtas me mospërfillje.

— Merreni, — tha. — Aty kam dyqind mijë lekë.

Zëri i Bashmetës ishte tmerrësisht i rreptë. Askush nuk lëvizi që të ngrinte librezën. Deshi të lëvizte Teberi, po Bashmeta e shikoi me tërbim dhe ai s'lëvizi.

— Të theret tani, — ulëriu Bashmeta. — Të theret dhe do të provohet se kjo bagëti ushqehet me drith populli, dhe do të provohet pa një pa dy se ajo shtëpi vjedh. Vjedhin burrë e grua. Ja, ky miku këtu... jazëk!

Bashmeta tha *jazëk* sikur të pështynte Teberin. Po Teberi ngriti lart njërën vetull. Ajo vetull ishte e paturpshme dhe ngrihej lart ashtu paturpësisht.

— Nuk kam luajtur nga mendtë, — tha Bashmeta me zë më të shkoqur. — Po mbani vesh e thereni këtë lopë dhe, në gënjejfsha unë, e paguaj gjashtëdhjetë mijë të vjetër. Ja, kështu. Topi s'e luan.

— Bash-me-të, mbaj gojën, — tha Teberi me njëfarë hovi. Po ai hov i ngjante trimërisë së mundur e të dëshpëruar.

— Hë! — ia bëri Bashmeta.

Po lopa, ajo lopë e bardhë me njërin bri të thyer e qime të shndritshme, sikur të kishte ndër se bëhej fjalë për të dhe mund ta thernin për ta parë se ç'kishte në bark, ngriti pak bishtin dhe ata shikuan se si doli avull nën bisht, pastaj shikuan se si, qetë-qetë, bajgat ranë përtokë, dhe afshi i freskët u përhap.

— Ja! — thirri Luke Faqevaruri. — Shikoni kokrra të papërtypura në bajgë! Iku, Teber, kësaj here e hëngre. S'të shkon më gomari në udhë.

Kokrrat e vogla të misrit dukeshin sikur qeshnin, gjithë gaz që patën mundur t'i shpëtonin ripërtypjes dhe dolën përsëri në dritë.

— E kam nga misri im, — thirri Teberi.

— Ti s'pate mbjellë misër, — i tha një fshatar tjetër.

— Pata mbjellë vjet.

— Mos gënje!

— Akoma ti?! — tha sekretari i byrosë së partisë të kooperativës. — Akoma? Do të ta provojë fshati në kishe mbjellë apo jo? Do të ta provojmë se ke livadhësuar shumë kështu poshtë e lart.

Teberi përsëri donte të fliste, po Luke Faqevaruri tha:

— Ky është kulak.

Një breshër i tërë talljesh dhe kërcëllimash.

— Gjë e pistë! — mërmëriti Bashmeta. — Ndyrësi!

Foli një fshatar i heshtur:

— Mos nxitohemi, o burra. Kështu gabojmë përsëri.

— Ashtu thotë edhe mendja ime, — pëshpëriti një tjetër më tej.

— Pse nxitohemi? Poo, e shpjegoj unë. Ne s'dëgjojmë për herë të parë që ky Teberi livadhës e vjedh. Nuk dëgjojmë për herë të parë. Kemi folur edhe vesh më vesh me njëri-tjetrin, por ama s'e kemi thënë fjalën si duhet e ku duhet. Neve s'na kanë munguar mbledhjet e brigadës, të fshatit, domethënë. Pse atëherë s'e kemi ndalur Teberin?

— Pikë. Kjo s'është pa vend.

Ata nisën përsëri të flitnin secili më vete me zë të lartë ose dy e dy.

Sekretari i ri i byrosë së partisë të kooperativës dëgjoi me vëmendje, pastaj u përkul, ngriti librezën, e fshiu dhe ia zgjati Bashmetës. Bashmeta i rrëmbeu nga dhëmbët dikujt llullën e ndezur dhe e futi në gojë të vet. Ishte bërë tepër nervoz.

— Fol, — i tha sekretari i byrosë së partisë të kooperativës Teberit. — Hë, fol! Tani ç'shteg do kërkosh për të livadhësuar?

Teberi prapë donte të fliste, po disa burra folën njëherësh dhe prapa tyre plakë Laçja tha:

— Do që të na kthejë kohët e para. Hë, more, ç'burra jeni, shtrijeni poshtas që të vijë e ta përmjerrë ky demi i lopëve. Hë, more. Hë, ikni e i zbuloni shtëpinë. Dhe na u ngrit njëherë vitin që shkoi e donte

të bënte veten e tij si kryetar këshilli. Pika, o ditëprerë, pika! Përmirreni!

Goja e Teberit u mbyll si me tapë. Nëpër flegrat e hapura të hundës vërshëlleu era.

Bashmeta iku çap-çap. Pinte duhan dhe ndenji një çast i vetmuar prapa shtëpisë, nën pullazin pakëz të anuar. Qe ulur mbi një vandak drush të lidhur. Nëpër mugun e tymit të duhanit iu përçqas fytyra e Nebiut, e shokut të fëmijërisë, që që vrarë në Luftë. Buzët e asaj fytyre lëviznin dhe këndonin. Këndoi një zog me nxitim. Zogu i borës, tha me mend Bashmeta dhe u ngrit e hyri brenda në shtëpi.

Gruaja kishte dalë. Ai u ul pranë dritares dhe shikonte përjashta. Sikur po më zihet fryma, mendoi dhe çeli njërën kanat. Brenda vërshoi ajri i freskët i fshatit të tij të dashur. *I bukuri im!*

Bashmeta foli me vete me zë: I tillë ajër shëron edhe fyerjet më të mëdha. Ëhë! Ja, jam... domethënë, kështu, sipas mënyrës sime, unë jam socializëm, domethënë... e dua socializmin me shpirt e me gjunjë. E kam fjalën se tërë mendja dhe uxhuti im, domethënë... qenia ime, janë socializëm. Kështu e di unë. Në këtë perëndi kam besuar nga Lufta e këtej. Domethënë në socializëm, për socializmin. Po del Teberi e ma vjedh... Ç'të bëj!... Ç'të bëj!... Të luftoj që të mbroj veten dhe... socializmin.

Luftë e madhe! Gjak i madh duhet akoma, se luftohet për lumturinë e të gjithëve. Unë s'mund të ndahem nga këta.

Përjashta këndonte një zog dhe dridhej. Po çelte pranvera! Binte borë. Ajo vinte e qetë dhe e ëmbël. Disa gala krakërinin dhe silleshin si re mbi majat lakuriqe të qershisë. Krakërin Teberi, tha Bashmeta me vete. Ndjell mot të keq.

Dhe binte borë. Ajo fluturonte vëngërthi me flo-

këza të bardha si lule të brishta me qoshe. Toka tani do të niste të çlodhej poshtë nën të; do të flinte...

Ai dremiste. Dhe shkundeshin lule të bardha. Nën qiellin e fshatit të tij të dashur. Njëpër flokët e përzier të tij.

Pranë dritares, te një degë, u ul dhe u ngrit një zog. Ai shkundi borë të freskët dhe bora vazhdoi një copë herë të përhapte grimca pluhuri. U pluhurosohemi i dritares, flokët dhe një pjesë e shpinës së Bashmetës.

Ai ndjeu ujë në qafën me rrudha të mëdha. Lëvizi dorën e madhe dhe u përmend. Eh, ia bëri. Pas dëborës do të buçasë dhe do të pastrohen qiejt.

Në shpirtin e butë, të bardhë e lirik, krejt si të një fëmije, të Bashmetës, atë kohë ishte zbuluar përsëri dashuria e zjarrtë dhe e furishme për jetën dhe njeriun, për fshatin dhe drurët, për çatitë, kopshtet dhe udhët... Njeriu i moshuar te dritarja shihte pranverën, shihte me sytë e mendjes se si nxitonin drejt fshatit punëtorët, shokët e punëve të tij, të përhapur andej-këndej. Ia donte shpirti. Edhe pranverën, edhe atë ndërgjegjen e klasës. Ajo po, ajo bën punë të mëdha, mëmëriti Bashmeta.

Ai ndjeu se u bë i madh, duke kujtuar këto pas kaq kohe.

Po, tani vërtet, ai ishte bërë më i madh dhe çast më çast shikonte më rreptë përqark. Do të shikonte më rreptë. Më me vëmendje!

Ndërsa pranvera vazhdonte të vinte së pari me tu-fëza bore, pastaj me degët e thata të thyera që u zbuluan, me gjethet e palosura, të ndryshkura e të zeza, të rëna nga viti i kaluar dhe.... Çelja e kaçeve të para, çelja e aguliceve.

Kumbonin përrenjtë gjithnjë e më fort, kumbonte zabeli dhe nga lajthitë po përhapej poleni i verdhë. Po trokëllinin lulet dhe këndonte qyqja. Po...

Atje nën mur ngrihej ajo qershia plakë. Edhe mbi të binte dëborë. Dëborë mbulonte degët e shtrira e të

shtrembra. Në pranverë ajo qershi do të lëshojë nga korja gjethëzà të buta... Tani në pranverë...

Të dua, o vend i bekuar, të dua! Qofsh me diell, qofsh me dimra. I bukuri im, të dua!

Dikush shtyu portën, ngjiti shkallët dhe shtyu derën. Brenda hynë e shoqja, sekretari i byrosë së partisë të kooperativës dhe dy fshatarë.

— Bie borë, — tha njëri nga fshatarët.

— Bie, — tha Bashmeta dhe u ngrit. — E shikoja nga dritarja dhe më dukej sikur binte pranverë mbi fshat.

Bashmetës i kishin bujtur të tjera mendime dhe shpirti i tij i tëri nisi të ndiente hove fisnike. Sytë po i zbukuroheshin nga emocioni.

Matanë zhuzhuriti diçka. Njëri nga fshatarët tha:

— Pas ca të ngrihemi e të shkojmë, se do therim derrin tim.

Bashmeta ngriti mjekrën dhe fytyra e tij tregoi dëshirën për të ecur nëpër fshat, përjashta.

Ai qe si një fëmijë zemërpastër.

FSHATARI DOKE

Kur qeni madhohej aq sa të kuptonte pse duhej të jetonte në shtëpinë e të zotit, edhe Dokja e kishte gjuar në bënte ai qen apo jo. Fshatari s'i vriste qentë që nuk i pëlqenin. Kur e kuptonte se qeni nuk bënte, ai e mërgonte, e faltë diku. Vononte kohë derisa të gjente dikë për t'i dhuruar qenin. Kjo e mundonte shumë.

Me qenin e fundit ai ishte ngjitur dy herë rresht në fshatin fqinj. Herën e parë nuk ia pranoi askush. Herën e dytë e la te shtëpia e një marangozi, po, ndërsa kaptonte shtegun e oborrit, qeni lehu sikur ta kishte kuptuar që i zoti e kishte braktisur përgjithmonë. Kështu leh një qen, i zgjuar, tha me vete fshatari. Po qeni nuk lehu më.

Fshatari thuri duhan dhe doli nga fshati, duke e braktisur në të djathtë. Në vesh i kumboi e lehura e genit.

Ai hyri në pyll dhe humbi midis drurëve për të prerë dy furka të gjata, të cilat do t'i ngarkonte natën në mushkë. Aty binte erë lagështi. Poshtë, nën degët e një

dushku, pylli ngatërrohej nëpër murriza dhe diku në një shtuf fshatari dalloi kulmak. Patjetër që këtu qan ujë, tha me mend. Zbriti edhe dy çape dhe poshtë, në të shkarën e lugut, hyri në pellgore me ujë. Fshatari u përkul pranë pellgores dhe baltës blu të murrëtyer të shtufit. Ai ndiqte me kujdes gjurmë kafshësh. Pas pak e kuptoi se aty kishte pirë ujë kopeja e derrave të egër. Ai ishte një pyll i madh me dushqe dhe drurë të tjerë, që zbriste gjer poshtë në një përrua të fshehur me rrape. Në të kaluarën aty kishte pasur shumë kope derrash dhe tani, gjithashtu, banonin derra të egër. Vonë, në vjeshtë, ata zbrisnin në fushë dhe bënin batërdi në arat me misër. Zbrisnin në fushë vetëm natën dhe ndaj të gdhirë ngjiteshin përsëri në pyllin e madh e të ngjeshur, të mbushur me mistere. Në atë pyll sundonin dushqet, ndaj kishte lënde dhe derrat e egër dimëronin aty. Ndaj atëherë, në vjeshtë, fshatarët zbrisnin në fushë, pranë arave të tyre dhe ndiznin zjarrin e prisnin sulmin e kopesë së derrave.

Fshatarit iu kujtua Pelo Gaxhi. Për të trembur derrat e egër, ai ndërtonte një aparat të çuditshëm: merrte një kungull të madh uji dhe e shponte nga të dyja anët. Nga fundi kungullin e mbyllte përsëri me një copë lëkurë keci dhe diku, te lëkura e kecit, ia lidhte një spango. Spangon e tërhiqte që brenda kungullit dhe e nxirrte te vrima tjetër. Pas kësaj ai e vendoste *aparatin* e tij sipër mbi një dru të lartë dhe herë pas here tërhiqte spangon. Pikërisht atëherë përhapej një zhurmë e gjatë ulëritëse që të trembte, e cila dëgjohej në thellësi të fushës e gjer në grykën e përroit që humbiste midis rrapeve atje, në kufi me murrizat e dushqet. Natën vonë, kur Pelo Gaxhi shtrihej pranë zjarrit që të flinte dhe mbulohej me velenxë, ai e lidhte te qafa e këmbës fillin e spangos. Dhe gjatë natës, kur ai lëvizte, kungulli i ujit lëshonte nëpër ajrin e lagështitur zhurmën ulëritëse e ngjethëse.

Megjithatë duhet qeni, tha Dokja me vete. Dikur fshatari kishte pasur një qen tjetër dhe atë ia kishin

çarë më dysh derrat e egër. Kështu i kishte ndodhur edhe Koto Gjobarit. Edhe ai kishte pasur një qen të fuqishëm që i ndiqte derrat larg, shumë larg. Po një mëngjes, në agim, ai nuk u kthye më. E kishin shqyer derrat pranë zallit të bardhë, kur do të kaptonin përroin.

Njeriu kujtoi këto dhe u ndje i vetëm. Atij i dhembti brenda kafazit të gjoksit që nuk kishte ende një qen dhe që këtë çast, në këtë pasdite vjeshte, u ndodh i vetëm, i humbur diku në thellësi të pyllit. Ai ngriti sëpatën dhe shikoi buzët e saj të mprehura. Nga një kope me derra të egër, po të mos e humbasësh toruan, mund të mbrohesh edhe me sëpatë, tha fshatari.

Atij iu kujtua se dy vjet më parë dhjetë veta nga fshati i tij ishin ngjitur në mal për të gjuajtur derra. Qentë e tyre kishin zbuluar dy dosa me këlyshë, që në fshat u thoshin bicunë dhe i kishin nxjerrë nga pylli. Gjahtarët kishin qëlluar në të dalë të shtigjeve dhe në pjerrësinë e malit, Telo Kalami kishte rrëzuar me sëpatë dhe e kishte çarë në shpinë një derr të vogël. Derri peshonte njëzet kile. Atë natë në fshat gjashtë derra të vrrarë.... Fshatarit iu përhi në sy ajo natë, muzgu, fshatarët përçark oborrit të Mako Dushit, derrat e shtrirë, të çarë gjatas në bark, gjaku dhe qentë që hungërinin e ngatërroheshin midis njerëzve.

Sidoqoftë unë duhet të kem një qen, tha përsëri fshatari. Ai ishte përkulur dhe nxitonte midis drurëve që të dilte sa më parë nga pylli. Çuditej edhe vetë se si ashtu pa u ndier kishte zbritur aq thellë në pyll.

Kur doli në krye, u mbush me frymë dhe shikoi në të katër pikat e horizontit. Në veri dhe në perëndim vija tek pikëzohej horizonti ishte shumë pranë. U ul dhe thuri një cigare. Si e mbaroi, u ngrit, preu dy furka dhe i nxori më tej, midis sfakave, atje tek mbaronte pylli. Frynte erë e ftohtë që të jepte dridhma. Zogjtë cicërinin dhe fshihnin qafën nën krahët e brishtë.

Pastaj nxitoi për në fshat. Qielli i zi ishte i vrazhdë e i ulur. Bregoret ishin të zhveshura, pa pemë. Duke-

shin të zbrazura e si të vdekura. Ashtu, midis tyre, ato të ngjallnin ndjenjën e njeriut të vetmuar.

Ai vazhdoi të ecte poshtë nën qiellin dimëror. Pas ca dalloj megjulla tymi dhe një çast përfytyroi fshatin në ditët e luftës. Ato ditë nuk ishin shumë larg. Atëherë fshatin e dogjën. Tani secili atje kishte ngritur shtëpinë e vet dhe fshatarët i qenë përveshur punës me një zell të paparë, që të punonin arat, të ngrinin lesat, të rregullonin muret dhe të mbillnin pemë.

Fshatari Doke i donte shumë pemët. Tek kujtonte pemët e reja që do të mbulonin kopshtin, ngrohej i tëri. Ai tani kishte ara dhe një kopsht të madh. Kopshtin e kishte përçark shtëpisë. Ditën punonte në ara dhe në mëngjes herët e në mbrëmje deri vonë ngrinte muret e kopshtit. Vazhdimisht mbillte pemë. Atij i qëllonte të shkonte diku në një fshat larg apo në qytet. Që andej patjetër që do të sillte fidanë. Shumë prej pemëve që mbillte, nuk ishin rritur ndonjëherë në fshatin e tyre. Fshatarët e shikonin me mosbesim kujdesin e Dokes për to. Nuk bëhen këtu thoshin ata. Ata ishin mësuar me atë paragjykim, duke kujtuar se toka e tyre bënte vetëm fiq të zinj, rrush debin dhe një lloj rrushi tjetër, që i thoshin razaki. Veç kësaj, ata e quanin punë pa dobi të merreshin në mënyrë të veçantë me rritjen e pemëve. Dikur në mbrëmje, në fund të vjeshtës apo në pranverë, ata çelnin gropa dhe mbillnin pemë. Vetëm kaq. Pas kësaj me ata fidanë të mbjellë s'merrej askush. Ata nuk i ujitnin dhe nuk i plehëronin në rrënjë. Qëllonte dendur që fshatarët t'i riçelnin gropat dhe të rimbillnin fidanë fiku apo shpatulla hardhish. Ndonjëri mbillte man, po atë e mbillte diku anës rrugës, gjithmonë në pjesën e kopshtit që shihte nga perëndimi apo në tokë djerr. Ishin të përgjëruar për tokë dhe nuk donin që në kopshtin e tyre të bëhej hije. Andaj nuk mbillnin arrë dhe shpesh qëllonte edhe të grindeshin me fqinjnin që mbillte pemë pranë gardhit.

Tërë kujdesi dhe pasioni i fshatarit ishte që të mbillnin misër dhe grurë.

Para Çlirimit ata kishin qenë të varfër dhe punonin në tokat e agait. Tani tokat ishin të tyre dhe ata kultivonin aty dy bimë klasike: misrin dhe grurin.

Po fshatari Doke edhe poshtë në fushë, anës arave, mbillte fiq. Megjithatë deri tani atje s'ishte rritur asnjë rrënjë fiku. Në vjeshtën e fundit, kur ishte vjelë misri, gardhinat shkeleshin dhe nëpër ara hynin bagëtia. Bagëtia qëmtonte kallamishtet, rrënjët e zverdhura të kostrevës dhe barërat e tjera. Ato hynin pa kujdes nga njëra arë në tjetrën dhe shkelnin ledhet ku Dokja kishte mbjellë fiq, kështu që s'ishte rritur asnjë fik.

Shtëpinë e tij Dokja e kishte ngritur në fund të fshatit, në mes të një qopshti të thurur. Më parë, në atë anë s'kishte pasur asnjë shtëpi. Këtu nuk bëhen pemët, i thoshte e shoqja. Ai e kishte parë të shoqen me inat dhe kishte vazhduar të çelte gropa. Balta ishte gëllmaç, e kaltëryer. Nuk bëhen pemët në këtë shtuf, thoshin fshatarët. Po ai punonte. Ai ishte tepër i kujdesshëm dhe këmbëngulës. Për këtë kujdes dhe këmbëngulje të Dokes në fshat qarkullonte edhe një epigram. Fshatari Doke kishte vazhduar të merrej me pemët. Hardhitë rriteshin të holla e të pamundura. Kjo e trishtonte atë. E shoqja thoshte shpesh se u kishte takuar vend i keq. Mirëpo fshatari Doke s'donte ta pranonte që ajo baltë s'do të rriste pemë. E dinte se rrënjët e hardhisë, diku poshtë, duhej të gjenin rërë. Rëra e mbante të freskët gjatë verës. Mirëpo ai gërmonte shtuf. Kjo e pikëllonte fshatarin, megjithatë vazhdonte të punonte. Fshati kishte vetëm një çezmë dhe deri në kopshtin e tij nuk arrinte uji.

Ai kishte nisur të shartonte hardhitë dhe fiqtë. Në verë, deri në mesnatë, sillte ujë me kova dhe ujiste pemët.

Një ditë, në një fund dimri, iku nga shtëpia. U largua një javë rresht. Pas një jave u kthye. Në trastë kishte një rrënjë ulliri dhe një rrënjë portokalli. Fshatarët shikonin të çuditur. Këtu nuk bëhet ulliri, as portokalli, thanë ata. Vërtet që dherave të tyre s'ishin

parë kurrë bimë të tilla. Fshati i tyre ishte gjashtëqind e ca metra mbi nivelin e detit.

Dokja e mbolli ullirin prapa shtëpisë, ndërsa portokallin nga jugu, pothuaj ngjitur me murin e shtëpisë. Por atë vit dimri erdhi shpejt dhe papritur. Gjethet e portokallit u vyshkën, sikur t'i kishte përcëlluar flaka. Një mëngjes pema mbeti lakuriq dhe në pranverë nuk çeli. Kurse ulliri lulëzoi. Kur të më mbijë bari do të ha kokrra nga ai ulli, thoshte e shoqja.

Një ditë tjetër Dokja u largua përsëri nga shtëpia. Kur u kthye, solli me vete një qen dhe një rrënjë portokalli. Ai mbushi me pleh e baltë një fuçi druri dhe në të mbolli portokallin. Pastaj fuçinë e futi në katua, pranë një dritareje që shihte nga jugu. Kur bënte diell, ai e mënjanonte kashtën e thekërt, me të cilën mbyllte dritaren dhe rrezet hynin brenda. E shoqja tha se ishte çmenduri të besojë se mund të rritej pema brenda në katua. Po ai s'ndërroi. Qeni ishte i vogël, ngjyrë mjalti, me një pullë të bardhë në shpatullën e djathtë dhe në veshin e djathtë. Ai ishte shumë i lëvizshëm dhe kishte sy të gjallë. Fshatari e quajti Pirka. Ata të gjithë i flitnin Pirka dhe qeni ngrinte kokën me nxitim, i shikonte në sy dhe kuishte sikur t'i pyeste se ç'i kërkonin.

Pirka ishte qen femër. Kur i zoti dilte nga shtegu, ajo dëshironte ta ndiqte nga pas, por ai asnjëherë nuk e la që të kaptonte shtegun. Ti, Pirka, kthehu në shtëpi, i thoshte fshatari. Ti e ke punën aty, vetëm aty dhe, për të ndjekur derrat, s'je rritur akoma.

Fshatari i tregonte shtëpinë dhe qeni kthente kokën e shikonte murin dhe pullazet. Pastaj shikonte përsëri të zotin. Ai lëshonte pëllëmbën mbi kokën e saj dhe e porosiste që të kthehej në shtëpi. Pas kësaj qeni ulte kokën, varte bishtin dhe kthehej i bindur.

Për çudi, ai doli një qen i zgjuar dhe simpatik. Fshatari Doke kishte dobësi të madhe për të. Ai s'donte kurrësi ta përkëdhelte dikush tjetër Pirkën. Inatosej kur kalonin njerëz në rrugë dhe i thërritnin qenit në emër. Sipas tij, qeni duhej të shqetësohej vetëm kur i

flitnin i zoti ose njerëzit e tjerë të shtëpisë. Atij s'i lejohej njohja dhe miqësia me asnjë njeri tjetër.

Fshatari Doke bënte të gjitha përpjekjet që kafsha e tij të lehte kur i fliste në emër një i huaj dhe të kuiste e të afrohej kur e ndillte dikush nga të shtëpisë. Atë qen e donte shumë vajza e madhe, e donte e shoqja dhe akoma më shumë e donte i biri. Në fillim qeni ngjiste shkallët e shtëpisë, kuiste pranë derës si një i vogël dhe ata e pranonin brenda pranë vatrës. Më vonë fshatari i ngriti një kolibe. Koliben e ndërtoi me dërrasa brenda në katua, pranë fuqisë së portokallit. Qenin e mbylli aty. Në ushqim i hidhte piper. E ushqente vetëm dy herë ditën, në mënyrë që kafsha të edukonte një stomak të vogël dhe të mos rritej shumë. Ai dëshironte që qeni i tij të ishte i shkathët dhe i sertë. Pikërisht për këtë ia përziente ushqimin me piper djegës. Ai do t'i zemërohej kujtdo që mund t'i qëllonte qenin. Qeni ishte ende i vogël dhe s'duhej qëlluar. Një qen që rrihet i vogël, rritet frikacak. Këtë e dinte mirë fshatari Doke. Ai nuk e rrahu asnjëherë qenin. Fjalët që i thoshte ishin të menduara, të kursyera dhe disa prej tyre ia përsëriste.

Brenda në atë të ndarë katoi fshatari kujdesej për portokallin dhe qenin. Qeni sikur e kishte kuptuar këtë dhe jetonte pranë portokallit, si pranë një qenieje të gjallë. Kur hynte fshatari në oborr, qeni e ndiente dhe kuiste. Atëherë i zoti e zgjidhte dhe qeni i sillej për qark plot hove si një ëndërr. Fshatari ulej te kucuret e oborrit dhe thurte duhan. Qeni lëvizte pareshtur, largohej vetëm dy metra, po befas kthehej përsëri. «Pirka, këtu!» thërriste fshatari dhe zgjaste gjuhën për të lagur letrën e cigares. Pas kësaj ai ngrihej dhe rrotullohej nëpër kopsht. Pirka e ndiqte, duke iu ngatërruar midis këmbëve dhe lëvizte sa më shumë që të shpinte muskujt. Lëvizja për të ishte nevojë e pashmangshme.

Fshatari Doke rrotullohej në të gjithë kopshtin dhe anës gardhit. Pirka asnjëherë s'kishte dalë jashtë gar-

dhit. Ajo njihte mushkën e të zotit, njihte lopën, demin dhe pulat. Të gjitha këto flinin në të ndarën tjetër të katoit. Kur tej gardhit kalonte ndonjë mushkë tjetër apo një lopë e huaj, Pirka ngrinte kryet, kreshpërohej dhe hungërinte. Fshatari atëherë gëzohej pa masë. Qeni donte të kapërcente gardhin që të hidhej matanë, por i zoti s'ishte dakord.

Një mbrëmje ai i tha: Kape! Pirka u zgjat, u ngrit dhe fluturoi tej gardhinës. Ajo u qep në vithet e një lope që po kulloste anës ledhit dhe e kafshoi fort. Lopa u llahtaris nga befasia me të cilën e sulmoi qeni dhe qëlloi me brirë brinjët e saj. Ajo nxitonte e lemerisur. Po Pirka kishte futur dhëmbët, thellë te mishi i trashë i bagëtisë. Dhe, ndërsa bagëtia nxitonte, qeni qëndronte i varur te vithet e saj, duke tundur kokën e vogël me një inat e këmbëngulje të rrallë. Fshatari, atje te kopshti tej gardhinës, ato çaste u hutua aq, sa mezi mundi t'i thërriste qenit. Thirri dy herë: Pirka, Pirka! Pas herës së dytë qeni u rrëzua nga lopa, sikur ta kishin goditur me plumb drejt e në zemër, u bë rrafsh me tokën dhe vrapoi drejt kopshtit. Po rritej një qen me të vërtetë i çuditshëm. Ai fluturoi mbi gardhinën dhe ndaloi midis këmbëve të veshura me shajak të të zotit, duke kuisur nga inati e duke dredhur kurrizin. I zoti ishte ende i hutuar dhe shikonte tej gardhit. Në një gardhinë tjetër, pranë një vije, midis ferrave, u dëgjua një zhurmë si të kishin hedhur një thes të madh të mbushur dhe lopa buluriti me llahtarë. Tej murit të rrëzuar të kishës klithi një grua dhe, pas ca, atje tek buluriti lopa, arritën tre-katër burra dhe ajo gruaja që kishte vënë kujën.

Fshatarit Doke iu drodhën flegrat e hundës, iu njom balli dhe belbëzoi: Pirka! Ai i foli qenit si të kërkonte shpëtim...

Ai i gëzohej shumë qenit. Ëndrra e tij e lashtë kishin qenë: shtëpia e tij, kopshti i tij, qetë e tij, oborri i tij, qeni i tij. Dhe tani ai qen i kishte ardhur nga larg si një bekim.

Fshatari e dinte se lopa është bagëti e rëndë dhe, ngaqë u tremb, u rrëzua të vija anës ferrave. Ajo patjetër që u dërrmua. Dokja i donte shumë kafshët dhe drurët. Ajo lopë ishte e Nase Ksenos. Në mbrëmje Ksenoja heshti, po në atë heshtje ndihej pabesi. Nase Ksenoja ruante ndaj tij një armiqësi të pazbutur. Kur shteti ynë i ri grumbullonte tepricat e drithërave, Nase Ksenoja e fshehu drithin. Fshatari Doke e denoncoi dhe një ditë, kur kthehej nga mulliri, Nasja nuk i foli, po lëvizi sëpatën që kishte në bërrylin e majtë të thyer përgjysmë. Me këtë donte të thoshte se ata të dy i ndante vetëm sëpata. Po Dokja i fliste vazhdimisht. Ai ishte i pajisur me urtësinë e Solomonit.

Ra nata. Përjashta frynte erë. Qeni lehu disa herë. Dokja doli në oborr, hyri në katua, po s'dalloi asgjë. Ai mendoi përsëri për lopën e Nase Ksenos dhe lutej me vete që ajo të mos dështonte. Doemos, thoshte ai, po t'i dështojë, unë do të thaj çanakun tim dhe do t'i jap lopën time.

Ai mendonte kështu dhe pikërisht atëherë koka i gjëmonte e jeta i dukej e ngatërruar dhe e rëndë. Përjashta, tej shkallëve të gurta, kopshtet me gjerde duke shinin si grumbuj errësire, ndërsa drurët, poshtë, nën dritën e zbehtë të yjeve, lëshonin hije të zgjatura.

Në mëngjes gruaja hyri brenda e lemerisur dhe lëshoi në mes të dhomës një dorë karthje. Ajo ishte shkattërruar në fytyrë dhe ia bënte *uuu*. I shoqi e shkundi nga bërrylat dhe doli përjashta. Në kopsht, gjatë natës, dikush kishte prerë gjashtë hardhi të mëdha. Ai u drodh dhe pikëllimi i rrodhi në tërë gjakun. Befas, sikur të ishte kujtuar për diçka, brofi dhe nxitoi prapa shtëpisë. Pikërisht atje desh u rrëzua përtokë. Një sëpatë e rëndë, e pamëshirshme, kishte prerë ullirin dhe, ashtu të prerë, e kishin shkelur me këmbë dhe e kishin lënë. Fshatari u ul pranë trungut të prerë dhe heshti. Ai s'dinte ç'të fliste. Vetëm sytë folën: derdhën lot që i dogjën faqet. Si ishte e mundur?! Si ishte e mundur?! Ai s'kishte dëgjuar asnjëherë, tërë jetën, që dikush të hakmerrej duke

prerë pemët. Fshati i tyre pati qenë i ndarë në dy agallarë, po asnjëherë, askush nga fshati s'preu një pemë në arat e agait. Ata u ngritën e luftuan, vranë italianë, gjermanë e agallarë, po pemë s'prenë.

Fshatari pshëretiu dhe u ngrit me ullirin e prerë në dorë. Ai po e rriste me shumë kujdes atë ulli dhe tani që ishte rritur aq dhe ishte bërë një gëzim i madh për shtëpinë dhe fshatin... Atij i dukej se në të gjithë botën s'gjendej thesar më i mirë sesa pemët, dhe veçanërisht agrumet, për të stolisur e rritur begatinë e fshatit. Atij i qëllonte vetë që të priste dru në pyll, po i vinte keq, ndiente dhembje kur rrëzohej druri i dushkut apo panna. Ai i donte shumë pyjet. Nderonte drurët dhe veçanërisht pemët. Gjithmonë kishte ëndërruar që të kishte një kopsht, ku të mbillte pemë. Ai përgjerohej për to dhe ishte besnik, si një rob, ndaj tyre. Kur kthehej nga puna në fushë, ai patjetër do të hynte në kopsht, dhe gruaja e tij thoshte se ai bisedonte me drurët. Ai punonte dhe, kur çlodhej, ulej si një shqerrë, diku në një qoshe. Dëshira e tij ishte të rriste portokalle e ullinj pikërisht në fshatin e tij, të rriste shumë pemë të tjera të çdo lloji. Për të kjo ishte detyra e parë dhe ai fshatar e kishte të zgjuar thellë ndjenjën e detyrës. Ai e quante mëkat, mallkim, që të ishin fare të shkreta ato kodrina të bukura ngjyrë plumbi, që të ishte i shkretë e i heshtur Pusheti.

Pushteti ishte pak më tej, në lindje të fshatit dhe përballë tij shtrihej vargu i rëndë e i turbullt i një mali. Dikur relievi i tij kishte qenë si vazhdim i tokave të fshatit, po një ditë ajo tokë patjetër që ishte këputur, ishte fundosur. Dhe tani Pusheti ndodhej, i ulur poshtë, thellë, fare buzë lumit. Ai ishte si një vathë e madhe, në prehrin e së cilës shekujt kishin rritur shpella. Në palcë të dimrit atje koha qe e butë, si fryma e njeriut. Përqark shpellave, nëpër parcelat e pambjella, mbinin ferra, driza, gorrica, fiq të egër. Atje nuk kishte pemë. Kur vendi mbulohej me dëborë, atje zbritnin tërë kopte: delet, dhitë, kuajt, lopët, gomarët. Fshatari Doke

meridonte shpesh për atë vend. Atij i dukej se, po të vazhdonin të mos e mbillnin me pemë atë vend, atje patjetër do të rritej kopeja e shpellave. Atje...

Fshatari Doke ishte përkulur i tëri dhe një çast iu duk sikur shikoi Pushetin të mbushur me drurë portokallesh e ullinjsh, sikur midis atyre drurëve kërceu dikush dhe filloi të priste trungjet me sëpatë. Ai u drodh dhe në gjoks iu mblodh një xhëng. Ai donte të ulërinte e të nxitonte, po nuk mundte.

Fshatari ndjeu të dridhura në gjunjë dhe era i ftohu djersët e gushës. Ai hapi e mbylli sytë disa herë dhe iu kujtua dita kur italianët hynë në fshatin e tyre. Ata ishin armiq dhe, si armiq, ishin të pamëshirshëm. Shkelën udhët, shkelën çaiet dhe gardhinat. Mushkat dhe kuajt i lidhën nëpër pemë dhe të nesërmen pemët u gdhinë me trungje të zhveshura e të mardhura. Pas kaq vjetësh, gjatë natës, një njeri i pamëshirshëm kërceu në kopshtin e fshatarit Doke dhe preu gjashtë rrënjë hardhi, preu edhe ullirin...

Fshatari e mbante në dorë trungun e prerë të pemës. E ngrinte përpara si të mbante në duar një nga gjymtyrët e djalit të vetëm. Ulliri ishte i lartë, sa ç'mund të jetë i gjatë një djalë nëntëvjeçar.

Ai u kthye prapa dhe u çapit me nëntëvjeçarin në duar. Që prapa shtëpisë e deri tek oborri, udha ishte e pikëllueshme, si kthimi nga një varrim.

Ai hyri brenda në katua dhe zgjidhi qenin. Katoi binte erë bajgë. Qeni nxitoi deri te dalja e katoit, po befas, si të ishte kujtuar se qe larguar shumë, u kthye tek i zoti. I zoti ishte ulur prapa në një trung afër fucisë. Qeni i mori erë në rroba dhe sillej përqark. Nga dritarja e zënë me thekër depërtonte dritë e bardhë. Gjethet e portokallit dhe bisqet e reja ngjanin si të gatuara me diell. Atë çast fshatarit iu bë sikur shikoi portokallin e prerë përpara tij. Ai u shkund dhe rifitoi përsëri sensin e vendit dhe të kohës. Vifin tjetër portokallin do ta nxjerr përjashta në kopsht, tha ai. Gruaja hyri brenda dhe tregoi se lopa e Nase Ksenos nuk kishte

shtirë, domethënë nuk kishte dështuar. Ajo e shikoi të shoqin në sy dhe ndjeu dhembje.

Një orë më vonë në shtëpi erdhën dy fshatarë që ishin anëtarë të këshillit. Ata shikuan hardhitë e prera, shikuan ullirin dhe mallkuan njëqind herë për atë bardi.

Pas një jave, në shtëpinë e fshatarit Doke erdhi i plotfuqishmi i lokalitetit.

Nuk kishte kaluar as një muaj, kur Nase Ksenoja bëri dasmën e vëllait. Në dasmë ftoi edhe fshatarin Doke.

Një javë pas dasmës Nase Ksenon e arrestuan. Një natë para dasmës dhe ditën e dasmës sipër në tavanin e shtëpisë së Nase Ksenos hanin e pinin dy diversantë. Atë mëngjes që arrestuan Nase Ksenon, fshatit nuk shkoi në ara. E, i tha kryetari i këshillit të fshatit Dokes. Fshatari Doke shikoi të arrestuarin dhe mermëriti: njeri brumëkeq. Rrugëbjerrës, tha kryetari i këshillit të fshatit.

Rrugëbjerrës, tha përsëri kryetari i këshillit të fshatit dhe pështyu me neveri. Fshatari Doke shfryu hundët në shami dhe heshti. Pastaj u kthye në shtëpi, hodhi plisat e zgjedhës mbi stavë dhe hyri në katua. Ai u ul mbi trugun pranë fuçisë së portokallit dhe thuri duhan. Duke pirë duhan, përmes tymit, iu shfaq fytyra e Nase Ksenos. Atij i regëtinë mollëzat dhe thirri:

«Qen!»

Qeni atje tej te hyrja e kolibes lëvizi përsëri, tundi mesin dhe kuisi, sikur të pyeste të zotin për hidhërimin që e mundonte. I zoti shikoi fytyrën e zgjatur të kafshës dhe belbëzoi.

«Pirka!»

Pirka kuisi gjithë gaz, duke lëvizur shpatullat e vogla midis qafës së gjatë dhe ai e zgjidhi. Fshatari mënjanoi te dritarja kashtën e thekrës dhe në katua, mbi fuçi, nxitoi drita e bardhë e përtejmurit. Portokalli u përzie me dritë dhe sikur u gëzua. Vitin tjetër do ta nxjerr përjashta në kopsht, tha përsëri ai.

Një vit më vonë ai thirri të birin dhe të dy së bashku,

me një kujdes të jashtëzakonshëm, e përkulën fuqinë horizontalisht mbi një tezgë dhe e nxorën përjashta.

Ishte pranverë. Atje, në oborrin e larë në dritën e diellit, portokalli ngjante si një lehonë e nxjerrë nga shtrati.

Pranë murit, në drejtim të jugut, fshatari Doke dhe i biri i kishin çelur një gropë të madhe dhe kishin hedhur pleh organik të djegur, të përzier me baltë. Kur e vendosi portokallin në gropë, fshatari u ngrit drejt, uli pëllëmbët në mes dhe tha me mend se portokalli patjetër do ta merrte veten. Atij iu kujtua Nase Ksenoja dhe, pak më vonë, fare pranë portokallit, lidhi qenin. Atë vit ai mbolli dy rrënjë të tjera ullinj dhe anës gardhit çeli kanale të thella. Në to hodhi baltë të re, të sjellë nga një çair dhe mbolli hardhi. Në verën e vonë gjethet e hardhisë ishin të freskëta dhe portokalli rriste bisqe të reja. Në vjeshtën e dytë ai gërmoi te rrënjët e portokallit dhe hodhi bajga gomari. Ai e dinte se portokalli e donte të ngrohtët dhe, nga përvoja e jetës, e dinte se bajgat e freskëta të gomarit e ruajnë një kohë të gjatë nxehtësinë. Dhe atë muaj vjeshte ai bëri tri lesa me thupra çermëdelli e kashitë dhe i mbështeti te njëra-tjetra përçark portokallit. Disa ditë më vonë ai e hoqi kashtën e thekrës nga lesa dhe në vend të saj shtroi gjethe misri. Gjethja e misrit e mban më ngrohtë, mendoj ai.

Gjatë natës qenin e lëshonte dhe Pirka s'dilte tej shtegut të oborrit e nuk e kapërcente gardhin e kop-shtit. Asnjë i huaj s'mund të hynte brenda shtegut, pa dalë të zotët. Qeni ishte i zgjuar, besnik dhe i sertë. Kështu thoshte fshatari Doke. Gjatë dimrit, natën vonë, kur dilnin nga mbledhja, qëllonte dendur që Dokja merrte kandilin dhe afrohej te portokalli. Portokalli gjëllonte atje brenda kasolles së ngritur me lesa e gjethe misri.

Në pranverë fshatarët i bënë tok pendët e qeve dhe së toku nisën të lëronin arat. Ata tani ishin bërë kooperativë.

Ishte viti 1952. Atë pranverë portokalli çeli lule dhe

gjatë verës ajo pemë tani kishte hyrë papritmas si një gëzim i madh, i dashur, i panjohur për tërë familjen. Ai kishte rritur 69 kokrra. Pranë tij qëndronte e lidhur Pirka. Po këtë radhë Pirka, më në fund, ishte enjtur dhe fshatari e shikonte shtrembër, me një lloj pakënaqësie, barkun e saj. Pirka kuiste, nxirrte pakëz gjuhën dhe lëvizte këmbën e parë të hollë. «Pse u mbarse?» i tha fshatari. Ajo e shikonte drejt në sy. Fshatari Doke nuk donte që ajo të mbarsej dhe nervozohej, kur kujtonte që asaj po i rritej barku sepse kishte shkuar me qen të tjerë. Dhe tani i dukej sikur qeni i tij po ndryshonte, sikur ai s'do të ishte më plotësisht i tij, i atij portokallit që po rriste kokrra. Ai nuk donte kurrsesi që dikush tjetër të ngatërrohej te shtëpia e tij, tek oborri i tij, te kopshti apo te qeni i tij. Ishin bërë kooperativë, por ishte ende herët dhe fshatarin vazhdonte ta ngacmonte gjer në palcë ndjenja e pronës private. Në shpirtin e tij ai jetonte atë të tashme mbi të cilën sundonte ende e kaluara. Po ndesheshin kohët dhe, doemos, epoka e re do të bënte patjetër që e tashmja të sundonte mbi të kaluarën.

Fshatari Doke e shikoi drejt me vëmendje Pirkën, «Pse?!...» dukej sikur thoshte fytyra e tij. Qëni e ndiqte me adhurim dhe mëshirë njëkohësisht. «Jo, jo», thërriste ajo fytyrë e pakënaqur. «S'duhej të ishe mbarsur». Po barku i saj rritej vazhdimisht dhe Pirka, atje poshtë te hyrja e stelës, që goditej nga dega e ngarkuar e portokallit, merrte frymë thellë dhe shihte ëndrra. Me siguri që shihte ëndrra, përderisa fare kot, pa e ngacmuar askush, kur bënte gjumë, lëvizte këmbën apo kokën. Të gjitha këto nuk kishin ndikuar aspak në humbjen e përgjimit. Jo. Ajo lehte tamam kur duhej të shqetësohej.

Fshatari i gëzohej portokallit, u gëzohej kokrrave që po rriteshin, i gëzohej Pirkës. Vetëm se qeni...

Polli gjashtë këlyshë. Dy ishin krejt të zinj, një i murrmë, dy të tjerë të zinj me pika të bardha dhe një ngjyrë mjalti me një pullë të bardhë te shpatulla e djathtë dhe te veshi i djathtë. Po ai ishte mashkull. Kur doli fshatari Doke në mëngjes te portokalli, qeni u ngrit dhe zgjati kokën. Ai shikoi këlyshët, që ishin akoma të verbër dhe silleshin me ngut mbi njëri-tjetrin sikur të nxitonin për diku. Zgjati majën e opingës dhe i përçau që t'i shihte përsëri. Pirka nuk kuisi. Ajo shikoi të zotin drejt në sy, sikur t'i lutej, sikur t'i thoshte se ata të gjashtë i kishte pjellë pikërisht ajo. Po ai i përçau edhe një herë me nxitim me majën e opingës dhe Pirka u tërhoq e i grumbulloi këlyshët pranë vetës, poshtë nën gjirin që i varej e i tundej si napë djathi në miniaturë. Gjiri lëkundej dhe te sisët e Pirkës qimet e verdhë, të përslagura, shkëlqenin në skaje. Pirka nxori këmbët e holla përpara dhe vërente përsëri të zotin. Njeriu seç mermëriti, po ajo e vërente sikur t'i lutej që ai të mos e shikonte me inat.

Fshatari Doke uli mesin dhe këqyri me vëmendje trungun e gjelbër të portokallit dhe e krahasoi atë me ngjyrën e trungut të ullirit. Portokalli rritej i shëndetshëm dhe trungun e kishte të pastër e të pacënuar. Diku në shpinën e tij ishin disa qime ngjyrë mjalti. Fshatari e kuptoi se ishte fërkuar qeni. «Pse u mbarse?» — thirri fshatari papritur. Qeni e shikoi drejt me sytë e tij besnikë e pak të turbullt. Ato çaste askush s'mund të mendonte se Pirka ishte një qen aq i shkathët, aq i sertë, aq besnik e që dinte t'i shërbente vetëm një trualli e një njeriu.

Po ajo polli. Këtë fshatari Doke nuk e dëshironte. Ai nuk ngurroi të hynte në kooperativë. Ai i bashkoi tokat me fshatarët e tjerë, bashkoi pendët e qeve dhe parmendën. Kopshti përçark shtëpisë ishte pronë e tij, ndërsa tërë arat prapa fshatit dhe fusha ishin pronë e tij dhe e fshatit së toku.

Fshatari Telo Maqi i tha që t'i jepte një këlysh, kur

të pillte Pirka. Ai i tha, po Dokja nuk i ktheu përgjigje. Një vit më parë, në fund të shtatorit, Puravel Duka, që ishte rojë në vreshtin e kooperativës, i tha që t'i rriste këlyshët e Pirkës. Rrushin e vreshtit e gjuan shumë dhelpira, tha Puraveli, dhe një qen si Pirka bën punë.

Po fshatari Doke nuk donte të dëgjonte. Ndoshta ajo e kaluar që mundahej të sundonte mbi të tashmen ishte shtyrë gjer aty te Pirka dhe s'largohej. Ai nuk do të jepte asnjë këlysh të Pirkës. Dhe Pirka nuk duhej të mbarsej.

Po ajo polli. Polli gjashtë. Fshatari ndjeu të trullusur dhe u mërzi. Ndjeu sikur dikush po grindej sipër në kokën e tij, brenda nën kafkë. Po grindeshin!

«Edhe ajo merr frymë», tha e shoqja për Pirkën. Djali iu lut që të mos i hidhte këlyshët, po babai nuk foli.

Kur u ul muzgu, këlyshët nuk ishin nën barkun e ngrohtë të Pirkës. Fshatari i futi në një trastë të vjetër dhe i zbriti poshtë në një guvë, që hynfe thellë në tokë. Një çast fshatari ndaloi dhe dukej sikur dëgjonte zhurmë që transmetonte toka. Zërat e këlyshëve nuk u ndien. Pas ca atij iu bë sikur era solli kuisjen e një fëmije. Fshatari ndjeu të dhembur në gjoks dhe kaq.

Kur u kthye në shtëpi, ai tha se do të mbanin këlyshë vetëm kur Pirka të plakej. Një qen që pjell, nuk është qen i fortë, tha ai. Por atë mbrëmje pranë vatrës biseda nuk ecte. Pirka lehu disa herë dhe atyre të gjithëve iu kujtuan këlyshët. Ajo lehu përsëri dhe gruaja mërmëriti: «Edhe ajo mëmë është, merr frymë».

Burri këputi një copë bukë dhe doli përjashta. Përjashta kishte hënë. Pirka ishte në këmbë pranë trungut të portokallit. Atë tani e mbanin lidhur. Burri i hodhi copën e bukës. Ajo nuhati vetëm një herë, po nuk e kafshoi. Ngriti kokën lart dhe shikonte të zotin drejt. Ai i fliste Pirkës, por ajo e vështronte ftohtë, butësisht dhe e përvuajtur. Diç kërkonte prej tij. I zoti u largua dhe, kur Pirka lehu, atij iu duk sikur ulërinte hëna. Ranë të flinin, por ajo lehu përsëri me një zë të zgjatur e të kobshëm.

Gruaja tha: Le t'i rriste, pastaj i jepnim në fshat.
Djali gjithashtu tha: T'i kishim mbajtur.

Babai nisi të gërhiste. Pirka gauniste kobshëm dhe me lemeri. E lehura nuk i ngjante zërit të saj të zakonshëm. Ai u shtinte frikë dhe u zgjonte mendime të këqija njerëzve.

Në mëngjes fshatari Doke u ngrit herët. Zbriti shkallët dhe humbi pas qosës së shtëpisë. Atje ishte portokalli dhe qeni. Qeni ishte në këmbë. E shikoi drejt të zotin, hapi gojën fort dhe drodhi kurrizin sikur të shkundte diçka. Asaj i numëroheshin brinjët. Fshatarit iu dhimbs dhe i foli në emër. Ai tha me mend se pas ca ajo do t'i harronte këlyshët. Pastaj uli mesin dhe zgjati dorën e rreshkët që ta përkëdhelte Pirkën. Qeni u tërhoq; sytë iu rrudhën dhe hapi gojën e skërmiti dhëmbët. Dokja theu gjurin e majtë dhe e uli në tokën e lagur nga vesa. Fare papritur ai shikoi trungun e portokallit dhe u drodh. Ajo ishte një dridhje e tmerrshme. Atij iu kontraktuan tërë eshtrat dhe e kapi një inat i verbër. Goja i thirri me një ulërimë të përhumbur, të thekshme, sikur ta kishte goditur dikush befas prapa kokës. Pirka u tërhoq edhe më pas dhe e shikonte drejt me armiqësi. Ajo tani s'mund të ishte Pirkë; atje më tej ishte qeni. Qeni!

Fshatari zgjati dorën e gjatë të dridhur te trungu i portokallit, po nuk e uli në shpinën e tij. Atij iu drodh fytyra, iu tundën nofullat dhe i lëvizën rrudhat e barkut te kërthiza. Një pjesë e trungut të portokallit zbardhte sikur të ishte kockë e lagur. Atij ia kishin rrjepur lëkurën dhe lëkura, copa-copa, kishte rënë në tokën e njomur nga vesa. Atë e kishin kafshuar me kujdes e me inat dhe përqark, në një sipërfaqe një pëllëmbë e ca,

trungu ishte krejt i zhveshur. Fshatari rrëzoi kokën prapa dhe shikoi pemën. Ajo ishte ende e freskët, e shëndetshme dhe era e mëngjesit e trazonte lehtë. Por ajo kafshë e përbindshme, që ndodhej aty nën të, e kishte zhveshur; ajo kishte zhveshur edhe drurin e listelës tek lidhej zinxhiri. Fshatari shikoi përsëri portokallin. Iu ulën qepallat dhe mëndoï atë pemë të bukur e të dashur, të vyshkur, të tharë, me 69 kokrra të pabëra, që tani do të fillonin të rrudheshin, të binin. Çeli sytë dhe afroi putrat e gishtave te trungu i rrjepur. Ai ishte i ftohtë, i njomë dhe i bardhë si ngjyra e kajmakut. Pema do të thahej. Ajo i kishte shkëputur lidhjet me botën e gjallë dhe limfa nuk do të qarkullonte më. Fshatarët, kur donin të thanin ndonjë pemë apo dru tjetër, vepronin pikërisht kështu: i hiqnin lëvozhgën rreth e rreth trungut. Këtë kishte bërë edhe Pirka.

Në thellësi të atyre syve të hidhur të fshatarit shkrepiti gjaku. Qeni uli sytë si një i dënuar që s'kërkon mëshirë. Sytë e tij ishin të trazuar e të përhumbur në një përzierje të verdhë e të gjelbër dhe në skajë kishte sklepa. Ata ngjanin sikur të ishin plakur krejt në një natë.

Hata, mërmëriti fshatari Doke.

Ai u ngrit dhe doli prapa shtëpisë. Kur u kthye në duart e tij të fuqishme ngrinte një gur të madh të zgjebur tërë vrima. Po çapitej drejt qenit. Ai nuk donte që të kuptonte se ajo e kishte emrin Pirkë.

Një kokërr portokalli e rritur, e pabërë e goditi në flokët e përzier sikur t'i kujtonte diçka të hidhur. Burri e ngriti edhe më lart, përmbi kokën e tij, atë alamet guri dhe u qas akoma pranë kafshës. Qeni u mundua të gjente vend që të zbythej ndaj murit, po vend nuk kishte. Atëherë mblodhi qafën, hapi fort gojën dhe burri shikonte drejt fridhjetë e dy dhëmbë të bardhë të pacënuar. Shikonte relfeksat e mishit të kuq anës dhëmbëve dhe ashkla të gjelbra nga të lëvozhgës së drurit të agrumes. Goja ishte krejt e kuqe, sikur të

ishte ndezur me zjarr. Ata e ndiqnin me armiqësi të jashtëzakonshme njëri-tjetrin. Qenit i dridhej lëkura e shpinës, ishte kreshpëruar dhe nëpër gojën e ndezur nxirrte ca zhurma sikur t'i kishte mbetur diçka në grykë. Ai lëvizi edhe një herë kokën dhe goditi zinxhirin me këmbë. Hija e gurit i lëvizte mbi kokë, mbi pullën e bardhë te veshi i djathtë dhe mbi pullën e bardhë te shpatulla e djathtë. Qeni u skërmit. Fshatari e lëvizi gurin dhe e lëshoi me tërë fuqinë...

Pas ca ditësh fytyra e fshatarit Doke u hütua krejt, u bë e zbrazur nga çdo mendim. Ajo u nxi e u zgjat si koka e mushkës. Dhe befas, me një shpejtësi të jashtëzakonshme, ai njeri u sulmua nga rrudhat. Sikur u zbardh përnjëherësh, sikur u shndërrua në gërmadhë. Njerëzit përçark, dhe veçanërisht njerëzit e shtëpisë, u shqetësuan seriozisht.

Por atë e ringjalli vetëm pasioni për punën dhe për drurët. Nisi të sillte fidanë të rinj portokalli, dy rrënjë ulliri, hardhi dhe hurma nga të Jemenit. Në mbrëmje apo në mëngjes herët dilte parçark nëpër kodrat e fshatit. Ai ndiente shqetësim, duke shikuar atë pamje monotone, të pajetë të kodrave dhe e quante mëkat e mallkim që ato i linin fare të shkreta. Dilte atje në lindje të fshatit, ulej mbi një shkëmb në livadhin e vogël dhe shikonte Pushetin. Përballë shtrihej vargu i rëndë i një mali. Patjetër që dikur relievi i Pushetit kishte qenë vazhdim i tokave të fshatit, po një ditë ajo tokë duhej të ishte këputur dhe qe fundosur. Kjo duhej të kishte ndodhur nga tërmetet. Midis asaj toke të butë të Pushetit ngriheshin shpella të murme si mërzi, të ngri-ra. Në lindje dhe në jug rridhte lumi. Anës shtratit të tij kishte rrape. Pusheti ishte tokë djerrë e mbushur

me bimë të egra dhe shpella, që natën kishin një pamje të frikshme. Atë nuk e punonte askush. Fshatarit Doke i vinte keq që s'e punonin. Atij i kishte shkuar në mend se pikërisht aty mund të mbilleshin agrume. Dhe pas asaj nate, kur i lindi mendimi se në Pushet mund të mbilleshin agrume, ai shkante shpesh atje te katrori i livadhit të vogël mbi shkëmbin. Tërë jeta e tij ishte e lidhur me natyrën. Ai dilte dhe vrojtonte erërat. Kishte provuar se në Pushet hynin erëra të ngrohta dhe veriu nuk e rrihte. Aty gjethet e pemëve rrëzoheshin vonë dhe në vjeshtën e tretë, midis barit, çelnin lule. Pikërisht në atë stinë lulet përhapnin në ajrin e lehtë të vjeshtës një aromë të rëndë, si bar fushe dhe miza zizëllinte ende.

Ai e donte kooperativën, por i vinte keq e trishtëhej që s'tregohej aq kujdes për pemët. Këtu nuk bëhen agrumet, i thoshin ata. Në mbledhjet e asamblesë, kur zgjidhej kryetari, ai doemos do të fliste përsëri për pemët. Nuk bëhen, o Doke, jo, nuk bëhen portokallet këtu, i thoshin ata.

Ende pa kërcyer pranvera, fshatari Doke zbriti një mëngjes në Pushet. Përbri burimit, që i thonë Burimi i Pushetit, midis ferrave, drizave e gorricave, ai mundi të çelte një gropë. Në atë gropë mbolli një rrënjë portokalli, që e kishte sjellë nga Bregdeti. Atje nuk mund të hynim bagëtitë. Përçark e thuri që të mos e dëmtonin lepujt e egër. Çdo verë ai zbriste dhe e ujiste. Katër vjet më vonë portokalli rriti kokrra.

Fshatari Doke s'kishte shkollë dhe s'dinte të fliste për ligjin e madh se eksperimentimi është arti për të pyetur natyrën. Po duke vepruar ashtu, ai e pyeti natyrën dhe natyra iu përgjigj me bujari. Ai shkante në mëngjes apo në mbrëmje në Pushet. Shtrihej barkas dhe zvarritej gjer thellë midis ferrave e drizave. Atje ishin pjekur kokrrat e portokallit. Një ditë, aty zbritën kryetari i kooperativës, agronomi i ri, kryellogaritari dhe gjashtë fshatarë. Kryetari i kooperativës qau. Fshatarët lëvdoheshin që Dokja ishte nga fshati i tyre.

Të nesërmen arritën aty kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit, agronomë dhe drejtori i SMT-së. Pas asaj dite Dokja flinte te Burimi i Pushetit. Ditën ai dhe fshatarët bënë qilizëm e çelnin tarraca aty në Pushet.

Lumi që kalon në lindje dhe në jug të Pushetit rrodhi shumë ujëra. Edhe fshatari Doke u kërrus dhe njerëzit e thërrasin plaku Doke. Atij i janë rruddhur qepallat. Nga bërryli e tatëpjetë është holluar e vyshkur. Ai rri akoma atje në Pushet dhe kujdeset për plantacionin e agrumëve. Atij i ngjan sikur është një me drurët e portokalleve. Kur një dru pëson goditje, ai e ndien goditjen në trupin e vet. Pa u ngjitur akoma vjeshta e parë, ai mbledh dru të thatë dhe afron stava të vogla midis rreshtave të portokalleve dhe në rrënjët e tyre hedh bajga gomari. Kur përqark ndihet sulmi i të ftohtit, ai qëndron me shkrepe në dorë që të ndezë zjarre dhe tymi të vozitë nëpër degët e gjelbra.

Po në Pushet s'fryjnë erëra të ftohta. Ditën ai rri nën një tendë mbuluar me bar të thatë atje pranë Burimit të Pushetit dhe pranë, të varur në një dru, mban radion me bateri. Në verë shushurij në drurët, cijatin zogjtë dhe fëmijët thërrasin te plazhi i lumit. Po të zbresësh atje, ndodhesh nën përshtypjen e një koncerti hutues.

Plaku Doke pi duhan me llullë dhe, nga larg, silueta e tij ka pamjen e një lëmshi. Kur i qasesh pranë, të duket më i madh. Gojën e mban vazhdimisht gjysmë të hapur, me sytë të mbërthyer diku. I ulur ashtu në atë pozicion, të duket sikur dëgjon diellin, dhe eshtrat e tij të lashta ndiejnë ngrohtësinë.

Ai plak nuk i është falur perëndisë as si njeri dhe as si qengj. Tërë jetën ai i është falur vetëm punës. Ai thotë se shumë fatkeqësi bien në botë ngaqë ka njerëz

të pavullnetshëm. Ka pësuar shumë humbje duke u ngjitur në malin e jetës, megjithatë jeta ka qenë më e fuqishme se vdekja dhe shpresa më e fuqishme nga dëshpërimi. Ai njeri asnjëherë s'ka ditur ç'do të thotë *mjaft*. Vazhdimisht punon. Është tepër plak dhe jeton në moshën biblike. Nuk di të mbajë ligjëratat për agrumet dhe pemët e tjera. Kur e pyet për to, ai lëviz dorën e djathtë poshtë e lart, sikur punon me kazmë: punë, punë. Këtë do të thotë me atë lëvizje.

— Po qeni Pirka? — e pyeti një ditë agronomi.

Plaku heshti. Ai shikoi diku në thellësi të vetvetes dhe thithi duhan i qetë e i butë si Sokrati kur do të pinte helmin. Agronomi ia kujtoi përsëri qenin Pirka. Atëherë plaku doli nga ajo gjendje dhe mërmëriti diçka që s'u mor vesh.

— Privatja është e keqe, — tha ai, sikur t'i vinte inat që s'kishte dhëmbë të breronte.

E kishte fjalën për pronën private. Plaku u ngrit në këmbë. Diku më tej lehu qeni.

— Privatja të shkatërron, — tha përsëri ai. — Të shkatërron shpirtin. Tani do isha kalbur në dhe, po të isha marrë vetëm me atë portokallin e kopshtit tim rreth shtëpisë dhe me Pirkën time. Time!

Sipër qielli kishte një kaltërsi të pasosur, të qartë e të shëndetshme.

QENI I MAZE LLAKATURËS

Ujërat e lumit buçitnin dhe unë shikoja tej te një arë e madhe katërhektarëshe e mbjellë me lakër foragjere. Në mes të parcelës ishte një dru i lartë e i gjerë dhe degët e tij hapeshin madhështore.

Ai dru ishte rrap. Atë rrap s'e kishte prerë askush. S'mund të binte sëpatë mbi të. Ishte tepër i pushtetshëm në tërë ato vise dhe ngjante si krijesë e gjallë me një pamje të rëndë meditative.

Ato çaste nuk fliste asgjë për praninë e njeriut dhe shpirti menjëherë të përfntonte një demokraci të bukur fushash, drurësh, gurgullimash dhe kodrash. Tepër qetësi, butësi, dhe tepër bujari.

Ndërsa anës lumit shelgjet dhe drurët e tjerë tunde-shin sikur t'i tërhiqte rrjedha. Këtu, këtu, u thoshte lumi. Pylli atje lart ishte i heshtur dhe i largët.

U dëgjua një zile. Një pelë e bardhë ngriti kokën dhe shikoi prapa. Ajo hingëlliu lehtë sikur të shkundte jelet dhe shpinën, pasi t'i kishin hequr samarin.

Nisi të kulloste përsëri në një parcelë, e cila pati qenë e mbjellë me duhan.

Njëzet metra prapa pelës, te një ledh, qe shtrirë me gjoks, me duart të kryqëzuara nën fytyrë një burrë. Pranë tij, pothuaj ngjitur kokë më kokë, ashtu paralel, i ulur gjatas, ishte një qen.

Ai, si duket, ndjeu dhe ngriti kokën. Hum, ia bëri e nuk lëvizi, po kokën e mbajti ashtu të ngritur përgjysmë dhe njërin vesh e luajti sikur ta shkundte nga pagjumësia.

Burri lëvizi krahun e majtë, e nxori nga nënfytyra dhe përqafoi qenin. Qeni kuasi me përkëdheli dhe nderi mirë kokën. Kokat e tyre ishin pranë e pranë.

Unë u çapita drejt tyre. Qeni gërmushi shpatullat dhe donte të nxirrte kokën nga poshtkrahun i burrit. Burri diç i foli ashtu vuvo. Qeni sigurisht nuk iu përgjigj, po njeriu vazhdonte t'i fliste sikur të dy, prej kohësh, bënë dialog.

— Lidhe, or, qenin, — thirra unë duke dashur të flitja me akcentin e atyre anëve.

Qeni brofi në këmbë dhe kapërceu të zotin. Turinjtë e tij të mprehtë u zgjatën me vigjilencë. I zoti rrotulloi qafën. Fytyra e tij shikoi nga qielli i kaltër i larë dhe tha:

— Kush është?

— Erdha të të marr pelën, — thashë.

— Pela e ka të zotin, — u përgjigj ai.

— Erdha të marr të zotin, — thashë unë.

— I zoti e ka të zotin, — tha.

Ishte miku im Maze Llakatura dhe unë u gëzova. E njihja mirë. Qe njeri me shpirt dhe vullnet.

Ai u ngrit dhe shkundi treçerekshen e rrjepur prej lëkure sorkadheje. Pastaj e veshi. Fytyrën e kishte të kuqërremtë. Buzët e holla i kishte me rrudha. Ato shprehnin forcë dhe në të njëjtën kohë delikatesë, fisnikëri. Ajo kokë sillej ashtu lirshëm me një buzëqeshje që të ndiqte sikur të ishte fëmijë. Po nuk të fyente. Gjithashtu, nuk të kishte zili që ishte intelektual dhe s'të respektonte sepse ishte i tillë. Ky ishte ndryshe nga Qebiri i tregimit me titullin homonim. Tek ai gjithçka

ishte energji. Dhe asgjë primitive në kuptimin e kësaj fjale. S'ishte diçka i dhjamur dhe i shurdhër ndaj jetës. Ai nuk gjëllonte me shpirtin e mbushur me zbrazëtirë. Aty te buzët, sytë, mollëzat, balli dhe veçanërisht te lëvizjet të shfaqeshin përnjëherësh tiparet e të parëve, gjithçka e tyre. Kishte diçka të egër, që zbutej menjëherë, sa ndeshej me ty që ishte ndryshe.

Qe patjetër pinjoll i lumtur.

— Nuk ta njoha zërin, — tha Maze Llakatura. Ai foli pa ceremoni.

— Po fytyrën ma njohë, — thashë.

— Hajt, or shejtan, — tha.

Ai qeshi dhe unë s'e ndjeva buçimën e lumit.

Qeni lehu, por uli kokën sikur përnjëherësh të ishte penduar.

— Hajt, hajt, — i tha Maze Llakatura. — Pa hiqmu, hiqmu! Ik te pela!

Qeni u shtri përpara gjunjëve të tij. Maze Llakatura kapërceu me kujdes mbi të dhe u takuam. Pastaj ai kërkoi një vend të thatë ku të uleshim.

U ulëm. Qeshi me tërë shpirt. Më shkriëronte pamja e tij. Burrë i vërtetë, të cilin mund ta rritin vetëm dhera të tilla kaq bujare dhe kaq epike.

Pela ktheu kokën dhe hingëlliu. Pashë se fytyra e tij u gëzua. Ajo fytyrë, ai gëzim shprehte dashuri të ndershme për kafshën e tij.

Pela turfulloi dhe nisi përsëri të kulloste.

Qeni kërcëu papritur dhe nxitoi si plumb. Kur arriti pranë pelës, hovi befas, u hodh me lehtësi dhe qëndroi mbi samarin e saj: (Pa të shohim kush afrohet për qark?) U ul në bisht dhe zuri vend mirë. Nxori gjuhën e kuqe dhe lëpiu turinjtë. Me bishtin e dendur qarkoi këmbët e parme dhe vrojtonte me sy të mprehtë.

Ulëriu tërë gëzim. Ulëriu sikur donte të më tregonte mua zanatin e tij të lashtë: lehjen.

Pela nuk u shqetësua aspak. Ajo kulloste duke e qëmtuar vendin me radhë, ndërsa qeni rrinte atje sipër, sikur të mbronte bisedën tonë.

Fryu pak erë dhe burri u kthye edhe më mirë nga unë e qeshi me habinë time.

Era i trazoi flokët ngjyrë kashte. (Atë kohë fliste sikur bota të ishte e tëra përqark tij, nëpër dherat dhe shkarëzimat që shkelnin ai, qeni dhe pela e tij.)

— Të bën çudi qeni im, ë? — tha ai. — Dje...

Hëngre mish prëmë? Ai qe mish i derrit të egër. Ja, të mos qe ai miku, as ti, as unë, të tërë s'kishim për të ngrënë mish. Është i zgjuar qerratai. Vetë e kam mësuar. Jo, racë vendi është. Ashtu, qen i gjetur mbi baltë. Ohu, lordët i kanë të zgjedhur, se kanë mundësi; punon populli!

E ku të bredhim ne e të kërkojmë raca qensh! E kllaposim vetë një e aq. Çdo qen që të ndodhet dhe, në daç e rritim shtatmadh, në daç shtatvogël, në daç të egër, në daç të butë. Ai bëhet besniku im dhe ja, e sheh: natën në verë dhe në vjeshtë, kur pela kullot për-jashita, unë s'bredh me shark pas saj që ta ruaj nga gjë e ligë. Bredh qeni. Shih, hipën mbi të në samar dhe vrojton.

Ne e gatujmë vetë racën e qenit. Dëgjo si më leh. A, rrruffjani, e kuptoi që po flas për të.

Dhe që thua ti, mik vëllai, s'ma priste mendja që të rrinte i vetëm derri te Burimet e Dades. Vjen lopari i mëshqerrave të kooperativës dhe më thotë mua se te Burimet e Dadës vjen rrotull një dërr monohitar. Monohitar ne e kthejmë kështu: i vetëm. Si? Që shkon vetëm? E njëjta gjë. Dava fjalësh.

Ai qerrata dërr qe harruar aty dhe rrinte nëpër ato biçim koshtare, nëpër ca ledhe me gjineshtra e drurë të tjerë. Po drurët atje janë të paktë. S'ka pyll të dendur e të lartë. Gjineshtrave ne këtej u themi xana. Ç'nuk kishte prerë! Xana, sfaka, shqopa, mrete, driza e degë.

Dhe e di ç'bën? I merr me dhëmbë ato xanat e degët e tjera, i grumbullon dhe i ngre në këmbë, i trazon e duken sikur të kenë mbirë vetë, apo sikur t'i ketë vënë natyra me dorë. Dhe të thuash ti që kjo është një gëmushë që s'e çan dot, apo është kasolle. Përçark, drurë të paprerë. Ç'të jenë: lisa, a çerçeme, a gështenja. Dhe vete e futet në kasolle. Atë e përdor si strehim.

Më kallëzoi ai çobani i lopëve dhe ngjitem një ditë vetë. Kërkova gjurmët. Ia gjeta kullotën. Domethënë gjeta gjurmët. Epo këtu e kemi, thashë me vete.

Kthehem në shtëpi dhe u bëj haber nja dy gjah-tarëve në qytet. Është një djalë i mirë i talentuar në gjah që unë e kam qejf. Mbase e ke dëgjuar, Rik i flasin. Paguani lejen dhe ju pres, i thashë Rikut.

Erdhi Riku dje dhe u bëmë nja katër veta. E ku rri derri i egër atje, më thoshin mua. Një kuintal e ca derr, u thashë. Ta panë sytë? Ma panë sytë e çobanit të mëshqerrave, u thashë.

Rambam me fjalë dhe sabahu na zuri te Burimet e Dades. Sipër është mali, ti e di, dhe më këtej, nga e djathta, mali bie thikë, sikur thyen hundën. Atje është shtegu me këllapa e shpella. Pastaj lëre, kalon matanë dhe vete në botë tjetër, bie në pyjet me pikse dhe s'bën punë çiftja. Atje vetëm sa të shkrehësh qentë.

Po ne ishim këtej nga kjo faqe që e nget dielli. Kishim me vete edhe atë qerrata doktorin e grave. Është i mirë shejtani, po më qeshet. Ka filluar ta ndjekë gjahun. Ai ecte sa ecte dhe fliste me vete: Hej, derr i egër në prag të shtëpisë?! S'më besohet!

Unë këtë qen kisha. Arritëm. Hajde, Mero, i thashë. Mero i ka mbetur emri të varfrit! Erdhi. Nxora zilen dhe ia vara në qafë. Baa, s'bëhet me këtë! Është inatçi i madh dhe e ndjek larg gjahun. Ndjaj i var zilen, që ta dëgjoj ku ndodhët.

Caktuam shtëgjet dhe kërcyem brenda çuesin dhe Meron. Vetëm Meron. Vetëm Meron kishim. Cuk, për derr s'kanë zagarë këta. Ai Riku ka një kulish, po s'i ka dalë akoma. Të shohim mot.

U ra çuesi poshtë e larë brinjave e rrjedhave rrotull Burimeve të Dades, po hiç. Trokëllimë, këmbë gjahu! Jepte e merrte ky i shkretë Mero, po gjene hiç. Luajtëm edhe ne nga shtigjet dhe kërcyem brenda sikur të ishim çues. Kërkuam nëpër shqope e shkozë e mrete, kërkuam në ferra e murriza, po hiç.

Unë prapë rashë në gjurmët e derrit.

O jatro i grave, i thashë doktorit, që më hëngri mëlçinë se s'besonte në gjurmët, pa eja! Nuk ka shkelur derri i egër këtu?!

Ai u thye mbi to dhe handakosi fytyrën.

— Gjurmë të freskëta! — bloi nëpër gojë me habi. E besoi, domosdo.

Ishin vërtet gjurmë të freskëta, po ç'të bënim! Meroja i varfër u këput duke kërkuar. Shkuli nja dy lepuj, po s'e lamë t'i ndiqte.

— Jo nuk ikim, — tha jatroi i grave.

— Po ç'të bëjmë? i thashë.

— Këtu është derri, — foli ai.

— Derr dhe derri i madh! — tha Riku. — Duket nga gjurmët.

— S'do pragu mish, — tha një fshatari ynë.

Mirë e kishin ata. Kishte shkelur këmbë e madhe në ato gjurmë!

I ramë përsëri poshtë e përpjetë, u bëmë tërë baltë, u shqyem e lamë rrobat drizave. Britëm e ulërimë, u shqye Meroja, por ende asgjë. Dhe dita që prerë në mes. Ditë e vogël tani!

E hëngrëm kot, thamë dhe dolëm te një kodër që të pushonim. Shpresat? Të humbura. Ç'të kërkoje më? Do të ketë dalë sipër te hunda e malit, thamë, dhe është futur në piks apo më poshtë te pylli me gështenja.

— Po ç'djall e detyroi të zbriste këtu? — tha Riku.

E pleqëruam se ai derri do të kishte qenë dikur me kopenë, po kopeja kishte rënë në pritë gjahtarësh, gjahtarët do të kishin vrarë ndonjë apo dy apo edhe më shumë dhe ky derri, në alarm e sipër, që shkëputur dhe e kishte lënë vrapin te Burimet e Dades dhe aty kishte

kullotur monohitar. Më pas do qe ngjitur lart. Kështu e plegëruam, po zemra na thoshte se derrin e kishim diku aty, se aty na thërritnin gjurmët e tij.

Doktori i grave zbriti edhe një herë te një burim i fjetur që humbte nëpër murriza.

— Gjurmë të freskëta, — tha kur u ngjit. Qe i mër-zitur. Ta shikoje, të vinte edhe për të qarë, edhe për të qeshur. Sikur të vinte për të kënduar, mor burrë. Na gjëmonte trupi nga inati dhe në këto raste, e ke vënë re, sikur mishrat e trupit të këndojnë me të dridhura.

Hapëm çantat dhe nisëm të hanim bukë. Frap, fare hapasëz, nja katërqind metra përpara, dëgjojmë çobanin e mëshqerrave. Ai po e ngjite kopenë andej nga ishim ne. Hy, hy, u fliste mëshqerrave. Ooo!, ia bëri doktori.

Në sy na ngriu derri. Ai vraponte drejt nesh. Ne u lidhëm, sikur të ishim të vegjël dhe ujku të na hidhte hijen! E kishin shikullur mëshqerrat. Nga drurët vinte një kërkëritje gurësh e degësh që thyheshin, dëgjohe-shin këmbë të nxituara. Një zhurmë si batërdi.

E shikonim: ai po ngjitej malit dhe të dukej sikur i kishte thënë mendja të arrinte sa më parë atje në majën e copëtuar nga shtrëngatat.

Çobani bërtiste: o derio portiesho! Zagari çau i lllah-tarisur. Ne mblodhëm veten dhe rrëmbyem çiftet.

Oburra, u them, t'i presim udhën, se, po na kaloi në Qafë, te hunda e malit, e qajtëm.

Të ikur që bënte! Veç ta shikoje. Po dhe ne, ama! Gjahu të tërbon. Të tërbon më shumë kur të vjen mu përpara duarve një derr i egër, nja një kuintal e gjys-më, i majmë që... Dhe kur, në kohë dimri!

Ik ne e ik derri. Merója s'i la kusur. Ne pas tij.

Bam, qëlloi doktori.

Hë, i thashë. Ai gati sa s'qante.

— Iku, — foli.

Kaptoi në Qafë, te hunda e malit. Kaptoi matanë!

— Qëllova kot nga inati, — tha doktori.

— E pe që kaptoi? i thashë.

— Lëre, lëre, — tha. — Po ku qe fshehur?!

U dëgjua zilja. Meroja lehte mbi një shkëmb sipër te qafa. Ah, iku, thamë. Na shpëtoi.

U kthye edhe Riku.

— Iku, — tha.

Na humbën fjalët. U ulëm dhe pimë cigare. Buka na dukej helm.

Na doli përpara çobani i mëshqerrave. Edhe ai mezi merrte frymë.

— Ju iku, ë?

— Na iku, — i thamë.

— Jo, moreee!

— Po ku e kishte jatakun? — i tha Riku.

— Oh! — bëri çobani. — Sa dinak! Kishte jatak si kasolle! Si kasolle, mu atje mbi një burim vuvo. Mbledhur atje xana, e mrete, e shkoza, e murriza, e ferra, dhe prapa qe një dushk me majë të prerë. Hiç s'të vente mendja. Ja, atje, e shkëlën lopët.

— Ooo, ç'na shkau! Na iku fëlliqur. — tha doktori.

Për këtë baltë, e di sa m'u dhimbs? Më shumë për atë. Se qe i ri në gjah dhe sa herë që kishte ardhur, s'kishim rënë në derr. Pa edhe do ikin, dreqin! Gjë e gjallë në pyll.

Lëreni, u thashë. Hajt, harrojeni këtë. Monohitar ai derr, s'shkulet kollaj dhe s'bie lehtë në çifte. Gjë e vetmuar. I vetmuari, o djalë, e ka të zhvilluar dinakërinë dhe jeton në përgjim. S'e zë dot papandehur.

— Të kishim qenë ne vetë, kur u ngrit, e vramë, — tha doktori.

Po rri, o jatro, i them, rri. Nuk vriten të gjitha, se, po të ndodhte ashtu, shkretohej vendi.

Po ku ulej doktori. Ai u bë pikë.

Pimë edhe nga një duhan dhe u ngritëm e ramë në udhën që zbriste në xhade. Grykat e çifteve doemos vështronin poshtë. U bë dhe një qiell i vrarë atë pasdite dhe s'na shqyqeshin nofullat që të këmbenim qoftë edhe një fjalë.

Unë u kujtova dhe i thirra zagarit. Po zagari ishte

akoma atje lart te qafa ku ul hundën mali. Rrinte atje dhe nisi të ulërinte thekshëm.

Shkreha çiften, po ai prapë s'erdhi. Rrinte në vend dhe ulërinte. Shtiva përsëri me çifte. Ai s'luahti nga vendi. Ulërinte si për gjëmë. Sikur e kishte zënë gjarpri. U tremba se mos kishte pësuar gjë dhe s'hiqej dot gjer te ne.

Shtimë pastaj një pas një me Rikun dhe pas një çike dëgjova zilen afër.

Meroja erdhi. U çapit ngadalë, pothuaj i mërzitur. Më ndaloi dy çape përpara, përpoqi dhëmbët, i bloi sikur të fërkonte copa metali dhe sytë i kishte gjak.

S'dëgjonte asnjë fjalë. E pashë mirë: s'qe çarë, domethënë s'qe gjakosur.

E lidha për qafe, po, kur e tërhoqa, ai s'u bind. Vuri këmbët e para dhe s'luante. U bë kokëshkëmb. Mor po zvarritej dhe s'ecte. S'donte. Po ma plaste shpirtin. E rraha. Duheshim me njëri-tjetrin, duhemi, dhe vjen ora ta rrahësh atë që do! Ka bërë përshtypje të madhe në këto anë njëherë, ca vite më parë, kur një fshatar, Doke i thoshin, vrau një qen që e donte për ditë të kiametit. Paçka, ajo mund të ketë ndodhur edhe për arsye të tjera, për çështje malli, po unë, i lodhur e i mërzitur, s'mund të duroja asgjë, as Meron.

— Mos ka gjah atje? — tha Riku.

Unë gjahtar i vjetër, po s'i ktheva përgjigje. Rraha prapë zagarin dhe u përpoqa ta tërhiqja me anën e një teli. Po ai kishte ngulur këmbë fort e s'lëvizte. Kërciste nofullat, qimja i ishte bërë drizë dhe zbythej, hungërinte dhe kuisej gjithë ankim.

Eeeh! thashë me vete. Nisi të më vinte ligisht. Sec kërkonte zagari.

— Nuk e lëshojmë njëherë dhe të shohim se ç'ka në mendje? — tha Riku.

E zgjidha dhe qeni ngriti kokën, më shikoi në sy, mu si njeri dhe u kthye prapa. Iku. U bë erë, ra si rrufë. Po kjo?!, thashë me vete.

Drodha duhan. Nuk folëm. Për një çikë, Meroja ulë-

riu lart te hunda e malit, te qafa. Kush ngjitej atje?!
E ç'ka atje? Ca kllapa shkëmbinjsh e ca gllanikë
me gurë.

I fërshëlleva, po ai s'erdhi. Unë fërshëlleva, ai lehte.
Botë e zezë sonte!, thashë me vete. Shkreha çiften.
S'erdhi.

— Vemi, — tha Riku.

Vamë me një frymë. Ne ngjiteshim këtej dhe nata
vinte nga deti.

Arritëm. Meroja s'luajti, po filloi të gërmushej sikur
çoç do të na tregonte. U afrua pak, lëvizi bishtin, u
kthye, na hoqi udhën midis shpellave e gurëve të më-
dhenj e të bardhë dhe u kreshpërua e lehu sikur grindej.

Kur u afruam ne, ai kërceu dhe humbi. Sikur kërceu
në një humbëtirë që të thyente kokën.

Dëgjua katrahurë. Po përleshëj me egërsirë!

Atje, o djalë, ishte një gllanik a zanok, s'di si t'i
them! Mu atje kishte rënë derri i egër, i ndjekur nga
qeni. Se donte të kaptonte matanë.

E pa doktori derrin sa një kalive dhe iu mor goja.
Riku arriti të kaptonte matanë. Do ti që ai derr sa një
hata, që kishte rënë në atë zanok, nga ku menduam se
s'dilte dot, sa na ndjeu që ia hipëm përsipër, ia bëri një-
herë brof, çau shkëmb më shkëmb e gur më gur dhe u
gjakos e u copëtua, po bëri shteg e doli! Si çau? Po të
ishte gjallë, po të kishte mendje njeriu, as derri s'do ta
tregonte dot. Pupuuu!

Zagari pas tij mbi kurriz! Unë qëllova në tym, se
s'e shihja mirë. Dy herë më erdhi në sy, po të dyja herët
s'e vura dot në shënjestër.

O hata, thashë, Iku! Iku!

Pam! U dëgjua një e shtënë. Qëlloi në mish. Pam
edhe një herë. U ngroha, dhe këtë herë qëlluan në mish.
Zagari zhgërryhej mbi gjah.

Dola më tej. Poshtë meje ishte Riku. Kishte qëlluar
ai dhe po i fliste Meros. E kishte mbajtur Riku derrin
me dy të shtëna. Meroja kullonte nga intati. O, të shihje

doktorin! U bë si i marrë nga gazi dhe iu hodh qenit,
dhe e shtrëngonte në gjoks. Mor po s'e lëshonte.

E vramë. Ja, ai qen s'e la derrin të na shpëtonte.
Fyuvit, eja, Mero. Eja, o qeni im.

Meroja kërceu nga samari dhe erdhi me nxitim. I doli përpara të zotit, lëvizte i papërmbajtur dhe e shikonte drejt, sikur t'i thoshte: Urdhër! Ç'dëshiron?

Burri zgjati pëllëmbën. Zagari menjëherë uli kryet dhe i zoti i lëshoi shuplakën e madhe sipër te sheshi i kokës.

Ai tundte majtas e djathtas turinjtë e hollë e të gjatë.

Pastaj i zoti i tha:

— Lena, Mero, lena të themi dy fjalë.

Qeni atëherë doli prapa, hodhi të dyja këmbët e para në të dy supet, nderi gushën pranë qafës së të zotit dhe zuri e po pushonte.

Unë shikoja putrat e tij të bardha e të murrme tërë të plasaritura.

Ai qëndronte ashtu i mbështetur i tëri tek i zoti. Pastaj mbylli njërin sy. I zoti e përkëdheli me gishtërinj te turinjtë dhe i buzëqeshi me zemërmirësinë e zakonshme. Ndihej se ai burrë nuk ishte aspak tiran dhe i egër me qenin e tij.

Qeni hapi pakëz gojën, plot dhëmbë të bardhë dhe bëri sikur e kafshoi. Po jo. Ajo ishte vetëm një përkëdhelje, që ajo qenie besnike, me mënyrën e vet, shprehte mirënjohjen ndaj të zotit.

Besnikëria sigurisht i takonte burrit të ulur në dhé. Ai ishte më se i denjë për atë mirënjohje.

Maze Llakatura më pyeti për *kulishët* e mi. Kur thoshte si janë *kulishët*, ai e kishte fjalën se si i kisha me shëndet fëmijët. Dhe pikërisht edhe në ato çaste

ndihej te Maze Llakatura njëfarë butësie fëmijërore që shfaqej hapur. Tamam kur duhej.

U bë heshtje. I shikoja të dy me vëmendje. Edhe ai, edhe qeni, të dy ishin në mjediset e tyre. Dhe aty e kërkonin lumturinë.

— Kanë zbritur ujë dhe u bien havale bagëtive, — tha Maze Llakatura.

Zagari çeli sytë përgjysmë, sikur të mbante vesh.

— Do të dilni? — e pyeta.

— Nesër do gjuajmë, — tha. — Do dalim. Mbase biem në ta!

— Dolën prapë re, — thashë.

— Dimër është, — tha ai me një ngadalësi metodike.

— Dimër, paçka se këto dy ditë ndërroi.

Një zog qëndroi te kaptelli i samarit të pelës dhe çuçuriti.

Ngrita kokën. Përqark përhapej buçitja e ujërave të lumit.

QEBIRI

Domosdo që unë e njoh. Ai është vëllai i Shere-metit, kunatit tim. Sa herë që veja në fshat te motra, ai vinte, zinte vend pranë oxhakut dhe s'ngrihej. Motra ngulte këmbë që unë t'u vija veshin *budallallëqeve* të tyre. Dhe ato *budallallëqe* për mua ishin fjalë të sin-qerta. Janë bark i madh dhe, kur vijnë, mbushet pragu i shtëpisë me opinga, thoshte ajo.

Unë mendoja një çast për Hatijen, motrën time. Prindërit, veçanërisht nëna, kishin dashur ta martonin me një burrë nga qyteti, po erdhi një çast delikat dhe ne e martuam në fshatin përtej përroit, që i thoshin Allak.

Burri i motrës punonte në fshat. Motra e kishte merak që jetonte në fshat, po të shoqin e donte. Ajo thoshte për të dhe për vëllezërit e tij se ata ishin nje-rëz të mirë, po që të mbushnin oxhakun me *budallallëqe*. Dhe qeshte.

Në të vërtetë, ajo dëshironte që unë apo ndonjë tje-tër të dallonim cilësitë e mira të burrit të saj apo të njerëzve të tij dhe t'ia thoshim këto.

Të tërë, pa përjashtim, e donin kooperativën dhe pushtetin. Jepnin jetën për të. Kur u ngrit kooperativa në fshatin e tyre, babai i Sheremetit, domethënë vjehri i motrës, pasi dëgjoji të deleguarin, u ngrit befasi dhe thirri: «Rroftë pushteti, rroftë pushteti!»

E duan me xhan këtë pushtet, thotë motra ime.

Kunati i motrës e kishte emrin Kardhash.

Si ta kanë ngjitur këtë emër? i thosha herë pas here unë për ta ngarë. Ai ngrinte supet. Ku di unë, thoshte. Ama përnjëherësh i pritej gazi, goja i mbetej pakëz e hapur, sytë m'i ngulte drejt dhe mollëzat i skuqeshin.

Unë zija bisedë tjetër. Ai qëllonte gjurin me pëllëmbë dhe rregullohej mirë që të rrinte gjer në fund, gjersa të vinte palca e natës. Madje gjer në mëngjes. Sigurisht nuk vinte për të ngrënë. Se edhe gruaja e tij, Kanakarja, vinte natën te ne dhe sillte herë pjatën me lakror, herë me mish, me ullinj. Ka qejf të madh të vijë e të bëjë muhabet me ty, më thoshte ajo mua.

Nganjëherë na shikonte i trembur, se mos atë natë na mbaroheshin fjalët shpejt. Dhe i dukej sikur duhej të qeshte me çdo gjë që thosha unë.

Ishte vërtet krim të spekulojë me të.

Unë e kisha qejf zjarrin në oxhak, zjarr me kucura që digjen përbrenda e kërcasin, dhe paqllëkun që mbretëronte në atë odë.

Ne rrinim pranë zjarrit dhe bisedonim.

Ata vërtet kënaqeshin. Po gjithmonë duke pritur diçka më të bukur, të re.

Të dy interesoheshin shumë dhe ndiqnin me vëmendje fjalët për fundin e spiunëve dhe tradhtarëve. Unë u flitja për gjyqet e popullit. Ata pastaj donin të dinin se si ishin pushkatuar të dënuarit.

E sigurt që u pushkatuan? pyeste Kardhashi me naivitet.

Ata bëheshin tërë veshë dhe dëgjonin. Motra hiqte thellë nga zemra. Ashtu ajo tregonte mërzi dhe pakënaqësi. Donte që të ishim vetëm dhe të këmbente ndo-

një mendim jashtë pranisë së tyre. Por as i shoqi dhe as kunati s'ia vinin veshin pakënaqësisë së Hatijes.

Atëherë motra, fare papritur, qeshte. I shoqi e shikonte drejt me sy të zgurdulluar. Kardhashi vështronte i hutuar. Inati i të shoqit dhe hutimi i kunatit sikur i injektonin edhe më shumë gaz motrës sime. Eh, ia bënte i shoqi dhe hungëronte. Ç't'i bëj këtij (për mua), pa...

Këto thoshte hungërima e tij.

Pikërisht atë kohë qeshja edhe unë. I shoqi i sime motre kthente kokën një çast fare të shkurtër, më shikonte me habi dhe njëherësh qeshnin edhe ai, edhe vëllai i tij.

Qeshnim të tërë.

Pastaj motra shtronte darkën. Kardhashi hante pa kujdes, ashtu siç dinte ai, ndërsa Sheremeti mundohej të përdorte pirunin. Por e përdorte ligisht. Atëherë motra ime ulte kokën, qeshte e gurgullonte dhe fliste si me kast: Ëëë, hamë me kulturë ne këtej nga mëhalla jonë!

— Ëh, ëh, e pastaj, — ia bënte Sheremeti dhe zgurdullohej e niste të hungëronte.

— Si ta kanë shpikur këtë emër? — i thosha unë përnjëherësh Kardhashit, që të fillonim bisedë tjetër dhe të shuaja inatin e kunatit.

— Hë de, — thoshte ai, — si ma kanë stisur?!

I

Kardhashin e takoja shpesh. Ai shkonte bari me bravaret e fshatit. Kokën e kishte të vogël, me një ballë të gjerë e të qëruar nga flokët. Nuk mbante shap-kë. Në kokën e tij, në flokët, në ngjyrën e fytyrës kishte diçka prej shtufi, diçka të hirtë. Qafën e kishte të gjatë, të hollë. Dejet nga pas qafës, të kuqe në

mavi. Mavi ishte gropa nga prapa saj. Supet i kishte të shtrembra. Dimër-verë mbante xhakëtë shajaku. Kur binte shi, dilte me llabane. Me llabane shkonte pas kopesë, me llabane dilte nëpër udhët e fshatit, hynte e dilte nëpër dyqane apo në vatrën e kulturës. Në qytet, në ditë shiu, s'e kisha parë me llabane.

Kur më pyeste për gruan apo fëmijët e mi, shikonte matanë, jo si njeri tinzar, po si njeri që kërkon fjalë të përshtatshme.

Një ditë e takova poshtë nën fshat. Dëgjova zilet e dhive dhe u ngjita mbi një ledh pranë udhës. Në të majtë ishte një pyll me dushknajë e drurë të tjerë. Midis qenë përhapur dhinë. Disa kishin ngjitur këmbët e para nëpër dumberushe. Më tej Kardhashi.

Këta njerëz vërtet kanë diçka të bukur që të tërheqin. Nuk mund të kaloja pranë tij pa i folur. Atij i bëhej gëzim në shpirt. Unë gjithashtu ndihesha i gëzuar.

Nuk i flisja përnjëherësh. Shikoja. Më dukej se gjithçka përqark, i tërë dekori ishte në funksion të tij, të lëvizjeve dhe të veshjes së tij. Sikur të mos ishte ai, aty diçka do të mungonte. Siç do të mungonte diçka, po të mos ishte ai guri i madh, i bardhë, pranë trungut të një dushku të vjetër, apo ai zogu që u ul me nxitim te një degë thane e nisi të këndonte duke tundur bish-tin e duke dredhur puplat.

Atë kohë Kardhashi ndolli një dhi. Kjo ngriti kokën dhe e shikoi drejt. Ai zgjati përsëri dorën me pëllëmbën e hapur përgjysmë dhe vazhdoi ta ndillte. Dhia vajti drejt tij. Unë shikoja dy lëmenjtë e vegjël të gjunjëve te të dyja këmbët e holla të dhisë. Kur iu afrua bariut, dhia kërreu gjuhën dhe nxori ca zëra të përhumbur, ndërsa mjekrën e bridhte nëpër shajakun e tij sikur donte ta lëpinte. Bariu e kapi nga zverku, pastaj e mbërtheu nga këmbët e pasme, theu mesin dhe uli ballin nën bishtin e saj. Ajo ktheu kokën anash, e lëpiu te flokët dhe vërriti sikur ta pyeste se ç'kishte ndër mend t'i bënte. Ai nxori opingën e djathtë dhe e futi nën gjinjëtë e dhisë.

Nisi ta milte. Qumështi çlirohet nga kalamat e gjinjve duke ia bërë pëzhzh, pëzhzh, pëzhzh dhe binte në opingë duke kërcyer stërkala të bardha dhe duke ngritur avull të bardhë si tym nga pluhuri i gëlqeres.

Kardhashi e lëshoi dhinë. Ajo iku katër çape, pastaj ndaloi, ktheu kokën, vërriti dhe goditi me turi vendin midis bishtit dhe gjinjve.

Bariu fërshëlleu, sikur të ndillte një qen. Nga hija e një trëndafili të egër nxori kokën një këlysh, lehu dy herë dhe vajti tek i zoti e iu fërkua te këmbët.

Kardhashi uli opingën, e mënjanoi pak dhe këlyshi nisi të pinte qumësht, duke nxjerrë sa mundte gjuhën e gjatë e të kuqe.

Pas ca bëri më tej, kapi një dhi tjetër, e moli edhe atë në opingë dhe qeni e lëpiu gjer në fund opingën.

Njeriu i vetëm atje midis dushqeve dhe kopesë së dhive seç mërmëriti nëpër buzë një varg të një kënge popullore, veshi opingën dhe u ngrit në këmbë.

Këlyshi lëpinte buzët, ndërsa Kardhashi theu pak gjurin, e uli përpara dhe me të përkëdheli këlyshin.

Unë i fola Kardhashit. Ai ktheu kokën me njëfarë përtese, po, kur më dalloj, fytyra iu gëzua dhe nëpër lëkurë iu këmbyen ngjyra njerëzore.

Shkuam drejt njëri-tjetrit dhe u takuam me mall. Gëzimi i tij ishte prekës.

Unë shikova përqark që të ulesha dhe ai nxitoi që të shtronte pallton e tij të shajaktë. Sigurisht që nuk pranova.

I dhashë një cigare «Partizani». Ai e thithte dhe unë shikova gropën që iu bë te qafa. Sytë e tij kishin dritë.

— Mos ik sonte! — tha.

Unë nuk fola. Pranë nesh erdhi qeni. Kardhashi lëshoi pëllëmbën në kurriz të tij dhe qeni u ul. Mbi këmbët e para të shtrira përpara uli qafën dhe gushën dhe mbylli sytë.

— Kam kulish të mirë, — tha ai. — Tani që është i vogël, e ushqej me qumësht. Gjatë ditës mjel nga pak

një dhi timen dhe një të Sheremetit. Sheremeti e di, po Hatijes s'i themi.

Kur tha «po Hatijes s'i themi,» fytyra i shprehu faj dhe buzët u munduan të qeshnin. M'u kujtua Hatija, motra ime.

U ngrita. Ai donte që të rrija ende.

— Ja, ka edhe një çikë diell, — tha. — Pastaj pri-shet dhe unë e mbledh kopenë.

Dielli atje tej në krifën e malit ishte i madh dhe i kuq. Ai qe i bukur.

— Akoma s'i bëmë dhitë kolektiv, — tha.

— Kur do t'i bëni?

— Po, do t'i bëjmë, — tha.

Unë shikova përsëri në perëndim te pluhuri i zjarhtë që hidhte dielli. Ai më shikonte drejt, pastaj u përhum-b dhe përsëri më shikoi drejt.

— A ka gjë të re? — pyeti.

— Çfarë?

— Për ata.

— Për kë?

— Tradhtarët, — tha.

— U bënë pleh, — thashë.

Ai u mendua me vete dhe mërmëriti:

— Mor, po të kemi mendjen se pa shih si dalin?

— Sigurisht të kemi mendjen, — i thashë.

— Qenat! — tha. — Rri ca. Aty përposh ka një burim dhe ka lule.

— Të ngjitem, — thashë. — Takohemi në mbremje.

Gjoksi dhe fytyra e tij brufulluan nga gëzimi.

— Ja, ra dielli dhe erdha, — tha.

Ai vërtet u gëzua që unë thashë: Takohemi në mbremje.

Ky fakt më përhumbi. Këta njerëz gëzohen shumë kur u rrimë pranë, kur i pranojmë dhe bisedojmë me ta. Këta na lindën dhe na rritën, duke punuar në fushë apo duke kullotur delet në dimër e në verë. Na dërguan në shkollë dhe na ushqyen, na veshën. Në karakterin dhe në dijet tona pa dyshim kërkojnë pjesën

e tyre, atë që s'mundën ta arrinin vetë. Është krim i madh, shpërbërje e qenies njerëzore, t'u kthesh krahët këtyre njerëzve, t'i mohosh. Na lindi e na rriti kjo baltë dhe, sa herë që ndodhemi ngushtë, këtej e kthejmë kokën. Shikojini me vëmendje: këta janë ashtu të virgjër; diçka që të kujtojnë tokën, drurët dhe ujërat, Ç'arsye mund të ketë një dykëmbësh i shkolluar që t'i mohojë, që të ngrihet diku në një katedër apo prapa një tavoline dhe t'u largojë hallet dhe gëzimet e vërteta; t'i sjellë ndryshe në filma dhe në faqet e librave?

— Të t'i mbledh ca lule?

— Falemnderit, po iki, — thashë.

— T'i sjell në shtëpi te Sheremeti, — tha. — Dëgjo! Unë u ktheva nga ai. Ai shikoi në tokë te rrënjët e një sfake. E përshëndeta me dorë dhe u largova.

Prapa meje, atje në kulmin e malit, dielli qe tërbuar fare. Qe i bukur dhe, duke e kundruar për një çast, ndieje se premtonte ditë edhe më të bukur.

2

Unë banoja në qytet dhe aty punoja si gjykatës. Atë ditë isha me shërbim në një qendër kooperative në periferi të qytetit, pranë stacionit hekurudhor. Kur po kthehesha, akrepat e sahatit të madh shënonin orën dy. Isha bërë tërë pluhur. Pluhuri më bezdis shumë.

Zbrita nga autobusi dhe zura të ecja me nxitim. Bashkë me mua nxitonte edhe Vjollca, që punonte si mësuese e marksizmit në shkollën e mesme bujqësore, te stacioni hekurudhor. Ajo s'ishte martuar ende. Atë kohë po flitnim për dushin. Ne lëvdonim shpikjen e tij. Ishte vërtet vapë e pamëshirshme. Vapë shkretëtire. Isha zyrtar dhe xhaketën e mbaja veshur. Ajo më rëndonte dhe e ndieja se si më kullonte djersa në qafë. Përqark

vërtitej pluhur që e ngrinin makina të ndryshme, dhe kjo mua më torturonte.

— Fol, po mos më ngacmo me dorë te bërryli, — i thashë Vjollcës.

Ajo qeshi me zë dhe tha:

— Pse?

— Më bezdis qoftë edhe një grimë pluhuri, — thashë.

— Vërtet?! — tha ajo dhe qeshi.

Vjollca ishte vajzë shumë e mirë. Ne ishim komshinj. Nxitonim. Befas, nga prapa dikush uli krahun te supi im. Ktheva kokën. Kardhashi.

Ai qeshi me të madhe, gjithë çiltërsi. Ishte qethur e rruar taze. Nëpër qafën e hollë i kullonin rrëkeza djerse dhe këmisha i qe ngjitur vende-vende pas trupit. Nëpër gropat e fytyrës, prapa veshit dhe te gusha i ishin ngjitur qime të prera.

Ai m'i hodhi të dyja duart në të dy supet. Thërriste dhe qeshte.

— E hodha, — tha.

Unë ktheva kokën dhe e shikova: çfarë hodhe?

— Sot e hodha atë djall emër, — tha.

Mjekra ime ngriu e ngritur lart.

— E rregullova, — tha. — Pagova 500 lekë të vjetër dhe e hodha.

U kujtova ta përqafoja dhe buzët e mia u hapën, që t'i thërritnin në emër, po ai ma mbylli gojën me pëllëmbë.

— Mos! Qebir më quajnë tani. Ja, kështu.

Pas kësaj më përqafoi fort, sa deshi, më puthi pa druajtje në buzë, në mjekër, në faqe dhe në gushë.

— Tani folmëni Qebir! — tha. — Gjyshit tim Qebir i flitnin. Mua më kishin shpifur atë emër! Po kjo?

Ai u kthye i tëri nga Vjollca.

— Një shoqe, — i thashë.

Ai i zgjati dorën dhe e shikonte drejt.

— Punoni, se luftë e madhe bëhet, — i tha Vjollcës. — Vriji armiqhtë!

Pastaj e përqafoi dhe i tha:

— Kur më polli mëma, sekush më ngjiti një emër si të lig, kështu të përçmuar. Unë linda më 1922. Tani kam emër tjetër. Emrin e gjyshit. Pati një që më foli në vesh e më tha se mund ta rregulloja në gjyq këtë punë. Fët 500 lekë të vjetër dhe tani u bëra i tëri Qebir! Pa eni!

Ai na hoqi zvarrë gjer te pastiçeria dhe na gostiti me pasta dhe arançata.

— Iku Qebiri, — tha ai kur u ndamë.

E tërë qenia e tij këndonte. Sa ndenjëm me të, përsëriti shumë herë emrin Qebir, që ta bënte sa më të qëndrueshëm.

Dhe humbi në bërrylin e rrugës me plepa.

Vjollca vazhdonte të qeshte pa të keq. Pastaj u bë pa gaz dhe tha:

— Sa njeri i mirë!

Unë s'fola.

— Pse? — tha ajo. — Pse?! Kështu janë njerëzit. Të ndryshëm: një ashtu, një kështu; ca përpara, ca më pas. Qe njeri i mirë Qebiri.

Unë përsëri s'fola. Çapet tona trokitnin në trotuar.

— Ç'mendoni? — i thashë.

— Kishim një shok në kurs, — tha. — I pëlqente shumë të dukej modern dhe hiqej se dinte. Që të dukej i tillë, e mundonte veten duke heshtur. Në ca gjëra ndihej se kishte informacion, po se ç'kishte diçka që s'më pëlqente tek ai njeri.

Unë nuk fola. Ajo ngriti supet për të përsëritur: «se ç'kishte diçka që s'më pëlqente tek ai njeri!»

— Se ç'kishte diçka! Lexonte dhe, për shumë libra, fliste me mospërfillje, me përçmim. S'e kam këtu, xhanëm, po se si ishte ai njeri! Ja, do ta shikonte me mospërfillje këtë fshatar, do ta vërente nga larg. Ose do të shtirej. Po gjithmonë *modern*. Nëse do të shkruhej tamam kështu për këtë fshatar, ai do kundërshtonte. «Ky është fshatari ynë i dikurshëm. S'është kështu fshatari i shekullit të njëzetë». Ai s'do ta kuptojë se ky është Qebiri, janë njëzet apo dyqind Qebirë të tillë

dhe edhe këta kanë jetën e tyre. Tërë fshatarët duhet të ndërrojnë: të bëhen si i kërkon ai. Çudi e madhe! Dhe heshte si kapacitet. Vuan nga deliri i madhështisë. Po s'janë pa dëm këta!

— Qebiri është njëri i mirë, që nuk shtiret dhe e fiton bukën me djersë, — i thashë.

— Edhe unë kam njohur të tillë, — tha ajo. — Ka edhe ashtu, edhe kështu.

Prapa nesh ndali urbani. Unë hipa dhe Vjollca më përshëndeti me pëllëmbën e vogël.

3

Përjashta binte shi. Kishte një javë rresht që shiu s'pushonte. Isha në ditët e fundit të lejes së zakonshme dhe qeshë ngujuar brenda. Atë ditë po lexoja librin «Kujtime për Kapitalin».

Dikush përjashta shtypi butonin e ziles. E shtypi rëndshëm dhe s'e hiqte mollëzën e gishtit. Korridorin dhe dhomat u mbushën me alarm.

U ngrita dhe hapa derën. Ishte Sheremeti, burri i motrës sime, i Hatijes. Qe lagur. Çadrën me bisht druri të trashë dhe pa dorezë e mbante nën sqetull. Mushamaja ushtarake i kullonte.

Rrinte dy këmbë tej pragut të derës.

— Hyr! — i thashë.

Ai shikoi veten dhe tha:

— Ku të hyj, jam bërë ujë.

— Hyr, ore!

Hyri me ngathtësi. Mezi i gjeti vend çadrës dhe hoqi mushamanë. Pastaj zgjati buzët dhe më puthi fort. Streha e kapelës kadife më njomi.

Sheremeti qeshi. Kur po hynim në kuzhinë, tha:

— Do iki në spital.

— Pse?

— Gruaja e Qebirit është ligisht.

— Pse?!

— Sec i ra në një anë të gjoksit dhe ka të dhembura. Pimë kafe me surba dhe dolëm.

— Heee! — ia bënte rrugës Sheremeti.

Sheremeti ishte trupbëshëm e i lartë. Çapitej i sigurt dhe qe veshur mirë.

Arritëm në spital. U ngjitëm në katin e dytë dhe u kthyem në të majtë.

— Te dhoma katër, — na tha një sanitare.

Dera qe hapur. Kishte pesë shtretër. Pranë njërit shtrat, mbi një stol qe Ka... Qebiri. Koka i dukej e gjatë dhe e hollë. Mbi kofshët e shajakta, te prehri, kishte shtrirë krahun e zverdhur të së shoqes, mbështjellë me një peshqir të lagur. Një peshqir tjetër, po të lagur, ia kishte vënë mbi ballë dhe në tëmtha.

Kapakët e syve të saj ishin të rënduar. Të mbyllur.

Unë dhe Sheremeti shikonim drejt Qebirin. Gjithmonë, kur isha përballur me të, Qebiri, që në çastin e parë, kishte qeshur. E qeshura e tij ishte plot mirësi.

Por ato çaste s'qeshi. Na shikonte edhe ai drejt. Drejt. Pa folur. Sheremeti *hodhi* dy çape. Atë kohë Qebiri lëvizi, ktheu pak kokën nga e majta, uli pëllëmbën në faqe e te buzët e së shoqes dhe diç mërmëriti. Pastaj ngriti kokën, e uli dhe sytë e tij u mbushën me lot. Qante si fëmijë. Nyja e grykës hyri në punë të madhe.

— Po mbahu, mbahu! — i foli i vëllai, Sheremeti. Po supet e Qebirit kërcenin.

Vetëm pas njëfarë kohe heshti, fshiu dosido fytyrën e lagur dhe iu lut së shoqes që të hapte pak sytë dhe të shihte Sheremetin, të më shihte mua.

— Pa hapi sytë, hë, Kanakare! Ka ardhur Seferi. Seferi, moj, për kokën tënde!

Ajo merrte frymë thellë. Sheremeti hoqi nga zemra.

Dikush solli dy stola dhe u ulëm pranë shtratit, afër gjunjëve të Qebirit.

Njëzet minuta më vonë Kanakarja mërmëriti:

— Erdhi Seferi?

— Ëhë, erdhi, ja Seferi, Seferi, moj, — i thoshte Qebiri.

— Bën be, — mërmëriti ajo.

Qebiri bëri be për kokën e saj dhe të fëmijëve. Beja qe prekëse.

Ajo s'foli. Pasi u ngop me frymë thellë-thellë, ndryshe nga herët e tjera, belbëzoi:

— Qebir, ngremë kapakët e syve të shoh Seferin.

Zemra ime u drodh si kurrë ndonjëherë.

O njerëz të mirë, më falni! Më falni për pakujdesitë! Më ndjeni nëse ju kam lënduar ndonjëherë padrejtësisht!

— Ngriji! — mërmëriti ajo përsëri.

Mund të mos i kisha shkuar, dhe atëherë s'di në do të më kishte rënduar kaq shumë në ndërgjegje. Tani e dija mirë, më mirë se kushdo tjetër se qenia e saj, shpirti i saj e kërkonte këtë.

Unë isha njeriu me shkollë të lartë në fisin tim. Motra ime ishte martuar në fshatin tjetër. Njerëzit e Sheremetit, të burrit të motrës, gëzoheshin me mua. S'kërkonin asgjë materiale. Veç që të isha i tyre. Edhe i tyre. Se ata ende s'kishin një njeri me shkollë të lartë në fis. Unë isha ëndrra e tyre, si duket. Dhe ata më përqaфонin me mall e dashuri.

Buzët e së sëmurës u drodhën. Qebiri mundohej t'i shkolliste kapakët e syve.

— Mos e mundo, — i thashë.

Nëpër grykë më kullonin lot të hidhur.

Qebiri arriti t'ia ngrinte kapakun e sipërm të syrit. Sytë e saj ishin të zbërdhulët, të veshur nga njëfarë mjegulle e turbullt.

Ajo shikoi tek unë dhe u mundua të buzëqeshte. Shqiptoi emrin tim dhe tërë mundim, me dorën tjetër, preku dorën e Sheremetit.

Sytë e Sheremetit u bënë pellg.

— E sheh, ja Seferi, — i thoshte Qebiri. — Foli një fjalë Seferit!

Ajo u gëlltit dhe tha:

— Si e ke gruan?

— Hë, hë, fol! Po gruaja e Seferit i mban sytë hapur, — i tha. Ajo tundi pak kokën me një mendim të zymtë.

— Oh! — ia bëri ajo.

— Ç'ke, ç'ndien, — i pëshpërita.

— Një orë gjumë, një milion lekë, — tha ajo.

— Çfarë thotë? — thashë unë.

— S'fle dot, s'fle dot, — tha Qebiri. — Ngordhi për gjumë, po s'fle dot.

Ajo i mbylli sytë. S'foli më.

Hyri mjeku kardiolog. Pas ca dola me të në korridor.

— Ç'të të them! — tha ai.

U ktheva brenda. Sheremeti më shikonte drejt.

— Ç'të tha doktori? — më pyeti Qebiri.

Si t'u thosha? Si t'u thosha?!

Pas pak gruaja e Qebirit s'ndihej mirë. Erdhën me nxitim infermierët dhe kryeinfermieri. Thirrën mjekët. Bënë përsëri konsultë. Kur dolën në korridor, më thanë se ishte rëndë. I kishte rënë infarkt.

Brenda në tërë dhomën ndihej frymëmarrja e rëndë e gruas së Qebirit. Qebiri e fërkonte te kyçet e duarve e në qafë e fliste me vete:

— Vdekje, o vdekje! Po hiq, moj, nga gruaja ime. Hiq, mos më bjer më qafë, mos më lër pa short.

4

Atë pasdite u nisa urgjent me shërbim në Tiranë. Atë mesnatë gruaja e Qebirit kishte vdekur.

Oh! Sigurisht, kur e kanë varrosur është bërë qetësi dhe Qebiri, në heshtje, do t'i ketë thënë së shoqes që të mos ketë merak se djemtë do t'ia martonte. Me siguri.

Unë i vajta për ngushëllim në fshat gjashtë ditë më vonë.

Qebiri u ngrit i pari në këmbë, qeshi, zgjati buzët dhe më uthi me përzemërsi.

Folëm për të ndjerën dhe Qebiri tha:

— Atë ditë, natën vonë, ndali frymën. Po hë, ç'kemi? Si i ke fëmijët? Si e ke gruan? Po ajo shoqja që e njoha atë behar në anë të asfaltit në qytet? Sa vajzë e mirë! Më shihte mua, atje tek hëngrëm nga një të ëmbël, me sy të ngrohtë. Merri nganjëherë shokët e dilnani këtej. Me ç'të na ndodhet.

Përrjashta ishte bërë natë. Kuiste me të madhe një qen.

— Vraje atë qen! — mërmëriti plaka e shtëpisë. — Vraje, se më mori nusen.

Qeni, si për inat, kuiste kobshëm.

— Vrajeni, — tha plaka.

Qebiri shikoi nga ajo me dashuri e dhembje, shikoi nga unë dhe më tha:

— E vjetër nëna, tetëdhjetenëntëvjeçe, dhe i këndon mendja se qeni na lëshoi vdekjen. Helbete, plakë!

Qebiri shikoi radion. Ajo kishte një mbulesë të qëndisur me fjalët «Mirë se erdhët», një vazo dhe një tufë me lule butaforike. Te muri ishte fotografia e shokut Enver.

Qebiri shikoi andej, u zgjua, si të kujtonte diçka, dhe përplasi pëllëmbët sikur nxitoi të trembte heshtjen e ligë.

Ai qeshi dhe foli për të mbjellat.

Te shkallët përjashta u ndien çape. Po vinin njerëz të tjerë.

Era rrinte zgjuar te xhamat.

5

Në mëngjes nuk kishte erë. Në kasolle buluriti një viç. Qebiri i kërkoi të birit telegramet e ngushëllimit dhe m'i tregoi mua. Unë i kalova me radhë. Kur mbarova, Qebiri zgjati një telegram tjetër dhe tha:

— Po ky telegram, mor vëlla, nga vjen, se s'e kërrëjmë dot?

Ai shikoi djemtë me radhë. Njëri prej tyre tha:

— Ne s'e njohim këtë emër!

Unë lexova telegramin dhe m'u ngroh gjoksi. Telegramin e dërgonte Vjollca.

— Jo, moreee! — ia bëri Qebiri. — Hëk, hëk, hëk, më i lumtë! Bravo i qoftë! Hallall shkolla, ore!

Ai u mendua thellë dhe sytë iu rrëmbushëm me lot.

— Hajde, shkollë, hajde! E paç të gjatë, o vajzë, e paç të gjatë, o Parti e madhe, që rrite këto vajza e këta djem! Qofshi!

Ai hoqi hundët dhe qau i papërmbajtur. Unë gjithashtu fshiva sytë. Në përslagien e syve të mi lëvizte imazhi i bukur i Vjollcës.

Qebiri reshti dhe më pyeti gjatë për Vjollcën dhe prindërit.

— Është martuar? — tha ai.

— Po, — thashë.

— Ashtu? Ka marrë ndonjë si vetja, apo...

— Ka marrë një djalë shumë të mirë, — thashë.

— Të rrojnë, — tha. — Po ku?

— Në Tiranë.

— Jo, more! Po nga Tirana vjen telegrami?

— Nga Tirana.

Sytë dhe fytyra e tij shprehën habi, u mbushën me dritë.

— Po ku mësoi për hatanë tonë?

— Unë isha atë pasdite në Tiranë dhe që andej fola me spitalin këtu në rreth. Përjashta rastësisht gjeta Vjollcën dhe i thashë.

— Ashtu thuaj!

Qebiri uli kokën dhe trazonte prushin me një copë dru.

— Hë, ç'vajzë ka pjellë barku!

Pas ca ata hapën bisedën e varrit.

— Po, po, do t'i bëjmë varr të mirë, — tha Qebiri.

— Tërë jetën ka punuar.

— Do ta bëjmë, — tha djali i madh.

— Varri është gjë fisnike, — shtova unë.

— Gjë e bukur, — tha Qebiri. Ai foli me krisma, sikur do të kërcente.

Djali i madh mori një letër mbi oxhak dhe lexoi fjalët e epitafit.

— M'i përpiloi shkrimtari Altin, — tha i biri.

— Cili? — thashë unë.

— Një flokëdrudhë. U ndodha në qytet, kur ai po grindej me disa që s'e respektonin. Unë jam poet, u thoshte ai i shkreti, por ata talleshin. Unë e hoqa mënjana dhe e shpura në kafe. Ai tha se ishte poet dhe kishte botuar katër libra, dhe gjashtëmbëdhjetë të tjerë i kishte në shtyp. I dhashë kafe e fërnet dhe ai m'i shkroi në minutë vargjet për pllakën e varrit të mëmës.

Qebiri rrinte si pa frymë. Ai kishte shtrembëruar mjekrën dhe dëgjonte me vëmendje. Fytyra i qe trishtuar.

Në fund ktheu kokën dhe më shikoi drejt.

— Si thua ti, Sefer? — tha.

Unë s'dija ç'të flitja. Isha në mëdyshje. Por epitafi i atij shkrimtari llafazan e të paskrupull, që thërriste nëpër rrugët dhe zyrat e qytetit, s'më pëlqente. Ato fjalë ishin turp. Për herë të dytë s'mund t'i dëgjoje.

Qebiri sikur nuhati diçka dhe më pyeti përsëri. Dukej sheshit se atij s'i pëlqenin ato fjalë. Hyri motra ime dhe pyeti se për se bisedonim.

— Ç'mendon ti? — më tha prapë Qebiri.

Motra më pa në sy. Unë kujtova diçka, kujtova edhe të ndjerën dhe thashë:

— Ajo qe punëtore.

— Punonte kiamet dhe ishte pa gojë, — tha Qebiri me nxitim. — Bam e bum në punë, tërë jetën.

— Pra, ishte e ndershme, — thashë sikur t'i flitja vetes. — Njeriu që punon, shpesh është i ndershëm.

— Hë, të paça!

— Ajo gjithashtu i donte njerëzit, se njeriu që punon, e do njeriun, atë që punon.

— Pyet kë të duash, — tha Qebiri.

— Ndoshta mund të bëhet kështu epitafi, — thashë. Ata më shikonin drejt pa lëvizur.

— «Këtu prehet Kanakare Llakatura. Lindi në këtë vit dhe vdiq në këtë vit. E donte punën, pra qe e ndershme. I donte njerëzit që punonin. I donte shumë bashkëshortin dhe fëmijët». Diçka e tillë, mbase, — thashë.

Qebiri ngriu. Gropat e syve iu lagën përsëri. Pastaj brofi dhe më përqafoi.

— Jemi të punës ne, — mërmëriti. — Kështu po, — tha pas pak dhe u ul.

— Kështu do ta bëjmë, — foli prerë djali i madh.

U ngrita. Dolëm përjashta. Qebiri vinte pas meje. Kur zbritëm shkallët, ai më propozoi:

— Dalim nga pas shtëpisë të shikojmë kopshtin.

Ai ecte përpara. Drurët e pemëve ishin të zhveshur, po limfa lëvrinte.

Qebiri ndaloi dhe preku me dorë një fidan.

— Kjo është hurma e re, — tha. — S'ka ca që e mbolli Kanakarja. Ja, po çel, shih sa e ka rritur sythin. Pranvera po vinte nga sythet.

NJERIU I PUNËVE TË MIRA

1

Herën e fundit që u ndodha atje, ai pothuaj çdo ditë më ftonte që të rrinim bashkë. Më ftonte në shtëpi, por unë ngurroja të shkoja shpesh. Vajza e tij ishte e bukur dhe prania e saj më shqetësonte.

Kishte qëlluar dy herë rresht që ajo të trokiste lehtë në derë, duke thirrur: babi, babi, kur ne të dy ishim brenda në shtëpi. Ai nxitonte të hapte derën. Ajo hynte. Ishte e lehtë dhe gjithçka në të ishte e lëmuar. Qerpi-kët i kishte të gjatë e të kthyer dhe buzët e vogla ngjyrë vishnje dukej sikur vazhdimisht digjeshin në një zjarr të pashuar. I ati i trazonte flokët dhe i puthte duart. Ajo më përshëndeste mua dhe, si lëshonte çantën, niste të luante në piano.

Pas këtyre unë tundohesha dhe herën e dytë ika pothuaj papritur. Më tundonte ajo bardhësi e mjellmët dhe e brishtë. Liqeni i mjellmave, më dukej sikur mërmërinte ajo. Silueta e saj më shfaqej si një urë e hollë e bardhë. Po...

Ndaj nuk shkoja më tek ai. Ai vinte tek unë në hotel dhe dilnim bashkë.

Kishte disa ditë që iknim herët në mëngjes dhe drekën e darkën i hanim te kampi që ndodhej në malin në lindje të qytetit. Aty ende nuk kishin ardhur kampistët, po neve na pëlqente ajo qetësi e ajo freski e mbushur me magjinë e fshehtë të drurëve dhe të mjegullës që e gjenim aty çdo mëngjes. Ajo ngjante si një qenie e gjallë që befas kishte ndalur në ato vise. Ajo ndodhej edhe poshtë nën ne dhe diku tej saj shtrihej qyteti.

Qytetin nuk e shquanim dhe ne rrinim ashtu shumë kohë e mugëtira e saj e bardhë na ngacmonte shumë ëndrra e kujtime. Rrinim aty derisa lëkura e saj e lagur na bënte të kishim ftohtë. Ngriheshim e largoheshim. Këpucët dhe fundet e pantallonave na lageshin dhe e ndienim se si shtyhej mjegulla ngadalë. E dinim se pas pak ajo do të pushtonte tërë malin, drurët e njomë dhe drurët pleq, ndërtesën e gjatë të kampit dhe repëtorin. Ajo do të mbulonte gjithçka dhe ne do të shndërroheshim në silueta dhe, me siguri, do të dukeshim si njerëz të huaj, të viseve shumë të largëta, të atyre viseve ku kishte shumë pyje të lashta, ndoshta që nga krijimi i botës, shumë pometa e dëborë.

Ecnim dhe na dukej si një ëndërr e çuditshme e fluide se diku poshtë nesh ishte qyteti me rrugë të gjera, me pallate moderne, me kinema dhe kafe «Jug» aq të dashur për ne. Na pëlqente shumë që ndodheshim aty dhe që e donim shumë qytetin.

Kur mjegulla kishte mbuluar gjithçka, hynim në sallën e gjatë të bufesë dhe, ndërsa unë lexoja ose shkruaja, shoku plotësonte etyde ose skiconte, duke vërejtur që brenda dritares së klubit.

Aty hanim drekë, aty pastaj flinim dhe pasdite shëtitnim në pyll. Na pëlqente mjaft që deri në njëfarë vendi rrugët që hynin në pyll ishin të shtruara me asfalt. Anës tyre kishin mbirë barëra nga më të ndryshmet dhe mua më vinte keq që dikush i kishte shkëlur ato.

Shoku im ishte i moshuar, po bëhej krejt si fëmijë kur

shëtiste nëpër pyll. I donte shumë lulet, aq sa thoshte se, po të mos ishte marrë me pikturë, patjetër do të ishte bërë botanist.

Disa vjet më parë, te Lugu i Qëne kishte zbuluar një lule të rrallë, të cilën e pati hasur në malet e Francës kur ishte student. (Atëherë, në pushimet e verës, vazhdimisht humbiste nëpër vise të bukura të maleve të Francës dhe krijonte koleksione lulesh.)

Në mbrëmje, kur kishte zbritur në qytet, ai kishte ngritur receptorin për të njoftuar profesorin N, që ishte punonjës shkencor. Profesori kishte qeshur në anën tjetër të receptorit dhe i kishte thënë se ajo lule vërtet ishte e rrallë, por ai e kishte zbuluar para shumë vitesh te Lugu i Qëne.

Kështu ne diskutonim gjatë për lulet. Pastaj ktheheshim përsëri dhe punonim deri vonë në mbrëmje, derisa shoferi i njëres nga makinat që ktheheshin të ngarkuara me dru, i binte borisë fort, dy-tri herë rresht. Atëherë zbritnim në qytet.

Në qytet pinim edhe nga një kafe dhe ndaheshim.

Në mbrëmje shoqja e sportelit më tha se e kishin marrë çelësin dhe unë e kuptova se në dhomë ishte dikush.

Ndërmjet boshllëkut të perdeve hynte në dhomë një rreze drite. Ndeza abazhurin dhe u zhvesha. Sepse ndjeva njëfarë boshllëku që më rëndoi. Në përgjithësi jetoja midis njerëzve. Dhe udhëtoja shpesh. Atje në qytetin e madh gjithashtu kishte shumë njerëz dhe shumë mjedise. Po fare pakuptuar sikur po mënjanohesha. I vetëm me profesorin kaloja ditën. I vetëm? Po unë i kisha vënë vetes për qëllim që të bëhesha artist. Po a mund të rritesh si artist i vetëm midis librave apo duke u shoqëruar vetëm me

një njeri? Rri dhe dëgjoj profesorin. Ai ka rrëmuar në libra. Po në jetë? Piktori Kamil Koro ka shënuar se *tallazi është vecoria e jetës*. Shkrimtari duhet të japë lëvizjen e jetës. Koroja thotë se piktori duhet «të bëjë një punë të pareshtur». «Shkrimtari doemos duhet të jetë në vorbullën e jetës, ta regjistrojë atë pareshtur. Unë, kaq i ri, kaq ditë që jam ndarë nga jeta e gjallë! E?! Profesori im... Ndoshta nga kjo ndiej këtë boshllëk që më rëndon?!

Mendoja kështu edhe sillesha me kujdes që të mos e zgjoja atë që flinte. Atë që flinte përbri?! Kushedi që nga vinte. Kishte fytyrë të lodhur, të gjerë, me shumë rru-dha. Në mes të ballit kishte një gropë. Po nuk e dalloja mirë. Në gjysmerrësirë konturet e fytyrës së tij dukeshin të mëdha. Shikova rrobat e tij. Pantallonat ishin prej stofi të trashë me kuti, po ngjyrën s'ua dalloja dot. Kishte rrip të gjerë e të trashë me një tokëz metalike që ndriçonte. Rrobat e tjera i kishte në varëse dhe drita e abazhurit s'arrinte gjer atje.

U shtriva dhe rregullova dritën. Mbi abazhur hodha peshqirin, në mënyrë që drita të binte vetëm mbi faqen e librit ku lexoja.

Ndërsa lexoja, më kujtohej përsëri piktori me të cilin shkoja në mal dhe pasioni i tij për lulet.

Por ai nuk u bë botanist. Një çast ne ishim ulur pranë një druri plak dhe piktori po shikonte me kujdes kërcellin e lules. Duke folur për njerëzit, ai, më në fund, tha se vuante nga një e metë e madhe, të cilën s'kishte mundur ta ndreqte: Ai nuk mundej, nuk kishte aftësi për t'u afruar me njerëzit. Kjo më ka dëmtuar rëndë, tha piktori, duke sjellë nëpër duar kërcellin. Ai e tha këtë me dhembje të thellë dhe unë e turbullova aq, sa nuk doja që ai të fliste për këtë çështje.

Unë s'doja ta dëgjoja këtë. S'doja që edhe vetë të vua-ja nga kjo e metë.

Kisha ndërprerë leximin dhe në faqet e librit nisi të ngjitej mjegulla që zvarritej si një qenie e gjallë pre-historike, brenda së cilës jetonin shkëmbinj, drurë, zogj dhe makina, të cilat ngjiteshin në rrugën që kacavirrej

malit. Imazhi i saj i vërtet më ngjante si një qenie e gjallë që pushtonte këto vise, që herë e rrethonte dhe e humbiste figurën e piktorit të moshuar, që trishtohej atje pranë drurit plak, duke ndier dhembje për një të metë, të cilën s'kishte mundur ta ndreqte. Mjegulla e dendur qëndronte atje një kohë të gjatë dhe unë çuditesha sesi ai piktor e kishte pasur të vështirë të afrohej me njerëzit.

Një çast pata mëshirë për piktorin, se mjegulla e mbuloi atë krejt, po pastaj ajo u shkri dhe unë dallova drurin e lartë me trung të madh të vjetër dhe atë me kërcellin e lules në dorë.

Dikur piktorin e kisha pasur mësues vizatimi. Ishte njeri i qetë dhe qeshte rrallë. Në shkollë, ishte mësuesi që bënte më pak shoqëri me të tjerët. Në qytet çelëshin ekspozita dhe ai merrte pjesë, por asnjëherë s'kishte pasur sukses. Vërtet asnjëherë.

Herët, fare herët, shumë njerëz shikonin tek ai artistin e përgatitur, me erudicion dhe e lëvdonin, e lëvdonin duke gjykuar kështu mbi një përshtypje të turbullt, po pranë tablove të tij nuk qëndronin gjatë. Askush s'mund të shpjegonte ku qëndronin vlerat e atyre krijimeve.

Po kjo ndodhte atëherë, herët.

Midis tablove dhe vetë mësuesit të vizatimit kishte diçka që i bënte të ngjanin. Ai ishte njeri krejt i veçantë, i zbehtë, i vakët, pothuaj i përhumbur. Edhe duke qëndruar para tablove të tij, të duket sikur syri dhe zemra e piktorit s'janë gëzuar asnjëherë.

Në pikturat e tij nuk ka shqetësime dramatike apo romantike. Në to ka stisje. Peneli i tij ka lëvizur i drujtur, a thua se ka pasur frikë nga drita e diellit dhe ajri i pastër, nga madhështia e maleve, nga punëtori me kominoshe dhe zetori. Ngjyrat në tablotë e tij janë tepër të varfra. Ai gjithmonë ka kërkuar një të bukur jashtë bukurisë tokësore.

Flet gjatë për Rafaelin e Rubensin. Ai flet gjithashtu shpesh për Zherikonë, për tablonë «Shitblerja e zezakëve» dhe veprën e mahnitshme «Koka e një zezaku».

Flet për Sikejrosin, për Rembrandin, El Grekon, Velas-kezin, Sezanin, Van Gjogun, Gogenin, Matisin etj. Dhe, po qe se ti e dëgjon me vëmendje, ai mund të flasë me orë të tëra rrjedhshëm, duke të shikuar drejt e në sy. Edhe kur mbaron, lëviz mollëzat mbi tavolinë, qesh dhe vësh-trimi i tij i ngulur sikur të thotë «E shikon! Unë nuk jam kot në art.».

Unë vërtet ndihem fare i vogël para tij. Në erudicion Vetëm në erudicion. Ndërsa këto ditë ai është kaq i thjeshtë; merret me mua!

Në pikturë vazhdon të punojë me këmbëngulje dhe di-sa mëmëritin se «tani është bërë kaq i mërzitshëm, sa na lodhi».

Megjithatë ai vazhdon udhëtimin e tij të pandalshëm. Bashkudhëtar i padobishëm, por i pashkëputur. Këta e shoqërojnë tërë jetën artin. Sigurisht sa janë gjallë. S'është e mundur t'u thuash: «Hajt, përjashta, bëni një punë tjetër më të dobishme!» Jo, kjo është e vështirë, të jemi realistë.

Ndonjëherë unë i tregoja ngjarje nga jeta, ngjarje fare të zakonshme dhe ai dëgjonte sikur flitej për gjëra fantastike. Ç'imazhe të bukura, mëmëriste ai dhe pshe-rëtinte. Ç'imazhe!

Pastaj thyente një nga gishtërinjtë e duarve dhe më kapte nga bërryli, Unë e kuptoja dëshirën e tij: donte të vazhdoja tregimin. Rrëfimet e mia i mbledh si pasuri të çmuar. Këtu ka edhe letërsi, edhe pikturë, thoshte ai Ai sikur s'dinte ç'të bënte me atë jetë që i dhuroja unë. Ai kështu bëhej si i fantaksur (më dridhet zemra dhe më vjen ligsht që them i *fantaksur* po... pa të jemi realistë), binte në pre.

Më ftonte në shëtitje me njëfarë përkujdesjeje të tep-ruar dhe të trembur. Më duhej të isha i *tij*. Unë mund të milesha. Ndërsa një miku im, mjeshtër i letërsisë, kur lexoi një tregim nga unë, lëshoi pëllëmbën e dorës mbi të, ngriti mjekrën dhe tha: «A e di objektin e artit, mor dja-lë?... Duhet jetë. Njih jetën...».

Këto po mendoja i vetëm, atje i shtrirë brinjas në kre-

vatin tim në atë dhomë dyshe në hotel. U përmenda kur njeriu që ishte në krevatin tjetër lëvizi dhe u kthye me fytyrë nga unë.

Çeli sytë dhe më shikonte. Unë nisa të lexoja. Ai shikoi një copë kohë po, meqë unë s'i ngrita sytë ta shihja, uli fletët e qepallave.

Ndoshta nuk kishte kaluar as gjysmë ore, kur i huaji lëvizi përsëri shpatullat dhe përsëri u kthye nga unë. Çeli sytë dhe më shikoi drejt. Ndjeva të dridhura nga mënyra se si shikonte ai, ndaj mbylla librin e fika abazhurin.

Ai u soll nëpër shtrat dhe fare vonë, pas mesnate, nisi të gërhiste.

2.

Të nesërmen piktori trokiti përsëri herët dhe më foli me zë të lartë se më priste përjashta në trotuar.

U mundova të dilja pa bërë zhurmë, po shoku i dhomës u zgjua dhe u ngrit përgjysmë.

Nuk foli. As unë nuk fola. Ai shikonte nga unë dhe m'u duk njeri tepër i çuditshëm.

E përshëndeta vetëm duke tundur kokën dhe dola.

Në mbrëmje, kur ngjita shkallët, m'u kujtua përsëri banori i dhomës. Mbase sonte nuk do të jetë, mendova.

Por, kur hyra brenda, ai ishte përsëri atje në shtratin në të majtë. Pantallonat e trasha me katrorë dhe rripi i gjerë me tokëzën metalike ishin te vendi, sikur ai të mos i kishte lëvizur. Ashtu si një natë më parë, qëndronin të varura rrobat e tjera.

Ai flinte. U shtriva dhe ndeza abazhurin.

I huaji lëvizi në shtrat. Unë ndenja një çast pa lëvizur. Ai përsëri lëvizi dhe unë mendova se patjetër i huaji vuante nga pagjumësia e unë po bëhesha shkaktar për ta shqetësuar. Atë patjetër e ngacmonte drita.

Fika abazhurin. U shtriva më mirë në shtrat. E kam të vështirë të më zërë gjumi pa lexuar. Gjithmonë lexoj diçka para se të fle.

Nisa të mendoja për shtëpi. Kur do të merrja shtëpi? Nuk ka gjë më të rëndë sesa të jetosh pa shtëpi, diku larg familjes. Megjithatë duhej të prisja. Patjetër që një ditë do të më lajmëronin të shkoja e të merrja çelësat e apartamentit.

Ishte vonë pas mesnate. Përjashta po pastronin bulevardin.

Nëpër të çarën e perdes, në dhomë hynte një rrip drite. Befas m'u kujtua Mari Kyri. Nuk di pse m'u kujtua pikërisht ajo dhe nisa të mendoja për radiumin. Po unë dija fare pak gjëra për të...

— Kthehesh vonë.

Një çast u rrëqetha, pastaj e kuptova se ishte zëri i atij tjetrit atje përskaaj komodinës.

— Po, — thashë dhe nisa të vrisja mendjen për të kuptuar se sa kohë mund të kishte kaluar që nga çasti kur fika abazhurin dhe se si e merrte me mend ai që unë isha ende zgjuar.

— Ata librat t'i rregullova, se i kishe hedhur andej-këtej, — tha me një ton më të rreptë.

Unë s'foli. Ai lëvizi në shtrat. Me siguri u khye me fytyrë nga shtrati im. Nuk lëviza.

— Edhe tavolinën mos e luaj nga vendi, — tha.

Unë përsëri s'foli, po kafshova buzën e poshtme. Nuk dija si t'i përgjigjesha. Është e vërtetë që tavolina në mes të dhomës më shqetësonte, po këto dy ditët e fundit s'e kisha lëvizur.

— Tavolina e ka vendin këtu, — tha ai dhe me siguri tergoi vendin me dorë, sepse lëvizën mbulesat.

Pas kësaj unë mëmërita sikur pohova diçka.

Heshtje. Shikoja rrezen e hollë të dritës që depërton-te midis perdeve dhe më dukej sikur ajo ishte diçka e gjallë, me jetë.

— Ti vjen vonë, — tha përsëri ai.

— Po, vij vonë.

— Gjithmonë?!

Zëri i tij sikur ndryshoi dhe tingëlloi më intim.

Si të qëllojë, herë-herë.

S'dija si t'i përgjigjesha.

— Duhet ta ruash shëndetin, — tha ai.

Unë s'fola. Pas kësaj, figura e tij nisi të më tra-zohej. Ndoshta do të jetë nga ata udhëtarë që s'i zë gjumi dhe që kanë qejf të bisedojnë, mendova. Këta njerëz shpeshherë e nisin pikërisht kështu bisedën.

— Me shëndetin nuk luhet, — tha ai dhe në shtra-tin e tij lëvizën mbulesat. — Ruaje, djalë!

— Keni të drejtë. Unë do të kujdesem më shumë për shëndetin.

Heshtje. Ndihej frymëmarrja e tij.

— Hape dritën, po deshe, — tha ai pas ca.

— S'ka nevojë, — thashë.

— Hape, hape!

Befas ai u ngrit dhe çeli dritën e dhomës. Ishte ashtu me një palë brekë të bardha, të gjata gjer te gjunjët dhe me një fanellë leshe me gjysmë mënge, të thurur me dorë. Këmbët i kishte të shkurtra, të trasha, krejt të bardha e me damarë të kaltër. Unë mendova se si do të dukej ai në mëngjes, pasi të ishte larë dhe të ishte veshur.

— Mos u pengo në punë, — tha ai dhe kroi sqetullën e majtë, duke ngritur mjekrën lart.

Tek e shikoje ashtu, mund të të vinte për të qeshur, po në të njëjtën kohë të ngacmonte mendimi se nuk duhej kurrsesi të qeshje me të, sepse një gjë e tillë nuk mund të ishte aspak serioze.

Ai ngacmoi edhe diçka te gjuri dhe u ul buzë kre-vatit të tij. Unë çela abazhurin dhe nisa të lexoja. S'më ndaheshin nga sytë vetullat e tij si furçë. Ai me siguri më ndjek mua tek lexoj, thashë me mend.

— Keni shkruar libra ju? — pyeti pas pak.

Ngrita kryet. Ai qëndronte atje buzë shtratit të tij me krahët e mëdhenj të lëshuar mbi gjunjët e skuqur.

— Po, — thashë.

— Atë që ka një njeri në kapak?

— Po, thashë.

Heshtje. Ai fërkoj gjurin dhe ngacmoi diçka në shpatullën e djathtë.

— Kam leje ta lexoj?

I hodha librin tim.

Ai nisi të lexonte dhe unë vazhdova të lexoja i përqendruar.

— Ç'do të thotë ky rreshti këtu? — tha ai.

E ngrita kryet menjëherë. Njeri i bazdisshëm, mendova.

Ai u çua nga krevati ashtu në brekë dhe me librin në dorë erdhi pranë meje.

— Ç'do të thotë ky rreshti këtu?

Unë lexova atje.

— Pse kështu? — tha përsëri ai.

— Po si!? — thashë.

— Jo kështu, — tha ai.

Unë nuk fola.

— «Rrëshqita shikimin nga këmbët tona gjer tej në të majtë», — lexoi.

— Po! — thashë unë.

— Si «po»?! — tha ai. — Ç'do të thotë «rrëshqita shikimin...»?!

— Ashtu! — mërmërita unë.

— Nuk thuhet kështu, — tha ai. — Unë nuk bëj dot libra, po në gjuhën tonë s'tuhet kështu,

— Nga vjen ti? — e pyeta.

Ai qeshi si të kishte përpara një fëmijë.

— Kështu, — tha. — Jo «rrëshqita shikimin!». Nga larg vij, nga jeta. Bëjmë punën që mundemi. Që të ruajmë jetën. Të gjithë përpiqemi nga pak.

Fjalët e fundit ai i tha shpejt.

— Atje banon? — thashë dhe në çast e kuptova se ai s'kishte thënë ndonjë emër fshati apo qyteti.

— Në vendin tim banoj, — tha dhe shkoi në shtrat.

— Kam ardhur me leje. Sot u bë operacion vajza e një mikut tim dhe isha në spital. Flemë?

Ai e tha këtë fare papritur dhe hyri në shtrat. U bë qetësi. Unë nisa të lexoja.

Po. Ai nuk donte ta pyesje më gjatë.

Duhej të ishte njeri që punonte dhe jetonte për njerëzit, po duhej të ishte i heshtur. Këtë ia kërkonte detyra. Edhe heshtjen. Me siguri. Që unë të isha i lirë dhe të mos më shqetësonin. Që Atdheu të ishte i sigurt dhe njeriu i mirë të ishte i lumtur. Që të mos na prekte askush.

Patjetër që edhe ai kishte dëshira dhe trille të tjera të çastit. Edhe njeriu i mirë, që punon e lodhet, edhe ai ka dëshirë të flasë për punët e veta, po detyra kërkon që të heshtë. Të heshtë për punë të mbara.

Ndoshta ky ishte një nga ata të heshturit e punëve të tjera të mira, të vështira.

Unë e mora për të tillë dhe e shikoja me dashuri.

— Tavolinën mos e lëviz më, — foli përsëri që tej nga shtrati i tij. — Ti e lëviz tavolinën nga vendi dhe e vë atje në fund. Ajo e ka vendin aty. Pse e prish bukurinë?!

Atë kohë dikush trokiti mbi dhomën tonë. Ai u zbulua përgjysmë dhe shikonte në tavan. Në dyshtim dhe dhomës që ishte mbi ne vazhdonin të goditnin me diçka.

— Ka rregull apo jo? — tha ai i nxehur dhe u ngrit. U vesh dhe doli në korridor. Unë ndoqa çapet e tij derisa ato u fashitën.

Pas pak, sipër u dëgjua kërkëllima e shuar e një dore që u hap dhe goditjet pushuan.

Mua m'u përqs figura e piktorit. Ai këtë çast fle gjumë të qetë. Tërë jetën ka rrëmihur në libra dhe tablorë. Ndërsa ky njeri «nervoz» shumë ditë dhe shumë net ka bërë gjumë të shqetësuar. Që të zbonte të keqen. Me siguri.

Ai zbriti në dhomë dhe tha:

— Ishin të huaj.

Fiku dritën dhe u zhvesh. Kur hyri në shtrat tha:

— Abazhurin mos e fik, lexo. E kuptoj që ti s'fle dot pa lexuar.

Unë hodha peshqirin mbi abazhur dhe mendja përsëri më shkoi te heronjtë e heshtur.

— Lexo, lexo, — tha ai,

Heshtje e gjatë. Rrezja e dritës që hynte nga të çarat e perdes dukej si qenie e gjallë, ndërsa drita që shpërndante abazhuri, si një qenie e butë, e druajtur. Tjetri mbuloi kokën me çarçaf. Pas ca e uli çarçafin dhe shikonte në tavan.

— Shkruan libra, ë?

— Po, mundohem, — i thashë.

Ai u vërtit nëpër shtrat.

— Bukur, — tha. — bukur!

Mori frymë thellë dhe shfryu si një kaçup që e shpojnë. U ngrita përgjysmë dhe largova peshqirin nga abazhuri.

— Trego, — i thashë. — Tregomë ndonjë gjë!

S'u përmbajta se, ngaqë po i kërkoja diçka, ndoshta s'duhej të përdorja pikërisht fjalën: trego! Pas kësaj, në mënyrë të rrufeshme, m'u kujtua përsëri piktori i moshuar. ulur atje pranë drurit plak me kërcellin e lules në dorë dhe mërmërima e tij e dhimbshme që thoshte se e kishte pasur vështirë të afrohej me njerëzit, m'u përfytyruan drurët e pyllit, shkëmbinjtë dhe mjegulla që ecte ngadalë, sikur nuhaste me vëmendje dhe mbulonte gjithçka.

— Vazhdo, — i thashë dhe zëri im m'u duk i ftoh-të e i panatyrshëm.

Po ai s'kishte filluar të tregonte asgjë. Më shikonte me dashuri, sikur t'i ngjaja me një të dashur, po që s'mund t'i shfaqej.

— Herë tjetër, — tha dhe mbuloi kokën.

Përsëri m'u kujtua piktori që kundronte kërcellin e lules. Si do ta zbulonte ai botën e këtij njeriu?

— Nesër do ta pimë kafën bashkë, — tha shoku i dhomës. — Ti asnjë mëngjes s'ke pirë kafe me mua.

— Mirë, — i thashë.

— Ashtu de.

— Mirë.

Ai lëvizi në shtrat dhe ktheu fytyrën nga muri.

— Do fle një javë plot me ty këtu në dhomë. Nesër do pimë kafën. Mirë?

— Mirë.

Ai ofshau. E ndieja se si i ngrihej e i ulej gjoksi i gjerë, por i shtypur. Disa herë u rrotullua nëpër shtrat. Pasta j nuk lëvizi më. Merrte frymë thellë. Unë nuk mund të përqendrohesha në libër. E fika abazhurin.

Ai nisi të lëvizte përsëri në shtrat. Pas pak u qetësua dhe filloi të gërhiste fort. Herë-herë llahtarisej në gjumë dhe thërriste fjalë që s'i kuptoja. Këtë ai e bëri disa herë dhe unë e pata të vështirë të mbyllja sy.

Rrija shtrirë dhe mundohesha të përfytyroja jetën e tij. Ai më përqasej si një forcë e mirë, që vërtitej të më mbronte nga ligësitë.

Në mëngjes, kur hapa sytë, ai ishte rruar e ishte larë dhe rrinte në këmbë në mes të dhomës.

— Shkrimtari! — tha dhe qeshi, sikur më përkëdhelte siç përkëdhelin fëmijën.

U lava dhe unë dhe dolëm së bashku. Hymë në kafe «Jug», përballë hotelit. Kur erdhi kamerierja, unë përshëndeta një moshatarin tim që ishte ulur më tej.

— Ç'është ai? — tha shoku i dhomës.

— Një koleg, — i thashë.

— Shkrimtar?

Shoku i dhomës shikoi nga ai dhe i buzëqeshi. Edhe shoku im buzëqeshi përzemërsisht.

— Shkrimtar, ë?

— Po, nga ne të rinjtë.

— Ç'do merrni? — tha kamerierja.

— Një lëng molle, — thashë unë.

— Çfarë do merrni?! — më pyeti edhe shoku i dhomës disi i habitur.

— Lëng molle.

— A! Mua një kafe e një konjak.

Kamerierja u largua. Ai nxori paketën dhe tha:

— Shkrimtar! — Dhe vetullat i lëvizën. — Pi lëng molle! Po konjak, po kafe?

Ai thirri kamerieren dhe i tha që t'i çonte atij shokut tim letrar atje tej një kafe e një konjak.

— Si urdhëron, — tha ajo.

— Ashtu, — mërmëriti ai.

— Ju mbrëmë nuk e pinit cigaren, — thashë.

— Në hotel, me të huajin, s'mund të pi cigare, — tha ai. — Ka rregull.

Kolegu përshëndeti. Shoku im i dhomës ia ktheu përshëndetjen tërë përzemërsi. Ata të dy ngritën lart gotat e konjakut.

— Lëng molle! — mëmëriti shoku i dhomës dhe buzëqeshi e tundi lart kryet.

Unë duhet ta kem parë i nemitur.

— Duhet të pushosh patjetër. Mos rri vonë natën, — më tha.

— Unë e shikova drejt.

— Kujdesu për shëndetin! Duhet të pushosh. A do të pushosh në Tushemisht? Aty kam një mik të afërt dhe të siguroj. Pusho në Tushemisht!

— Mirë, — thashë. — Unë do të pushoj në Tushemisht.

— Të siguroj unë, — tha:

Ai tha kështu dhe sikur iu shqetësuan bebëzat dhe qerpikët e syve. Sikur u mundua të largonte përلاغien e tyre. Nofullat iu drodhën pakëz, po me shqetësim. Lëkura te kombi i grykës iu rrudhos.

Mos i ngjasova me ndonjë të afërt, të cilin s'duhej ta shihte? S'duhej ta puthte?

E mblodhi veten, bëri shuplakën si kupë dhe ktheu fundin e gotës.

— Tani do paguajmë hotelin dhe do nisemi për punë. Natën do bisedojmë. Mirë?

— Mirë, — i thashë. — Do fle edhe në drekë.

— Fli, — tha. — Ti duhet të flesh.

— Do fle.

Ai ishte bërë i butë dhe tani më dukej edhe më i afërt.

— Ti mbrëmë gërhije dhe thërritje diçka nëpër gjumë. Thërritje sikur kërkoi të largoje dikë, — thashë.

— Ashtu?!

Ai ktheu përsëri gotën në kupën e dorës.

— Po, gërhije dhe flitje me zhurma.

— Përsëri!

Atij i shkoi buza shtrembër. Mërmëriti:

— Domethënë përsëri?!

Sytë e tij kërkonin vend ku të nguleshin.

Thirri kamerieren dhe pagoi. Tani u bë më i hesh-tur dhe në fytyrë i ranë rrudha të tjera.

Në rrugën midis kafenesë dhe hotelit u takua me një burrë të lartë e të bëshëm. Unë prita më tej. Pas ca ai tha:

— Zëre hotelin, unë paguaj më vonë. Mirupafshim!

Në çast erdhi një automobil, ndaloi, ata dy hipën dhe automobili nxitoi.

Ashtu i ngrirë shikoja akoma rrugën nëpër të cilën po humbiste automobili. Pas ca ndjeva dikë që më vuri dorën te supi. U ktheva me ngathtësi.

— Më trego ndonjë gjë, — tha.

Unë e pashë me habi dhe hutim.

— Hë, thuamë diçka!

— Për çfarë?!

— Për të, — tha.

— Për kë?

— Për atë që pive kafe dhe e përcolle.

Unë shikova në sy Fredin. Fredi ishte marangoz dhe unë e kisha mik.

Ai tha:

— Ç'u hutove, a derëbardhë?

— Unë piva kafe se fle në një dhomë me të, — i thashë.

— S'e njeh?

— Jo.

— S'e njeh?! Ai është Hero i Popullit, hero i hesh-tur.

— Hero?

— E, — foli. — A e di çfarë tha kur i dorëzuan de-
koratën?

— Nga ta di? — mërmërita. — Ai nuk më tha asgjë.

Unë s'e njihja.

— I dërguari i Byrosë Politike të Komitetit Qen-
dror që i dorëzoi dekoratën, kur po pinin kafe, e py-
eti: «Ç'do të thuash?»

— Dhe ç'tha ai?

— Ai u mendua, pastaj mërmëriti: «Diku në Veri thonë: Trimit, sa është gjallë, mos i ngri këngë, se ka kohë me u koritë».

— Isha pranë tij dhe...

— Gjyshi i tij ka këngë. Ishte gjashtëdhjetë e nëntë vjeç në Luftë dhe ballistët e mbyllën në burg. Në kutinë e duhanit, midis letrave të cigares, i gjetën një yll partizan. I thanë që ta pështynte yllin, po ai s'e bëri atë. Pështyu ballistët. Atëherë ata i nxorën syrin e majtë dhe e kalbën në tortura, ndërsa syrin ia lanë varur. Ashtu e vranë. Ky nipi i ka të rrallë shokët. Hero i heshtur. O, sa dëshirë kisha të rrija pak me të!

— Të rrije me të? — mërmërita.

— Eja të pimë kafe, — tha.

Unë u hutova dhe e ngushëllova veten duke menduar se do të vinte mbrëmja dhe me të do të ishim bashkë në një dhomë.

Në mesditë s'munda të kthehesha në dhomë. Në mbrëmje u ktheva shpejt. Në sportel s'ishte askush. Zilja e telefonit të bardhë tingëllonte pa pushim. Mora çelësin e dhomës dhe u ngjita lart.

Në dhomë, pranë abazhurit, ishin dy copa letre të vogla. Ato ishin letra të vogla, të shkëputura nga një bllok i zhubrosur. Germat ishin të shtrembra, të shkruara me laps kopjativ. Në njërën shkruhej:

Shoku Damjan, më falni që po largohem nga dhoma. Ashtu më doli një punë. Përsëndetje miqësore, L.B.

Në copën tjetër të letrës ai i drejtohej një emri krejt të panjohur për mua, që punonte diku në Tushemisht.

Të strehoni patjetër për pushime shokun tim të mirë Damjan C. Të fala L.B.

Unë ngela me ato dy copa letra në dorë. Nuk më besohej që ai s'do të vinte më në dhomë.

Ku të ishte tani?

U shtriva në krevat me gjithë rroba dhe në mend me kaloi figura e piktorit të moshuar. Tërë pasditen ai mblodhi lule dhe i bëri tufë. Ku është këtë çast piktori? Mund të jetë në shtëpi dhe vajza e tij luan në Shubertin, ndërsa ai dëgjon dhe lulet e mbledhura në tufë dridhen. Unë kam shkuar në shtëpi të tij. E bija vinte nga shkolla dhe, si na përshëndeste, lëshonte çantën në këndin e pianos, ndërsa i ati e thërriste e i puthte dorën. Unë atë e kam parë rrallë, po shpesh më shfaqet befas.

Dua me çdo kusht ta largoj befjen e saj, atë bardhësi të mjellmët e të brishtë. Por ajo më sulmon vazhdimisht dhe unë vazhdimisht mundohem ta largoj. Megjithatë silueta e saj nuk më ndahet. Ajo është rritur e si thurur në pëlhurë merimange. Jo, jo. Ajo nuk duhet krahasuar kështu. Ajo më afrohet me imazhin e një mjellme. Jo, jo. Ky është një krahasim klasikegjant. Ajo ngjan sikur është shkëputur nga një vrushkull uji i shkumëzuar, që nga çasti në çast, do të fluturojë të ulet në piano. Ajo ngjan me ato harkoret që përgatiten në Elbasan për ngritjen e kombinatit metalurgjik. Ajo i përgatit Shavul Boci dhe janë krejt të bardha e të brishta. Trashësia mesatare e tyre është 6 centimetra. Po ato peshojnë katër tonë njëra. Atëherë ajo ngjan...?!

Unë nuk duhet të mendoj më për të. Duhet patjetër ta mbyt këtë dobësi të fshehtë.

Unë duhet të vë në vend porosinë e mjekut për të pushuar. Këtë ma tha dhe shoku im i dhomës, Të pushoj në Tushemisht. Ndërsa piktori...

Ku të jetë tani L.B., që fjeti katër net në dhomën time? Ku të jetë?

U ngrita dhe zbrita shkallët krejt i hutuar.

— Sot u kthyet herët, — tha sportelistja.

— Po.

— Qëparë ju kërkoi një shoqe.

- Kush ndodhej paradite në sportel?
— Unë, se Monda është sëmurë.
— Pse iku banori i dhomës sime?
— O, ç'njeri i çuditshëm! Tha se natën kishte gërhitur dhe i vinte shumë keq që ju kishte lënë pa gjumë. Dhomë njëshe nuk kishim, kështu që iku.
— Ashtu?!
— Edhe neve na u duk njeri i mirë. Njeri shumë i mirë. E di? Emri i tij sikur është i dëgjuar. Ai...
Ishte mbrëmje dhe përjashta bulevardi gjëmonte nga zhurmat.
Ku do të takohem me njeriun e mirë L.B.?

DHEMBJA E GUÇE GËRBIT

Shikova në ndenjësen përbri, tek ishte ulur gjyshja.
Ajo s'e ngrinte kokën; e kishte lëshuar veten krejt.

Autobusi atë kohë u kthye për të ndaluar.

Zura gjyshen për krahu dhe zbritëm. (Kjo është tepër e moshuar dhe në fshat i thërresin Mëmëlale.) Një çast ndalua te sheshi i asfaltuar, përpara hyrjes së autobusit. Pak më lart fillonte udha e shtruar me kallërm. Kallërimi dukej i bërë me kurriz. Mëmëlalja qëndronte si mbi gjemba e s'donte të shikonte asgjë përçark.

— Të ikim, — tha.

Kërkonte të mbërrinte sa më shpejt në fshat.

— Gjej një nga ato verveletë e xhindosura dhe të ikim, — tha përsëri.

— Prit, — mërmërita. Ndoshta gjejmë taksì.

Unë thashë ashtu dhe u kujtova menjëherë se ajo vervele i thoshte taksisë.

— Hë, de, pa në më pafsh më!

— Të pimë nga një kafe, — i thashë.

— S'i vë në buzë lëngrat e qytetit unë.

Dolëm në një vend më tej, nën hijen e një muri të

lartë me gurë të gdhendur. Atje ishte vendqëndrimi i taksive dhe pas pak erdhi një makinë. Shoferi zbriti dhe tha.

— Jam i zënë me të tjerë, më pritni pas një ore. Ja, rrini atje te kafja.

— Mirë, — belbëzoi gjyshja.

— Po eja të pimë diçka, — i thashë.

— Unë pres këtu, ti, në daç, bridh këtë sahat, — foli ajo dhe s'më shikoi në sy. Tha ashtu dhe u kthye me kujdes të madh, sikur të trembej se mos i thyhej trupi kaba. U ul pa të keq te një bordurë, nën hijen e murit dhe më ktheu kurrizin. Kurrizin e kishte të gjatë, të përkulur dhe këmbët të shkurtra.

— Të sjell diçka për të ngrënë, — i thashë.

Ktheu pak kokën, ngriti mjekrën lart dhe më shikoi me sytë e përzbardhur. Buzët e mbledhura e të shkurtra i lëvizën.

— Kam shtëpi, — tha. — Po të mos gënjejë e të kthehet pas një sahati ky burri i aftoqinit të vogël, sossëm në shtëpi...

Kështu kishte vendosur: të hante kur të mbërrinte në shtëpi...

Me mundim të madh e bindëm që, më në fund ta merrja në Tiranë dhe ta mbanim atje dy muaj. Po erdhi dhe, sapo hyri në pallat, u tërbua nga mërzia. Tetë ditë ndenji, po na shqetësoi seriozisht. U bë grindavece, e paduruar. Kështu që ditën e tetë vendosëm ta kthenim në fshat.

I bukur ë qyteti, po i bukur ë dhe fshati im, thoshte.

Ajo trembej që ndodhej jashtë trojeve të fshatit. Se atje kishte jetuar mbi 90 vjet. Vetëm atje. Dhe tani kujtimi i fshatit, çdo çast, i fliste për një jetë të gjatë e të paturbulluar. Atje s'kishte pleqëri për të. Ndërsa qyteti e trembte.

— Këtu plakem, thoshte...

— Eee! — thirra befas kur isha larguar nga Mëmë-lalja.

Para meje, në shëtitore, ecte i vetëm Guçe Gërbi i fshatit tim. Ai ndihej i hutuar dhe lëvizte me plogështi.

— O xha Guçe! — thirra përsëri, sikur të kisha frikë se do të më zhdukej e do ta humbisja. Prania e tij atje në qytet më gëzoi pa masë. Po sepse m'u dhimbs!

U takuam. Ai diçka mërmëriti ngadalë. E kapa nga bërrylat dhe e shikova drejt. Sytë shprehnin mërzë. Dhe buzët i kishte të vrerosura. Tërë pamja e tij shprehte lodhje dhe përhapte një hidhërim therës. Unë u preva dhe përnjëherësh m'u krijua një boshllëk i madh. Isha i lodhur nga udha e gjatë dhe kisha nevojë për pak gaz, për pak argëtim. Po Guçja që i mjerë dhe mjerimi gjithmonë ka nevojë për ngushëllim. Ai nuk po qante, po diç donte të thoshte, se buzët i lëviznin. Kisha përpara njeriun e dashur të fshatit tim. Pat qenë i varfër, pat qenë partizan, kishte lindur nëntë fëmijë dhe tani punonte si rojë në zyrat e kooperativës. Është fjalëpak dhe i ndershëm. Ende s'po fliste.

— Hë! — Vetëm kaq tha. Në gojë i luhatej bishti i zi i llullës.

— Ç'të ka ndodhur. — i thashë dhe shikova përqark mos shihja fshatarë të tjerë. «Pse krejt i vetëm, Guçe Gërbi?! I vetëm dhe kaq i mjerë?!»

— Mirë je me fëmijë, mirë?

— Shumë mirë, — i thashë.

— S'foli më. Buzët iu drodhën përsëri. Kishte dhembje të madhe.

E shikova drejt. Ajo dhembje sikur e lartësonte edhe më. Siç lartësohet një vigan i plagosur.

Nga plaga, mustaqet karakteristike atë ditë sikur i qenë fishkur. Po zverdhej dhe sytë vazhdonin t'i fundoseshin.

— Hyjmë në kafe, — i thashë dhe e tërhoqa me kujdes nga bërryli.

Ai u çapit hapazvarrë.

— Humbi edhe një, — murmuriti i trishtuar.

Guçe Gërbi dukej sikur vinte nga një gjëmë. Kishte parë edhe një që kishte humbur.

Unë i thashë kamerieres të na sillte nga një krrikëll me birrë dhe pak më vonë nga një kafe.

— Për mua dy kafe, — tha Guçe Gërbi. — Vetëm dy kafe. Me pak.

Nuk fola. Porosita edhe unë vetëm kafe. Ai i piu njërën pas tjetrës dhe ngatëroi gishtërinjtë e duarve. Më shikoi drejt. Buzët donin të thoshin diçka.

Varrosëm një shok, — tha ai më në fund. — Një shok nga tanët.

— Këtej ishte, nga qyteti?

— Këtu punonte, — tha Guçe Gërbi. — Qe komunist që në ballë e gjer para dy sahatësh kur e mbuluam. Eh!

Guçe Gërbi nisi të fliste për vite të shkuara. Dëshpërimi dhe dhembja i shpien mendimet në të kaluarën.

Ai erdhi fare i vogël në batalion. Katërmbëdhjetë vjeç qe. Sot që e varosëm, i pashë pëllëmbët e verdha të ulura mbi bark, në kërthizë të tij. Më ra varomë për pak, o djalë. Atje te kyçi i dorës së majtë kishte sahatin. Një sahat që vetëtinte. Ndenja tërë natën pranë tij dhe piva shumë duhan, dhe e pashë në fytyrë ashtu të vdekur. E shikoja që ta besoja se kishte vdekur. S'më besohej. Po atë minutë që hapën kapakun e sëndukut të kuq, para se ta futnin në dhé, sytë më ranë në pëllëmbët dhe shikuam sahatin. Sahatin e verdhë që vetëtinte. Ai send akoma qe gjallë. Dhe m'u duk sikur u ngrit Qebiri. U ngrit ashtu me 14 vjeçët e vegjël me ata 14 vjeç që erdhi në batalion. Me vjeçët dhe me emrin që s'e ndërroi kurrë.

Njëri nga shokët përgjegjës këtu në rreth lexoi një letër plot fjalë të mira për Qebirin, po mendja ime fliste për atë natë të 1944-es. Ja, këtu ishte qyteti, këtu.

Kështu ishin gjermanët dhe ballistët. Ne do të bënim luftë. Duhej ta merrnim qytetin, pastaj të iknim më tej. Urdhër.

Kishim zbritur atje përtej lumit, te Balta e Bardhë, Flini, tha komandanti i batalionit. Flini, se, pa gdhirë, do bëjmë luftë.

Fjetëm ca. Pa vajtur sahati 12 i natës, më zgjuan. Gati, thanë. Mbathëm opingat dhe i lidhëm në mes. Qe behar. Fund behari apo fillimi i vjeshtës së parë, më duket.

Në qytet kishte shumë ballistë dhe gjermanë. Nuk vemi në dasmë, tha komandanti. Komandanti rron akoma. Rroftë! Po Qebiri iku. E mori një sëmundje e ligë... Kështu, nuk vemi në dasmë, tha komandanti. Ashtu thoshte ai para sulmit.

Në mesin e natës nisëm sulmin. Lufta vazhdoi gjer në mëngjes, kur zbardhi dita. Luftonim në katër pika të qytetit. Edhe ballistët luftonin si qena dhe s'hiqeshin Hakçe! Po në mëngjes hymë në qytet. Mua më kishin trembur dy plumba. Njëri në sup dhe tjetri në shpatull. E, atë gërvishtje atëherë e mora. Cuk, më dogji një çikë. Pak gjak rrodhi, po e vulosa me duhan dhe s'pikoi më. Zumë dyqind ballistë; i çarmatosëm dhe i bëmë grumbull si lopët. Oburrani, përpara! thirri përsëri komandanti i batalionit. Po gjermanët u treguan dinakë; ata qenë ngjitur në kala dhe qenë mbyllur brenda. Kështu që duhej ta medonim mirë atë punën e kalasë. Numëruam shokët. Na qenë vrarë ca. Rrethuan prefekturën dhe e hodhëm edhe atë në dorë. Tamam në atë kohë u dha urdhri që të tërhiqeshim. Të tërhiqeshim, se nga kufiri në jug po hynte një autokolonë gjermane.

U kthyer te kodra e Baltës së Bardhë. Atje prisnim dhe u përgatitëm përsëri. Me ne ishte edhe Qebiri, ky Qebir që të llafos. Qebir trimi, 14 vjeç! Ka kërryer trima me okë kjo baltë.

Dy ditë përballë qytetit që e sundonin prapë armiqtë S'na rrihej. Më në fund u vendos dhe pas mbrëmjes, kur gjermanët qenë grumbulluar në kala, sulmuam. Dy

kompani nxituan dhe hynë brenda në kala. E, unë isha komandant i kompanisë së dytë. Qebiri qe partizan në kompaninë tjetër. Qe i vogël. Erdhi në batalion dhe s'e përzunë.

Nejse, në mëngjes i tërë qyteti ishte yni. E fituam. Na mblodhën komandanti e komisari dhe na pyetën. Edhe mua më pyetën për plagët. M'i zbuloi e m'i pa komandanti. Të t'i mjekojnë, tha. Më shëron duhani, i thashë. Ai iku më tej, seç bisedoi me komisarin dhe erdhi përsëri. Kërreu një orë të florinjte dhe ma dha. Merre, tha, se je komandant kompanie dhe të duhet. Merre, tha, s'është malli im dhe s'ta dhashë me mendjen time. Hë, e mira është që të tërë të kemi orë.

Ai sahat vetëtinte.

Qe hapur dielli dhe sahati shkruante nëntë. Nuk e mbajta të lidhur të kallami i dorës, po më pëlqeu. E shikoja fshehura. Të tregonte sahatin e ditës dhe të natës. Shpikje e njeriut!

Kur u hap dielli dhe filloi të nxehtë, zbritëm në fund të qytetit. Atje, një çikë më tej, ishte një spital i vjetër. Ne po rreshtoheshim te sheshi. Nga dera e spitalit u dha një infermiere. Vinte drejt nesh. Vinte me një frymë. Ajo i mbajti këmbët pak më tej dhe kërkoi komandantin. Kur komandanti nisi të llafosej me infermieren, unë dhe një partizan shikonim sahatin e florinjte. Na dukej si i gjallë. Qe me shkronja dhe me numra. Tani sahati është dhjetë e një çikë mbi të, tha partizani. Sikur e dëgjoji zërin e tij dhe pas kaq kohe. Ehë!

Komandanti u kthye nga ne. Thirri dy partizanë dhe i dërgoi bashkë me infermieren. Neve na tha se brenda në spital, te shtretërit e të sëmurëve, ishin futur katër kapterë. Qenë shtrirë e mbuluar për t'u fshehur.

Pas ca dolën kapterët, me duart lart. Përqark, ca nga ca, u mblodhën banorë nga mëhallat e qytetit. Ata i njihnin të katër kapterët dhe folën për ta. Kishin bërë maskarallëqe dhe kishin vrarë njerëz të mirë, kishin plaçkitur. Ah, kapterët! Njëri nga banorët e qytetit, që kishte zbritur atje, s'përmbahej nga zemërimi. Ai u

zgjaste një shkop të gjatë, në majë të të cilit kishte një gjilpërë, si hosteni ynë, që të shponte kapterin e gjatë. Ah, qëni, ia bënte ai. Ah, qëni, ç'na ka punuar! Ka hequr babanë tim osh, e shpuri prapa kalasë dhe e pushkatoi. Pastaj i rropi xhepat. Dhe u kthye e piu në kabare. Ah, qëni; lërmani t'i pi gjakun!

Ulërinin banorët dhe donin t'i shqyenin. S'përmbahe-shin. Po foli komisari ynë dhe tha se atë kohë do të bëhej gjyqi partizan e do t'i jepte dënimin e merituar. Dakord? i pyeti më në fund ai. Dakord, thirrëm të gjithë.

U bë gjyqi atje në shesh. Folën shumë njerëz. Ata qenë tradhëtarë, të poshtër e brashnjarë.

Gjyqi vendosi t'i pushkatonte. I nxorën më tej, të katër, përpara skuadrës së pushkatarëve. Po atëherë, tamam atë sahat, doli nga rreshti edhe Qebiri i vogël. Ai shkoi te komandanti i batalionit, i qëndroi përballë dhe... Fol, i tha komandanti. Qebiri foli diçka sikur cicëriti. Po komandanti e mori vesh mirë se ç'kërkonte.

— Dëgjoni! — tha përsëri. — Qebiri që vështroni këtu, lutet që ta lejojmë të pushkatojë njërin nga kapterët.

Komandanti dhe komisari diç thanë me njëri-tjetrin. Pastaj komandanti ktheu kokën nga të dënuarit. Qebiri ngriti krahun dhe tregoi me gisht kapterin e gjatë me trupin e madh si lis. Ai e shikoi ftohtë Qebirin. E shikoi si qen i rrahur.

— Atë dua ta pushkatoj vetë, — tha Qebiri.

Komandanti qeshi dhe e gëzoi në majë të kokës. I trazoi leshrat dhe i rregulloi mirë kapelën e madhe.

— Po pse, o shpirt, — i tha, pse?! i luftove si trim dhe të pushë me këta sy që vrave armiq.

— Aman, komandant! — iu lut me të përtypur Qebiri.

— Aman! — bëri edhe komandanti me zë të lartë dhe e mbështolli me krahët e gjatë. E puti në ballë. Qebiri dukej foshnjë para tij. Foshnjë qe.

— Ta pushkatojë Qebiri — thirrën partizanët.

U llafosën prapë me zë të ulët komandanti e komi-sari.

E nxorën kapterin e gjatë e të bëshëm veç. Iu afrua Qebiri. Ndaloi çapet dhe e shikoi drejt. Fytyra e tij e vogël si kopsh i lulëzuar u err dhe buzët iu drodhën, iu holluan e iu zbardhën. Kapteri s'e shikonte në sy. Na dukej vërtet çudi! Kapteri, dy metra i lartë, i gjerë e si i shtrembëruar nga shëndeti i tepërt, dhe Qebiri, një pëllëmbë fëmijë. Dhe s'di pse, po donim t'i shikonim të dy ashtu në këmbë, ballë njëri-jatrit. Dhe heshtnim. Eh, Qebiri djali! Qebiri pastaj kontrolloi dyfekun dhe i vuri fi-shekë. E kaloi armën në dorën e djathtë. Ne prisnim ta ngrinte e të qëllonte, po ai e shikonte mu në surrat. Pastaj eci përpara drejt kapterit. Iu qas një çap afër. Ngriti lart mjekrën, e shikoi, u ngrit në majë të gishtave dhe e pështyu.

Komandanti ynë u çudit, po menjëherë i ulëriu kap-terit, që të mos lëvizte e të mos bënte gëk. Thirrëm të gjithë. Si në shfaqje. Kapteri lëvizi vetëm qafën, shi-koi shtrëmbër dhe u mundua të fshinte pështymën me bërryl. Qebiri u tërhoq me të shpejtë dhe ngriti dyfe-kun. Qëlloi dy herë. Një plumb i prishi surranë kap-terit dhe tjetri i hapi një vërë në zverk. Ai u kthye dhe ra. Qebiri i pa surranë të prishur dhe u kthye nga ne.

Mbasi skuadra e pushkatarëve lau hesapet edhe me ata të tre që kishin mbetur dhe si i mbuluam me baltë, ikëm. Ashtu qe urdhri.

Nata na pllakosi te Pylli i Mullirit, atje në të shka-rën e malit. Me natën erdhi edhe shiu. Qe një shi i shtru-ar, që të ndillte gjumë. I tërë batalioni do të flinte në pyll U ula. Pranë më erdhi ai partizani sevdalli dhe tha

të shihnim sa qe sahati. E kërreva nga xhepi. Ai ndezi shkrepësen. Po sahati vetëtinte vetë. Shkronjat e numrat dukeshin si zjarre të vogla dhe fusha e tij si jonxhishhtë. U bëra fare si i vogël atë minutë dhe m'u kujtua fshati, dhe m'u fanit fëmijëria. Në behar, në netët e verës, ne djemtë e mëhallës u hipnim kuajve dhe zbritnim anës lumit, nëpër luadhe, që të kullotnim. Bëheshim në grupe dhe ndiznim zjarre, dhe përralloseshim me fjalët e me mendjen tonë gjer në të thyer të natës së thellë.

Ja, ato kujtova atë natë kur shihja atë sahat të huaj, atë fushë, ata numra dhe ato shkronja. Ndërsa partizani merakçi vazhdonte edhe ai të shikonte i humbur. Ku di unë ç'i thoshte mendja atij atë kohë! Mbase... Pas bëryllit tim zgjati kokën Qebiri.

— E shikon? — i thashë.

Unë e Qebiri u mbështollëm bashkë me një gunë të vjetër. Mua më lidhte gjumi menjëherë. Edhe sot e kësaj dite, po i thashë vetes fli, hop bie në gjumë.

Po Qebiri rrotullohej e s'gjente rehat.

— Ç'ke? — i thashë. Po ai nuk foli. Heshte. Pastaj gërc u rrotullua përsëri.

U menduaç me vete.

— O Qebir! — i foli. Ai, pas pak, zbuloi kokën. — Pse ngule këmbë sot që ta vritje atë kapterin e gjatë? — i thashë.

— Se qe tradhtar, — tha.

— Po edhe ata tre të tjerët tradhëtarë qenë!

— Ai qe më tradhtar, — tha.

— Pse?!... È?!...

U ndodha ngushtë në atë muhabet me atë djalë dhe s'dija si të bëja. E ai gulçonte. Kur papritur, nisi të qante. Qante fshehur, me kokën mbuluar nën gunë. U shqetësova shumë.

— Pse qan?! — i thashë. — Pse?!

— Ai qe dajkua im, — mërmëriti djali.

— Qysh?! Dajkua yt?!

— Èhè!

— Dhe... tani të vjen keq, të dhimbet?!

— Jo, thirri ai. — Jo. Më vjen ligisht që s'mundem ta vras dy herë. A kupton? Qe tradhtar. E pe ç'flitnin dhe ç'bënin njerëzit e mirë për të? Donin ta shqyenin, ta shponin me gjilpëra. Se ka bërë keq, ka vrarë e ka plaçkitur. Pse... pse s'erdhi me udhën e popullit, pse s'doli partizan?... Ah!

Hungëriu djali sikur të këpuste mishtë e vet. Edhe unë qava, djalo. Qava. E urren tradhëtinë njeriu i mirë. S'ka më keq. «Që s'e vras dot dy herë», tha Qebiri. Dhe kështu m'u bë edhe më i dashur e i mirë Qebiri.

E mbështolla në gjoks, sikur doja ta futja brenda në xhan atë djalë. Ta mbushja xhanin me ndershmëri nga e tija. Dhe ashtu dremitëm. Sa herë, natën në gjumë, ai kërciti nofullat.

U zgjova shpejt. Vajta te komandanti dhe ia thashë, por ata e dinin. U ktheva. Po flinte. I tërhoqa dorën e mëngjër dhe i lidha sahatin sipër kyçit. Plakë e huaj, po hynte në punë. Populli kudo i bën gjërat të bukura. Edhe ai sahat qe i bukur. Edhe Qebiri qe stisur i bukur.

Luftoi një luftë të tërë dhe plumbi s'e mori. Cuk. Tani që kërceu në të dyzetetetat, i ra sëmundja e ligë dhe e mori. Ç'ti bësh natyrës! Ç'ti bësh, o djalë!

Po rrojti i mirë, s'lojti. Aaa, për kokën e Qebirit qe. Më dhanë lajmin se mbaroi Qebiri. Erdha mbrëmë këtu.

Sot e mbuluam.

Kur e hapën kapakun e sëndukut të kuq, para se ta futnin në dhë, sytë e mi të vjetër përsëri ranë, si për shejtan. te pëllëmbët e verdha të ulura mbi kërthizë. Te kyçi i dorës ishte sahati. Sahati i florinjte i luftës. M'u duk sikur lëvizti Qebiri atje në fushën e sahatit. Qebiri 14 vjeç. Dhe mendja nisi të fliste për atë ditë dhe atë natë të 1944-ës. Dhe shikoja ashtu i humbur lëvizjet, luftën dhe dëgjoja zërin e Qebirit... U plakç, djaloo! Ç'e bëre Mëmëlalen? Na ka ndihur në luftë. Dha dhe burrin për vatan. Dha. U plakëm! Dhe sikur s'kam fuqi të ha-

roj Qebirin. Qe me nder. Harrohet nderi? E harrove, ike rrokullimë, të mori lumi pakuptuar. Nën këtë qiell ka të mira, po Qebiri s'është. S'është... Epo, natyra...

Guçe Gërbi mbushi llullën dhe e nderi. Në gojë nisi përsëri t'i luhatej bishti i zi i llullës dhe lart fytyra dhe koka u bënë me tym. Deshi të fliste edhe diçka tjetër:

— Eh, Qebir, — mërmëriti Guçe Gërbi dhe iu drodhën noçkat e gishtit tregues.

Dikush trokiti te xhami i kafes. Përjashta u projektua koka e një burri.

Ishte shoferi i taksisë.

Dolëm. Dielli po binte. Në qiell u dukën ca re të ulëta të shpupurishura. Nga perëndimi nxitonte një re e madhe, e cila duhej të kishte derdhur një pjesë të shiut në ara e pyje të tjera, diku gjatë.

Pranë Mëmëlales kishte ndaluar taksia. Mëmëla-laja na pa dhe ndoshta, ngaqë atje në qytet shikoi Guçe Gërbin e fshatit të saj, fytyra i shprehu padurim. Kërkonte diçka me sy, me fytyrë, me tërë qenien.

Brenda në makinë ajo i zgjati përsëri dorën Guçe Gërbit. Nisi ta pyeste me fjalë të ngrohta dhe, duke folur, i shndriste një dashuri e veçantë dhe një buzëqeshje e gëzueshme.

Po shkonim në fshat. Kur arritëm, Mëmëlaja thirri:

— Ja!

Ajo e ngriti buzën si sqep dhe më në fund iu duk buzëqeshja. Sikur për të fillonte dita.

Këtë po, këtë mund ta arrijë njeriu ynë: të dojë vendlindjen. Kjo s'është dashuri primitive. Përkund-drazi.

— Ja! — thirri përsëri ajo.

Ata u kthyen të dy njëherësh. Dielli i kuq, i dalë për një çast nga retë, shtangu në degën e njomë të një lofate. Në udhë cicërinte një fëmijë i bukur kokëkuq.

— E humbëm edhe Qebirin, — mërmëriti me vete Guçe Gërbi.

Tani nën këmbët e tij ishte balta e dashur që e gëzonte dhe ai ngazëllim i kujtoi njeriun e dashur.

— E humbëm! — mërmëriti përsëri fshehur, me dhembje.

Ky ishte një zakon i lashtë: E humbëm, thoshin luftëtarët e gardës së vjetër.

Guçe Gërbi zbriti dhe flokët iu trazuan sikur t'i kujtonin lodhjen e luftërave.

Tani, sigurisht, ky do të qetësohet, mendova. Sepse këtu, mes njerëzve të tjerë, këtu midis këtyre çative dhe kopshteve do të gjejë ngjarje më të gëzueshme në jetë dhe në kujtimet e tij e do ta shuajë dhembjen.

Kurse Mëmëlalja gjeti, më në fund, pas tetë ditësh, zinxhirët e fortë me të cilët është lidhur pas atij trualli. Kishte humbur fuqinë, fuqinë fizike, po jo dashurinë.

P È R M B A J T J A

Nga libri «NJË BISEDË NË MESNATË», 1971	3
Djaloshi që donte kuajt	5
Burri i vogël që... ..	23
Nga libri «DADEMADHJA», 1976,	
Anilka	41
Po ti si thua?	62
Mos e përplasni çizmen!	74
Puravel Duka	85
Pasi dëgjova këngën e një gruaje	110
Dademadhja	137
Nga libri «ERA E UDHËVE», 1981	
I bukuri im	197
Fshatari Doke	254
Qeni i Maze Llakaturës	276
Qebiri	288
Njeriu i punëve të mira	305
Dhembja e Guçe Gërbit	323